



Duke dëgjuar viktimat

Përvojat e identifikimit, të kthimit
dhe të ndihmës në Evropën Juglindore

Duke dëgjuar viktimat

Përvojat e identifikimit, të kthimit
dhe të ndihmës në Evropën Juglindore

Shkruar nga:

Rebecca Surtees
Instituti NEXUS i Luftës Kundër Trafikimit Njerëzor
Vjenë, Austri

Grupi kërkimor:

Marija Babovic, Genta Bibo, Milica Djordjević, Viorelia Rusu, Rebecca Surtees dhe Diana Tudorache

Grupi i ICMPD:

Sonja Busch, Mariyana Radeva, Danijela Srbic dhe Elisa Trossero

E drejta e autorit:

ICMPD (Qendra Ndërkombëtare e Zhvillimit të Politikës së Migrimin), 2007

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, kopjohet apo transmetohet në asnjë lloj forme apo mjeti, elektronik apo mekanik, përfshirë fotokopjimin, regjistrimin në një sistem kërkimi apo informimi, pa lejen e zotëruesve të së drejtës së autorit.

ICMPD (Qendra Ndërkombëtare e Zhvillimit të Politikës së Migrimin)

Gonzagagasse 1, 5th Floor

Vienna, Austria

A-1010

www.icmpd.org

Ky studim u ndërmor si pjesë e programit rajonal të ICMPD-së, të financuar nga USAID në mbështetje të ndërtimit të mekanizmave gjithëpërfshirës, efektive dhe të institucionalizuar transnacionale të referimit (MTR) për viktimat e trafikimit në Evropën Juglindore.

Pikëpamjet e autorëve, të shprehur në këtë botim, nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e ICMPD-s, të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar (USAID), apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Paraqitja grafike nga: ANH & Florin Paraschiv

Shtypur dhe lidhur nga: OstWest Media

ISBN 3-900411-10-7

Parathënie

Vitet e fundit, luftimi i trafikimit të qenieve njerëzore ka qenë vazhdimisht në axhendën e administratave kombëtare dhe të aktorëve ndërkombëtarë. Janë kryer një sërë studimesh për të hartëzuar përmasat e këtij problemi, si një aspekt i krimit të organizuar ose i migrimit të parregullt, dhe janë projektuar një numër programesh, pikërisht për të trajtuar nevojat që kanë viktimat dhe që sot vuajnë pasojat e këtij krimi. Megjithatë, pjesa më e madhe e politikave dhe e praktikave të vëna në jetë, si dhe studimet me karakter më teorik, thjesht diskutojnë gjendjen aktuale të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar, merren me nevojat e ndërtimit të kapaciteteve të një grupi specifik, ose përqendrohen mbi masat parandaluese, si për shembull mbi ato që lidhen me rritjen e ndërgjegjësimit. Studimi *“Duke dëgjuar viktimat: përvojat e identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës në Evropën Juglindore”* ofron një përjasje të ndryshme ndaj problemit të trafikimit. Duke dëgjuar vetë viktimat, duke ua njohur dhe dhënë përparësinë e duhur “nevojave që kanë dhe që shprehen nga ato vetë”, ky studim përpiqet të nxjerrë në pah dilemat e ndryshme, me të cilat përballen viktimat e trafikimit. Ai shpjegon se, nuk është e mundur të jepet një zgjidhje e përgjithshme për të gjitha këto nevoja, por duhen ndërmarrë ndërhyrje të përzgjedhura e të shënjestruara në nivele të ndryshme.

Studimi pasqyron një situatë dinamike në fushën e trafikimit që realizohet në rajonin e Evropës Juglindore. Ai përpiqet të kthjellojë paqartësitë dhe

ndërlikimet që shoqerojnë trafikimin e qenieve njerëzore, me qëllim që t'u paraprihet zgjidhjeve dhe masave policore të njëanshme. Studimi nuk përmban ndonjë katalog rekomandimesh, por ofron pika ku mund të ndalojnë të gjithë aktorët e përfshirë në anti-trafikim. Duke përshkruar, në një rën anë, angazhimin e institucioneve dhe të organizatave të ndryshme qeveritare dhe jo-qeveritare në procesin e identifikimit, të ndihmës dhe të referimit të viktimave të trafikimit, studimi jep sugjerime mbi rregullimet dhe përmirësimet e mundshme të rolit që duhet të luajë secili nga këta aktorë të anti-trafikimit. Nëpërmjet zërit të vetë viktimave, formulohen sugjerime të mundshme në adresë të aktorëve shtetërorë dhe jo-shtetërorë. Ky është veçanërisht rasti në fushën e rehabilitimit dhe të ri-integrimit, pas kthimit të mundshëm në vendin e origjinës, që zbulon një spektër të gjërë mundësish për bashkëpunim dypalësh dhe shumëpalësh.

Ky studim është pjesë përbërëse e *Programit në mbështetje të ndërtimit të Mekanizmave Transnacionalë të Referimit (MTR) për personat e trafikuar në Evropën Juglindore*, i vënë në jetë nga ICMPD dhe i mbështetur financiarisht nga USAID. Duke u ngritur mbi mekanizmat kombëtarë të referimit për viktimat e trafikimit, që ekzistojnë tashmë ose që janë duke u krijuar në një numër vendesh të rajonit, programi i MTR-s kërkon të përpunojë procedura operative standarde dhe udhëzime për referimin e viktimave të trafikimit.

Gjetjet e këtij raporti shërbejnë si bazë për hartimin e "*Udhëzimeve për Mekanizmin Transnacional të Referimit për Viktimat e Trafikimit*". Duke inkuadruar praktikat e mira të vendeve të Evropës Juglindore dhe duke i lidhur ato me përvojat e vendeve të destinacionit, Udhëzimet ofrojnë një model në ndihmë të një reagimi gjithëpërfshirës ndaj nevojave të viktimave të trafikimit.

Ne besojmë se, ky raport do të jetë një mjet i dobishëm për të kuptuar nevojat e viktimave të trafikimit dhe për të projektuar politika efektive anti-trafikim. Studimi tregon sesa e rëndësishme është që të lidhet çështja e trafikimit të qenieve njerëzore me problemet në fushat e tjera të rëndësishme si, në fushën e migrimit ekonomik, të shfrytëzimit të punës, të integritetit dhe dhunës në familje. Pra, studimi bën thirrje për ndërhyrje të caktuara, të cilat do të duhet të kryhen në nivele të ndryshme dhe do të përforcojnë bashkëpunimin midis të gjithë aktorëve të përfshirë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë.



Gottfried Zürcher
Drejtor i Përgjithshëm, ICMPD

Falenderime

Ky studim është pjesë e një programi më të madh, të financuar nga USAID-i dhe të menaxhuar nga ICMPD-ja mbi Mekanizmat Transnacionalë të Referimit (MTR) për personat e trafikuar në Evropën Juglindore (SEE). Unë do të dëshiroja që të falenderojë fillimisht USAID-in për gatishmërinë që treguan për të mbështetur financiarisht këtë komponent studimor të programit, i cili përqendrohet mbi nevojat e viktimave, siç vihen në pah nga vetë ato, mbi problemet që ndeshin në procesin e identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës që iu ofrohet atyre. Gjithashtu, do të dëshiroja të falenderojë ICMPD-n për nxitjen dhe mbështetjen që i dhanë këtij raporti vlerësimi, pjesë e përpjekjeve për identifikimin e çështjeve të ngritura nga vetë personat e trafikuar, dhe si një hap i parë për gjetjen e zgjidhjeve.

Ishin të shumtë ata që kontribuan për këtë studim. Para së gjithash, do të dëshiroja të vija në pah të gjithë personat e trafikuar, të cilët ofruan me zemërgjërësi kohën e tyre të vyer për t'u intervistuar në kuadrin e këtij studimi. Përvojat e tyre vetjake në lidhje me mënyrën e identifikimit, të kthimit dhe të marrjes së ndihmës, formojnë themelin e këtij raporti, ato ishin thelbësore për të kuptuar situatën në rajon dhe për të hartuar rekomandimet. Unë shpreh falenderimet e mia të ngrohta për dëshirën, sinqeritetin dhe kurajon që treguan këta persona gjatë diskutimit të çështjeve shumë të vështira dhe krejt vetjake të tyre.

Përveç kësaj, një numër ofruesish shërbimesh në rajon treguan mbështetjen e tyre ndaj projektit dhe dëshirën për të lehtësuar kontaktet me përfituesit e shërbimeve të tyre. Ndërkohë që ne nuk arritëm të intervistojmë përfituesit e të gjitha organizatave që punojnë në terren, unë do të dëshiroja të falenderoj ata që na ndihmuan dhe na mbështetën në punën tonë. Këtu përfshihen, në Shqipëri – IOM Tirana, Different and Equal, Gjirokastra Community Centre (GCC), Vatra, Tjetër Vizion, Qendra Kombëtare e Pritjes (NRC) dhe Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikut (QKPVT); në Bosnje-Hercegovinë – IOM Sarajevo, IFS dhe La Strada; në Moldavi – Qendra Ndërkombëtare për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Grave “La Strada”, IOM Chisinau, Interaction, Compasiune dhe Qendra Kombëtare mbi Parandalimin e Abuzimit të Fëmijës (The National Centre on Child Abuse Prevention); në Rumani – Young Generation (Brezi i Ri), Adpare, Reaching Out, Save the Children, Conexiuni, Betania dhe IOM Bukuresht; dhe në Serbi – Atina, Counselling against Family Violence (CAFV) (Këshillim kundër Dhunës Familjare) dhe IOM Beograd. Përveç këtyre, Divizioni i Kundër-trafikimit i IOM, në Gjenevë, mbështeti punën kërkimore dhe lehtësoi kontaktet me Misionet e saj në terren, të cilët ofruan ndihmën e tyre. Fakti që na pritën kaq shumë organizata dhe na lehtësuan kontaktet, flet për një nivel transparence, i cili është jetësor për punën në sektorin social, si edhe për angazhimin e tyre në përmirësim të nivelit të shërbimeve për personat e trafikuar. Duke i inkurajuar përfituesit e shërbimeve të tyre që, të flisnin hapur rreth problemeve me të cilat përballeshin, këto organizata lehtësuan procesin e shkëmbimit të një informacioni të rëndësishëm dhe të parë nga këndvështimi i viktimës. U intervistuan një numër organizatash të përfshira në luftën kundër trafikimit, të cilat dhanë ndihmesën e tyre, na kushtuan kohën dhe ndanë përvojat e mendimet e tyre në ndihmë të këtij studimi, gjë që ne e vlerësojmë së tepërmi duke shprehur falenderimet tona.

Disa individë meritojnë falenderime të veçanta për mbështetjen dhe ndihmën që dhanë. Falenderimet e mia shkojnë për grupin kundër-trafikim të ICMPD-së, për mbështetjen e tyre të vazhdueshme – si logjistike ashtu dhe materiale – gjatë studimeve në terren dhe gjatë hartimit e përpunimit të vetë procesit. Në veçanti, falenderoj Sonja Busch, Danijela Srbić, Elisa Trossero, Mariyana Radeva, Brigitte Stevkovski dhe Galina Vadaskaya në Vjenë, si dhe nëpunëset e ndërlidhjes në secilin nga vendet e projektit – Tamara Agolli (Shqipëri), Ajli Bahtijaragić (BH), Melita Gruevska Graham (Maqedoni) Tatiana Fomina (Moldavi), Madalina Manea (Rumani) dhe Irma Lutovac (Serbi). Intervistat u përkthyen nga një grup përkthyesish të talentuar, që punuan

nën afate shumë të shtrënguara. Falenderoj Alina Legcobit, Eugen Filip, Julian Hasa, Irena Rushaj dhe Milena Marković.

Po ashtu, një numër personash rishikuan dhe kontribuan për raportin me sugjerimet e tyre të dobishme, si Sonja Busch, Danijela Srbić dhe Elisa Trossero (ICMPD), Ruth Pojman (USAID), Anelise Araujo (OSCE AT Assistance Unit), Maria Antonia di Maio (Save the Children), Marija Babovic, Diana Tudorache, Viorelia Partas dhe Ruth Rosenberg. Falenderoj, gjithashtu, Stephen Warnath, Drejtorin Ekzekutiv të Institutit Nexus, i cili mbështeti fort studimin kërkimor, duke rishikuar projekt-raportin gjatë fazave të ndryshme të hartimit të tij, dhe duke dhënë, si përhersë, kontributin e tij të vlefshëm.

Së fundi, dëshiroj të falenderojë singërisht grupin kërkimor – Marija Babovic, Diana Tudorache, Genta Bibo, Viorelia Rusu dhe Milica Djordjević – me të cilat ishte një kënaqësi të punojë, dhe të cilat, pavarësisht nga koha e kufizuar, udhëtimet e gjata dhe problemet e dimrit, mblodhën një informacion të paçmueshëm rreth përvojave të identifikimit, referimit dhe të ndihmës së ofruar personave të trafikuar.

Rebecca Surtees

Studiuese
Institutit NEXUS për Luftimin e Trafikimit Njerëzor
Vjenë, Austri

Pasqyra e përmbajtjes

Parathënie.....	3
Falenderime	5
Përmbledhje ekzekutive	10
Akronimet dhe shkurtime.....	19
1. Hyrje	21
2. Kuadri studimor	25
2.1. Sfondi i projektit dhe objektivat studimore	25
2.2. Njohuritë ekzistuese dhe mangësitë	27
2.3. Metodologjia studimore dhe mbledhja e të dhënave	29
2.4. Probleme të etikës.....	34
2.5. Përkufizimet dhe terminologjia e përdorur.....	36
3. Trafikimi dhe anti-trafikimi në Evropën Juglindore	39
3.1. Kush janë viktimat e trafikimit?	39
3.2. Përpjekjet anti-trafikim – identifikimi, kthimi dhe ndihma	43
3.2.1. Procedurat e identifikimit	43
3.2.3. Ndihma dhe mbrojtja.....	47

3.2.2. Procedurat e kthimit dhe të referimit.....	45
3.2.4. Sistemet dhe mekanizmat kombëtarë të referimit.....	49
4. Identifikimi i përvojave të personave të trafikuar	51
4.1. Si ishin identifikuar viktimat.....	51
4.2. Çfarë mendonin personat e trafikuar dhe si e përjetuan procesin e identifikimit	58
4.3. Problemet dhe pengesat në procesin e identifikimit.....	73
4.4. Përmbledhje	106
5. Përvojat e kthimit dhe të referimit të personave të trafikuar	108
5.1. Si ktheheshin personat e trafikuar	109
5.2. Si ndiheshin personat e trafikuar dhe si e përjetuan procesin e kthimit dhe të referimit.....	111
5.3. Problemet në procesin e kthimit dhe të referimit	117
5.4. Përmbledhje	136
6. Përvojat e ndihmës dhe të mbrojtjes së personave të trafikuar	137
6.1. Si ndihmoheshin dhe mbroheshin personat e trafikuar	138
6.2. Si ndiheshin viktimat dhe e përjetonin fazën e ndihmës dhe të mbrojtjes	138
6.3. Çështjet dhe pengesat në procesin e ndihmës dhe të mbrojtjes – vendet e destinacionit, të tranzitit dhe të origjinës.....	158
6.4. Përmbledhje	236
7. Disa mendime dhe përfundime	238
Referencat e cituara.....	247

Përmbledhje ekzekutive

Ndërkohë që një numër studimesh dhe dokumentesh kanë marrë në shqyrtim procesin e identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës për personat e trafikuar, vëmendja ka qenë drejtuar fillimisht drejt kuadrit ligjor dhe administrativ brenda të cilëve realizohet identifikimi, kthimi dhe ndihma. Këto përmbajnë parimet dhe udhëzimet mbi procesin e identifikimit dhe të ndihmës, kuadrin legjislativ dhe studimet e kuadrit të ndihmës, përfshirë praktikën e mira. Shumë më të pakta kanë qenë studimet mbi mënyrën sesi vetë viktimat e përceptojnë dhe e përjetojnë jetën e tyre pas-trafikimit, dhe sesi i vlerësojnë e i gjykojnë ata këto ndërhyrje dhe ndihma. Ky raport hartëzon – parë nga këndvështrimi i viktimës – trajektoren e plotë të ndërhyrjeve që realizohen nga aktorët e anti-trafikimit, që nga identifikimi, kthimi dhe referimi, deri tek fazat e ndryshme të ofrimit të ndihmës dhe të mbrojtjes. Ndërkohë që ndërhyrjet anti-trafikim janë, pa asnjë dyshim, jetësore për rikuperimin e personave të trafikuar, viktimat raportuan pasoja e përvoja pozitive, por dhe negative nëpër fazat e ndryshme të ndërhyrjes, informacion thelbësor ky për përpjekjet që ndërmerren në vijimësi nga sistemet e referimit transnacional dhe të ndihmës për personat e trafikuar.

Ky studim nuk është një raport vlerësimi. Ai nuk përpiqet të vlerësojë apo shqyrtojë punën e anti-trafikimit të vendeve përfituese, të programeve apo organizatave dhe njeh punën e rëndësishme që po kryhet nga aktorët e anti-

trafikimit në të gjitha fazat e ndërhyrjes. Studimi është më tepër një konsideratë mbi si është kuptuar kuadri ekzistues i identifikimit, i referimit dhe i ndihmës, i përceptuar dhe i përjetuar nga viktimat e intervistuar. Këto viktimat formonin një grup me përbërje të ndryshme, i trafikuar në drejtim të, nëpërmjet dhe nga Evropa Juglindore (SEE), si dhe në një numër të madh vendesh destinacioni. Edhe përvojat e tyre të trafikimit, të identifikimit dhe të ndihmës ishin, po ashtu, nga më të ndryshmet. Shpresohet që, duke dëgjuar viktimat dhe duke paraqitur nevojat e tyre, të formuluar nga ato vetë, do të jetë e mundur që të ndihmohen dhe mbështeten organizatat dhe aktorët e shumtë në punën që bëjnë kundër trafikimit në rajonin e SEE.

Në lidhje me fazën e identifikimit, viktimat u identifikuan nga një numër i madh aktorësh të luftës kundër trafikimit (policia, nëpunësit në terren, personeli i ambasadave, OJQ-të, organizatat ndërkombëtare (ON-të), punonjësit socialë, klientët dhe vetë viktimat), si dhe personat e profesionistët që nuk përfshihen, përgjithësisht, në identifikim, si transportuesit, qytetarët privatë apo organizatat fetare. Në të njëjtën kohë, u vërtetuan raste të humbjes së mundësive të identifikimit. Për shumë nga viktimat e intervistuar, përvoja e procesit të identifikimit ishte një përvojë e lodhshme, e mbushur me shumë emocione dhe reagime. Viktimat folën si për reagime pozitive ashtu dhe negative ndaj personelit identifikues, gjatë fazave të ndryshme të procesit të identifikimit. Nuk ishte e rrallë, për shembull, që viktimat të ndiheshin të lehtësuara kur identifikoheshin, por dhe të frikësuara e me plot dyshime për aktorin identifikues. Po ashtu, nuk ishin të rralla rastet kur ndjesitë negative (frika dhe dyshimi) i lëshonin vendin ndjesisë së lehtësimit, sapo viktimat ndihej e/i sigurt dhe arrinte t'u besonte personave identifikues. Përveç përshkrimit të ndjesive, viktimat folën edhe për probleme e çështje me të cilat u përballën gjatë procesit të identifikimit, si në vendin e lindjes, ashtu dhe jashtë tij. Këto çështje kishin të bënin me mundësinë e qasjes së viktimës tek një informacion i plotë dhe gjithëpërfshirës rreth situatës dhe opsioneve që mund të kishin gjatë identifikimit; me aftësitë e mangëta të disa aktorëve identifikues; me përvojat e një trajtimi të kujdesshëm, por dhe të një trajtimi mospërfillës gjatë identifikimit; me disa përvoja të marrjes në pyetje dhe të trajtimit si person i ndaluar, në vend të identifikimit si person i trafikuar; me disa raste korrupsioni midis radhëve të aktorëve identifikues; me raste të keqtrajtimit dhe të moskokëçarjes; me çështje që lidheshin me pengesat gjuhësore në procesin e identifikimit; me faktin që identifikimi kryhej në disa rrethana të pafavorsme për disa viktimat; me rastet kur shumë viktimat nuk dinin kujt t'i drejtoheshin për të kërkuar ndihmë; dhe me probleme që lidheshin me viktimat e trafikimit që nuk dëshironin të identifikoheshin.

Procesi i kthimit – kur trajtohet me korrektësi – parashikon një numër hapash të projektuar për të siguruar një kthim të sigurt dhe dinjitoz të çdo viktime individuale. Idealisht, kthimi duhet të nënkuptojë përgatitjen e dokumenteve; marrëveshjet e udhëtimit; informimin e personave të trafikuar rreth hapave që do të ndërmerren gjatë procesit të kthimit dhe mbi opsionet e ndihmës në vendin e origjinës; shqyrtimin e rrezikut (për tranzitin dhe për vendin e origjinës); komunikimin dhe bashkërendimin midis vendeve të origjinës dhe të tranzitit/të destinacionit; transportimin dhe procesin e mbështetur të udhëtimit (përfshirë kthimin e shoqëruar, sipas nevojës dhe ndihmën në tranzit); pritjen dhe referimin pas mbërritjes; dhe transportimin brenda vendit të origjinës. Një procedurë e pasigurt kthimi paraqet rreziqe për viktimat, gjë që në rastet më ekstreme, mund të rezultojnë edhe në (ri)trafikim. Personat e trafikuar, të cilët u intervistuan për qëllimin e këtij studimi, ishin kthyer në shtëpi në mënyra të ndryshme – disa të ndihmuar, por shumë të tjerë të pandihmuar. Kur u bisedua në lidhje me kthimin e tyre në shtëpi, viktimat shfaqën një mori emocione dhe reagimesh. Shumë nga këto emocione ishin negative – frikë, ankth, zhgënjim, lodhje mendore dhe pasiguri, nervozizëm dhe hutim – dhe vinin jo vetëm si pasojë e procesit të kthimit si i tillë, por edhe nga fakti sesi ishte administruar ky proces. Në të njëjtën kohë, viktimat folën edhe për emocione pozitive që lidheshin me kthimin e tyre, përfshirë ndjenjën e padurimit dhe të lehtësimit, si dhe ndjesitë e të qenit të sigurt dhe të mbështetura. Përveç kësaj, siç ishte rasti në fazën e identifikimit, shumë viktima përballeshin me emocione të vetvetishme dhe shpesh kundërthënëse. Për shembull, shumë nga viktimat ishin të lumtura dhe të lehtësuara rreth procesit të kthimit. Ishin të lehtësuara, sepse do të ishin larg duarve të trafikantëve të tyre, të lumtura se po largoheshin nga vendi i shfrytëzimit të tyre, të emocionuara se do të takonin njerëzit e familjes dhe të gëzuara se do të ktheheshin në shtëpitë e tyre. Gjithsesi, nuk ishin të rralla rastet, kur kjo lumturi shoqërohej me emocione negative si, me frikën e ndeshjes me trafikantin e tyre ose me nervozizmin mbi pasigurinë sesi do të priteshin nëpër familjet e tyre. Procesi i kthimit dhe i referimit nënkupton një numër hapash që duhen ndërmarrë për të siguruar kthim të sigurt dhe të denjë për personat e trafikuar. Në ato raste kur këto hapa nuk ndërmerreshin plotësisht, si duhet apo me ndjeshmërinë e nevojshme, viktimat përballeshin me probleme gjatë procesit të kthimit dhe të referimit. Personat e trafikuar ndesheshin me një sërë problemesh, të cilat kishin lindur që në fazën e parnisjes, gjatë fazës së tranzitimit dhe/ose me mbërritjen në shtëpitë e tyre. Viktimat përmendën si problem të kësaj natyre mungesën e përgjithshme të një informacioni të plotë dhe të gjithanshëm mbi procesin e kthimit dhe të referimit; transportimin në kthim,

i cili ishte shumë i ngjashëm me transportimin që kishin patur kur ishin trafikuar; rëndësinë e kthimit të pidentifikueshëm dhe të ndihmuar nga aktorët përkatës; problemet që kishin patur gjatë tranzitit, si për shëmbull marrja në pyetje dhe trajtimi i papërshtatshëm nga ana e autoriteteve; vonesat për kthimin e tyre në vendet e tyre të origjinës; moskryerjen e një shqyrtimi të saktë dhe të përshtatshëm të rrezikut dhe të sigurisë; si dhe përvojat e tyre gjatë pranimit dhe referimit në vendin e tyre të origjinës.

Ofrimi i një ndihme dhe mbrojtjeje të përshtatshme dhe të nevojshme personave të trafikuar është thelbësor për stabilizimin e tyre të menjëhershëm, drejt një rikuperimi afat-gjatë dhe ri-integrimit në shoqëri. Ndhima dhe mbrojtja ofrohet në vendet e tranzitit, të destinacionit dhe të origjinës, dhe studimi mori në shqyrtim ndërhyrjet/masat e disponueshme për viktimat në të gjitha vendet nën studim. Personat e trafikuar u intervistuan në fazat e ndryshme të ndihmës – në reagimin e parë emergjent, si dhe gjatë gjithë kohës së dhënies së ndihmës deri në ri-integrimin e tyre më afat-gjatë. Pavarësisht nga dallimet midis vetë viktimave dhe përvojave që kishin kaluar, në pah dolën disa tema dhe çështje të përhershme, kur viktimave u bëheshin pyetje mbi si e shikonin ato, apo si e kuptonin dhe përjetonin ndihmën dhe mbrojtjen e ofruar. Personat e trafikuar, që u intervistuan, përshkruan emocione negative – që nga frika deri te tronditja që kishin pësuar dhe hutimi që ndjenin në vetvete, që nga dyshimi deri te lodhja mendore dhe turpi. Por, me rëndësi për t'u theksuar është se, në këtë fazë të jetës së tyre të pas-trafikimit ato folën edhe për ndijime pozitive, më së shumti për ndjenjën e qetësisë dhe të sigurisë, për ndjenjën e të qënurit bashkë më të tjerët dhe jo vetëm, për një lehtësim dhe mirënjohje. Në shumë raste të tjera, viktimat folën edhe për ndjenja negative në fazat fillestare të ndihmës, kur kishin më pak besim dhe jo shumë të qeta, por me kalimin e kohës ndjenjat u transformuan në ndijime më pozitive, sidomos kur kishin fituar siguri dhe vetëbesim. Problemet e vëna në dukje nga viktimat në lidhje me fazën e ndihmës dhe të mbrojtjes ishin të panumurta dhe të ndryshme, që preknin një gamë të gjërë çështjesh që lidheshin me këtë fazë. Këtu përfshiheshin problemet e hasura për shkak të pengesave kulturore dhe gjuhësore si midis përfitueseve ashtu dhe midis përfitueseve dhe personelit; disa nga shqetësimet që paraqitën viktimat kishin të bënin me rregullat dhe kufizimet e pranishme në programet e ndihmës; me rëndësinë që ka mundësia e pasjes së një informacioni të arritshëm, të përshtatshëm dhe të gjithanshëm si jashtë vendit ashtu dhe brenda vendit; me nevojën e përfshirjes së viktimave në procesin vendim-marrës; me mundësinë e viktimave që t'i drejtohen drejtësisë (dhe disa here, me mospasjen e kësaj mundësie) në kontekstin e përvojave të tyre të trafikimit; me problemet

e fajësimit dhe të diskriminimit, me të cilat përballeshin viktimat pas përvojës së tyre të trafikimit; me çështjet që lidheshin me jetën dhe sigurinë e viktimave; me vështirësitë dhe domosdoshmërinë e vendosjes së një drejtpeshimi midis mëvetësisë dhe varësisë së viktimës për marrjen e ndihmës; me shqetësimet rreth intimitetit dhe fshehtësisë për viktimat e trafikuar; me mënyrën sesi mund të përballoheshin nevojat e veçanta për ndihmë për një grup të ndryshëm personash të trafikuar; me situatat kur viheshin kushte për marrjen e ndihmës; me mungesën, përgjithësisht, të ndihmës shtetërore në rajon; me problemet e ndërlikuara të procesit të ri-integrimit; me mënyrën më të mirë për të siguruar kapacitete profesionale dhe cilësi përkujdesjeje.

Ndërkohë që në çdo fazë viktimat e trafikimit identifikuan probleme dhe shqetësime specifike, në pah dolën disa tema gjithëpërfshirëse e të rëndësishme që karakterizojnë të gjithë procesin e identifikimit, të kthimit/referimit dhe të ndihmës. Këto ishin:

- *Qasja tek informacioni*: Viktimat kanë nevojë dhe kërkojnë më shumë informacion rreth mundësive që kanë dhe procesit që duhet të ndiqet, një informacion që duhet të jetë specifik, i arritshëm, i gjithanshëm, i kategorizuar sipas moshës, gjuhës dhe mentalitetit të viktimës. Koha ishte një element i rëndësishëm për ata që i përket shpejtësisë së marrjes së këtij informacioni – pra, që informacioni të jepej në kohën e duhur, të ofrohej më shumë se vetëm njëherë, dhe se viktimave u duhej lënë koha e mjaftueshme për ta përpunuar informacionin e marrë dhe për të marrë vendime, respektivisht. Të qenurit i/e përfshirë në vendim-marrje, më shumë sesa të qenurit thjesht një marrës pasiv i informacionit, ishte një element qendror në drejtim të njohjes së këtij fluksi informativ.
- *Keqtrajtimi dhe ndërveprimet problematike*: Disa viktima raportuan për raste të moskokëçarjes, mospërfilljes apo të diskriminimit, ndërsa të tjerat për raste të keqtrajtitit. Janë në mënyrë të veçantë shqetësuese rastet e abuzimit me viktimat gjatë kohës, kur ato merren nën mbrojtje. Trajtimi jo i mirë (edhe kur është i paqëllimshëm) ndikon negativisht mbi personat që janë tashmë të traumatizuar dhe të shfrytëzuar, si dhe mbi dëshirën e tyre për të pranuar mbështetjen e personave ndihmues. Në veprimtarinë e anti-trafikimit janë thelbësorë mekanizmat e llogaridhënies, përfshirë monitorimin dhe vlerësimin, si dhe procedurat e ankimit.
- *Çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes fizike*: Procedurat e sigurisë dhe të mbrojtjes fizike ishin trajtuar jo në mënyrë të njëtrajtshme dhe ndryshonin në mënyrë të konsiderueshme nga njëra organizatë në

tjetrën, nga njëri institucion në tjetrin dhe nga një vend në tjetrin. Jo vetëm që shqyrtimet e rrezikut ishin përgjithësisht të pakta e të kufizuara, por, po ashtu, jo gjithmonë vlerësoheshin si duhet problemet e sigurisë, rast pas rasti dhe përgjatë gjithë jetës pas-trafikim të viktimës. Në të njëjtën kohë, disa viktimat u ishin nënshtruar kufizimeve shumë të repta të masave të sigurisë dhe këto masa për sigurinë dhe mbrojtjen e tyre fizike nuk ishin parë nëse ishin të drejtpeshuara përkundrejt rëndësisë që ka përjetimi normal dhe afat-gjatë i periudhës së rikuperimit.

- *Pengesat gjuhësore dhe kulturore:* Në të gjitha fazat e procesit, viktimat ndesheshin me pengesa komunikimi – si nga pikëpamja e gjuhës ashtu dhe nga ajo e kulturës – gjë që shërbente si një pengesë për të formuar besimin, për t’u ndjerë i/e sigurt dhe për të ofruar ndërhyrje cilësore. Tejkalimi i këtyre pengesave – nëpërmjet përkthimit, personelit me njohuri të gjuhëve të huaja, me ndërmjetës kulturorë, etj. – mund të japë dorë për të gjitha fazat e procesit, megjithëse dihet se çdo zgjidhje ka kufizimet e veta (p.sh. kosto, mundësi ofrimi, trajnime), të cilave, në fakt, duhet t’u kushtohet vëmendja e duhur.
- *Modelet e ndërhyrjes dhe të kujdesit cilësor:* Lloji dhe cilësia e ndërhyrjeve – që nga identifikimi deri tek ndihma – ishin veçanërisht jo të të njëjtit nivel, jo vetëm krahasuar midis vendeve, por edhe brendapërbrenda të njëjtit vend. Përveç kësaj, modelet dhe filozofitë e programeve të ndihmës ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga një organizatë në tjetrën. Vetë viktimat vunë në pikëpyetje disa nga modelet e përkujdesjes që përdoren (p.sh. qendrat e mbyllura në krahasim me ato të hapura, programet rezidenciale me ato jorezidenciale), si dhe rregullat dhe kufizimet që zbatoheshin brenda shumë programeve. E lidhur ngushtësisht me këtë çështje ishte mungesa tërësore e monitorimit dhe e vlerësimit të këtyre modeleve të përkujdesjes dhe të ndërhyrjeve profesionale. Mendimet dhe komentet e viktimave, vlerësimi që ato bëjnë për cilësinë e ndërhyrjeve janë, po ashtu, shumë të rëndësishme për ndërtimin, personalizimin dhe zbatimin e programeve dhe të masave policore.
- *Nevoja për një ndërhyrje dhe ndihmë më të madhe shtetërore:* Shumë viktimat kishin probleme për përfitimin e shërbimeve nga më baziket, madje dhe të një mbështetjeje minimale. Kështu, viktimat raportuan që aktorët shtetërorë punonin shumë për të gjetur zgjidhje dhe mbështetje për ta, në një kohë kur kufizoheshin shpesh për shkak të burimeve të pakta

shtetërore. Dhe më tej, mundësia e shfrytëzimit të shërbimeve ndërlikohej nga procedurat burokratike dhe shumë viktimat hasnin pengesa serioze për negociimin e këtyre procedurave, të cilat, në një sërë rastesh, sillnin si rezultat thjesht mospërfitimin fare të këtyre shërbimeve të nevojshme.

- *Angazhimi i viktimave në projektimin dhe vënien në jetë të ndërhyrjeve:* Viktimat shpesh kanë ide të qarta se cilat janë nevojat e tyre dhe si mund të përmirësohen proceset dhe procedurat për t'iu përgjigjur më mirë këtyre nevojave. Angazhimi i viktimave në diskutimin e halleve të tyre, si dhe tërheqja e mendimeve të tyre në lidhje me projektimin dhe zbatimin e ndërhyrjeve në fjalë, mund të shërbejë që ndërhyrjet – qofshin ato të aspektit ligjor, apo social – të kenë si fokus qendror vetë viktimën dhe të bazohen mbi realitetet që jetojnë nga personat, të cilëve duhet t'u shërbejnë dhe mbështesin. Sistemet e ndërhyrjes dhe të ndihmës, kur formulohen, zbatohen dhe përshtaten nëpërmjet pjesëmarrjes së viktimave, janë shumë më efektive, efçente dhe, ajo që është më e rëndësishme, janë më humane. Angazhimi i viktimave në këtë mënyrë, duhet të jetë një proces në vijimësi e i vazhdueshëm.
- *Mangësitë e procesit:* Në procesin e identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës së viktimave të trafikimit rezultojnë disa mangësi e probleme, që meritojnë të vihen në dukje. Këtu përfshihen aftësitë e dobëta të identifikimit të aktorëve identifikues dhe raste të mosidentifikimit të viktimave; rastet kur viktimat mbaheshin të mbyllura/nën arrest dhe merreshin vazhdimisht në pyetje; kthime pa dhënien e mbështetjes e të ndihmës; kthime me vonesë të viktimave të huaja të trafikimit; mundësitë e kufizuara të viktimave për t'iu drejtuar drejtësisë dhe pakënaqësinë e tyre me procesin kriminal dhe gjyqësor; kushtëzimi i dhënies së ndihmës; padijenja se kujt mund t'i drejtoheshin për ndihmë; dhe ndërlikimet e procesit të ri-integrit. Ndërkohë që këto pika nuk shtjellojnë deri në fund të gjithë gamën e mangësive dhe të çështjeve problematike, ato, sidoqoftë, vejnë në dukje se cilat janë disa nga shqetësimet e tyre më të mëdha dhe na ofrojnë një pikë fillimi nga ku mund të nisë shqyrtimi i mundësive të përmirësimit dhe i zgjidhjes së tyre, në të mirë të procesit transnacional të referimit.
- *Rëndësia e trajtimit individual, rast pas rasti:* Del nevoja e fleksibilitetit dhe e trajtimit më proaktiv jo vetëm të nevojave, që dalin gjatë procesit të identifikimit dhe të mënyrës së dhënies së ndihmës, por edhe për t'iu përgjigjur profileve të ndryshme të viktimave. Kjo do të thotë që,

duhet shqyrtuar secili rast si unik dhe të trajtohet sipas veçorive që paraqet, duke qenë të ndërgjegjshëm për ndryshueshmërinë dhe ndërlëkimet e rastit në shqyrtim. Të kuptuarit më mirë të formave më të pazakonta të trafikimit, për rrjedhojë dhe trajtimi i nevojave më pak të njohura nga ana e aktorëve të angazhuar të anti-trafikimit, mund të luajë një rol të rëndësishëm në plotësimin e këtyre aktorëve me njohuritë që kërkohen. E të njëjtës rëndësi është dhe ndihma e specializuar për rastet më “të vështira”, si për shembull për viktimat me pa-aftësi, me çrregullime të sjelljes, me varësi të ndryshme, me nevoja specifike shëndetësore, për viktimat me persona në ngarkim, etj.

- *Çështjet gjinore dhe të seksit:* Çështjet gjinore dhe të seksit duhet të merren parasysh gjatë gjithë procesit – që nga identifikimi, kthimi dhe dhënia e ndihmës. Si burrat edhe gratë janë viktimat të trafikimit dhe shpesh kanë përvoja të ndryshme të trafikimit, nevoja dhe interesa të veçanta. Marrja parasysh e çështjeve të seksit dhe të gjinisë shpesh rezultojnë në marrjen dhe ofrimin e masave të ndryshme anti-trafikim. Duhet t’i kushtohet më shumë vëmendje mënyrës sesi çështjet gjinore dhe të seksit informojnë realizimin e trafikimit, por dhe veprimeve anti-trafikim që duhen ndërmarrë me qëllim që të mbështeten të dyja gjinitë në mënyrën e duhur dhe efektivisht.
- *Nevoja për një kërkim studimor me qendër viktimat; vlerësimi dhe formulimi i programit:* Personat e trafikuar janë në pozicionin më të mirë për të identifikuar dhe komunikuar hallet e tyre – çfarë kanë nevojë dhe çfarë do të ishte më e dobishme dhe e rëndësishme për to. Kërkimi studimor me qendër viktimën mund të ofrojë një informacion të paçmuar për formulimin e ndërhyrjeve anti-trafikim dhe për të siguruar që në qendër të vëmendjes e të diskutimit nga ana e aktorëve anti-trafikim, do të vendoset plotësimi i nevojave të viktimave. Kjo mund të shërbejë për të fuqizuar viktimat – për t’i vendosur mendimet e opinionet e tyre në të njëjtin nivel diskutimi me ato të profesionistëve – gjë që mund të luajë një rol të rëndësishëm në procesin e rikuperimit.

Është e rëndësishme të theksohet se, qëllimi i këtij raporti është që t’u japë zë dhe profil përvojave dhe problemeve të përjetuara nga personat e trafikuar të intervistuar, dhe që të përdoren gjetjet e këtij raporti si një pikënisje për ndryshime. Studimi u parashtrua si nevojë për një informacion më të pavarur dhe të bazuar në kërkime studimore rreth proceseve të identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës për personat e trafikuar në rajonin e SEE. Si pikë

qendrore ishte nevoja e vlerësimit të këtyre proceseve, duke vendosur në qendër viktimat, të cilat u shprehën vetë se cilat, sipas pikëpamjes së tyre, kanë qenë përvojat pozitive dhe negative, si dhe në ç'mënyrë u janë plotësuar (ose nuk u janë plotësuar) nevojat që kishin. Intervistat prodhuan një tërësi problemesh, të identifikuar nga vetë viktimat përgjatë trajektores së identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës. Tregimet dhe vëzhgimet e tyre në vetën e parë, japin një pamje shumë të qartë mbi funksionimin e mekanizmave dhe të procedurave të anti-trafikimit dhe u ofrojnë mendime e sugjerime konkrete aktorëve të anti-trafikimit, me shpresën se do të ndihmojnë politikën dhe praktikën e deritanishme. Këto komente dhe gjetje, për këtë arsye, paraqiten në këtë raport në interes dhe si domosdoshmëri për përmirësime dhe angazhime të vazhdueshme, dhe shpresohet që vëzhgimet dhe gjetjet do të lexohen në dritën e duhur.

Akronimet dhe shkurtimet

ABA-CEELI	American Bar Association–Central European and Eurasian Legal Initiative
AI	Amnesty International
AIDS	Sindromi i defiqencës së fituar imunitare (AIDS)
AT	Anti-trafikimi
BE	Bashkimi Evropian
BH	Bosnja-Hercegovina
CAFV	Këshillim kundër Dhunës Familjare
CIS	Komonuelthi i Shteteve të Pavaruara
CPTW	Qendra për Parandalimin e Trafikimit të Grave
CRC	Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës
D&E	Different and Equal
ECPAT	Fund prostitucionit të fëmijës, pornografisë së fëmijëve dhe trafikimit të fëmijëve
FATW	Fondacioni kundër trafikimit të grave
FYROM	Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë
GAATW	Aleancia globale kundër trafikimit të grave
GCC	Gjirokastra Community Centre
HIV	Virusi i defiqencës imunitare humane (HIV)
ICCO	Organizata Ndërkishëtare për Bashkëpunimin për Zhvillim
ICMPD	Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikës së Migrimit
IDP	Personat e Zhvendosur brenda Territorit
IFS	Forumi Ndërkombëtar për Solidaritetin
IHRLG	Grupi i Ligjit të së Drejtës Humane Ndërkombëtare
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës

IOM	Organizata Ndërkombëtare e Migrimit
ISF	Ambient i Përkohshëm Sigurie
KBF	Fondacioni i Mbretit Baudouin
KE	Komisioni Evropian
KiE	Këshilli i Evropës
KPS	Shërbimi Policor i Kosovës
KT	Kundër-trafikimi
KVN	Kthimi Vullnetar i Ndihtuar
LPQ	Lejet e Përkohshme të Qendrimit
MB	Mbretëria e Bashkuar
MKR	Mekanizmat Kombëtarë të Referimit
MoHSP	Ministria e Shëndetësisë dhe e Politikës Sociale
MTR	Mekanizmat Transnacionalë të Referimit
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
ODIHR	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
OJQ	Organizatë jo-qeveritare
OKB	Kombet e Bashkuara
ON	Organizatë Ndërkombëtare
OQ	Organizatë Qeveritare
OSBE	Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
POS	Procedurat Operative Standarde
PRK	Pikë Rajonale Kontrolli
PTSD	Çrregullimi i Stresit Post Traumatik
PVPT	Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit
QKP	Qendra Kombëtare e Pritjes
QKPVT	Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikut
QPS	Qendrat e Punës Sociale
SEE	Evropa Juglindore
SPTF	Task Forca e Paktit të Stabilitetit për Trafikimin e Personave
STDs	Sëmundjet e Transmetuara Seksualisht
STIs	Infeksionet e Transmetuara Seksualisht
TIP	Trafikimi i Personave
TQNj	Trafikimi i Qenieve Njerëzore
UAMs	Të miturit e pashoqeruar
UNAIDS	Programi i Kombeve të Bashkuara për HIV/AIDS
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNHCR	Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNICRI	Instituti Kërkimor i Kombeve të Bashkuara për Krimin dhe Drejtësinë Ndër-rajonale
UNOHCHR	Zyra e Kombeve të Bashkuara e Komisaritit të Lartë të Drejtave të Njeriut
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar
VAW	Dhuna kundër grave
VeT	Viktimë e trafikimit

1. Hyrje

Ky raport paraqet gjetjet e një studimi rajonal në Evropën Juglindore, i cili eksploroj procesin aktual të identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës për viktimat e trafikuar. Objektivi specifik i studimit ishte që të ravijëzonte qartësisht në një hartë sesi realizohet sot ky proces nga, brenda dhe nëpërmjet Evropës Juglindore, duke përfshirë atje praktikën e mira dhe problemet e ndeshura. Në këtë mënyrë, u shqyrtua i tërë procesi i referimit dhe i ndihmës – që nga identifikimi (qoftë jashtë vendit apo brenda vendit), kthimi (qoftë i brendshëm apo ndërkombëtar), referimi (nga OQ-të, OJQ-të dhe/ose ON-të) dhe ndihma e mbrojtja (qoftë afatgjatë apo afat-shkurtër, në vendin e lindjes apo jashtë tij, nga OQ-të, OJQ-të dhe ON-të). Për këtë arsye, studimi u ndërmor në vendet e origjinës, si në Shqipëri, Moldavi dhe Rumani, si edhe në vendet, BH dhe Serbi, të cilat gjithmonë e më shumë po shndërrohen në vende origjine, por edhe destinacioni e tranziti. Ndërkohë që ky studim u realizua në pesë vende, ai u referohet rasteve të trafikuar nga ose te secili nga dhjetë vendet e SEE – Shqipëri, BH, Bullgari, Kroaci, Territori i Kosovës nën Administrimin e OKB-s, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (FYROM), Moldavi, Mal i Zi, Rumani dhe Serbi, si dhe vendet e Azisë së Mesme, të ish-Bashkimit Sovjetik, vendet e ndryshme të BE dhe Turqi. Ajo që është shumë e rëndësishme të theksohet është se, studimi përdor si lente të saj parësore perspektivën e grave dhe të burrave të trafikuar, të cilët

kanë kaluar nëpër procedura të ndryshme. Metoda e përdorur është, pra, që të mësohet sa më shumë nga ata që janë në pozicionin e shpjegimit të përvojave vetjake dhe të problemeve që kanë ndeshur vetë personalisht. Ndodh shumë rrallë që viktimave t'u jepet mundësia që të dëgjohen në momentin kur formulohen dhe vihen në jetë programet dhe politikat e anti-trafikimit. Duke vepruar kështu, pra, duke i dëgjuar vetë viktimat, lind një mundësi për t'u dhënë atyre më shumë fuqi. Siç është diskutuar edhe në një vend tjetër,

synimi parësor i procesit të fuqizimit ... është që të vendosen në qendër të procesit zërat e lënë menjanë, duke siguruar që të dëgjohen dhe të respektohen të gjithë individët. Kjo kryhet duke folur rreth përvojave individuale në familje, komunitet dhe në mjedisin më të gjërë të viktimës, për të kuptuar kontekstin e përvojës së saj sociale, politike dhe historike (Blitz et al 2003: 160).

Ky studim kërkimor nuk kërkon të bëjë vlerësimin e ndonjë vendi, programi apo organizate që punon në SEE. Ai, më së shumti, është një konsideratë mbi si kuptohet, perceptohet dhe përjetohet nga viktimat e intervistuarat kuadri i sotëm i identifikimit, i referimit dhe i ndihmës. Shpresohet që, duke dëgjuar viktimat dhe duke paraqitur nevojat dhe dëshirat që formulohen nga vetë ato, do të jetë e mundur që të ndihmohen një sërë organizatash dhe aktorësh, që kërkojnë të trajtojnë problemet e trafikimit në SEE dhe më tej.

Korpusi kryesor i raportit është i ndarë në tri seksione të mëdha – përvojat e viktimës gjatë 1) identifikimit, 2) kthimit dhe 3) ndihmës e mbrojtjes. Çdo seksion merr në shqyrtim, në terma të përgjithshëm, sesi realizohet procesi, se çfarë përjetojnë viktimat në këtë fazë të procesit (ndjesitë pozitive dhe negative) dhe cilat, sipas atyre, ishin çështjet dhe pengesat me të cilat u ndeshën në çdo fazë. Në intervistat me viktimat, vëmendja nuk u orientua mbi temën se çfarë bëjnë apo kanë ndërmend të bëjnë aktorët e anti-trafikimit, por në vend të kësaj, u hodh dritë mbi atë çfarë përjetojnë dhe kuptojnë vetë viktimat gjatë këtyre ndërhyrjeve. Domethënë, nuk bëhet më fjalë vetëm për informacionin dhe opsionet që u ofrohen viktimave, por për si i kuptojnë viktimat këto opsione dhe informacione. Po ashtu, vëmendja nuk u përqendrua vetëm mbi çfarë mbështetje dhe ndihme i ofrohej viktimës, por mbi si e perceptonin dhe e përjetonin viktimat atë mbështetje dhe ndihmë. Qëllimi ishte që të kuptohej më mirë se çfarë gjetën pozitive dhe, po ashtu, negative, viktimat, bazuar mbi përvojat e përjetuara drejtpërdrejt nga ndërhyrjet anti-trafikuese, si në vendin e tyre ashtu dhe jashtë tij. Vëzhgimet dhe mendimet nuk kanë peshë të njëjtë për të gjitha vendet. Për shembull, disa nga çështjet

lidhen me llojet specifike të programeve apo të ndërhyrjeve, të cilat, ndonëse të njëjta në rajonin e SEE-s, nuk janë i vetmi lloj i ndihmës së disponueshme dhe të ofruar. Po kështu, disa vëzhgime janë veçanërisht të rëndësishme për vendet e destinacionit dhe nuk mund të jenë të zbatueshme në vendet e origjinës. Pas kësaj paraqitjeje, shumë nga çështjet e shqyrtuara do të jenë të dobishme për një numër të madh aktorësh të anti-trafikimit që veprojnë në një numër kontekstesh.

Aktorët e anti-trafikimit janë të përkushtuar në punën e tyre, të angazhuar dhe zotërojnë kapacitete të forta në fushat e identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës, dhe nuk duhet të nënvlerësohet rëndësia dhe vlera e punës së tyre. Ky ishte një mesazh i qartë që doli nga intervistat me viktimat – këta aktorë dhe ofrues shërbimesh kanë qenë shumë të vyer për procesin e rikuperimit dhe të ri-integrimit të viktimave të trafikimit, dhe se ndërhyrjet e ndryshme provuan të kishin qenë të një rëndësie jetësore në përpjekjet anti-trafikim. Duke qenë të tillë, qëllimi ynë nuk është që me pa të drejtë të kritikojmë këta profesionistë të zellshëm dhe të përkushtuar, apo përpjekjet anti-trafikim që ata ndërmarrin. Qëllimi ynë është që t'u japim zë dhe profil përvojave dhe problemeve të hasura nga personat e trafikuar, që u intervistuan për këtë studim, dhe t'i përdorim gjetjet si një pikënisje për ndryshimet e kërkuara. Këto gjetje dhe komente ofrohen në interes të përmirësimeve dhe të angazhimeve të përhershme, dhe shpresohet që këto gjetje dhe vëzhgime të lexohen në dritën e duhur.

Vëmendja dhe pikënisja e këtij studimi është perspektiva e grave dhe të burrave që përdorin procesin e referimit dhe që zhvendosen nëpër të, dhe, për rrjedhojë, janë në gjendje më të favorshme për të komentuar procesin e referimit dhe për të formuluar alternativat e mundshme. Kur u pyetën sesi do të ndiheshin po të merrnin pjesë në një projekt të tillë, vetë viktimat u shprehën:

Ky studim është i rëndësishëm, është e rëndësishme që merret parasysh mendimi ynë.

Mendoj se ideja është e mirë dhe se duhet të kryhet një studim i tillë, sepse vetëm duke folur me përfituesit do të ndihmohen ofruesit e shërbimeve që të kuptojnë se çfarë është mirë dhe çfarë është keq ... dhe ka rëndësi që përfituesit do të mund të marrin pjesë në këto studime dhe se mendimet e tyre merren parasysh.

Përfituesit duhet të flasin për ndihmën që marrin dhe të përshkruajnë se çfarë ndjejnë.

Është mirë që të dëgjohen problemet e përfituesve, me qëllim që të kuptohet sesi mund të ndihmohen ato. Kjo është normale.

Për mua kjo nuk krijon ndonjë problem. Unë u kënaqa që mendimi im shërben për diçka, dhe mendoj se informacioni që dhashë do të jetë i dobishëm ... Po, përgjithësisht të le një shije të mire, kur mendimet e tua merren parasysh. Ky studim do të ndihmojë që të kuptohen më mirë problemet tona.

Pra, janë vlerësimet, perceptimet dhe komentet e viktimave mbi këtë proces, që qëndrojnë në qendër të studimit dhe në themel të gjetjeve të tij. Dhe studimi është pikërisht një përgjigje ndaj përvojave dhe perceptimeve të tyre vetjake, dhe duke u mbështetur mbi mendimet dhe sugjerimet e tyre jepen përfundimet dhe rekomandimet tona.

2. Kuadri studimor

2.1. Sfondi i projektit dhe objektivat studimorë

Në korrik të 2006, ICMPD¹ nisi programin e saj rajonal të financuar nga USAID në mbështetje të ndërtimit të mekanizmave të gjithanshëm, efektivë dhe të institucionalizuar të referimit transnacional (MTR) për viktimat e trafikimit në Evropën Juglindore (SEE). Programi – i zbatueshëm në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Territorin e Kosovës nën Administrimin e OKB-së,

¹ Qendra Ndërkombëtare e Zhvillimit të Politikës së Migrimit (ICMPD) është një organizatë ndërkombëtare me seli në Vjenë, me statusin e vëzhguesit në OKB. Qëllimi i saj është të promovojë politika të reja, të gjithanshme dhe të qendrueshme migrimi dhe të funksionojë si një mekanizëm shkëmbimi shërbimesh për qeveritë dhe institucionet në Evropë. ICMPD-ja është aktive në fusha të ndryshme, përfshirë politikat e vizave, menaxhimin e kufijve, problemet e azilit dhe të ripranimit, dhe ka fituar një përvojë të gjatë në drejtim të hartimit dhe zbatimit të projekteve në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Programi anti-trafik i ICMPD-s synon mbështetjen e vendeve në nivel kombëtar dhe rajonal, duke ofruar përgjigje në ndihmë të anti-trafikimit, në përputhje me standardet dhe praktikën e mira ndërkombëtare dhe evropiane. Ky program kontribuon në drejtim të përfundimit të përpjekjeve të ndërtimit të institucioneve dhe të kapaciteteve nëpërmjet trainimeve, ndihmës teknike dhe këshillim ekspertësh, duke vënë në jetë një metodë të qendrueshme, shumë-disiplinore dhe gjithëpërfshirëse. Duke punuar afër me qeveritë, organizatat ndërkombëtare dhe grupet e shoqërisë civile, ICMPD-ja promovon përjasjen e bazuar mbi të drejtat e njeriut.

ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë (FYROM),² Moldavi, Mal të Zi, Rumani dhe Serbi – ka për qëllim ngritjen e mekanizmave transnacionalë të referimit (MTR) për viktimat e trafikimit, me synimin që të ndërtohet një sistem i duhur i menaxhimit të rasteve midis vendeve të origjinës, të tranzitit dhe të destinacionit.

Për t'u siguruar që në qendër të programit të MTR-së janë vendosur nevojat reale për ndihmë dhe mbrojtje të viktimave të trafikimit, ICMPD-ja ngarkoi Institutin NEXUS³ që të ndërmerre një studim empirik në vendet e rajonit të SEE-s, si vende të origjinës dhe të destinacionit të këtij trafikimi (Shqipëri, BH, Moldavi, Rumani dhe Serbi). Ky studim u përqendrua në përvojat e identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës për personat e trafikuar, brenda dhe nëpërmjet rajonit të SEE-s. Gjetjet dhe rekomandimet e këtij studimi do të përdoren si themel dhe bazë udhëzimesh për punën referuese transnacionale në vendet e rajonit, dhe, si të tilla, do të shërbejnë si për mjetet, ashtu dhe për hapat operative që parashikohen të ndërmerren gjatë realizimit të projektit.

Studimi u ngrit mbi nevojën e një informacioni më të pavarur dhe të bazuar mbi kërkime shkencore në lidhje me proceset e identifikimit, kthimit dhe ndihmës për personat e trafikuar. Shtylla qendrore ishte nevoja për një vlerësim nga ana e viktimave të këtij procesi, ku ato të shprehnin vetë se cilat ishin për to përvojat pozitive apo negative dhe sesi u plotësoheshin (ose jo) nevojat që kishin. Personave të trafikuar u kërkua që të përshkruanin përvojat e tyre mbi ndërhyrjet e ndryshme që realizoheshin nga aktorët e anti-trafikimit gjatë periudhës pas-trafikim – që nga identifikimi, kthimi dhe gjatë fazave të ndryshme të ndihmës e të mbrojtjes. Një pikë qendrore për qëllimet e studimit tonë, ishte sesi ndiheshin viktimat në fazat e ndryshme të kësaj trajektoreje

² Më tej do të përdoret ose Maqedoni, ose FYROM.

³ NEXUS është një qendër studimore politikash shumëdisiplinore me seli në Vjenë, që i kushtohet kërkimeve dhe analizave që shërbejnë si bazë për hartimin e ligjeve, të politikave dhe shërbimeve më të mira dhe efektive kundër-trafikimit pas një informimi më të plotë mbi gjendjen reale. NEXUS është i specializuar në ofrimin e analizave të pavarura, duke u mbështetur mbi një studim evidencash; shqyrtim objektivash dhe vlerësime konstruktive; këshillim teknik; mbështetje për trajnim dhe ndërtim kapacitetesh. Instituti NEXUS është anëtar i Grupit të OSBE-s, i Koordinimit të Aleancës së Ekspertëve dhe në grupin e saj këshillimor bëjnë pjesë IOM, Përfaqësuesi Special i OSBE mbi Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Qendra Kërkimore Innocenti e UNICEF-it, Projekti i Mbrojtjes së Universitetit Johns Hopkins dhe Qendra Evropiane e Trajnimit për të Drejtat e Njeriut dhe Demokracinë. NEXUS sjell përvojën e saj të gjerë të kërkimeve në fushën e anti-trafikimit, si në Evropën JL, ashtu dhe në rajonet e tjera dhe ka botuar një sërë studimesh mbi trafikimin në SEE, përfshirë edhe studime mbi përse viktimat e trafikimit refuzojnë ndihmën; mbi trafikimin e fëmijëve për punë dhe lypje në SEE; mbi programe të ndihmës në SEE; trafikimin për punë dhe masat anti-trafikim; mbi profilet dhe sjelljet e trafikantëve; dhe mbi trafikimin e fëmijëve në Sierra Leone.

dhe sesi e vlerësonin apo e komentonin ato këtë proces. Në thelb, parimi organizues i studimit ishte që të vihej në pah ajo çka shikonin, kuptonin dhe përjetonin viktimat e trafikimit përgjatë këtyre fazave të ndryshme.

2.2. Njohuritë ekzistuese dhe mangësitë

Ndërkohë që një sërë studimesh dhe dokumentesh kanë studiuar procesin e identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës për personat e trafikuar, vëmendja e tyre ka qenë e përqendruar kryesisht mbi kuadrot ligjore dhe administrative brenda të cilëve zhvillohej ky proces. Këtu përfshihen parime dhe udhëzimet për procesin e identifikimit dhe të ndihmës,⁴ kuadri legjislativ (kombëtar dhe ndërkombëtar)⁵ dhe studimet e kuadrit të ndihmës, përfshirë edhe praktikatat e mira.⁶ Shumë më të pakta kanë qenë studimet mbi si e përceptonin dhe përjetonin vetë viktimat jetën e tyre pas-trafikimit dhe si i vlerësonin dhe i komentonin ato vetë ndërhyrjet që bëhen në ndihmë të tyre. Me daljen në pah të këtij problemi, disa studime të kohëve të fundit kërkuan ta trajtojnë këtë mangësi, duke marrë si pikënisje, apo si fokusin e tyre kryesor, opinionet e viktimave, përceptimet dhe përvojat që kalojnë në kuadrin e ndihmës.

Jeta e vet (2005) është një studim i programeve të rehabilitimit në Serbi dhe në Moldavi dhe niset nga nevoja e një informacioni të bazuar mbi studimet në lidhje me përmbajtjen dhe efektet e rehabilitimit tek viktimat e trafikimit (shih Bjerkan 2005).

Duke lënë pas të kaluarën (2007) nëpërmjet një studimi empirik të problemit në tri vendet e SEE – Shqipëri, Serbi dhe Moldavi, analizohen arsyet përse disa viktima e refuzojnë ndihmën. Arsyet përse disa viktima refuzojnë të hyjnë në kuadrin e ndihmës përfshijnë, por nuk kufizohen me, çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me fajësimin, si nga fakti se kanë qenë të trafikuar, ashtu dhe nga fakti se po ju jepet ndihmë; me mangësitë dhe problemet që

⁴ Lutemi shihni: Bump & Duncan 2003; EC 2005; EU 2005; EU 2004; EU 2002; FATW, GAATW dhe IHRIG 1999; GAATW 2000; ICMPD 2003a, 2003b, 2006; ILO 2006; IOM 2005b; Mitchels 2004; OSBE/ODIHR 2004; UNICEF 2005; UNOHCHR 2002.

⁵ ABA CEELI 2005; IOM 2005a; La Strada & OSCE 2006.

⁶ Andreani & Raviv 2004; Dottridge 2004 & 2006; Hunzinger & Sumner-Coffey 2003; ICCO 2004; Kvinna til Kvinna & Kvinnoforum 2003; Kvinnoforum 2003; La Strada Moldova 2005; Limanowska 2002 and 2003; Pearson 2002; Reiter 2005; Rosenberg 2006; Somach and Surtees 2005; Surtees 2005, 2006a, 2006b, 2007; Tdh & ARSIS 2006; Tdh 2005; Tozaj 2006; UNICEF 2004; UNICEF & STC 2004; van der Kleij 2003.

ndeshen në vetë kuadrin e ndihmës; me mungesën e besimit në sistem; me të kuptuarit e kufizuar të kuadrin të ndihmës; me dëshirën për t'u kthyer në shtëpi tek familjet apo komuniteti i tyre; me faktin se nuk kanë patur nevojë për ndihmë; dhe me faktin se refuzojnë të identifikohen si viktimat të trafikimit (shih Brunovskis & Surtees 2007).

Agenci apo sëmundje – zgjedhjet dhe sjelljet e viktimave të trafikimit (do të dalë në dritë në 2008) merr në shqyrtim sistemet e ndihmës në SEE, përfshirë vlerat dhe filozofitë, si pjesë përbërëse të këtyre programeve. Vëmendje e veçantë i kushtohet përdorimit të rregullave dhe të kufizimeve në disa programe të ndërtuara për viktimat e trafikimit dhe ndikimit që kanë ato në rikuperimin e viktimave (shih Brunovskis & Surtees, do të dalë në dritë në 2008).

Zërat e viktimave (2004) është një studim pilot mbi përvojat e grave të reja në prostitucion në Hollandë. U intervistuan dhjetë gra të reja rreth përvojave të tyre, pasi qenë të detyruara të ushtrojnë profesionin e prostitucionit, si dhe rreth ekspozimit të tyre ndaj profesionistëve të kujdesit mendor, policisë dhe gjyqësorit (shih ECPAT 2004).⁷

Dëshmia kurajoze (2006) diskuton përvojat e grave, pasi kanë pranuar apo refuzuar të dëshmojnë, përfshirë dhe arsyet që i shtyn për të marrë vendimet e tyre, bën analizën e mëtejshme të pasojave të vendimeve që patën marrë, dhe përvojat para, gjatë dhe pas seancave gjyqësore (shih Bjerkan & Dyrliid 2006a).

Përvoja nën heshjte (2006) diskuton disa nga pengesat për një ri-integrim të denjë dhe të qetë, përfshirë frikën nga fajësimi dhe paragjykimi. Artikulli vendos theksin mbi nevojën për të marrë parasysh këto kushte, kur formulohen programet e ri-integrimit dhe, po ashtu, argumenton se historitë, përvojat dhe perspektivat e ardhshme, aq të ndryshme nga rasti në rast, kërkojnë ndërmarrjen e programeve të larmishme dhe elastike për ri-integrim (shih Bjerkan & Dyrliid 2006b)

Buzëqeshjet e vjedhura (2006) është një studim i ndikimit fizik dhe psikologjik i trafikimit mbi gratë dhe adoleshentët, të trafikuar drejt Evropës. Studimi, duke qenë se është gjërësisht sasior, ofron, gjithashtu, një informacion cilësor mbi përvojat e dhënies së ndihmës viktimave, që lidhen me mirëqenien e tyre fizike dhe mendore, dhe ve në pah se, cilat janë nevojat afat-shkurtëra dhe afat-gjata të personave të trafikuar (shih Zimmerman et al. 2006).

Po kështu, një studim rajonal i "Save the Children", që do të dalë përsëshpejti, po kryhet në kuadrin e Programit Reagues ndaj Trafikimit të Fëmijës në Evropën Juglindore. Studimi prek ndërveprimet e drejtpërdrejta me të miturit dhe përipiqet të japë përgjigje, duke u nisur nga pozicioni i vetë fëmijëve, se përse trafikohen fëmijët. Studimi është në zbatim e sipër në shtatë vende të SEE (shih Save the Children, do të dalë në dritë në 2007).

2.3. Metodologjia studimore dhe mbledhja e të dhënave

Studimi bazohet mbi punën e bërë në terren dhe mbi intervistat e marra në vendet e Evropës Juglindore. Puna në terren u realizua në vendet tradicionale të origjinës (Shqipëri, Moldavi dhe Rumania), si dhe në vendet e tranzitit dhe të destinacionit, të cilat janë shndërruar, gjithashtu, në vende të origjinës (BH dhe Serbi). Ndërkohë që personat e trafikuar, të cilët u intervistuan ishin nga pesë vende (pra Shqipëria, BH, Moldavia, Rumania dhe Serbia), është e rëndësishme të vihet në dukje se përvojat e tyre të transportimit dhe të shfrytëzimit shpesh përfshinin pesë vende të tjera të rajonit të SEE – Bullgarinë, Kroacinë, Territorin e Kosovës nën Administrimin e OKB-s, Maqedoninë dhe Malin e Zi – si edhe vendet më larg, të Azisë së Mesme, Rusisë, të vendeve të ish-Bashkimit Sovjetik, vendet e ndryshme në BE dhe Turqi. Disa viktimat ishin me origjinë nga vendet e rajonit të SEE, të tjerat ishin trafikuar në drejtim të, ose nëpërmjet SEE, dhe disa të tjera ishin identifikuar dhe/ose ndihmuar në këtë rajon. Çfarë është me rëndësi për t'u theksuar në këtë rast është se, gjetjet ishin pasqyruese të problemeve në një numër të madh vendesh, si brenda ashtu dhe jashtë rajonit të SEE dhe nuk përjashtonin problemet e vëna re në vendet ku u krye studimi. Komentet dhe vëzhgimet e viktimave i referohen trajektoreve të plotë të ndërrimeve anti-trafikim – në vendet e origjinës, të tranzitit dhe të destinacionit – dhe një numri ndërmjetësish – shtetit, OJQ-ve dhe ON-ve. Si të tilla, është e rëndësishme të theksohet se gjetjet nuk duhet të lexohen e të kuptohen si specifike për vendet ku u realizua studimi. Dhe po njëjloj e rëndësishme është që të kuptohet se, gjetjet nuk janë pasqyruese të veprimtarisë së ndonjë organizate apo të ndonjë institucioni të caktuar, por janë modele të përgjithshme, të dokumentuara në një numër të madh rastesh dhe kontekstesh.

Me personat e trafikuar u realizuan intervista gjysmë të strukturuar edhe për fazat e ndryshme të jetës së tyre pas-trafikim. U përzgjodh një format

⁷ I disponueshëm vetëm në gjuhën daneze.

interviste gjysmë i strukturuar, pasi ai lejon mbledhjen e të dhënave të krahasueshme, duke ndjekur një sekuencë të dhënë temash diskutimi, dhe në të njëjtën kohë mundëson një elasticitet për t'iu përshtatur situatës specifike të personit që intervistohet (Kvale 1996). Pjesa më e madhe e intervistave u ndërmor nga punonjës të specializuar të vendit përkatës, ndërsa një pjesë tjetër u krye nga koordinatori i studimit kërkimor gjatë misioneve në terren. Grupi kërkimor përbëhej nga Rebecca Surtees, Marija Babovic, Diana Tudoarche, Genta Bibo, Viorelia Rusu dhe Milica Djordjevic. Të gjithë anëtarët janë punonjës kërkimorë me përvojë dhe/ose profesionistë të kujdesit social, që punojnë me popullatat e pambrojtura, përfshirë viktimat e trafikimit.

Studimi kishte karakter gjithëpërfshirës, duke i afruar njerëzit e trafikuar drejt një çështjeje të përbashkët, asaj të përvojave të tyre gjatë identifikimit, kthimit dhe marrjes së ndihmës. Objektivi ishte që të pozicionoheshin përvojat e tyre vetjake dhe individuale në qendrën e këtij diskutimi/studimi dhe procesi reflektimi dhe të fillohej një diskutim me personat e trafikuar në lidhje me përvojat dhe përceptimet e tyre, për të gjetur zgjidhjet e mundshme në përgjigje të problemeve me të cilat përballeshin këto persona. Të intervistuarve nuk iu kërkua që të flasin për përvojat e tyre të trafikimit, dhe në ato raste ku u diskutuan, ato u bënë me nismën e vetë të intervistuarit apo të intervistuarës.

Metoda e modelimit kërkoi të identifikoheshin një maksimum rastesh dhe tipash të intervistuarish dhe përvojash. Synimi ishte që të merreshin mësim nga një spektër sa më i gjërë personash të trafikuar, duke identifikuar në këtë mënyrë një gamë të tërë përvojash dhe çështjesh. Në total u intervistuan 80 persona të trafikuar. U njohën profile të ndryshme viktimash – meshkuj dhe femra, të rritur dhe të mitur – si dhe individë të trafikuar për qëllime të ndryshme, përfshirë shfrytëzimin seksual, shfrytëzimin për punë dhe lypje/kundërvajtje të ndryshme. Ndërkohë që pjesa më e madhe e të intervistuarve ishin gra, modeli përfshin intervista me dymbëdhjetë meshkuj. Moshën e të intervistuarve shkonte nga 15 deri në 75 vjeç në kohën e marrjes së ndihmës. Megjithëse secili nga anëtarët e grupit kërkimor ishin të trajnuar nga ana profesionale dhe kishin përvojë pune me të mitur, studiuesit me qëllim intervistuan vetëm ata të mitur (13 gjithsej) që ishin të një moshe disi më të madhe – nga 15 deri në 17 vjeç – për shkak të kapacitetit të tyre më të madh për të analizuar dhe vlerësuar procesin e identifikimit dhe të kthimit, si dhe të ndihmës së ofruar për ta. Viktimat që u intervistuan ishin nga vendet e ndryshme të rajonit të SEE, por edhe të shtetësive të tjera, të trafikuar në këtë rajon. Të intervistuarit ishin trafikuar në një numër të madh destinacionesh, duke përfshirë vendet e SEE, të BE, Rusinë dhe ish Bashkimin Sovjetik, Turqinë, Lindjen e Mesme dhe Azinë Qendrore.

Disa viktima u intervistuan menjëherë pas identifikimit dhe referimit të tyre dhe para se të ktheheshin në shtëpi, të tjerët menjëherë pasi ishin kthyer në shtëpi dhe në fazën fillestare të ofrimit të ndihmës dhe/ose të vendim-marrjes, dhe, përsëri, të tjerët u intervistuan gjatë fazave të ndryshme të ri-integrimit të tyre. Kontaktet me viktimat u mundësuan nëpërmjet organizatave e programeve të ndryshme, përfshirë OQ-të, OJQ-të dhe ON-të.⁸

Nga të 80 personat e trafikuar, që u intervistuan, përvojat e trafikimit lidheshin pikësëpari me gratë e trafikuar për shfrytëzim seksual, megjithëse nga të 52 rastet e shfrytëzimit seksual, njëri ishte mashkull. Modeli, gjithashtu, përfshiu dymbëdhjetë viktima të trafikimit për punë në të zezë, 8 nga të cilët ishin meshkuj dhe katër ishin femra. Kishte gjashtë raste të trafikimit për lypje/kundërvajtje të ndryshme – pesë femra dhe një mashkull; një grua shfrytëzohej për punë dhe shfrytëzim seksual; dhe një tjetër për shfrytëzim seksual dhe lypje. Trafikimi ndodhte kryesisht në nivel ndërkombëtar, por përfshinte dhe raste të trafikimit të brendshëm. Ndërkohë që pjesa më e madhe e të intervistuarve kishin qenë të shfrytëzuar dhe më pas të identifikuar zyrtarisht si viktima të trafikimit, në katër raste personat ishin identifikuar para se të shfrytëzoheshin, duke patur tregues të fortë për secilin nga këto raste se ekzistonte rreziku real i trafikimit ose i synimit për shfrytëzim. Në tri raste të tjera, nuk ishte e mundur për studiuesin që të sqaronte mirë formën e trafikimit të ushtruar mbi to, megjithëse këta persona kishin qenë të identifikuar zyrtarisht si të trafikuar nga organizata ndihmëse dhe trajtoheshin në kuadrin e ndihmës anti-trafikim. Meqenëse intervista kishte të bënte me procesin e identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës dhe jo me përvojat e tyre të trafikimit, kërkuesit, në këto raste, nuk përqendroheshin mbi hollësitë e shfrytëzimit të tyre.

Ndërkohë që fokusi i studimit binte mbi përvojat e drejtpërdrejta të viktimave, mbi perceptimet dhe mendimet e tyre, ishte e rëndësishme, po ashtu, që të mblidheshin të dhëna e informacione edhe nga vetë ofruesit e shërbimeve. Kjo u realizua për të sqaruar informacionin e mbledhur për ndonjë

⁸ Këtu më poshtë listohen agjencitë që ndihmuan kërkimin studimor, duke lehtësuar kontaktet me përfituesit e shërbimeve të tyre dhe që mbështetën grupin kërkimor me informacion të vlefshëm. Organizatat bashkëpunuese përfshijnë në Shqipëri – IOM Tirana, Different and Equal (D&E), Gjirokastra Community Centre (GCC), Vatra, Tjetër Vizion, Qendra Kombëtare e Pritjes (QKP) dhe Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikut (QKPVT); në BH – IOM Sarajevo, International Forum for Solidarity (IFS) dhe La Strada; në Moldavi – International Center for Women Rights Protection and Promotion Center „La Strada“, IOM Chisinau, Interaction, Compasiune dhe the National Center on Child Abuse Prevention; në Rumani – Young Generation, Adpare, Reaching Out, Save the Children, Conexiuni, Betania dhe IOM Bukuresht; dhe në Serbi – Atina, Counselling against Family Violence (CAFV), si dhe IOM Beograd.

rast të veçantë, ose për informacion më të përgjithshëm rreth procedurave dhe praktikave që zbatohen në procesin e identifikimit, të kthimit dhe të dhënies së ndihmës. Për këtë arsye, u kryen edhe intervista me ofrues të përzgjedhur shërbimesh dhe aktorë të anti-trafikimit në rajon, nga punonjësit kërkimorë të vendit, ose nga koordinatori i kërkimit studimor.

Kufizimet

Gjatë studimit u ndeshën një sërë çështjesh dhe kufizimesh, të cilat, domosdoshmërisht do të ndikonin mbi gjetjet kërkimore. Këto përfshijnë, si vijojnë:

- *Kohë e kufizuar*: Koha e kufizuar si dhe periudha kur u krye studimi, ndikuan mbi kuadrin e modelimit. Disa nga personat e trafikuar, që kishin rënë dakord për t'u intervistuar, nuk ishin në dispozicion brenda asaj kohe që ishte caktuar për studimin tonë. Ndërkohë që u bën të gjitha përpjekjet për të zgjidhur problemet e planifikimit kohor, kjo nuk u arrit gjithmonë. Një tjetër pengesë ishte dhe fakti që intervistat u mbyllën brenda një periudhe prej katër deri gjashtë javësh, që u përputh me periudhën festive të Krishtlindjeve dhe të Vitit të Ri.
- *Vështirësia e zgjedhjes*: Duhet mbajtur parasysh se vetë fakti që të intervistuarit përfitonin tashmë nga procesi i marrjes së ndihmës brenda programit, krijonte një vështirësi më vete për përzgjedhjen e tyre dhe, besojmë se duhet mbajtur parasysh kur lexohen dhe analizohen të dhënat. Personat që varen nga ndihma mund të mos jenë plotësisht të qetë për të diskutuar problemet, duke menduar se informacioni që do të ofronin do të kishte pasoja negative në kuptimin e vazhdimin të përfitimit të këtij shërbimi, ose që do të gjykohej nga ofruesit si një shenjë mosmirënjohjeje. Mund të kishte, po kështu, vështirësi në lidhje me faktin se cilat do të ishin viktimat që do të propozoheshin për intervistim nga organizatat. Në disa intervista, të intervistuarit ishin hezitues për të thënë ndonjë gjë që ata mendonin se do të dëmtonte imazhin e programit, apo dhe të personelit. Nganjëherë, do të duhej inkurajimi i vetë personelit që të intervistuarit të flitnin për problemet që hasnin. Ky faktor, nga ana tjetër, bën që të kuptohet se informacioni që u dha, duhet të konsiderohet edhe më i rëndësishëm dhe mbresëlënës. Ndërkohë që ky kërkim mendohet se është një hap i rëndësishëm për t'i angazhuar viktimat në diskutimin e nevojave dhe shqetësimeve të tyre, duhet mbajtur parasysh se, sidoqoftë, ai është vetëm një pikënisje.

- *Ndoshta një model jopërfaqësues.* Personat që ndihmohen paraqesin vetëm një farë profili përfituesish. Që ata kanë pranuar të marrin ndihmë, nënkupton, përgjithësisht, se ata kanë shumë pak opsione të tjera dhe mund të përbëjnë një kategori veçanërisht të pambrojtur personash të trafikuar (Brunovskis & Surtees 2007, Brunovskis dhe Tyldum 2005, Surtees 2005). Si të tilla, gjetjet tona mund të mos jenë përfaqësuese e personave të trafikuar në përgjithësi, dhe në veçanti, as të atyre që janë në gjendje të negociojnë situatën e tyre të trafikimit, përkundrajt disa përfitimesh (financiare dhe strategjike) dhe/ose që, për rrjedhojë, nuk kanë nevojë për ndihmë apo ndërhyrje.
- *Përzgjedhja e punonjësve kërkimorë.* Për këtë studim u kërkuan punonjës të pavarur, të cilët nuk bënë pjesë në radhën e ofruesve të shërbimeve apo të organizatave ndihmëse. Meqenëse nuk ishte gjithmonë e mundur që të gjendeshin kandidatë të përshtatshëm dhe me kualifikimet e nevojshme, në dy raste këta punonjës u morën nga OJQ-të, që ofronin shërbime ndihmëse. Gjithsesi, niveli i lartë profesional dhe paanshmëria e punonjësve bëri që kontributi i tyre të rezultonte i dobishëm dhe inkurajues për këtë proces kritik dhe vlerësues, i cili shërbeu, të paktën pjesërisht, që të zbutej ai kufizim.
- *Mundësi e kufizuar kontaktimi me viktimat.* Ndërkohë që u kontaktua një numër i madh organizatash në lidhje me punën tonë kërkimore, disa nga to refuzuan të marrin pjesë, duke pretenduar dëmet që do u shkaktoheshin përfituesve që do të merrnin pjesë në këtë kërkim dhe pavarësisht faktit që fokusi i studimit nuk do të binte mbi trafikimin si të tillë, por mbi praktikën/përvojat e identifikimit dhe të ndihmës. Kjo ndryshonte nga një organizatë në tjetrën, të cilat, pasi merrnin të dhënat e hollësishme mbi projektin, parametrat e kriteret e pjesëmarrjes dhe tipin e temave që do të shqyrtoheshin, u këshilluan me përfituesit e shërbimeve të tyre nëse kishin dëshirë të merrnin pjesë në studim, dhe disa prej tyre refuzuan e disa jo. Fakti që disa agjenci refuzuan të marrin pjesë në kërkim, bëri që dhe modeli të ndikohej pasi nuk pasqyroi dhe nuk u mundësoi përfituesve të shprehnin pikëpamjet e tyre mbi përvojat e identifikimit dhe të ndihmës.
- *Vonesa në kohë e intervistave.* Ndërkohë që përvojat e marrjes së ndihmës ishin mjaft të vonshme, disa nga gjetjet në raport pasqyrojnë përvoja më të hershme trafikimi dhe marrje ndihme, dhe jo ato të përjetuara në një kohë më të afërt. Për këtë arsye, disa nga çështjet e

trajtuara nga të intervistuarit mund të jenë prekur në ndonjë rast tjetër. Por, nga ana tjetër, u mbajt parasysh që përvojat e kaluara mund të ndihmojnë që viktimat të kuptojnë drejt dhe të shprehin dëshirën për të marrë pjesë në kuadrin e identifikimit dhe të ndihmës, përvoja që mund të ndikojnë drejtpërdrejt mbi vendimet që marrin viktimat.

2.4. Probleme të etikës

Studimi është ndërmarrë duke patur me kujdes parasysh çështjet etike, të cilat pashmangshmërisht lindin si probleme me personat e trafikuar në një kërkim studimor që përqendrohet mbi viktimat. Puna u krye duke u kushtuar një vëmendje të veçantë çështjeve etike gjatë intervistimit të viktimizeve, siç përshkruhet në botimin e OBT-së, *'Rekomandimet etike dhe të sigurisë për intervistimin e grave të trafikuar'* (*Ethical and safety recommendations for interviewing trafficked women*). Problemet me karakter etik u studiuan me hollësi gjatë takimit parapërgatitor të punës, që u organizua për grupin kërkimor dhe ku u hartua një protokoll për të udhëhequr punën gjatë zbatimit të projektit kërkimor. U trajtuan si shumë të rëndësishme çështje të tilla si pranimi nga i intervistuari, pasi ai/ajo të ishte i/e informuar mirë, fshehtësia, e drejta për intimitet, anonimat dhe siguria e viktimizeve, dhe secili nga punonjësit kërkimorë ishte i detyruar që të firmoste një marrëveshje për ruajtjen e fshehtësisë. Këta punonjës u trenuan mbi mënyrën sesi duheshin drejtuar pyetjet, duke i shprehur mbështetjen dhe duke mos e gjykuar të intervistuarin; duke u paraprirë me profesionalizëm çështjeve dhe pyetjeve që mund të ishin traumatizuese për të intervistuarin. I gjithë grupi kërkimor pati parasysh problemin kyç, atë të organizimit të një interviste të qetë dhe me atmosferë pozitive për të intervistuarin.

Gjatë vënies në jetë të projektit, iu kushtua një vëmendje e veçantë pikërisht këtyre problemeve me karakter etik. Të intervistuarit u kontaktuan nëpërmjet ofruesve të ndryshëm të shërbimeve, të cilët ishin informuar më parë rreth projektit, dhe të cilëve u ishte ofruar një informacion me shkrim rreth projektit kërkimor dhe hollësive mbi rolin e viktimizeve si të intervistuar të mundshëm. Përveç kësaj, gjatë zhvillimit të intervistës, secili i intervistuar informohej gojarisht mbi projektin kërkimor, objektivat e tij, mbi mënyrën sesi do të realizohej intervista, sesi do të përdorej informacioni i marrë, se ata mund të mos u përgjigjeshin pyetjeve për të cilat nuk ndiheshin mirë dhe se ata mund ta ndalonin intervistën në çdo cast, pa dhënë ndonjë shpjegim. Gjithsesi, edhe para fillimit të intervistës, merrej një pëlqim me gojë.

Intervistat u zhvilluan në mjedise private, si mjediset e vetë programeve, apo shtëpitë e të intervistuarëve, zyrat e organizatës dhe në kohën më të përshtatshme për të intervistuarin. Vendi caktohej duke e diskutuar me të intervistuarin, dhe atij i ofrohej opsioni që të mbante pranë ndonjë person tjetër (të besuar), sipas dëshirës. Në rastet kur lindi nevoja për përkthyes për intervistimin e viktimave të huaja, ata u përzgjedhen me kujdes dhe imtësisht, u informuan për çështje të tilla si fshehtësia, anonimati dhe ndjeshmëria e viktimës, dhe u detyruan që të firmosin një marrëveshje fshehtësie. Mëtej, çështja e etikës është mbajtur vazhdimisht parasysht edhe në radhët e grupit kërkimor, dhe procesit të intervistimit iu bënë rregullime në mënyrë që të pasqyroheshin problemet e etikës, që mund të kishin lindur gjatë punës në terren.

Objektivi i intervistave ishte përvoja e viktimës në lidhje me identifikimin dhe ndihmën, dhe jo ajo me trafikimin. Në ato raste kur u diskutuan këto përvoja, ato u bënë me nismën e vetë të intervistuarve dhe intervistuesit u përpoqën, mesa patën mundësi, që ta drejtonin bisedën drejt përvojave të tyre rreth identifikimit, kthimit dhe ndihmës. Intervistuesit, gjithashtu, ishin të vëmendshëm në qetësimin e viktimave dhe gjatë intervistave e siguronin të intervistuarin që ai/ajo mund të refuzonte të diskutonte çdo gjë, që nuk ishte e dëshirueshme për të.

Meqenëse pjesa më e madhe e të intervistuarve ishin tashmë pjesë e programit të ndihmës, për t'u përfshirë në këto programe nuk nevojiteshin, përgjithësisht, referimet. Gjithsesi, çdo punonjës kërkimor ishte i pajisur me të gjitha hollësitë e shërbimeve të ndihmës të disponueshme në vend, në rast se do të dilte nevoja e referimit drejt këtyre shërbimeve. Të intervistuarve, gjithashtu, iu dhanë kontaktet e punonjësit kërkimor në rast se ata do të kishin ndonjë shqetësim apo pyetje në lidhje me studimin, në një fazë të më vonshme. Në rastet kur ne kishim ndonjë problem në lidhje me të intervistuarin apo kontaktet e mëtejshme, punonjësit kërkimorë lidheshin me ta ose u bënë vizitë personave të trafikuar dhe/ose organizatës ndihmuese. Në një vend, punonjësi intervistoi një viktimë, e cila kishte qenë abuzuar, ndërkohë që ishte në programin e ndihmës dhe pas trafikimit. Që nga ai cast, e intervistuarja u zhvendos në një vend të sigurt në një OJQ dhe nuk u kërkua ndonjë ndërhyrje e menjëhershme. Sidoqoftë, me këtë OJQ vazhduan diskutimet rreth nevojës së raportimit dhe ndjekjes së këtij rasti, apo ndërmarrjes së hapave të mëtejshëm, me synimin që ky rast të ndihmohej sipas programit të MTR-së.

Pra, etika dhe siguria kanë qenë, gjithashtu, shqetësimet tona kryesore gjatë përgatitjes së këtij studimi. Të intervistuarve nuk u kërkohesh të jepnin ndonjë informacion identifikues, por dhe kur ata vepronin kështu, këto të dhëna kamufloheshin në shënime që mbaheshin dhe, për rrjedhojë, edhe

në raport. Vetëm punonjësi përkatës dhe koordinatori i kërkimit kishin të drejtë për t'u njohur më shënimet, dhe të gjitha shënimet e punës në terren u mirëmbajtën me kujdes, në përputhje me standardet e brendshme të mbrojtjes së të dhënave të Institutit NEXUS dhe të ICMPD-s. Dhe më tej, në vetë raportin, i gjithë informacioni vetjak, identifikues rreth viktimave individuale është ndryshuar ose është lënë jashtë, në mënyrë që tregimet e viktimës të mos njihen apo identifikohen lehtësisht nga të tjerët dhe në studim nuk paraqiten në ndonjë mënyrë që të përbëjë rrezik apo thyerje të intimitetit të viktimës dhe/ose familjes së saj/të tij.

2.5. Përkufizimet dhe terminologjia e përdorur⁹

Viktimë/person i trafikuar: për shumë persona termi 'viktimë' nënkupton të qenit i pafuqishëm dhe ndërton një identitet mbi faktin e viktimizimit të individit. Në të njëjtën kohë, i parë në kuadrin e të drejtave të njeriut, termi 'viktimë' është domethënës, pasi lidhet me një dhunë të përjetuar dhe me një përgjegjësi për ta vënë të drejtën në vend. Është në këtë kuptim që në këtë raport përdoret termi 'viktimë'. Termi 'person i trafikuar' përdoret këtu, gjithashtu, sepse edhe ai njih si problem qendror përvojën e personit të trafikuar dhe nevojën për ta vënë të drejtën e këtij personi në vend. Të dy termat përkufizojnë personat që kualifikohen si viktima të trafikimit, në përputhje me Nenin 3 të Protokollit të Trafikimit të OKB-s dhe/ose në përputhje me legjislacionin kombëtar përkatës.

Viktimë e ndihmuar: një person, i cili është identifikuar si një viktimë e trafikimit dhe që ka pranuar të marrë ndihmë nga një organizatë jo-qeveritare, qeveritare, ndërkombëtare ose nga ndonjë organizatë tjetër që lidhet me këto fusha veprimi.

Viktimë e identifikuar: një person, i cili është identifikuar si një viktimë e trafikimit, në përputhje me një mekanizëm formal ose jo formal identifikimi.

Viktimë e mundshme: një individ i identifikuar para se të shfrytëzohej, por kur ka shënja të forta se bëhet fjalë për një proces trafikimi. Ky term ndryshon nga termi 'viktimë e hamendësuar', përkufizimi i të cilit shpjegohet më poshtë.

⁹ Shumë nga përkufizimet dhe terminologjitë janë marrë nga *Regional Clearing Point's Second Annual Report on Victims of Trafficking in SEE* (shih Surtees 2005).

Viktimë e hamendësuar: personat që hamendësohen se janë viktimat të trafikimit (pasi përmbushin kriteret e Protokollit të Trafikimit të OKB-s), por që nuk identifikohen formalisht si viktimat të trafikimit nga autoritetet përkatëse, ose që kanë refuzuar të identifikohen zyrtarisht apo ligjërisht. Në disa vende, kësaj kategorie personash iu referohet si 'viktimë e mundshme', gjithsesi, në këtë raport termi viktimë e mundshme ka një kuptim tjetër. Lutemi shihni përkufizimin si më lart.¹⁰

Aktorët anti-trafikim: personat nga OQ-të, OJQ-të ose ON-të, të cilët janë përfshirë në përpjekjet për të luftuar trafikimin e personave dhe që punojnë në një ose më shumë drejtime të identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës.

Ndihma dhe mbrojtja: masat, programet dhe shërbimet me qëllim rikuperimin e personave të trafikuar, siç parashkruhet në Nenin 6 të Protokollit të Palermos. Këto mund të ofrohen nga organizatat jo-qeveritare, qeveritare ose ndërkombëtare në vendet e destinacionit, të tranzitit dhe të origjinës. Mund të përfshijnë, por nuk kufizohen me vendqendrimin/strehimin, kujdesin mjekësor, ndihmën psikologjike, arsimimin, trenimin profesional, punësimin, ndihmën ligjore dhe transportimin. Ndihma mund të përbëhet nga një shërbim ose nga shërbime shumëfishe.

I/e mitur: çdo njeri nën moshën 18 vjeç.

Mekanizmi ose sistemi kombëtar i referimit: i referohet mekanizmave të nivelit kombëtar të referimit të viktimave, të cilat janë ngritur për të identifikuar, kthyer dhe ndihmuar viktimat e trafikimit. Këto mekanizma ekzistojnë në vendet e tranzitit, të destinacionit dhe të origjinës dhe ia referojnë rastet të gjithë sistemit/procesit të referimit në nivel kombëtar, që nga identifikimi fillestar deri tek ndihma dhe mbrojtja, duke angazhuar bashkëpunimin midis institucioneve të ndryshme qeveritare dhe aktorëve jo-qeveritarë. Referimi mund të nënkuptojë një nga këto hapat, ose të gjithë hapat.

Rikuperimi: procesi gjatë të secilit viktimat e marrin veten dhe stabilizohet mirëqënia e tyre psikologjike, sociale dhe fizike.

¹⁰ Secili vend i rajonit ka një terminologji të ndryshme për personat e trafikuar, veçanërisht për ata që konsiderohen 'në rrezik' për t'u trafikuar dhe për ata që konsiderohen se janë trafikuar, por që nuk janë identifikuar formalisht si të tillë nga autoritetet. Përveç kësaj, organizatat e ndryshme shpesh përdorin terma të ndryshme për këto kategori. Në kontekstin e këtij studimi, ne përdorim terminologjitë 'viktimë e mundshme' dhe 'viktimë e hamendësuar', siç u parashkruan në përkufizimet e dhëna më lart dhe jo sipas terminologjisë që mund të përdoret ndonjë organizatë.

Ri-integrimi/integrimi: ri-integrimi ose integrimi i viktimave të trafikimit përqendrohet mbi ribashkimin e individit me familjen apo komunitetin e saj/të tij, ose mbi integrimin e personit të trafikuar në një komunitet të ri. Përveç veprimit fizik të kthimit, ai nënkupton bashkimin/pajtimin me mjedisin social të individit dhe synohet si një zgjidhje social-ekonomike afat-gjatë.

Kthimi: të kthyerit në vendin dhe/ose komunitetin e vet të origjinës. Në kontekstin e punës anti-trafikim, kthimi nënkupton jo vetëm transportimin fizik të viktimës, por edhe mekanizmat të cilat sigurojnë që kthimi është i sigurt dhe dinjitoz.

Ofruesit e shërbimeve: organizatat dhe individët që ofrojnë një ose më shumë nga tërësia e shërbimeve dhe e ndihmave që janë në dispozicion të viktimave të trafikimit. Ofrues shërbimesh mund të jenë punonjësit socialë, psikologët, personeli i strehimit, personeli mjeksor ose profesionistët ligjorë nga OJQ-të, ON-të dhe OQ-të.

Mjediset e strehimit/rezidenciale: janë mjedise që mundësojnë qëndrimin në to të viktimave të trafikimit përkohësisht, ose dhe për një kohë më të gjatë. Strehëzat mund të jenë të hapura ose të mbyllura; mund të ofrojnë qëndrim afat-shkurtër ose afat-gjatë; dhe/ose përdoren për rastet e emergjencave ose të mbështetjeve për ri-integrim.

Mekanizmat transnacionalë të referimit: këto u referohen mekanizmave dhe sistemeve të projektura për të ofruar ndihmë të gjithanshme dhe mbështetje transnacionale viktimave të trafikimit. Mekanizmat transnacionalë të referimit e lidhin të gjithë procesin e referimit, që nga identifikimi fillestar, kthimi dhe ndihma, me vendet e tranzitit, destinacionit dhe të origjinës dhe nënkupton bashkëpunimin midis institucioneve të ndryshme qeveritare dhe aktorëve jo-qeveritarë. Këto mekanizma mund të angazhojnë një ose më shumë veprime referimi në këtë proces.

Mbrojtja e dëshmitarit: tërësia e masave të sigurisë, të nevojshme për të garantuar mbrojtjen e dëshmitarit në procedimet ligjore. Mbrojtja e dëshmitarit mund të ofrohet para, gjatë dhe/ose pas procedimeve ligjore dhe mund të përfshijë një masë apo kombinim masash, të cilat vihen në lëvizje për sigurimin e jetës dhe të mbrojtjes së dëshmitarit dhe të familjes së tij/të saj.

3. Trafikimi dhe anti-trafikimi në Evropën Juglindore

Ky seksion do të ofrojë një vëzhgim të shkurtër mbi si realizohet sot trafikimi në, drejt dhe nëpërmjet rajonit të SEE-s. Në terma shumë të përgjithshëm, këtu do të shqyrtohen, gjithashtu, profilet e viktimave dhe çështjet që lidhen me pambrojtshmërinë e tyre dhe përvojat e trafikimit. Po me të njëjtin theks, ky seksion do të marrë në shqyrtim gjendjen aktuale të përpjekjeve anti-trafikim në rajon, duke i kushtuar vëmendje të veçantë kuadrit të identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës, si dhe të sistemeve kombëtare të referimit.

3.1. Kush janë viktimat e trafikimit?

Rajoni i SEE-s është një zonë origjine, tranziti dhe destinacioni për viktimat e trafikimit. Viktimat trafikohen në një numër të madh në drejtim të këtij rajoni, nëpërmjet rajonit dhe nga rajoni; me mijra viktima janë identifikuar dhe ndihmuar që nga fundi i viteve 1990s.¹¹ Disa vende si – Shqipëria, Rumania, Moldavia dhe Bullgaria janë kryesisht vende të origjinës – me një numër të

¹¹ Numri total i viktimave të trafikuar, të identifikuar dhe të ndihmuara gjatë periudhës 1 janar 2000 deri 31 dhjetor 2004 brendapërbrenda vendeve të Evropës Juglindore ishte 6,255 (Surtees 2005: 12).

madh viktimash të trafikuar nga secili prej këtyre vendeve çdo vit. Ekzistojnë sinjale paraprake që vende të tilla si Rumania dhe Bullgaria po bëhen gjithmonë e më shumë vende tranziti dhe destinacioni, prurje këto që ka shumë të ngjarë të fryhen me aderimin e tyre së fundmi në BE. Vendet/entitetet e tjera në rajon si – Kroacia, BH, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (FYROM), Serbia, Mali i Zi dhe Territori i Kosovës nën Administrimin e OKB-s – kanë qenë tradicionalisht vende tranziti dhe destinacioni, por kohët e fundit po dalin si vende të origjinës, me shtetas të tyre që trafikohen si brendapërbrenda kufijve të tyre, ashtu dhe jashtë tyre.

Vetë viktimat janë një popullatë e larmishme, me përvoja të qarta trafikimi, ku përfshihen burra, gra dhe fëmijë të të gjitha moshave. Sigurisht, gratë përbëjnë pjesën më të madhe të viktimave të identifikuar dhe të ndihmuara, përgjithësisht të trafikuar për shfrytëzim seksual, megjithëse në disa raste rezultoi se janë trafikuar edhe për punë të detyruar, si për shembull punë nëpër familje. Përveç kësaj, në vitin 2004, Programi Rajonal i Pikës së Kontrollit (the Regional Clearing Point Programme, RCP)¹² dokumentoi një numër për t'u mbajtur parasysh të viktimave meshkuj midis atyre që morën ndihmë në rajonin e SEE-s në 2004. Më e dukshme ishte situata në Shqipëri, ku 70 përqind e viktimave të trafikuar për punë, lypje dhe akte të tjera kriminale në vitet 2003 dhe 2004 ishin djem të mitur. Po ashtu, 47.8 përqind të viktimave të huaja të trafikimit për punë në Serbi në vitin 2004, ishin meshkuj, si të rritur ashtu dhe të mitur. Viktimat meshkuj ishin trafikuar për punë, lypje, akte të tjera të dënueshme dhe birësime. Në raportin e RCP nuk kishte të dokumentuar asnjë rast për shfrytëzim seksual, megjithëse në vitin 2003 dy meshkuj moldavë – 48 dhe 23 vjeç – raportuan rastin e tyre në policinë moldave dhe u identifikuan si viktima të trafikimit. Të dy burrat ishin gënjyer me premtime për punë në Maqedoni, por u detyruan të punojnë në ndërtim gjatë ditës dhe të ofronin shërbime seksuale gjatë natës (Surtees 2005: 302-303). Për më tej, IOM Shkup kreu një vëzhgim të sektorit të seksit të meshkujve, i cili gjeti që gjashtë përqind e homoseksualëve të vëzhguar, kishin shfrytëzuar shërbimet e një të huaji, të trafikuar për shfrytëzim seksual dhe 16 përqind kishin njohje të drejtpërdrejta me dikë nga komuniteti e homoseksualëve, që kishin përdorur shërbimet e një të huaji, të trafikuar për shfrytëzim seksual (Handziska dhe Schinina, 2004:

¹² RCP u ngrit nën kuadrin e Task Forcës të Paktit të Stabilitetit për Trafikimin e Personave në vitin 2002, për të siguruar të dhëna rajonale të standardizuara mbi trafikimin dhe ndihmën e viktimave, dhe për të mbështetur zhvillimin e mëtejshëm të programeve të ndihmës për viktimat nëpër të gjithë Evropën Juglindore (SEE). Në qershor të 2005 programi RCP u transferua pranë Institutit NEXUS, në Vjenë.

10-14). Për t'u shënuar në këtë rast është që, nga viktimat meshkuj të intervistuar gjatë studimit tonë, një numër i pakët kishte qenë i shfrytëzuar seksualisht.

Po ashtu, të miturit përbënin një numër të rëndësishëm të viktimave të ndihmuara në disa vende. Në 2003 dhe 2004, të miturit përbënin 20 përqind dhe 65 përqind të viktimave serbe të ndihmuara, 100 përqind të viktimave shqiptare të trafikimit për punë, lypje dhe akte kriminale, si dhe 58.6 përqind të viktimave të ndihmuara në BH (Surtees 2005: 13).

Përvojat e trafikimit ishin, gjithashtu, të ndryshme dhe përfshinin raste të shfrytëzimit seksual, për punë, lypje, akte kriminale dhe birësime, siç jepet me hollësi në tabelën e mëposhtme. Më së shumti, kemi të bëjmë me raste të shfrytëzimit seksual dhe për punë, por u vunë re edhe kombinime të formave të tjera të shfrytëzimit.

Tabela 1: Format e trafikimit të shtetasve të ndihmuar në vendet e SEE-s, 2003 dhe 2004

Format e trafikimit	2003	2004
Shfrytëzimi seksual	824 (65.2%)	864 (74.2%)
Punë	91 (7.2%)	48 (4.1%)
Lypje dhe shkelje të tjera	51 (4%)	75 (6.4%)
Birësim	0 (0%)	9 (0.8%)
Shfrytëzim seksual dhe punë	245 (19.4%)	97 (8.3%)
Shfrytëzim seksual, lypje dhe shkelje të tjera	10 (0.8%)	27 (2.3%)
Punë, lypje dhe shkelje të tjera	11 (0.9%)	2 (0.2%)
Shfrytëzim seksual, punë, lypje dhe shkelje të tjera	1 (0.1%)	0 (0%)
Viktima të mundshme ¹³	31 (2.5%)	43 (3.7%)
Totali	1264 (100%)	1165 (100%)

Burimi: Surtees, R. (2005) *Raporti i dytë vjetor mbi viktimat e trafikimit në Evropën Juglindore*. Gjenevë: IOM & RCP.

Një mori faktorësh dhe variablësh shkaktojnë pambrojtshmërinë e individit ndaj rrezikut të trafikimit dhe shpesh, ky rrezik shfaqet të jetë një kombinim faktorësh, që më vonë përkthehen në rrezik trafikimi. Problemet kyçe të vëna

¹³ Ky përcaktim u përdor në kërkimin që realizoi RCP për rastet, kur individët u ndihmuan për një kohë të pamjaftueshme gjatë së cilës do të mund të përcaktohej përvoja e tyre e trafikimit, ose kur individit identifikohesh dhe ndihmohej para se të shfrytëzohej, por kishte shënja të forta që tregonin se ishte në procesin e trafikimit.

re përfshinin, por nuk kufizoheshin me moshën, marrëdhëniet familjare, arsimin, mundësitë ekonomike dhe të punësimit në vendin e vet dhe me përkatësinë etnike. Në të njëjtën kohë, megjithëse këta faktorë çënojnë apo shtojnë nivelin e pambrojtshmërisë së tyre, dhe mund të mos jenë të paevitueshëm, gjithsesi, ka shumë përjashtime, të cilat mund të merren parasysh gjatë projektimit dhe zbatimit të programeve. Për shembull, ndërkohë që shumë viktima vijnë nga një sfond ekonomik 'i varfër' ose 'shumë i varfër', një numër çuditërisht i lartë viktimash vinin nga familje me nivel 'mesatar' ose 'të pasur'. Po kështu, ndërsa shumë viktima të trafikimit kishin një nivel të ulët arsimor, shpesh ky kontigjent ishte në të njëjtin nivel me thuajse të gjithë popullsinë, dhe një numër i vogël viktimash nga vende si Ukraina, Moldavia, Rumania dhe Bullgaria kishin edhe nivelin universitar apo atë të shkollës së mesme. Dhe, ndërkohë që marrëdhëniet problematike në familje ishin, në shumicën e rasteve, si një katalizë për individët që të migronin, shumë viktima raportuan për marrëdhënie të mira dhe mbështetëse në familje dhe në komunitet. Në disa raste, mund të kenë qenë pikërisht këto marrëdhënie pozitive (dhe dëshira për të mbështetur dhe ndihmuar familjen), që i kishin bërë viktimat të migronin (Surtees 2005).

Disa nga kërkimet e bëra shqyrtojnë faktorët e ndërlikuar dhe, shpesh, shumë shtresorë që shërbejnë si mundësi të krijimit të gjendjes së pambrojtshmërisë dhe si pikë nxitëse për trafikim. Aspiratat e jetës duket se përbëjnë një nga këta faktorë. Në një studim në Rumani, u gjet që vajzat "në rrezik" kishin prirje të ushqenit një dëshirë të fortë për të kërkuar punë jashtë vendit, madje ishin gati dhe të thyenin rregullat zyrtare dhe jo formale. Vajza të tilla, lehtësisht të cënueshme, kishin prirje që të ishin mjaft të pavarura dhe që ta merrnin rrezikun në sy, të afta të përballeshin me pasiguritë (Alexandru & Lazaroiu 2003; cf. Bjerkan 2005; Brunovskis & Tyldum 2004). Kërkimet e tjera kanë vënë në pah se, shumë viktima bien viktima të trafikimit si rezultat i një krize, si për shembull, i ndonjë sëmundjeje të rëndë në familje, apo i një kërkese urgjente për para (Brunovskis & Tyldum 2004; Surtees 2005; Bjerkan 2005). Disa studime të tjera sugjerojnë që, trafikimi mund të ndodhë kur personat migrojnë për të realizuar detyrimet e tyre sociale dhe kulturore për të mbështetur familjen e tyre, për të përmbushur rolet që u janë caktuar nga pikëpamja sociale – për gruan/nënë, vajzën apo djalin, e kështu me radhë (Surtees 2005; 2003; 2000), dukuri kjo që u dokumentua edhe gjatë punës në terren që u krye për këtë studim. Një variabël shtesë është dhe fakti që shumë viktima vijnë nga shoqëria, ku migrimi është një normativë shoqërore (Brunovskis & Tyldum 2004; Surtees 2005 & 2003). Është vënë re, gjithashtu,

se në kontekstin e diskutimeve evolutive sociale dhe kulturore, prekshmëria nga trafikimi nuk është as një rrezik i drejtpërdrejtë dhe as i paevitueshëm, dhe se identifikimi i rrezikut është një proces i vazhdueshëm (Surtees 2003).

3.2. Përpjekjet anti-trafikim – identifikimi, kthimi dhe ndihma

Problemet që lidhen me ofrimin e ndihmës për viktimat janë analizuar në një numër dokumentesh dhe konventash ndërkombëtare, ndoshta më shumë në Protokollin e OKB-s mbi *Parandalimin, Shtypjen dhe Dënimin e Trafikimit të Personave*. I njohur edhe si Protokollin e Palermos, ky dokument parashkruan në Nenet 6, 7 & 8, të drejtat e përgjithshme dhe shërbimet që duhet të ofrohen në kontekstin e mbështetjes dhe të mbrojtjes së viktimës. Në nivelet rajonale dhe kombëtare, ndihma garantohet edhe nëpërmjet disa dokumenteve të tjera. Për shembull, në BE, ku po trafikohet një numër gjithnjë e më i madh viktimash të rajonit të SEE-s, *Plani i Veprimit i BE-s* u bën thirrje Shteteve Anëtare të saj që të ofrojnë mbrojtje dhe ndihmë viktimave, si pjesë e një ndjekjeje të drejtpeshuar dhe efektive penale dhe në përputhje me kushtet dhe praktikat kombëtare (4, vii). Po ashtu, në Konventën e Këshillit të Evropës, *Mbi Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (on Action Against Trafficking in Human Beings)*, Kapitulli III përshkruan masat për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e viktimave. Parimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me procesin e identifikimit dhe të referimit trajtohen edhe te *Plani i Veprimit të OSBE-s*, te *Parimet dhe Udhëzimet e Rekomanduara të OKB-s mbi të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimin Njerëzor* dhe te *Udhëzimet e UNICEF-it mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve Viktima*.

Identifikimi, kthimi dhe ndihma e personave të trafikuar kërkon marrjen parasysh të një sërë faktorësh, çështjesh dhe situatash. Duke qenë se format e shfrytëzimit dhe profilet e viktimave, të identifikuara në rajon, janë nga më të larmishmit, edhe mekanizmat e identifikimit dhe të ndihmës duhet të jenë të ndryshëm dhe mjaft të sofistikuar. Ndryshueshmëria e përvojave të trafikimit dhe ndërloja e ndërlikuar midis faktorëve të zgjedhjes dhe atyre të detyrimit, duhet, gjithashtu, të merren parasysh në këtë proces.

3.2.1. Procedurat e identifikimit

Në rajonin e SEE-s, fillimisht u ngritën mekanizmat e identifikimit të viktimave të trafikimit për t'iu përgjigjur një lloji viktime, që mendohej se ishte prototip i viktimës, pra – një grua e re, e rritur, e trafikuar për shfrytëzim seksual. Dhe

kriteret ekzistuese të identifikimit ishin të orientuara kryesisht në drejtim të identifikimit të këtij prototipi viktime, ku përgjithësisht mungojnë kritere më të gjëra, më përfshirëse. Ky lloj orientimi ka bërë që shumë aktorë anti-trafikim të mos kërkojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe proaktive që të identifikonin format e tjera, alternative, të trafikimit dhe/ose të viktimave me profile të ndryshme. Në disa raste, policia, nga njëra anë, identifikonte viktima “të mundshme” të trafikimit seksual,¹⁴ ndërsa në anën tjetër, nuk arrinte të identifikonte viktimat e trafikimit për punë në të zezë (si meshkuj, ashtu dhe gra), duke i trajtuar ata si migrantë të paligjshëm (Surtees 2005a: 497, 513). Nevoja e përqendrimit të vëmendjes, përgjithësisht, mbi viktima femra të rritura ka bërë që aktorët identifikues të mos kenë fituar aftësi të domosdoshme dhe training të përshtatshëm për filtrimin e kujdesshëm dhe intervistimin e të miturve.

Një gjindet shpesh ndonjë legjislacion specifik mbi identifikimin dhe filtrimin e viktimave. Megjithatë, disa vende kanë përfshirë dispozita mbi identifikimin brenda planeve të tyre kombëtare të veprimit, dhe *Plan i Veprimit i BE-së* u bën thirrje Shteteve Anëtare të ngrejë një strukturë qeveritare të mirë bashkërendimi për identifikimin e hershëm dhe referimin e personave të trafikuar. Por, janë të rralla metodologjitë dhe udhëzimet për filtrimin dhe identifikimin e viktimave të trafikimit. Disa vende kanë hartuar një listë treguesish, ose kanë formuluar pyetësorë për intervistimin e viktimave të dyshuara të trafikimit. Gjithsesi, në këtë fushë ekzistojnë më shumë përjashtime se sa rregulla (IOM 2005a: 12-13).

Një tjetër çështje në lidhje me hapat që ndiqen për identifikimin e një viktime, apo të një viktime të dyshuar të trafikimit, është sistemi i referimit. Disa vende kanë procedura të qarta referimi për këto rrethana, ndërsa të tjerave u mungon sistemimi i procedurave. Edhe në ato raste kur ekzistojnë sistemet, nuk është gjithmonë e qartë nëse të gjithë aktorët identifikues kanë të njëjtin nivel njohurie mbi proceset e identifikimit dhe të referimit. Siç doli e qartë gjatë intervistave me viktimat e trafikimit, identifikimi mund të ndodhte, në shumicën e rasteve, kur aktorët privatë apo publikë të identifikimit të ishin të pajisur me informacionin e duhur mbi këtë proces dhe të ishin treinar si duhet në drejtim të njohjes së mekanizmave të identifikimit dhe të referimit. Është, po ashtu, me rëndësi që, procedurat e identifikimit t’u përgjigjen të gjitha formave ekzistuese të trafikimit dhe t’u përshtaten profileve të viktimave. Këto procedura duhet, gjithashtu, të pasqyrojnë e të ndjekin prirjet dhe

¹⁴ Në kontekstin e këtij shembulli, termi ‘viktimë e mundshme’ i referohet dikujt që jep shenja të forta se është në proces trafikimi, por që ende nuk është shfrytëzuar.

modelet e kohës, si trafikimi i brendshëm, ose ndryshimi i rrugëve që përdoren nga trafikantët (ICMPD 2006: 46; Surtees 2005).

Jo gjithmonë ndërmerret shqyrtimi i rrezikut për viktimat e mundshme dhe të identifikuar, i cili është një hap i domosdoshëm për të gjitha fazat e procesit të identifikimit dhe të referimit. Menjëherë sapo të bëhet identifikimi, duhet të ndërmerret shqyrtimi i standardizuar i rrezikut. Niveli i rrezikut është i luhatshëm – shtohet ose pakësohet – sipas situatës, kohës, vendndodhjes dhe në varësi të faktit nëse individit ka lëshuar ndonjë deklaratë ose jo, apo është duke bashkëpunuar (ose mendohet se është duke bashkëpunuar) me policinë ose jo, duke e bërë, në këtë mënyrë, shumë të rëndësishme marrjen e masave për të parashikuar çdo rrezik të mundshëm në të ardhmen. Shqyrtimet e rrezikut nuk janë statike; ato janë një proces në vazhdimësi dhe me përgjegjësi.

Përgjithësisht, mendohet që identifikimi ndërmerret në vendin e destinacionit. Gjithsesi, në intervistat me personat e trafikuar u zbulua se shumë nga këta persona ishin identifikuar në vendin e tyre të origjinës. Në disa raste, kjo kishte ndodhur menjëherë pas kthimit (dëbimit ose kthimit vullnetar) në kohën kur kisin rënë në kontakt me policinë ose me agjencitë ndihmëse në pikat kufitare apo në vendet e tranzitit. Në situata të tjera, gjithsesi, viktimat u vetë-identifikuan, duke përfituar ndihmë pasi ishin kthyer në mënyrë të pavarur, ose pasi kishin kaluar pa u identifikuar nëpërmjet procesit të kthimit/të deportimit. Kjo ve në dukje mangësitë që ekzistojnë në procesin e identifikimit në vendet e destinacionit dhe të tranzitit dhe, në të njëjtën kohë, flet për rëndësinë e ngritjes së mekanizmave të larmishëm të identifikimit, të bazuar mbi kulturën e komunitetit në vendet e origjinës.

3.2.2. Procedurat e kthimit dhe të referimit

Parimi më i rëndësishëm që duhet ndjekur është: kthimi duhet të jetë i sigurt dhe me dinjitet për të gjithë personat e trafikuar, dhe viktimat nuk duhet të kthehen në vendet, ku ka një dyshim të bazuar se do të vuanin, ndëshkoheshin, fajësoheshin ose diskriminoheshin. Në rastet kur kthimi duhet të kryhet, janë një sërë hapash të rëndësishëm që duhen ndërmarrë në procesin transnacional të kthimit dhe referimit, siç përvijohen më poshtë:

- Përgatitja e viktimës për kthimin (dhënia e informacionit mbi opsionet e mundshme);
- Përgatitja e dokumenteve dhe e marrëveshjeve të udhëtimit;
- Komunikimi dhe bashkërendimi midis destinacionit/tranzitit dhe origjinës;

- Shqyrtimet e rrezikut (niveli i sigurisë dhe analiza e familjes);
- Transportimi dhe procesi i udhëtimit me mbështetje (përfshirë kthimin me shoqërim, në rast nevojë), dhe ndihma në tranzit;
- Pritja dhe referimi në vendin e tij/të saj.¹⁵

Sot për sot në SEE, përgjithësisht nuk janë të zhvilluara sa duhet mekanizmat e kthimit dhe të referimit, megjithëse disa organizata zbatojnë standarde më të larta në drejtim të proceseve të kthimit, përfshirë dhe kthimet me shoqërim dhe shqyrtimin e faktorëve të sigurisë, para se të ndodhë kthimi. Aktualisht, kthimet dhe referimet kanë prirje që të operojnë në bazë të lidhjeve e rrjeteve organizative, gjë që do të thotë, përgjithësisht, se viktimave jo gjithmonë u ofrohet gama e plotë e shërbimeve të disponueshme në vendin pritës, por vetëm ato që ofrohen nga agjencia ndihmuese dhe partnerët e saj. Ndërkohë që bashkëpunimi dhe komunikimi midis organizatave të SEE-s është përmirësuar, disa organizata në vendet e tranzitit dhe të destinacionit nuk zotërojnë informacion të plotë dhe të përditësuar në lidhje me praninë e shërbimeve të ri-integrimit brenda vendeve të origjinës. Kjo mungesë informacioni pengon ofrimin e tij viktimave të huaja rreth pranisë së opsioneve të ndihmës, të disponueshme në kthim, dhe planifikimin e duhur të trajtimit të rastit në fjalë. Më tej, ofruesve të shërbimeve në vendet e origjinës shpesh u referohen viktimat për të cilat kanë vetëm një informacion të kufizuar, gjë që rezulton në një proces të zgjatur ri-intervistimi dhe ofrim të pakët të kujdesit për viktimën e referuar. Po ashtu, problem mbetet bashkëpunimi dhe referimi përtej kufijve të SEE-s, që sjell më shumë viktimat të trafikuara në drejtim të BE-s, Turqisë, ish Bashkimit Sovjetik dhe Lindjes së Mesme. Ka lindur nevoja e lidhjeve me organizatat përkatëse në këto destinacione dhe e një bashkëpunimi ndër-qeveritar (Surtees 2005, 2006a, cf. Bjerkan 2005).

Një tjetër çështje për t'u vënë në dukje, është që shumë viktimat përjetojnë një kthim pa patur mbështetjen e duhur. Shumë viktimat "të vetë-kthyerat", udhëtojnë në mënyrë të pavarur (dhe pa mbrojtje) dhe me paratë e tyre. Për më tej, një numër i madh viktimash vazhdojnë të kthehen nga vendet e destinacionit në BE, Turqi dhe Lindjen e Mesme dhe identifikohen si viktimat

¹⁵ Përveç kësaj, duhet t'i kushtohet një vëmendje e veçantë si realizohet kthimi i të miturve. Këtu përfshihet, por nuk kufizohet me, kthimi me shoqërim, shqyrtimet e sigurisë dhe të familjes para kthimit, të qendrës pritëse/strehimit të sigurt, që do t'i përgjigjen nevojave të veçanta të të miturve dhe caktimit të një kujdestari ligjor, si në vendin e destinacionit, ashtu dhe në atë të origjinës.

të trafikimit vetëm në vendin e tyre të lindjes.¹⁶ Pak janë ato viktimat në rajonin e SEE-s, të dëbuara nga BE dhe vendet e tjera të destinacionit, që marrin ndonjë informacion para kthimit në lidhje me mundësitë e ndihmës, të mbrojtjes dhe ri-integrimit në vendin e tyre të origjinës, duke shkelur kështu standardet dhe detyrimet ndërkombëtare (Surtees 2006a).

3.2.3. Ndihma dhe mbrojtja

Ofrimi i ndihmës dhe i mbrojtjes – qoftë në vendin e origjinës, të tranzitit apo të destinacionit – duhet të jetë i fshehtë dhe të ndërmerret në një mënyrë të tillë që të mos identifikohet personi si i trafikuar, për të menjuar fajësimin social dhe diskriminimin dhe/ose zbulimin e tij para rrezikut të ndëshkimit nga ana e trafikantëve. E gjithë ndihma duhet të jetë vullnetare, jo-diskriminuese, jo-gjyquese dhe në përputhje me parimet e të drejtave të njeriut (ICMPD 2006). Shërbimet duhet të jenë elastike dhe t'u përgjigjen nevojave e interesave specifike të tipave të ndryshëm të viktimave (meshkuj, të mitur, viktimat kombëtare dhe të trafikuarat brendapërbrenda), si dhe të viktimave të formave të ndryshme të trafikimit (punë, seks, lypje, shkelje penale) dhe duhet të përshtaten me kalimin e kohës, t'u përgjigjen prirjeve dhe zhvillimeve të reja në këtë fushë (Surtees 2006a: 15). Një vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet të miturve, në kuptimin e shqyrtimit të nevojave të tyre dhe të ofrimit, përkatesisht, të ndihmës dhe të mbrojtjes.

Në vendet e tranzitit dhe të destinacionit

Shërbimet afat-shkurtëra dhe ndërhyrjet në rast krize për viktimat e huaja është orientimi kryesor i shërbimeve në pjesën më të madhe të vendeve të tranzitit dhe të destinacionit, megjithëse këto, përgjithësisht, planifikohen më shumë për të rriturit se sa për të miturit. Shtetasit e huaj shtrehohen në strehëza (zakonisht godina të mbyllura) dhe atyre u ofrohet ndihma emergjente, si për shembull, kujdes mjekësor, nevojat bazike (veshje dhe ushqim), ndërhyrje psikologjike në rast krize, veprimtari krijuese dhe ndihmë ligjore (përgjithësisht në formën e përpunimit të dokumentit, megjithëse për disa edhe përfaqësim ligjor) para kthimit të tyre në vendin e lindjes. Në varësi të rrjetit dhe kontakteve

¹⁶ Për shembull, 2978 gra bullgare u dëbuan nga vendet e BE-s në vitin 2003, dhe 2908 u dëbuan në 2004, një përqindje e të cilave mund të kishin qenë viktimat e trafikimit. Sipas Shërbimit Kombëtar të Policisë Kufitare, rreth dhjetë përqind e grave të dëbuara, mund të ishin viktimat e trafikimit, por që nuk ishin identifikuar si të tilla para ekstradimit. Po kështu, 221 nga 291 viktimat, të ndihmuara nga një organizatë shqiptare, ishin dëbuar për në Shqipëri, të cilat u identifikuan nga zbatuesit e ligjit kur u kthyen në vend (Surtees 2005).

që ka agjencia ndihmuese, këta persona mund të referohen për ndihmë edhe në vendin e tyre të origjinës.

Në disa vende, ku shtetasit e huaj marrin leje qendrimi të përkohshme apo të përhershme¹⁷, ata kanë mundësinë e përfitimit të një ndihme me afat më të gjatë (që idealisht përqendrohet drejt ri-integrimit). Në kësi rastesh, ofrimi i shërbimeve realizohet njëloj si dhe për viktimat e vendit.¹⁸ Atje ku nuk është ky rast, ndihma e marrë nëpërmjet sektorit social, mund të ofrojë përkujdesjen e nevojshme më afat-gjatë.

Në vendet e origjinës

Viktimat kthehen në shtëpi edhe të ndihmuara (nëpërmjet programeve të kthimit të ndihmuar të OJQ-ve dhe ON-ve) edhe të pandihmuara (nëpërmjet masave të dëbimit dhe vetë-kthimit). Si të tilla, me mbërritjen në vendin e origjinës, disa viktimat mund të kenë përfituar tashmë ndihmë (përfqjithësisht afat-shkurtër/emergjence), ndërsa të tjerat, jo. Ndhma në vendet e origjinës është kryesisht e përqendruar drejt shërbimeve të ri-integrimit, megjithëse viktimat kanë opsionin e përfitimit të ndihmës afat-shkurtër, kur kthehen, dhe/ose të përfitimit të shërbimeve si mjet ndërhyrjeje në rast krize në faza më të vonshme. Format standarde të ndihmës së disponueshme në vendet e origjinës përfshijnë strehim të sigurt (afat-shkurtër, afat-mesëm dhe afat-gjatë), nevojat bazike (ushqim, veshje), kujdes mjekësor, ndihmë ligjore, ndihmë psikologjike, gjetje pune, trajnim profesional, arsimim, ndërmjetësim në familje, veprimtari krijuese, ndihmë strehimi, mbështetje financiare, etj. Shtrirja dhe cilësia e shërbimeve

¹⁷ Në dhjetor 2002, vendet e rajonit të Ballkanit firmosën deklaratën e Tiranës mbi Angazhimet në lidhje me legalizimin e statusit të viktimave të trafikuar, përfshirë dhe një angazhim për lëshimin e lejeve të përkohshme të qendrimit (TRPs) për viktimat e huaja të trafikimit. Në gusht 2003, me nismën e Task Forcës mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore të Paktit të Stabilitetit (SPTF) dhe me financim nga Fondacioni King Baudouin (KBF), IOM shpalli projektin “Ndërtimi i mekanizmave për leje të përkohshme qendrimi për viktimat e trafikimit dhe dëshmitarët në Ballkan”, me synimin e forcimit të kapacitetit të lojtarëve përkatës në rajonin e Ballkanit për të plotësuar detyrimet e tyre brenda kuadrit të mbrojtjes dhe ndihmës për viktimat e trafikimit. Nën programin TRP janë lëshuar tridhjetë e gjashtë leje qendrimi në rajon, qëkur hyri në fuqi legjislativi përkatës (korrespondenca me email me Jovana Skrnjug, IOM Beograd, dhjetor 2006).

¹⁸ Për hollësi të mëtejshme në lidhje me mbrojtjen dhe ndihmën e disponueshme në disa vende të BE-s, shih IOM 2005A, Pearson 2002, van der Kleij 2003. Për hollësi në lidhje me ndihmën e disponueshme në vendet e SEE-s, shih Andreani & Raviv 2004; Dottridge 2004 & 2006; Hunzinger & Sumner-Coffey 2003; ICCO 2004; Kvinna til Kvinna & Kvinnoforum 2003; Kvinnoforum 2003; Bjerkan 2005; Bjerkan & Dyrliid 2006a dhe 2006b; Brunovskis & Surtees 2007; La Strada Moldova 2005; Limanowska 2002 dhe 2003; Pearson 2002; Reiter 2005; Rosenberg 2006; Somach dhe Surtees 2005; Surtees 2005, 2006a, 2006b; Tdh & ARSIS 2006; Tdh 2005; Tozaj 2006; UNICEF 2004; UNICEF & STC 2004; van der Kleij 2003.

ndryshon nga njëri vend tek tjetri, madje edhe nga një agjenci tek tjetra. Në tërësi, një pikë kritike mbetet mungesa e standardeve, e protokolleve dhe e modeleve për ngritjen dhe zbatimin e shërbimeve dhe të ndihmës për viktimën. Në ato raste kur janë hartuar manuale dhe udhëzime, ato shpesh mbeten dokumente të brendshme, që nuk u ofrohen të tjerëve, ose janë tepër të përgjithshëm dhe jo mjaftueshmërisht operacionale¹⁹ (Surtees 2006a: 16).

Ndihma – si ajo afat-shkurtër dhe ajo e përqendruar drejt ri-integrimit në rajonin e SEE-s, bazohet mbi ofrimin e strehimit, të paktën gjatë fazës fillestare dhe vendoset në kryeqytete. Për më tej, shërbimet, përgjithësisht, vendosen nëpër qendra urbane dhe për këtë arsye disa lloj shërbimesh mbeten të pa-arritshme për ata persona që janë jashtë qyteteve të mëdha – për shembull, kujdesi psikologjik dhe psikiatrik, shërbimet e specializuara mjeksore, programe dizintoksikimi, shërbimet për personat me probleme fizike, etj. Gjithsesi, po bëhen gjithmonë e më të disponueshme shërbime jo-rezidenciale në vende të ndryshme nga ato të qendrave urbane dhe nëpër të gjithë vendin. Ndër shërbimet e ofruara si pjesë e shërbimeve të ri-integrimit, janë ato arsimore apo trenime profesionale, gjetje pune për të fituar të ardhura dhe këshillim/ndërmjetësim në familje. Këto lloj shërbimesh janë të përhapura më shumë në vendet tradicionale të origjinës, si në Moldavi, Bullgari, Rumani dhe Shqipëri. Me daljen kohët e fundit të viktimave kombëtare në vendet tradicionalisht vende tranziti dhe destinacioni, si BH, Kroaci, Territori i Kosovës nën Administrimin e OKB-s, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi, në këto vende kërkohen dhe ofrohen gjithmonë e më tepër shërbimet e ri-integrimit. Përfituesit e shërbimeve të ri-integrimit janë, para së gjithash, shtetas të vendit, megjithëse me zbatimin e kohëve të fundit të lejeve të përkohshme të qëndrimit për viktimat e trafikimit në gjashtë vendet e rajonit të SEE-s, mbështetja për integrim u është ofruar edhe shtetasve të huaj.

3.2.4. Sistemet dhe mekanizmat kombëtarë të referimit

Mekanizmat kombëtarë të referimit dhe të ndihmës ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga njëri vend i SEE-s tek tjetri në drejtim të metodës dhe fazes së ndërtimit të tyre. Kryesisht, ata i referohen kuadrit bashkëpunues nëpërmjet të cilit aktorët shtetërorë plotësojnë detyrimet e tyre për mbrojtjen

¹⁹Këtu bën përjashtim *Manuali i ndihmës së drejtpërdrejtë* i IOM që është i zbatueshëm kur ofrohen shërbimet për viktimat e trafikimit nga ana e OJQ-ve dhe qeverive, i cili është për përdorim publik në: http://www.iom.int/jahia/wwbdav/site/myjahiasite/shared/shared/mainsite/published_docs/books/CT%20handbook.pdf.

dhe promovimin e të drejtave të njeriut të personave të trafikuar, në një partneritet strategjik me shoqërinë civile dhe aktorët e tjerë të kësaj sfere (OSBE/ODIHR; Reiter 2005: 20). Objektivi i këtij mekanizmi është që të sigurojë që të gjitha viktimat e trafikimit (kombëtare, të huaja, të trafikuar ndërkombëtarisht dhe brendapërbrenda vendit) të kenë mundësinë e përfitimit dhe të marrjes së mbështetjes dhe të mbrojtjes së duhur, siç parashkruhet në Protokollin e Palermos dhe në legjislacionin përkatës kombëtar. Ndihma dhe mbrojtja duhet të ofrohet dhe të jetë në dispozicion që nga identifikimi fillestar dhe nëpër të gjithë procesin e kthimit dhe referimit, drejt një rikuperimi dhe ri-integrimit të qendrueshëm. Në vijim, kur bëhet referimi drejt mekanizmave kombëtarë të referimit, kjo nuk do të thotë që duhet të zbatohen me rreptësi ato që përshkruhen në manualin e OSBE/ODIHR. Disa vende – si Serbia dhe Maqedonia – kanë ngritur mekanizmat e tyre kombëtarë të referimit sipas atij modeli, duke krijuar një agjenci brenda Ministrisë së Punës, Punësimit dhe Politikës Sociale, përgjegjëse për bashkërendimin e ofrimit të ndihmës dhe të shërbimeve viktimave, duke lidhur dhe bashkërenduar punën me qendrat e punës sociale në të gjithë vendin, si edhe me OJQ-të përkatëse. Gjithsesi, vendet e tjera kanë ndërtuar një sistem të vetin, unik dhe specifik. Për shembull, në Moldavi, Ministria e Shëndetësisë dhe e Politikës Sociale (MoHSP) është përgjegjëse për bashkërendimin e grupeve shumëdisiplinore në nivel rrethi, të cilat janë të ngarkuara me ofrimin e shërbimeve nga organizatat dhe agjencitë e ndryshme, si nga shteti ashtu dhe shoqëria civile. Në Rumani, ndihma për viktimat kontrollohet, bashkërendohet dhe monitorohet nga Agjencia Kombëtare kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, e cila ka tetë qendra rajonale dhe i referon viktimat tek ofruesit e ndihmës, dhe monitoron ofrimin e kësaj ndihme. Dhe në Shqipëri, është ngritur Autoriteti Përgjegjës (i përbërë nga përfaqësues të Sektorëve të Kufirit dhe të Anti-trafikimit, Drejtoria Konsullore dhe Drejtoria e Shërbimit Social) me përgjegjësinë e bashkërendimit të procesit të referimit për një ndihmë fillestare dhe mbrojtje dhe rehabilitim afat-gjatë të të gjitha viktimave të trafikimit, në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha ministritë, institucionet dhe programet që merren me viktimat e trafikimit. Pra, modelet e referimit kombëtar në secilin vend/territor të rajonit ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga njëri-tjetri, ashtu siç ndryshojnë fazat e ndërtimit të tyre, synimet dhe niveli i zbatimit.

4. Identifikimi i përvojave të personave të trafikuar

Gjatë punës kërkimore, një nga shqetësimet tona kryesore ishte të mësuarit e përvojave që kishin kaluar viktimat gjatë identifikimit të tyre – si ishin identifikuar, si e ndjenin veten gjatë identifikimit, dhe cilat ishin, në sytë e tyre, problemet, shqetësimet apo praktikatat e mira të procesit të identifikimit. Ky seksion do të përqendrohet specifikisht mbi këto tri pika kryesore, në një përpjekje për të kuadruar përvojat dhe mendimet e personave të trafikuar që ndodhen në qendër të diskutimeve mbi praktikatat e identifikimit.

4.1. Si ishin identifikuar viktimat

Viktimat e intervistuar ishin identifikuar kryesisht nga aktorë dhe mekanizma të anti-trafikimit – nëpërmjet zbatuesve të ligjit, punonjësve në terren, linjat e komunikimit telefonik, personeli i OJQ-ve dhe i ON-ve, personeli i ambasadave, punëtorët socialë, klientët dhe vetë viktimat. Po ashtu, identifikimi ishte bërë edhe nga persona që, përgjithësisht, nuk janë të përfshirë në punën anti-trafikim, si për shembull, personeli i transportit, qytetarë të thjeshtë dhe organizata fetare.

Zbatuesit e ligjit kishin luajtur një rol kyç në identifikimin e viktimave në rajonin e SEE-s, si dhe përtej këtij rajoni. Zbatuesit e ligjit nuk përfshin vetëm policinë e specializuar anti-trafikim, por edhe autoritetet e imigrimit dhe të

kufirit, njësitë policore të qytetit, policinë ushtarake dhe njësitë kundër krimin të organizuar. Shumë nga viktimat e intervistuar ishin identifikuar si rezultat e një ndërhyrjeje proaktive të zbatuesve të ligjit. Në rastet e tjera, kur familjet depozitonin deklaratat e tyre në polici, kjo çonte në identifikimin dhe lirim të tyre, madje edhe kur bëhej fjalë për raste jashtë vendit. Një grua shpjegoi sesi ishte liruar pasi kishte marrë në telefon bashkëshortin e saj duke i kërkuar ndihmë, nga lokali ku po shfrytëzohej seksualisht:

Sapo kërkuam të më shfrytëzonin seksualisht, unë fillova të kërkojë ndonjë mundësi për t'u lidhur me burrin tim dhe pas disa javësh të një poshtërimi total dhe dhune, njëri nga klientët e mi më la të marrë në telefon shtëpinë. Arrita t'i them burrit se kushëri im më kishte shitur dhe i kërkoja atij të më shpëtonte në qytetin ku ndodhesha, emrin e të cilit arrita t'ia tregoj tim shoqi. Burri bëri një deklaratë në polici dhe policia mori informacionin që unë isha një person në kërkim. Kur ndodhesha në shtëpinë e pronarit tim, në apartament erdhi polici i zonës dhe i tha pronarit se do të kishte shumë probleme për shkak të mbajtjes sime nën detyrim. Më dha para për biletë dhe një ryshfet për të kaluar lehtësisht kufirin. Ai ishte i interesuar që unë të largohesha nga ai vend.

Viktimat e tjera identifikoheshin thujse në të njëjtën mënyrë:

Arrita të marrë në telefon motrën time nga celulari i njërit prej klientëve të mi. I kërkoja asaj të më ndihmonte që të dilja nga ajo skllavëri në të cilën ndodhesha... I dhashë adresën e saktë të vendit ku qendroja. Motra ime kontaktoi njërin nga të njohurit tanë në polici, dhe ai mblodhi informacionin e duhur dhe e përcolli më tej. Mendova se shpëtimi im do të vinte të nesërmen e telefonatës sime, por nuk ndodhi kështu... një vajzë tjetër i tregoi pronarit mbi telefonatën që kisha bërë në shtëpi dhe ai më rrahu... Pas një dite, arrita të marrë përsëri në telefon shtëpinë dhe u thashë, duke qarë, se do të më shitnin në [një vend tjetër] po të mos vinin të më shpëtonin menjëherë. Para kësaj, unë kisha qenë e shfrytëzuar në [një vend tjetër]...Mesa kuptova unë, motra ime, duke dyshuar se veprimet e policisë do të zgjatnin shumë, shkoi tek një organizatë dhe e informoi atë. [Organizata] e dërgoi këtë informacion te [një tjetër organizatë në vendin e destinacionit]. Menjëherë pas kësaj, një ditë më vonë, policia erdhi dhe filloi të na bënte pyetje.

Arrita të njoftojë kushërinjtë e mi dhe t'u tregojë adresën. Nëna ime kontaktoi policinë e qytetit tonë. Në pak javë oficerët e policisë së drejtorisë qendrore... erdhën në tregun ku punoja dhe më morën me vete.

Në disa vende, vetë-referimi ishte një mjet i zakonshëm i identifikimit, vetë viktima kish kuptuar së në çfarë situatë ndodhej, pra në atë të trafikimit ose të paktën të shfrytëzimit.²⁰ Kishte raste kur vendimi për t'u vetë-identifikuar merrej pavarësisht nga rreziku i lartë që mund të vinte nga ky veprim. Një grua, e cila kishte qenë trafikuar nga ish i dashuri i saj, u rrah keq, kur arriti të shpëtonte dhe të kthehej në qytetin e saj të lindjes. Ajo shpjegoi se ishte rrahur dhe torturuar deri në atë pikë sa kishte humbur ndjenjat: "Jam rrahur dhe torturuar edhe më parë, por kësaj here ai gati sa s'më mori jetën. Kisha dhimbje të tmerrshme, dhe thuajse mbarova. Bërtisja në kup të qiellit". Megjithatë, kur arriti të shpëtojë nga ai, ajo shkoi menjëherë në polici:

Kisha shumë frikë. Së pari, për shkak të dhunës fizike. Më pas më përdhunoi, më kërcënoi se do të më linte sakat, nëse do ta denoncoja. Ai tha se në rast se ai futej në burg, do të vinte një tjetër person për të marrë hakun e tij. Kjo gjendje zgjati rreth njëzetekatër orë. Në mengjes më rrahu përsëri. Deri në atë moment nuk isha ende e sigurt nëse do ta denoncoja në polici ... i premtova se nuk do të shkoja në polici. Iu luta që të më lëshonte të ikja tek motra e të merrja pak veten. Kisha frikë të rrija me të, se isha e sigurt që ai po priste thjesht një rast tjetër që të më shiste përsëri ... Isha shumë e dëshpëruar. Hezitova për ta denoncuar, mendova të shkoja fillimisht tek motra ime dhe të qetësohesha pak. Më besoi dhe më la të shkoj tek ime motër ... shkova në stacionin e autobusit, hypa në autobus për të shkuar tek ime motër, por pastaj vendosa ta denoncojë. Zbrita në stacionin e fundit të [qytetit], por kur dola nga autobuzi kisha frikë të ecja. Mora një taksì dhe i thashë të më çonte në stacionin e policisë.

Në lidhje me vetë-referimin, lidhjet telefonike²¹ ishin veçanërisht të rëndësishme, kur kërkohesh shpëtim nga situata e trafikimit, si dhe përfitim të ndihmës:

²⁰ Në BH në vitet 2003 dhe 2004, shumë viktima u vetë-referuan, duke përfituar ndihmën që u takonte qoftë duke iu drejtuar vetë, qoftë edhe nga sugjerimet e familjeve të tyre. Kjo u provua shumë e vërtetë për viktimat kombëtare të trafikimit, 69.2 përqind e tyre u vetë-referuan në 2003. Ndërkohë që numri i të vetë-referuarave u ul në vitin 2004 (në 33.3 përqind), vetë-referimi mbetej një mjet i rëndësishëm i identifikimit dhe i referimit. Viktimat e huaja në BH, gjithashtu, u vetë-referuan në shumë raste – në 27.1 përqind të rasteve në 2003 dhe në 21.4 përqind në 2004. Po kështu, viktimat janë vetë-referuar në Shqipëri (veçanërisht viktimat e mitura të trafikuar për punë dhe lypje), Bullgari, Kosovë, Moldavi, Rumani dhe Serbi (Surtees 2005: 152).

²¹ Ekzistojnë disa linja komunikimi telefonik (helpline) në rajon, të cilat trajtojnë trafikimin njerëzor dhe dhunën. Ndërkohë që shumë nga telefonatat lidhen me parandalimin, shumë nga to kthehen në identifikim viktimash. Anonimati i linjës telefonike është me rëndësi për

Punoja në një hotel, ku punonin edhe gra të tjera. Por ata punonin atje si prostituta me dëshirën e tyre. Njëra nga to më pa duke qarë dhe më pyeti se çfarë më kishte ndodhur. I thashë se punoja në atë hotel kundër dëshirës sime. Ajo më dha një fletë me një numër telefoni komunikimi në linjë në [vendin tim] dhe më rekomandoi që të telefonoja. Po atë natë, iu luta njërit prej klientëve të mi që të më lejonte të marrë në telefon nga celulari i tij. Unë telefonova në numrin e dhënë dhe u thashë se çfarë po më ndodhte dhe se ku ndodhesha. Këshilltarja nga ana tjetër e telefonit më siguroi duke thënë se çdo gjë do të shkonte mirë dhe se policia do të vinte të më kërkonte dhe se unë duhej t'u thoja të vërtetën. Më thanë që të bëja edhe një telefonatë tjetër në linjën e [vendit të destinacionit] dhe thjesht të kërkoja ndihmë. Nuk kishte nevojë që unë ta shpjegoja nga fillimi rastin tim, pasi informacioni kishte qenë dërguar nga [vendi im i origjinës]. Bëra siç më këshilluan dhe mbrëmjen tjetër erdhi policia.

Në një numër çuditërisht të madh rastesh të grave të trafikuar për prostitucion, ishin klientët ata që kishin dhënë ndihmë për të shpëtuar nga trafikimi, duke i lejuar që të merrnin në telefon nga celularët e tyre, ose edhe në ndonjë mënyrë edhe më proaktive, si në rastin e mëposhtëm.²²

Një burrë vinte vazhdimisht në restorant. Ai fliste [gjuhën time] shumë mirë. I kërkoja ndihmë, sepse më mbanin në restorant me detyrim. Në fillim ai pati frikë të më ndihmonte, por në fund më ndihmoi. Një ditë më tha se do të më priste në makinë, të parkuar aty afër në rrugë.

Një klient vendosi të më ndihmonte. Më mori në hotel dhe e pagoi pronarin për një ditë që ai do të kalonte me mua. Pas disa orësh, ai më lejoi të largohesha, kështu që ika me vrap.

Punonjësit në terren kanë luajtur rolin e tyre në procesin e identifikimit në vendet e BE-s, por mungesa e përgjithshme e këtyre programeve në SEE,

viktimat, të cilat janë të frikësuar dhe nuk i besojnë policisë apo aktorëve të tjerë. Megjithatë, identifikimi nëpërmjet këtij mjeti, varet edhe nga mundësia e përdorimit të kësaj linje, nga fakti nëse linja është e lirë, nga orët kur funksionon dhe nga aftësitë e personelit ndihmës.

²² Në BH, një numër viktimash të huaja të trafikimit seksual u ndihmuan nga klientët e tyre – 12.9 përqind në 2003 dhe 17.9 përqind në 2004. Po kështu, 4.8 përqind e viktimave të BH në vitin 2004 u identifikuan nga klienti. Kjo prirje u vu re edhe në Rumani. Megjithatë, meriton të përmendet fakti se disa nga gratë, që u ndihmuan “të shpëtojnë” nga klientët e tyre, më pas u mbajtën nga këta, si shërbyese/si ‘bashkëshorte’ (Andreani & Raviv 2004; Surtees 2005).

Turqi, Lindjen e Mesme dhe ish Bashkimin Sovjetik, përbën një rast të munguar për identifikim. Një grua, e trafikuar në Itali, shpjegoi se kur më në fund ajo arriti të shpëtojë në të vetmin vend që njihete, për të kërkuar ndihmë, ai ishte personeli i terrenit:

Pasi shpëtova nga burri për të cilin punoja, unë qendrova më këtë djalë, i cili rastisi të ishte shumë i gatshëm të më ndihmonte në çdo mënyrë. Ai kishte vendosur të më ndihmonte që të kthehesha në shtëpinë trime. Kështu që, në fillim ai mori numratorin dhe kërkoi disa numra ... pastaj, m'u kujtuan ata doktorët që vinin me mikrobuz dhe shpërndanin kontraceptivë, fletushka dhe sende të tjera... pra, m'u kujtua organizata e tyre dhe ne shkuam tek vendi ku qendronin ata doktorët zakonisht dhe takuam disa vajza që banonin në [rrugën], me të cilat kisha marrëdhënie të mira ... njëra nga to më dha fletushkën, të cilën, fatmirësisht, e kishte me vete. Mëngjesin tjetër i morëm në telefon.

Në disa raste, punonjësit shtetërorë socialë kanë identifikuar viktimat, gjë që shihet si një përmirësim në rajonin e SEE-s, pasi në të kaluarën këta punonjës rrallë përfshiheshin në identifikim.²³ Një viktimë e mitur u identifikua tek punontre në një bar dhe, në bashkëpunim me policinë e zonës, u largua nga ajo situatë me ndihmën e punonjësve socialë shtetërorë. Po kështu, një tjetër viktimë e mitur shpjegoi se vetëm kur kishin mbërritur punonjësit socialë shtetërorë në stacionin e policisë, ku po mbahej në pyetje, rasti i saj u njoh si rast trafikimi.

Gjatë intervistave me viktimat, u vunë re edhe pika të tjera ndihmëse për identifikim, përfshirë këtu edhe ndërhyrjet nga punonjës të transportit, shtetas privatë dhe organizata fetare. Kur një grua, e trafikuar në ish Bashkimin Sovjetik, kishte arritur të shpëtonte nga pronari i saj, ajo i kërkoi ndihmë konduktorit të trenit. Gruaja nuk kishte pasaportë (mbahej ende nga trafikantët e saj) dhe as para për të blerë biletën e trenit.

Siç isha tepër e dëshpëruar, iu afrova krye-konduktorit të trenit dhe ia tregova të gjitha. Më tha se do të përpiqej të më ndihmonte që të kaloja të gjitha pikat e kontrollit ... unë nuk kisha asnjë rrugëdalje tjetër, ai ishte rasti i vetëm dhe ndoshta i fundit për të shpëtuar. Po të më refuzonte ndihmën, nuk e di se çfarë do të arrija të bëja me veten time, ndoshta

²³ Shumë të pakët kanë qenë personat e trafikuar, të ndihmuar në SEE në 2003 dhe 2004, që u identifikuan nga punonjës socialë shtetërorë, megjithëse disa raste u shënuan në Kroaci, në Territorin e Kosovës nën Administrimin e OKB-s dhe në Serbi (Surtees 2005). Kohët e fundit, kjo është vënë re edhe në vendet e SEE-s, si Maqedoni, BH dhe Rumani.

do të isha hedhur poshtë trenit ... po vuaja psikologjikisht ... por ai reagoi menjëherë. Siç më shpjegoi më vonë, ai kishte një vajzë në moshën time dhe mendoi se mund të kishte qenë vajza e tij në pozicionin tim ... i erdhi keq për mua, më kuptoi dhe më trajtoi mirë. Nuk më kërkoi para.

Një numër njerëzish që arritën t'i shpëtonin trafikimit dhe u kthyen vetë në shtëpitë e tyre, raportuan se kishin qenë identifikuar dhe ndihmuar nga qytetarë të thjeshtë, të cilët i kishin ndeshur rrugës për në shtëpi. Një burrë tregoi sesi kishte takuar një njeri në rrugën që po bënte me këmbë për në shtëpi, rrugë që ishte me mijra kilometra e gjatë.

Ai thjesht më tha që duhej të pushoja, pasi isha shumë i lodhur dhe i dobët. Më tha se mund të qendroja atje derisa të ishte gati pasaporta ime në ambasadë. Më lejoi të merrja [shtëpinë] në telefon. U përpoqa të marrë njërin nga të njohuritë e mi, i cili kontaktoi mamanë time. Ne nuk kemi telefon në shtëpi. Nëna ime komunikoi me linjën telefonike (helpline) dhe u kërkoi ndihmë. Siç më tha më pas mamaja, [organizata] në vendin tim kontaktoi [një organizatë në vendin e destinacionit]. Disa ditë më vonë, mua më mori në telefon një punonjës i linjës telefonike në vendin ku ndodhesha (të destinacionit) dhe më ofroi një ndihmë.

Interesante për t'u përmendur është dhe numri i vogël i rasteve ku kanë luajtur një rol në identifikimin e viktimave organizatat fetare, në shumicën e rasteve pa i identifikuar ato si viktimë të trafikimit, por si individë në nevojë. Një grua e re – 17 vjeç në kohën e intervistës së saj – ishte e detyruar të punonte si prostitutë dhe e vetmja rrugë për të marrë ndihmën që kërkonte, ishte një murgeshë:

Gjatë vizitave të mia të shpeshta në kishë, unë po diskutoja problemet e mia të ndryshme familjare me [atë murgeshë] dhe ajo ishte gjithmonë e gatshme të më dëgjonte dhe të më ndihmonte. Kur gjendja u bë jashtëzakonisht serioze... unë fola me të. Ajo më tregoi për një strehëz dhe më premtoi se do të isha e siguruar dhe e mbrojtur në atë vend.

Në një rast tjetër, një burrë, që ishte trafikuar në ish Bashkimin Sovjetik, u identifikua nga një grup kishëtar. Ai ishte ndaluar nga zbatuesit e ligjit për shkak të mungesës së dokumenteve dhe nuk u identifikua si viktimë trafikimi:

Ishte tepër e vështirë për mua që t'i kaloja ato katër muaj në stacionin e policisë. Askush nuk më besonte. Kisha probleme me këmbët e mia, nuk i ndjeja më për shkak të mos-ushqyerjes dhe depresionit që po

kaloja. Unë pata fat, sepse [qeveria] shpalli amnisti të përgjithshme dhe mua më liruan. Unë mezi arrija të hidhja këmbët. Duke qenë në një gjendje të tillë të tmerrshme, ndesha me disa të krishterë, të cilët më morën në apartamentin e tyre, ku luteshin. Qendrova atje për tre muaj, më dhanë ushqim dhe më trajtuan mirë. Më premtuan se do të më ndihmonin të merrja pasaportën time.

Një grua tjetër, e trafikuar për lypje:

Një ditë një grua e krishterë m'u afrua dhe filloi të më pyeste për jetën time. I tregova gjithçka. I erdhi keq për mua dhe më ndihmoi të merrja një dokument udhëtimi. Mori fotografinë time dhe shkoi në ambasadë. Dhe një ditë bleu biletat, më shoqeroi për në [vendin tim të lindjes]. Më tha se do të më çonte tek një organizatë, që ndihmonte njerëzit e shfrytëzuar. Kjo ishte mënyra si erdha deri këtu.

Po aq me rëndësi për t'u vënë në dukje janë rastet e identifikimit të munguar. Në rastin e një burri, të trafikuar për punë, rasti për t'u identifikuar dhe për t'u ndihmuar dështoi nga ana e disa aktorëve të ndryshëm – nga personeli mjekësor (ishte shtruar në spital për dëmtime fizike që kishte marrë gjatë punës), nga rojet kufitare (kur u përpoq të kalonte kufirin drejt shtëpisë së tij) dhe autoritetet policore të burgut (kur u arrestua për kalim të paligjshëm të kufirit). Pavarësisht se të gjithë këtyre aktorëve u tregonte historinë e tij, asnjeri nuk e mori seriozisht, apo bëri ndonjë përpjekje për ta ndihmuar atë. E vetmja ndihmë që mori, ishte ajo e ofruar nga qytetarë privatë, të cilët i ofruan ushqim dhe para, pasi më vonë ai udhëtoi me këmbë për në vendin e tij të lindjes. Kjo është shqetësuese, duke qenë se personat e trafikuar, përgjithësisht, i kanë shumë të pakta rastet apo rrugët për t'u identifikuar. Lexoni, për shembull, komentin e një vajze të re, të trafikuar për prostitucion në vendin e saj të origjinës:

Nuk kisha kujt t'i drejtohesha tjetër veçse [murgut]. Kisha një familje që nuk më mbështeste. E ndjeja veten gjithë kohën vetëm, pa ndonjë mbrojtje ... vëllai im më keqtrajtonte, më rrihte, babai pinte, nëna më vdiq ... njerëzit kërkonin të përfitonin nga unë. I vetmi person, ku mund të gjeja mbështetje dhe qetësi, ishte [murgu].

Në një numër rastesh, viktimat nuk u identifikuan, pavarësisht kontaktit nga ana e tyre dhe kërkesës së drejtpërdrejtë për ndihmë drejtuar autoriteteve të ndryshme. Një grua e trafikuar në një vend të BE-s për shfrytëzim seksual,

u arrestua dhe u burgos për shkak të dokumenteve të saj të paligjshme, dhe për rrjedhojë, asaj iu refuzua ndihma nga ana e ambasadës së vendit të saj:²⁴

Më pas më liruan [nga burgu] dhe më dhanë pak të holla për trenin për të shkuar në [kryeqytet], ku mund të merrja një pasaportë në ambasadën [time]. Veçse ekzistonte një tjetër problem: në bazën e të dhënave nuk kishte informacion mbi mua, pasi unë nuk kisha patur më parë ndonjë pasaportë ... Ambasadori më tha se nuk do të më lëshonte pasaportë, po të mos e paguaja atë. Kur i thashë që nuk kam para, ai m'u përgjigj, 'atëherë ik e shko e i thuaj familjes të shesin shtëpinë, e çdo gjë që kanë dhe m'i dërgo paratë këtu' ... i shpjegova për situatën time të trafikimit, por atij as nuk i interesoi fare.

Po kështu, një viktimë kish kërkuar ndihmë nga policia, u kish treguar historinë e saj dhe kishte kërkuar ndihmë, por pa shpresë dhe ajo u detyrua të kthehej në gjendjen e saj të trafikimit:

Sepse pjesën më të madhe të rasteve policia është e korruptuar. Jo të gjithë, por në më të shumtën e rasteve, po. Unë shkova tek ta disa herë, madje edhe atje në [vendin e destinacionit], dhe të gjithë ata veçse talleshin me mua. Dhe mua më duhej që t'i zgjidhja të gjitha problemet vetë, që të ikja e të arrija deri në ambasadë.

Që viktimat nuk ishin identifikuar me kohë, ishte një gjetje e rëndësishme nga intervistat e kryera dhe flet për mundësi të humbura, të cilat nuk shkaktojnë gjë tjetër, veçse zgjatjen e përvojave të tyre të trafikimit. Për viktimat e tjera, mos identifikimi do të thoshte arrestim (shpesh si prostitutë apo migrante e paligjshme), abuzim e madje edhe ri-trafikim.

4.2. Çfarë mendonin personat e trafikuar dhe si e përjetuan procesin e identifikimit

Për shumë viktimat përvoja e identifikimit ishte një periudhë stërmundimi dhe e mbushur me shumë emocione dhe reagime. Viktimave iu bën pyetje në

²⁴ Personeli konsullor dhe i ambasadës i disa vendeve kanë qenë të angazhuar në identifikimin e viktimave të trafikimit, përgjithësisht kur personat e trafikuar i drejtoheshin ambasadës për ndihmë, për dokumente udhëtimi, për ndihmë në kthim në vendin e tyre, etj. Disa vende e kanë trenuar personelin e tyre konsullor jashtë vendit mbi procedurat e identifikimit dhe të referimit për viktimat e trafikimit, megjithëse qëllimi i ndërhyrjes së tyre në këtë drejtim nuk është i qartë (Surtees 2005).

lidhje me cilat ishin përceptimet e tyre në kohën e identifikimit – qofshin pozitive, apo negative – për të ndihmuar kuptimin më të thellë sesi ata, si individë dhe në dritën e shfrytëzimit të tyre, e kishin përjetuar procesin e identifikimit. Viktimat folën për një gamë të tërë reagimesh – si pozitive, ashtu dhe negative – ndaj personelit identifikues, si edhe gjatë fazave të ndryshme të procesit të identifikimit. Nuk ishte e rrallë, për shembull, që viktimat të ndjenin lehtësim te fakti se ishin identifikuar, por edhe frikë e dyshim te aktori identifikues. Po ashtu, nuk ishte e rrallë që ndjenjat negative (frika dhe dyshimi) t'i hapnin rrugë ndjenjës së lehtësimit, sapo viktimat ndihej e sigurt dhe me besim ndaj personit identifikues. Reagimet emocionale të viktimës kishin shpesh arsye shumë-shtresore. Në pjesën që vijon, personat e trafikuar i përshkruajnë me fjalët e tyre këto ndjenja dhe reagime.

Frikë dhe dyshim

Nuk është ndoshta i çuditshëm fakti që shumë viktimat raportojnë se kishin ndjerë frikë dhe kishin patur dyshime gjatë identifikimit. Kjo lidhej shpesh me frikën se do të ktheheshin përsëri në situatën e tyre të trafikimit, duke qenë se shumë trafikantë u kishin thënë se edhe nëse u drejtoheshin autoriteteve gjatë përpjekjeve për të shpëtuar, autoritetet do t'i kthenin mbrapsht:

Unë i lutesha që të më linte të shkoja poshtë, në restorant, dhe të punoja atje. I lutesha që të silllej mirë me mua, siç silllesha unë me të. Ai më premtoi, por me një kusht – që unë të mos provoja të ikja ose t'i thoja ndonjë njeriu. Më paralajmëroi se do të ishte e kotë, sepse policia ishte me të. Më tha se do ta pësoja keq, pasi nuk do të mund të provoja gjë.

Atje [jashtë vendit] nuk kisha guxim të denoncoja [trafikantin tim]. Unë i besova kur më tha se kishte lidhje me policinë. Në restorant vinin shpesh policë.

Trafikantët, thjesht, u thonin viktimave të tyre se policia bashkëpunonte me ta, dhe se po t'i drejtoheshin policëve, viktimat përsëri do t'u ktheheshin trafikantëve, dhe për më tepër, do të dënoheshin akoma më rreptësisht, po të kërkonin të iknin:

Kisha frikë se mos polici do të më kthente përsëri [tek vendi] i shfrytëzimit, dhe se ai njeriu që më ndiqte, do të më kapte e do të bënte të njëjtën gjë.

Në rastet kur viktimat ndjenin se shfrytëzuesi i tyre u qendronte afër, frika dhe dyshimi ishin shpesh shumë të forta. Një viktimë, që kishte qenë e shfrytëzuar për shtatë vjet, fillimisht për të punuar në një bar, dhe më vonë e mbajtur si “bashkëshorte”, na tregoi mbi frikën që ndjente kur u intervistua herën e parë nga autoritetet, megjithëse ishte e mbrojtur nga policia dhe nga shërbimet sociale:

[duke folur për punonjësen sociale] Ajo më tha që nëse nuk ndihesha mirë apo e qetë për ndonjë gjë, unë duhet t’ia thoja asaj menjëherë. Edhe nëse kisha ndonjë pyetje, ta bëja pa ndroje. Por unë isha kaq e ngatërruar në atë moment sa i thashë që, tani për tani nuk kam asnjë pyetje, ndoshta herën tjetër. Isha shumë e tronditur dhe e frikësuar, sepse im shoq po priste jashtë ndërtesës.

Disa viktimat kishin frikë se mos trafikuesit e merrnin vesh, që ato kishin lëshuar deklaratat në polici:

Punonjësi social dhe psikologu erdhën për të biseduar me mua, por unë nuk desha të flisja me askënd, sepse kisha frikë...kisha frikë se gjërat që do të thoja mund të binin në vesh të personave që më shfrytëzonin, dhe unë i njihja mirë ata. Ishin të aftë t’i bënin keq familjes sime në [vendin e origjinës]. Nuk mund t’i besoja asnjë njeriu.

Edhe vetë ofruesit e shërbimeve e mbështetën këtë shqetësim: “Në rast se trafikanti merr vesh që viktimat e tij po ndihmohet, ai mund t’i frikësohet procedimit ligjor. Madje, shpeshherë viktimat thonë se “e bëj me dëshirën timë” thjesht se kanë frikë nga trafikantët” (Brunovskis & Surtees 2007).

Frika nga ndëshkimet – për vete apo familjet e tyre – përbënte një shqetësim për shumë viktimat:

Vajzat kanë frikë ... e di që kanë frikë sepse kemi folur me njëra-tjetrën e bënim plane që të iknim [nga trafikanti], por gjithmonë thonin se kishin frikë ta bënin. Thonin se kishin frikë për familjet e tyre në shtëpi, sepse veç atyre që na mbanin të mbyllur [në atë vend], kishte dhe të tjerë në [vendin e origjinës], që mund të shkonin e t’u bënin keq familjeve.

Kisha frikë të shkoja në [fshatin tim], sepse kisha familjen atje... nuk kam frikë për vete. Le të më vrasë, po të dojë të më vrasë. Por kam frikë për njerëzit e mi, se ai mund të na djegë shtëpinë, veç për të na hapur telashe ... pa folur pastaj se mund të vrasë edhe vellezërit e mi.

Shumë trafikantë i paralajmëronin viktimat e tyre se, po të binin në duart e policisë, ato do të arrestoheshin, burgoseshin dhe dëboheshin për shkak të statusit të tyre të paligjshëm, një argument ky shpesh shumë bindës për individët, përvoja e trafikimit e të cilëve është e lidhur me ikjen nga shtëpia për të fituar para. Pra, ka raste kur vetë viktimat nuk e duan identifikimin:

[rreth kërkimit të ndihmës dhe identifikimit] askujt nuk i kërkova ndihmë, sepse thjesht nuk kisha kujt t'i drejtohesha ... ndodheshim në një vend larg qytetërimit. Zyra më e afërt e policisë ishte shtatëdhjetë kilometra larg. Nuk desha të shkoja në polici, sepse kisha frikë se do të më arrestonin, meqenëse nuk kisha dokumente. Organizata të tjera nuk kishte. Prandaj dhe vendosa ta kaloja dimrin atje dhe pastaj të provoja të largohesha në drejtim të [qytetit më të afërt].

Duke qenë se ishim punëtorë të paligjshëm atje, ne kishim frikë nga policia (shpresonim se do të merrnin paratë për punën që kishim bërë), e cila do të na dëbonte. Prandaj dhe pasaportat tona mbaheshin nga pronari, që në rast se do të vinte policia, ne të mos identifikoheshim si punëtorë të paligjshëm.

Një viktimë shpjegoi sesi, në një numër rastesh një polic vinte tek bari ku punonte ajo dhe i jepte informacion dhe numrat e kontaktit të organizatave të ndyshme ndihmuese, informacion të cilin ajo e zhdukte menjëherë:

Ne i grisnim shënimet me [informacionin], sepse bosi ynë na kishte porositur që të mos merrnim asgjë nga policia, dhe ta zhduknim atë menjëherë. "Ju gënjejnë, ju mashtrojnë, se nuk kanë kanë ndërmend gjë tjetër, veç të nxjerrin urdhër-dëbimin", na thoshte pronari. Dhe ne e zhduknim [informacionin] që na jepte polici.

Shumë viktimat i frikësoheshin, po ashtu, keqtrajtimit në duart e policisë, frikë kjo e bazuar shpesh mbi fjalët që kishin dëgjuar për korrupsionin dhe egërsinë e policisë (si në vendin e tyre, ashtu dhe jashtë tij) histori, këto, që përforcoheshin edhe nga trafikantët.

Unë u kapa bashkë me një grup tjetër nga [vendi i origjinës], të cilët po shkonin drejt [vendit fqinj]. Kur na ndaluan, pata shumë frikë... ku dihej se çfarë mund të na bënin. Kishim dëgjuar shumë histori sesi po të të kapnin [autoritetet e huaja], nuk të linin më gjallë. Por, lavdi Zotit, nuk ndodhi asgjë e ngjashme. Na shoqeruan në një stacion të vogël policie, që ishte aty afër, na kërkuan emrat, dhe aq.

[ku duhet të drejtohesh për ndihmë] Varet. Policia mund të jetë një mundësi, por disa policë janë të lidhur me këta [trafikantët].

Kisha frikë nga policia ... Po të kisha pasaportën time, asnjehërë nuk do t'i isha drejtuar asaj për ndihmë ... nuk e di pse, por prisja që polici të më rrihte ... këtë ide ma kishte futur në kokë pronari për të cilin punoja ... Pronari më thoshte, gjithashtu, se të gjithë policët janë të korruptuar.

[Kishin kaluar] thujse pesë vjet [para se të kontaktoja policinë]. Në fillim kisha frikë nga policët. E dija se shumë nga ata kishin lidhje të ngushta me trafikantët. Kisha frikë se mos më dëbonin nga [vendi i destinacionit].

Në atë çast, nuk dija se ku mund të drejtohesha për t'u ankuar. Por asnjehërë nuk do t'i ankohesha policit, po të mos më ishte drejtuar ai mua në fillim. E dija që policët ishin të korruptuar, që [trafikantët] u jepnin para policëve që patrullonin zonën tonë, zonën ku unë shfrytëzohesha.

Frika është ushqyer edhe nga përvoja vetjake e viktimave me policinë, të cilët, në disa raste të shfrytëzimit seksual të tyre, kishin qenë klientët e viktimave. Dhe çuditërisht, identifikimi i disa prej viktimave u bë nga të njëjtët persona dhe institucione që kishin abuzuar dhe i kishin shfrytëzuar ato.

Kam frikë nga policia. Meqenëse punoja në rrugë, policët do të vinin të bënin seks me mua. Kam frika nga ata, nuk kam asnjë besim ... [kisha frikë] se do të më dërgonin përsëri në rrugë.

Ua kisha frikën, sepse kisha klientë që ishin oficerë policie.

Për disa viktime procesi i identifikimit dhe i referimit ishte i ngjashëm me atë çfarë u kishte ndodhur më parë gjatë trafikimit – premtime për ndihmë dhe jetë të mirë, zhvendosje nga persona të cilët nuk i njihnin, vendosje nëpër vende ku "çdo gjë do të ishte shumë mirë" dhe ku "do të kishte kujdes për to". Për këto arsye, për shumë persona të trafikuar vetë procesi i identifikimit u ngjallte dyshime, veçanërisht kur shihej me sytë e ndonjë tjetri, i cili ishte vetë i tejlodhur, i frikësuar dhe me mendime të ngatërruara. Një viktimë përshkroi sesi e kishin zhvendosur nga një stacion policie tek tjetri, për të lëshuar një deklaratë formale, dhe se sa e frikësuar ishte ajo, thjesht nga mendimi se, në fund të fundit do ta dorëzonin përsëri në duart e trafikuesit të saj:

Polici më dërgoi në një stacion tjetër policie. Nuk e njihja atë vend, kështu që nuk i besova ... por kur hyra brenda, pashë dhe kuptova se nuk isha më në rrezik dhe nuk pata më frikë.

Vëzhgime të së njëjtës natyrë janë vënë në dukje edhe në një studim tjetër në lidhje me viktimat e trafikimit në Shqipëri, Serbi dhe Moldavi, sipas të cilave ndërhyrjet nga ana e aktorëve anti-trafikim shiheshin me dyshim e mosbesim, pikërisht prej ngjashmërisë së procedurave të referimit dhe të ndihmës me procesin e rekrutimit dhe të trafikimit të tyre. Aspekte të ndryshme të identifikimit dhe të referimit u dukeshin disa viktimave sikur përsëritnin përvojën e tyre të trafikimit, e cila nga ana e saj, kishte ndikuar mbi aftësinë e tyre për t'u besuar këtyre shërbimeve dhe organizatave (Brunovskis & Surtees 2007).

Ndërkohë që frika dhe dyshimi ishin ndjenja të zakonshme për shumë viktimat, është e rëndësishme të theksohet se këto emocione zbuteshin me kohë, kur viktimat kuptonin se procesi i identifikimit të tyre ishte i vërtetë. Megjithatë, koha e nevojshme që duhej për të shuar frikën, ishte e ndryshme nga njëri person tek tjetri, dhe lidhej ngushtë me kontekstin e identifikimit, sjelljet dhe marrëdhëniet ndërvetjake që lindnin me aktorët identifikues.

Tronditje, ndërlikim dhe çorientim

Shumë viktimat shpjeguan se ishin ndjerë të ngatërruara dhe të çorientuara gjatë fazës së identifikimit. Kryesisht, kjo vinte nga fakti se identifikimi realizohej menjëherë pas ikjes prej trafikantëve dhe viktimat ishin ende në gjendje tronditjeje dhe çorientimi. Shumë viktimat raportuan se ishin shumë të tronditura gjatë identifikimit dhe nuk e kishin të qartë nëse kishin shpëtuar, ishin duke u arrestuar apo do të ktheheshin përsëri në duart e trafikantëve (Brunovskis & Surtees 2007). Viktimat shpjegonin se sa të hutuara ndiheshin në atë fazë:

Flisja pa asnjë lloj lidhje, isha krejt e çorientuar ... më dukej se nuk do të mbaronte kurrë. Ndoshta ishte vetëm një gjysmë ore, por mua më dukej se po zgjatej shumë.

Isha krejt e çorientuar. Mezi po prisja të shkoja në shtëpi. Nuk më besohej. Vetëm kur të shihja shtëpinë, do ta besoja.

U mbylla në vetvete. Nuk po kuptoja se çfarë po më ndodhte. Kisha shumë frikë nga policët. Kur më duhej të tregoja së çfarë më kishte ndodhur, unë ngecja, thjesht u bllokova. Dhe kur oficeri i policisë filloi të më bërtiste, unë e humba krejt dhe u mbylla në vetvete si në një guackë.

Në disa raste të tjera, ky ndërlikim ndodhte sepse viktimat nuk e kuptonin plotësisht se çfarë është procesi i identifikimit. Një viktimë tregoi se nuk e

kishte fare idenë së për çfarë duhej deklarata – “Ata nuk më shpjeguan se çfarë është, dhe përse duhej deklarata. Nuk dija asgjë për të”. Po kështu, kushtet ku realizohet identifikimi në shumë vende të destinacionit – për shkak të bastisjeve nëpër bare apo hotele, të operacioneve policore, etj. – mund të minojnë përpjekjet e mëvonshme për identifikim.

Të them të vërtetën, më shpjeguan sesi si do të vepronin, por unë nuk u besova. Shansi ishte 50 me 50. Ndoshta do të ishte ndryshe nëse ndonjë përfaqësues i [organizatës] do të ishte i pranishëm atje. Por, kur ti nuk ke dëgjuar asnjëherë për atë organizatë, është e vështirë të besohet. Isha në një vend të huaj.

Në disa raste, vetë aftësia e të kuptuarit të shërbimeve që do të ofrohen, është e lidhur ngushtë me kapacitetet specifike dhe individuale të vetë viktimave. Kjo lidhet me kapacitetin e viktimës për të kuptuar drejt rrethanat, me pengesat gjuhësore, me mungesën e njohurive dhe me mosnjohjen e ekzistencës së mundësisë për t’u ndihmuar, por edhe me gjendjen e tyre psikologjike. Si rezultat, shumë viktima, në kontaktin e tyre të parë me personelin kundër-trafikim, jo gjithmonë janë në gjendje të kuptojnë se çfarë ndodh. Kjo fazë fillestare pas-trafikim mund të jetë shumë çorientuese dhe aktorët anti-trafikim flasin për vështirësi në komunikimin me viktimat (Brunovskis and Surtees 2007). Për shembull, një studim i grave të trafikuar në Evropë, zbuloi se 56 përqind e grave kishin simptoma të çrregullimit sugjestiv të stresit post-traumatik, kur arritën të përfshihen në programin e ndihmës (Zimmerman et al. 2006: 3).

Për shumë viktima, gjendja e tronditjes dhe e ngatërresës dukej se ishte një problem kohe dhe shumë nga to e ndjenin se kishin nevojë për një periudhë të shkurtër çlirimi, para se të kuptonin drejt se çfarë po ndodhte përreth tyre:

Mendoj se do të ishte ideale sikur të na kishin lënë vetëm për disa ditë, për të na dhënë kohë për t’u qetësuar disi ... unë isha krejt e tronditur ... madje as nuk arrija të mbaja mend se çfarë po më shpjegonte oficeri i policisë.

Ndjenja lirimi, sigurie dhe qetësie

Identifikimi nuk ishte përherë një përvojë negative apo e lodhshme për personat e trafikuar. Për shumë viktima, të qenit identifikuar i bëri të ndjenin veten për herë të parë të sigurt për një kohë të gjatë. Një viktimë shpjegoi sesi kishte ikur nga trafikanti i saj dhe sesi ishte paraqitur menjëherë në polici:

Po, atje nën mburojën e policies, u ndjeva e shpëtuar ... isha më tepër e shqetësuar se çfarë do të më ndodhte nëse do të më detyronin të largohesha nga stacioni i policisë.

Edhe viktima të tjera kanë treguar se u ndjen të sigurta, sapo kishin mbërritur në polici apo kishin takuar aktorët e tjerë identifikues:

...kur hyra në stacionin e policisë, pashë dhe kuptova se nuk isha më në rrezik, kështu që nuk kisha më frikë ... Pastaj, vura re në mur disa fotografi mbi dhunën familjare, trafikimin e njerëzve. Atëherë kuptova se ky ishte vërtet një stacion policie dhe jo ndonjë shaka e hidhur. U qetësova.

Njerëzit e stacionit të policisë më trajtuan shumë mirë. Psikologu më foli dhe pastaj foli me mamanë. Ata më thanë, gjithashtu, se shumë djem po shfrytëzoheshin nga [ky trafikant], dhe për ta mbyllur këtë çështje ata kishin nevojë për disa informacione. Ata më siguruan se informacioni im do të mbahej i fshehtë. E pata shumë të lehtë të flisja me një psikolog.

... isha shumë mirënjohëse dhe e gëzuar. Vlerësoj mënyrën sesi [konduktori i trenit] më dëgjoi dhe më kuptoi. Kisha turp, por, sidoqoftë, isha e gëzuar që gjeta një person që dëshironte të më ndihmonte.

Në raste të tjera, duhej të kalonte njëfarë kohe që individi të ndihej i sigurt, shpesh deri kur të mbërrinin në shtëpi, ose deri kur përfshiheshin në ndonjë program ndihme.

Në atë çast pata frikë, sepse nuk po kuptoja se ku po shkoja. Kur mbërritëm te [strehëza], isha aq e frikësuar, sa nuk mund ta shprehë me fjalë. Por me kohë u mësova.

Kur u pyetën se çfarë do të ishte e dobishme në kohën e identifikimit për ta, një numër të intervistuarish nënvizuan se, prania e ndonjë personi tek i cili kishin besim, do t'u jepte ndjenjën e besimit të aktorët identifikues dhe të sigurisë. Për shembull, një gruajë, në kohën e identifikimit ende në moshë të mitur, nuk iu lejua që të kishte pranë mamanë e saj, kur u paraqit në stacionin e policisë për të lëshuar deklaratën. Ndërkohë që viktima pranoi, nga ana e saj, se do ta kishte të vështirë të kishte pranë të ëmën – “ndoshta do të ishte më vështirë për mua në rast se do të ishte ajo atje, se do të më

vinte turp po të dëgjonte nëna ime mbi gjithçka kisha kaluar” – viktimat, përsëri shtoi se prania e një gruaje do të kishte qenë e dobishme:

Do të kisha parapëlqyer që deklaratën ta kisha lëshuar para një gruaje, edhe sikur ajo të mos ishte personi me të cilën duhej ta bëja deklaratën, do të ishte me rëndësi që atje të kishte qenë një grua.

Mjetet e krijimit të atmosferës së qetësisë lidheshin, në shumë raste, me profilin specifik të viktimës, por edhe me përvojën e trafikimit dhe të shfrytëzimit të saj/të tij. Ndoshta ka rëndësi që viktimave t’u jepet mundësia e zgjedhjes se me cilin person do të dëshironin të flitnin, përfshirë edhe mundësinë e pranisë së një personi mbështetës, si për shembull të një punonjësi social. Viktimat folën edhe për gjëra të tjera, të cilat, sipas atyre, mund të ndihmonin për krijimin e atmosferës së qetësisë gjatë fazave të para të identifikimit:

Po, u besova atyre. Ata më pritën shumë mirë. Më blenë ushqime, më pyetën nëse kisha nevojë për ndonjë gjë.

Pata fat se arrita të flasë me dikë nga një organizatë jo-qeveritare. Nuk besoj se do të isha në gjendje që t’i thoja policit të vërtetën, po të mos kishte qenë ajo gruaja. Para së gjithash, unë nuk kisha besim tek oficerët e policisë, kisha frikë të flisja me ta për trafikantët, dhe së dyti, unë thjesht nuk e njihja gjuhën [e vendit].

Ishte shumë e rëndësishme që të jepeshin siguri për të qetësuar ndjenjat negative të viktimave, për t’u krijuar atyre qetësinë dhe besimin. Shumë vetë shpjeguan se sa e rëndësishme ishte për ta që të qetësoheshin e siguroheshin nga aktorët identifikues se, ishin në duar të besuara se, asgjë nuk do të mund t’u ndodhte më dhe se, çdo gjë do të shkonte më së miri.

Dëshpërim dhe hutim

Disa persona të trafikuar shpjeguan se sa i madh ishte dëshpërimi i tyre në kohën e identifikimit. Ndërkohë që ata, si shumë viktimat të tjera, ishin shpesh dyshues ose të frikësuar nga aktorët identifikues, gjendja e tyre ishte aq kritike, sa që ata nuk shikonin para tyre shumë opsione për vete. Në shumë raste, viktimat identifikoheshin në momentin e dëshpërimit të tyre më të madh:

Për mua kishte rëndësi të mbetesha gjallë. Nuk prisja të merrja ndonjë ndihmë. E rëndësishme për mua ishte të gjeja mbrojtje.

Personat e tjerë, prej dëshpërimit të tyre, shmangnin (ose u përpoqën të shmangnin) identifikimin, sepse deshën vetëm të ktheheshin sa më shpejt në shtëpi dhe të përpiqeshin të merrnin veten:

[rreth mbërritjes në shtëpi] Unë thjesht nuk desha të torturohesha më me pyetje ... Nuk desha të flisja me asnjëri, aq shumë e dëshpëruar isha. Nuk kisha askënd me të cilin mund të flisja lirshëm ... Nuk desha të tregoja se çfarë më kishte ndodhur [jashtë vendit].

Isha bashkë me një vajzë tjetër. Edhe ajo shfrytëzohej si unë. Në fillim ata pyetën shoqen time dhe ajo u tregoi gjithçka. Madje ajo u tha se edhe mua më kishte ndodhur një histori e ngjashme. Ishte pikërisht në atë moment që unë dëgjova për herë të parë se kisha qenë viktimë e trafikimit ... Isha aq e lodhur sa nuk pyesja më ... Desha të shkojë në shtëpi sa më parë që të ishte e mundur.

Në raste të tjera, ishte pikërisht ky dëshpërim që i bëri viktimat të pranonin identifikimin dhe ndihmën. Siç del, pranimi lidhet me mungesën e opsioneve të tjera, dhe në rast se do të kishin alternativa të tjera, të shpeshta do të ishin rastet kur shumë viktimat nuk do ta pranonin ndihmën (Brunovskis & Surtees 2007).

Një numër viktimash shpjeguan se qendrimi i tyre gjatë identifikimit ishte i vështirë, sepse ato ndiheshin të turbulluara dhe të dëshpëruara. Një viktimë tregoi sesi u ndje dhe u suall gjatë identifikimit, duke vënë në dukje se ishte shumë e vështirë të merreshë vesh me të: “[Ndiheha] shumë keq. Thoja fjalë të pista. Isha krejtësisht jashtë vetes dhe shumë e dobët”.

Siç ndodh edhe me reagimet e tjera negative, dëshpërimi është një ndjenjë që me kohë fashitet dhe me një trajtim të kujdesshëm nga ana e aktorëve identifikues, personi mund ta marrë shpejt veten. Por është e rëndësishme të vihet në dukje që, meqenëse dëshpërimi mund të shfaqet në formën e agresivitetit, ky reagim mund të keqinterpretohet nga aktorët identifikues dhe mund të çojë në keqkuptim, tension dhe, madje, edhe në konflikt.

Të turpëruara dhe të gjykuara

Disa viktimat shpjeguan se ndiheshin me turp, kur takonin fillimisht aktorët e anti-trafikimit, si ofruesit e shërbimeve ashtu dhe autoritetet e tjera. Atyre u vinte turp nga çfarë kishin përjetuar dhe, në disa raste, ndiheshin përgjegjëse për çfarë u kishte ndodhur. Një grua përshkroi se sa mirë ishte pritur dhe trajtuar nga oficeri i policisë, kur i kishte kërkuar ndihmë, por, megjithatë, asaj i vinte shumë turp:

Ishte e vështirë. Më vinte turp sepse ishte hera e parë për mua që po shkoja në polici. Kjo ishte nga njëra anë, nga ana tjetër, e ndjeva se më në fund dikush po më ndihmonte.

Kishte raste kur viktimat kishin turp të shpreheshin në prani të njerëzve të afërt të tyre:

Im shoq nguli këmbë që të shkoja në polici. Shkuam bashkë. Kur u takuam me oficerin e policisë, ai u tregua shumë i sjellshëm me ne ... I tregova gjithë çfarë më kishte ndodhur. Qaja kur i tregoja peripecitë e mia. Për më tepër sepse më vinte turp të tregoja të gjitha ato gjëra në prani të burrit tim. Ai nuk desh të largohet nga dhoma dhe tha se unë nuk duhej t'i fshihja atij asgjë.

Po ashtu në një rast tjetër, për shkak të komenteve dhe të qendrimeve të të afërmëve të tyre:

Më dukej sikur më kishte rënë e gjitha bota mbi kokë. Ndihesha keq. Më dukej sikur ia kisha bërë vetes. Sepse edhe babai i im ma tha këtë më vonë, dhe shumë njerëz të tjerë – “vetë e kërkove” ... kishte edhe gra që më thonin kështu. [mesazhi ishte] “Çfarë bëjë atje, përse shkove? Vetë e ke fajin”.

Turpi dhe vetëgjykitimi nuk lidhet përherë dhe përjashtimisht me faktin se ishin shfrytëzuar seksualisht. Një viktimë mashkull shpjegoi sesi turpi që nuk kishte gjetur dot punë e nuk kishte fituar para për familjen, i kishte bërë shumë viktima të ndiheshin me faj e të turpëruar deri na atë pikë sa, do të preferonin më mire ta ekspozonin veten ndaj shfrytëzimeve të formave të tjera, se sa ta pranonin se kishin dështuar:

Unë kisha dëgjuar edhe nga burra të tjerë se, kur kishin arritur të iknin nga vendi i shfrytëzimit, nuk kishin guxuar të ktheheshin në shtëpi. Dhe jo sepse ishin të raskapitur dhe kishin nevojë për një pushim të mirë, por sepse kishin turp të ktheheshin në familje pa të holla. E ndjenin veten fajtor se i ishin futur asaj rruge ... kishte burra që nuk ia treguan të vërtetën askujt. Burrat parapëlqejnë të provojnë një tjetër mundësi në një vend të huaj, se sa të kthehen në shtëpi me pak para.

Kishte raste, kur viktimat tregonin sesi sjellja dhe qëndrimi i personave ndihmues i bënte ata të ndiheshin me turp:

Më pyetën dhe unë po flisja me këtë inspektor dhe po rrija kështu [me duar kryq] ... dhe disa policë rrinin te dera, nja shtatë a tetë, sepse dera ishte e hapur. I kisha parë ata disa herë nëpër rrugë. E njihnin babanë dhe vëllain tim..., e si do të flisja unë me ta?... dhe inspektori po më thoshte: "Si arrite ta turpëroh babanë tënd në këtë mënyrë". Si mund t'i përgjigjesha unë pas kësaj.

Punonjësit tanë të kufirit nuk krahasohen me ata të vendeve të tjera ... këta vetëm sa talleshin me mua. Më pyesnin, 'hë ç'na ke sjellë nga [jashtë shtetit]', se deshën që unë t'u jepja atyre ndonjë gjë.

Tejkalimi i ndjenjës së turpërimit për shumë viktime ishte një pikë kritike në drejtim të stabilizimit të tyre dhe të rikuperimit afat-gjatë. Një grua, kur u pyet se cili do të ishte mesazhi më i rëndësishëm që ajo do t'ua përcillte të tjerëve që kishin kaluar nëpër të njëjtën përvojë si ajo, tha shumë thjesht, "Do t'u thoja mos ia vini vetes fajin për asgjë". Dhe vazhdoi të arsyetojë:

Të kenë sa më shumë kurajo dhe të vazhdojnë të përpiqen ... sepse, këtu në këtë vend asnjëherë nuk mund të gjesh mbështetje për këto rrethana. Do t'u thoja që të mos presin t'u vijë njëri në krah dhe të mendojnë se duhet të bëjnë gjithçka vetë, të mos e lëshojnë veten. T'i mbledhin të gjitha forcat dhe të shkojnë e të denoncojnë.

Për shumë viktime, identifikimi ishte pozitiv dhe jo-gjykses, gjë që për ta ishte jetësore dhe i ndihmoi të pranonin ndihmën. Mos gjykimi dhe sigurimi që ajo që kishte ndodhur nuk ishte për faj të tyre, ishte një mesazh i rëndësishëm për shumë viktime, i cili duhet të përsëritet vazhdimisht.

Zemërim, ankth dhe zhgënjim

Për disa viktime, të qenit i identifikuar nuk është në vetvete zgjidhja e problemeve të tyre të para-trafikimit, probleme, të cilat përgjithësisht nuk zgjidhen, madje shpesh amplifikohen nga situata e trafikimit. Për ata që kanë qenë në kushte më pak shfrytëzuese, ose që kanë patur mundësi të vejnë ca të holla menjanë, pavarësisht se ishin në një situatë trafikimi, identifikimi mund të shihet si fundi i mundësive të tyre ekonomike. Një grua, e cila ishte trafikuar fillimisht jashtë vendit, por më vonë kish qendruar të punonte në kushte më pak shfrytëzuese, nuk ishte e kënaqur nga identifikimi, pasi kjo gjë kishte ndikuar negativisht mbi mundësinë e dërgimit të të hollave në shtëpi për fëmijën e saj.

Ndjenjat e ankthit dhe të zhgënjimit mund të mos jenë veçanërisht të mprehta, kur njerëzit identifikohen në tranzit, kur nuk janë shfrytëzuar ende

dhe kanë shpresa për një jetë të mirë jashtë vendit. Në rastet kur viktimat ishin migrantë me plot ide të bukura për atë që i priste (shpesh të pandërgjegjshëm për rrezikun e trafikimit), identifikimi për ta, të paktën në fillim, mund të jetë zhgënjyes: “Gjëja më e mirë ishte kur kaluam kufirin e parë. Dhe kur e kaluam atë me këmbë, vërtetë ishte shumë e rëndë, por i thamë vetes se do të kalonim çdo kufi në atë mënyrë. Kështu që ndiheshim mirë”. Djemtë që u interceptuan në tranzit, shpjeguan që për ta pjesa më e keqe ishte, kur kuptuan se nuk do të arrinin në destinacion dhe, për këtë arsye, nuk do të mund të punonin dhe të dërgonin para në shtëpi:

Sepse kishte rëndësi për ne që të iknim nga shtëpia sa më shpejt që të ishte e mundur. Dhe kur u futëm në stacionin e policisë, kuptuam se nuk do të mund të vazhdonim më udhëtimin tonë për në [BE].

Na ndaluan, nuk ishte e lehtë. Kishim bërë një rrugë të gjatë, dhe pastaj, në fund u kapëm.

Mënyra sesi identifikohen viktimat (dhe viktimat e mundshme) mund të luajë rol në mënyrën sesi do ta përjetojnë ata këtë proces. Disa viktima raportuan se ishin tallur nga të tjerët, gjë që ua kishte shtuar zhgënjimin, por shpesh dhe zemërimin:

Dolëm nga mikrobuzi [i policisë së vendit të huaj] dhe u futëm në mikrobuzin e policisë [së vendit të origjinës]. Pritëm atje një gjysmë orë përderisa policët mbaruan punët e tyre me njëri-tjetrin dhe pastaj na sollën në [qytet] ... ata filluan të tallen me djemtë e rinj: “Nuk ia dolët kësaj radhe, eh”. Mua më thanë: “Si ia kalove andej?” dhe disa fjalë të tjera të bezdisshme.

Në varësi të kushteve të identifikimit dhe të aftësive të aktorëve identifikues, ka mundësi që fillimisht viktimat të mos identifikohen si të tilla, por t’u ekspozohen pyetjeve sikur të ishin migrantë të paligjshëm, prostituta dhe/ose kriminelë. Në të tilla raste, viktimat binin nën një breshëri pyetjesh, dhe ajo që duhej të ishte një intervistë identifikuese, kthehej në një marrje në pyetje për qëllime kriminale. Ky keqidentifikim, dhe për rrjedhojë, keqtrajtim, mund të shkaktojë zemërim dhe ankth midis viktimave. Kur përshkroi trajtimin në kohën e identifikimit të saj jashtë dhe brenda vendit, një grua tha se identifikimi ishte më i mirë jashtë vendit:

Është më e mirë [policia e huaj]. Ata na morën emrat dhe na lanë të qetë. Ndërsa këtu më zhgënjyen: “Si ike”, “me kë ike”, “çfarë kishe

ndërmend të bëjë atje” dhe nuk e di se sa pyetje të tjera... Më kërcënuan se do të më futnin në burg, në rast se nuk u thoja dhe nuk pranoja që kisha ikur me personin që më përmendnin ata.

Besimi dhe mosbesimi

Për shumë persona të trafikuar, mungesa e besimit – tek njerëzit dhe institucionet – ishte një nga rezultatet kryesore të përvojës së tyre të trafikimit. Kjo, nga ana e saj, ndikonte mbi gatishmërinë e tyre për t’u identifikuar dhe, po ashtu, për të pranuar ndonjë kontakt tjetër apo ndihmën e ofruar. Një grua përshkroi sesi kishte marrë një numër telefoni të linjës së komunikimit për viktimat e dhunës nga punonjësi i saj social, por kishte frikë të merrte në telefon, sepse nuk kishte besim: “Ishte hera e parë që dëgjoja për atë organizatë, hera e parë që dëgjova se kishte dhe kështu gjërash. Dhe pasi kisha përjetuar diçka shumë të tmerrshme, unë nuk i besoja më asnjëri”.

Shumë viktimat nuk kishin besim tek autoritetet dhe kjo i shtynte që të mos identifikonin veten, edhe kur u jepej mundësia.

Mund t’i isha drejtuar policisë, por në [atë vend] të gjithë policët janë të korruptuar. Mund të kisha kërkuar ndihmë një OJQ-je, por nuk kisha as adresë dhe as telefon, e nuk kisha as para për të udhëtuar, apo telefonuar.

Në atë çast unë nuk i besoja askujt dhe nuk mund ta kuptoja, në përgjithësi, se atje jashtë ka njerëz që duan të bëjnë gjëra të mira për ty.

Jo, mendova se policia do të më shiste mbrapsht tek ndërmjetësi. Ndër klientët e mi kishte dhe policë. Nuk kisha besim tek policët.

Një tjetër çështje që ka të bëjë me besimin është që, disa viktimat kuptonin se aktorët identifikues – qofshin policë apo ofruar shërbimesh – nuk u besonin tregimeve të tyre. Kjo ushtronte një ndikim negativ mbi viktimat. Sipas njëres viktimë, ky ishte dhe aspekti më negativ i identifikimit:

Ishte mosbesimi i atyre njerëzve, i njerëzve që marrin deklaratën tëndë. Ky mosbesim..., dukej sikur me sytë e tyre më thonin, “po na gënjen”... dukej sikur deshën të të thonin “pa na u hiq qafe”.

Pasja e besimit – tek një individ apo institucion – kishte luajtur rol për disa viktimat që të kërkonin dhe të pranonin që të identifikoheshin. Besimi ishte, gjithashtu, i rëndësishëm në drejtim të referimit të mëtejshëm të tyre për ndihmë. Në shumë raste, elementi i besimit ishte element qendror në

procesin e identifikimit. Në disa raste, viktimat refuzonin identifikimin nga aktorë, të cilëve nuk u besonin, ndërsa pranonin të identifikoheshin nga ata tek të cilët kishin besim.

Për disa njerëz, besimi ishte i lidhur me vetë institucionin, si për shembull kisha, në rastin e njeriut të identifikuar jashtë vendit të tij pas shumë vitesh të shfrytëzimit të punës. Kur e pyetën përse kishte besim tek ai person, viktimat shpjegoi:

Pikësëpari, mendova që njerëzit që besojnë në Zot nuk të lënë në baltë ... u isha shumë mirënjohës ... ishin aq të mirë me mua. Gjithçka ata bënin për mua, bëhej shumë sinqerisht dhe pa egoizëm. E bënin me gjithë zemër ... ata u lidhën me [ambasadën e vendit tim] dhe më siguruan se do ta merrja përsëshpejti pasaportën time. Ishin njerëz normalë. Nuk pinin alkool, nuk pinin cigare dhe më trajtonin mirë.

Personat e trafikuar identifikuan mjete të ndryshme me anë të të cilave individët dhe institucionet do të arrinin të fitonin besimin e tyre. Disa herë viktimat ndjenin më shumë besim dhe kishin më shumë siguri, kur autoriteti i institucionit ishte i qartë dhe i dukshëm. Për shembull, për disa viktimat fakti që policia ishte me uniformë kishte një rëndësi të madhe, dhe praktika e mbajtjes së rrobave civile u shkaktonte shumë ngatërresa:

Kur u qetësova pak, ata thirrën disa inspektorë. Erdhi njëri. Kisha frikë të shkoja me të, të hypja në makinën e tij, sepse ai ishte pa uniformë. Më tha se ishte një inspektor dhe se unë nuk duhej të trembesha nga ai. Më shpjegoi se do të më çonte në një stacion tjetër policie... Po, [uniformat] kishin rëndësi për mua. Inspektori ishte me rroba civile dhe unë kisha frikë nga ai. Iu luta të mos më dërgonte tek [trafikantët]. Më tregoi se po më shoqeronte për tek një stacion tjetër policie, ku ishte më qetë, pa shumë njerëz përreth. Më premtoi se do të pinim diku një kafe, dhe se atje mund të flisnim të qetë. Po ashtu, ai më shpjegoi se ka shumë inspektorë policie, që nuk mbajnë uniformë. Më çoi te stacioni tjetër i policisë. Unë nuk isha e familjarizuar me atë stacion policie dhe nuk i besova. Por, më vonë kuptova që ai ishte përgjegjësi i atij stacioni tjetër dhe se ai thjesht nuk kishte veshur uniformën.

Më dhanë gjithë çfarë kishin. Por, me kokën time unë mendova që ata nuk duhej të rrinin me rroba civile. Nuk besoja që ata ishin punonjës policie.

Disa ishin më të prirura për të patur besim dhe për të qenë më të qeta, nëqoftë se një grua –punonjëse policie apo punonjëse sociale – do të ishte

e pranishme në identifikim, pasi kjo gjë i bënte ata të ndiheshin më të sigurt dhe të qeta. Në një rast tjetër, një viktimë përshkroi se sa e sigurt u ndje ajo, kur pa që në vendin e identifikimit ishte një oficere grua: “Vetëm atëherë u qetësova. Atje kishte edhe gra. Njera po përgatiste kafënë, tjetra po pastronte”. Gjithsesi, kjo nuk përjetohet njëllë nga të gjithë të intervistuarit dhe ndjenjat e besimit janë shumë individuale dhe specifike, dhe lidhen si me kontekstin ashtu dhe me individët, që vijnë nga një sfond i caktuar social dhe kulturor. Të miturit meshkuj që u intervistuan, jo gjithmonë i qetësonte prania e një oficere policie, por mendonin se personat e moshuar janë më të besueshëm (dhe më të respektuar) se djemtë e rinj:

Përse do të jetë më keq [po të mos ketë gra të pranishme]? Nuk ka asnjë rëndësi, njëllë është ... do të parapëlqëja ta bëja identifikimin me njerëz më të moshuar, sepse dijnë shumë më tepër se ju [me moshë më të re].

Në disa raste të tjera, viktimat raportuan se ishin trajtuar pa shumë ndjeshmëri nga oficeret gra të policisë dhe nga kolegët e tyre. Një viktimë e përshkroi takimin e saj, si vijon:

Dy gra [police] më morën në pyetje. Nuk më kishte ndodhur kurrë në jetë gjë më e keqe. Unë jam grua, ju jeni grua, por nuk ka gjë më të shëmtuar në jetë se sa kur një police grua të merr në pyetje.

Me rëndësi për t’u vënë në dukje është se, edhe kur viktimat flitnin për mungesën e besimit ndaj një institucioni apo individi, kjo nuk ishte e pakalueshme. Sidomos një grua kishte patur një përvojë veçanërisht të hidhur me policinë, duke qenë se kishin abuzuar me të dhe detyruar të bënte punën e prostitutës: “Kur punoja në rrugë, ata më patën rrahur keqas disa herë. Atje kishte plot vajza që punonin si unë, por ata gjithmonë do të më rrihnin mua. Nuk e kuptoj përse”. Pra, për ta tejkaluar këtë frikë dhe mosbesim, u deshën shumë punë. Megjithatë, mosbesimi i saj ndaj autoriteteve të zbatimit të ligjit u tejkalua në sajë të trajtimit që i bën viktimës oficerët e policisë pas identifikimit të saj: “Po, kam frikë nga policia. Por tani nuk e kam më. Ata më dhanë edhe ndihmë”.

4.3. Problemet dhe pengesat në procesin e identifikimit

Vetë natyra e fshehtë e trafikimit e ndërlikon identifikimin e viktimave. Në rastet kur shfrytëzimi seksual, për punë, lypje dhe akte/shkelje kriminale realizohet në vende të fshehta ose nën vëzhgimin e rreptë të kontrolluesve

të viktimave, mundësia për të ndërhyrë në këto vende është shumë e kufizuar. Po kështu, viktimat shpesh nuk janë në gjendje të kërkojnë ndihmë, as për nevojat e tyre emergjente, dhe as si mundësi largimi. Për këtë arsye, është e arsyeshme të mendohet se do të mund të identifikohet vetëm një numër i vogël i viktimave të trafikimit dhe/ose ata që do të mund të bijnë në kontakt me programet e ndihmës (Brunovskis & Tyldum 2005; Surtees 2005: 25).

Problemet që lidhen me identifikimin shkojnë përtej vetë natyrës së trafikimit dhe lidhen me një sërë çështjesh dhe variablash të tjerë. Përvojat e personave të trafikuar zbulojnë një numër çështjesh që ndeshen në procesin e identifikimit, si në vendet e destinacionit, ashtu dhe në ato të tranzitit dhe të origjinës.

Mundësia e marrjes së informacionit gjatë identifikimit

Marrja e një informacioni të plotë dhe të gjithanshëm rreth identifikimit dhe referimit është një moment i rëndësishëm për viktimat – për largimin e frikës dhe krijimin e ndjenjës së qetësisë dhe të sigurisë. Shumë nga to ishin informuar me korrektësi dhe në mënyrë të plotë mbi procesin e identifikimit dhe mbi procesin që vinte më pas gjatë asaj faze. Disa viktimat morën informacion, i cili për ta ishte i qartë, i saktë dhe informues, duke luajtur një rol të rëndësishëm në vendimin për të marrë mbështetjen e ofruar:

Po, gruaja më shpjegoi qart se cilat do të ishin shërbimet që unë mund të përfitoja në strehëz. Çdo gjë ishte e qartë. Ajo më dha një broshurë në [gjuhën time], ku shpjegohej gjithçka.

Megjithatë, të shumta ishin viktimat që raportuan se kishin marrë informacion të pamjaftueshëm dhe/ose të paqartë në kohën, kur u identifikuan fillimisht dhe kur u duhej të merrnin vendim në lidhje me të ardhmen e tyre dhe me mundësitë e marrjes së ndihmës. Në disa raste, viktimat nuk kishin marrë fare informacion nga autoritetet në lidhje me mundësitë e përfitimit të ndihmës. Kur u pyetën se çfarë u kishin thënë autoritetet – pas dhënies së deklaratave në polici, takimit me ofruesit e shërbimeve, etj. – shumë persona të trafikuar përshkruan pak a shumë të njëjtat situata:

Nuk më thanë ndonjë gjë të veçantë. Erdhën të më marrin në mëngjes dhe më dërguan përsëri në stacionin e policisë ... një gjë më thonin vetëm, "sot do të shkosh atje dhe nesër do të të dërgojmë në [qytet]".

Policia erdhi tek ai vendi dhe më mori në stacion të policisë. Më morën një deklaratë dhe më sollën këtu ... ata thanë vetëm që nëse desha të

shkoja, mund të shkoja dhe se duhet të mendohesha mire për këtë gjë. Më thanë se atje do të ishte mirë dhe se do të kujdeseshin për mua.

Pas asaj ai tha që do të shkonim në [kryeqytet]. Dhe kjo më tronditi pa masë. Nuk e dija se çfarë më priste atje ... nuk më thanë asnjë gjë. Vetëm që do të shkonim në [kryeqytet] ... se do të takoheshim me prokurorin. Vetëm kaq më tha.

Në rastin e djemve të mitur, të identifikuar në tranzit, ata u mbajtën në stacionin e policisë dhe pastaj u transferuan në një strehëz për të miturit, pa u dhënë asnjë informacion mbi mbajtjen e tyre në stacion, ose mbi çfarë po ndodhte dhe/apo do të ndodhte:

Problemi ynë ishte se nuk dinim se ç'do të bëhej me ne, kështu që as nuk mendonim dot as për ushqim e as për ujë ... prisnim si do të vepronin me ne, çfarë do të thonin.

Në raste të tjera, viktimat kishin marrë informacion, por shumë nga viktimat ishin të mendimit se ai informacion ishte i pamjaftueshëm. Një viktimë theksoi se kjo mungesë informacioni ishte çorientuese dhe përsëriti disa herë gjatë intervistës se ata nuk i kishin dhënë informacion të mjaftueshëm mbi procesin, por disa të dhëna bazë në lidhje me strehëzën. Kur u identifikua fillimisht, ishte policia ajo që i kishte folur mbi mundësinë e marrjes së ndihmës:

Më thanë se ishte një shtëpi private, ose se do të qendroja në ndonjë hotel ... nuk dija se ç'duhej të prisja. Nuk dija ku do të shkoja. Duhet të më kishin shpjeguar pak më mirë se çfarë do të ndodhte me mua. Kur shkova në polici, nuk dija asgjë. Nuk e dija se ekzistonte kjo lloj strehëze.

Dhënia vetëm e një informacioni të pakët, mund të rezultojë në ndonjë ndërlikim situatash. Një viktimë shpjegoi se e kishin çuar në një shtëpi, por nuk i kishin thënë se ajo ishte një strehëz:

Nuk e dija se ishte një strehëz. Ata veç më thanë, "do të shkosh në një shtëpi"... tamam kështu më thanë "në një shtëpi". Ndoshta në një shtëpi publike, apo të ngjashme me të. Nuk kisha ide se për çfarë lloj shtëpie bëhej fjalë. Dhe unë u thashë: "Nuk shkoj atje".

Duhet shënuar këtu që në gjuhën e vendit "shtëpi publike" ka dy kuptime, kuptimi i dytë mund t'i referohet edhe "bordellos". Duke qenë se kishin të

bënin me një viktimë të shfrytëzimit seksual, mund të kuptohet qendrimi i saj kundërshtues, i ardhur nga një informacion i paqartë, madje edhe i frikshëm për një viktimë të tillë.

Vetë fakti se shumë viktima vijnë nga vende dhe komunitete, ku ndihma sociale është një dukuri e pazhvilluar, ose nuk ekziston fare, shpjegon mënyrën e reagimit dhe nivelin e njohjes së kësaj dukurie, e cila është, përgjithësisht, e kufizuar. Një studim i fundit i kryer në rajon, gjeti që viktimat shpesh çuditëshin (ose ishin dyshuese) rreth mundësisë së ndihmës, pikërisht prej mungesës së njohjes së tyre të këtij optionsi, si pasqyrohet në rastin e mëposhtëm:

Një viktimë shpjegoi kthimin e saj, “Te dogana, kur polici më pyeti përse nuk kisha para me vete, unë i shpjegova situatën time, dhe ai më mori menjëherë dhe më tregoi për organizatën [që ofronte ndihmë]”.

Kur u pyet viktimja sesi e kishte pritur këtë informacion, ajo tha, “Mendova se më ra një dhuratë nga Zoti. Në vendin tim ju nuk mund të gjeni asgjë pa para”. Një mike e saj, po ashtu viktimë e trafikimit, i përforcoi dyshimet e së parës, “Po kush jam unë që të më ofrojnë ndihmë? Dhe aq më tepër nga një polic” (Brunovskis & Surtees 2007).

Në të vërtetë, një numër i madh viktimash të ndihmuara që u intervistuan, shprehën çudinë e tyre mbi praninë e shërbimeve dhe programeve të tilla, shumica e viktimave asnjëherë nuk kishin përfituar ndihma apo mbështetje në të kaluarën nga ndonjë OJQ apo aktorë qeveritarë. Një viktimë e shpjegoi reagimin e saj ndaj ofertës për ndihmë, “Ne të gjitha kishim dyshimet tona, sepse ishte hera e parë që dëgjom për një gjë të tillë dhe nuk mund të besonim se dikujt do t’i vinte keq”. Një tjetër viktimë shpjegoi se, pavarësisht që i ishte ofruar një strehim, ajo preferoi të shkojë në burg. Ajo mendoi se do të kalonte vetëm një muaj atje, dhe ishte e përgatitur ta kalonte atë muaj në një burg. E dinte se çfarë e priste po të shkonte në burg, por strehimi për të ishte një ent i panjohur, një “besim në diçka të paprovueshme”. Edhe pasi foli me personelin e programit të ndihmës, ajo nuk ishte e qartë mbi programin dhe ishte e frikësuar. Si tha dhe vetë ajo, “Asnjëherë nuk mund ta imagjinoja se mund të kishte një vend të tillë” (Brunovskis & Surtees 2007).

Po kështu, po të shqyrtojmë komentet e viktimave të ndryshme, të intervistuar për studimin tonë, kur u pyet njera nëse kishin patur dijeni mbi mundësitë ekzistuese të ndihmës në kohën para identifikimit ose pas trafikimit, tha:

Jo, nuk dija gjë. As nuk më shkonte ndërmend që unë mund t’i kërkoja dikujt ndihmë ... po të kisha më shumë kohë, ndoshta do të kisha

kërkuar ndihmë. Ndiqesha nga disa njerëz, kisha frikë ... do t'i isha drejtuar një organizate, të cilës i besoja se mund të ndihmonte me të vërtetë, për shembull [një OJQ-je]. Në atë moment nuk e dija se ekzistonte një si kjo.

Jo, nuk dija absolutisht asgjë se kujt mund t'i drejtohesha për ndihmë. As që e mendoja se kishte një organizatë të tillë.

Mendoj se është e vështirë për viktimat e trafikimit, të cilat vijnë nga shtresat më të pambrojtura të shoqërisë, që nuk kanë radio apo TV, të gjejnë ndonjë burim informacioni, të paktën mbi linjën telefonike të komunikimit. Këta njerëz nuk kanë as telefona. Nuk e kuptoj sesi do të mund të gjenin këto viktima ndihmën që u nevojitej në [vendin e destinacionit].

Jo, asgjë, nuk dija asgjë [rreth ndihmës], sepse unë kalova nga një makinë tek tjetra, dhe më mbyllën në shtëpinë e tim shoqi. Nuk kam dalë jashtë, nuk më lejohej të flisja me asnjëri. Ndërkohë që isha në apartament, rrija gjithë kohën në atë apartament, pastaj më dërguan në një shtëpi, ku qendroja më shumë brenda se sa jashtë saj. Kur, me ndonjë rast dilja jashtë, në pazar apo dyqane, kisha frikë t'u afrohesha njerëzve.

Përveç kësaj, fjalë të tilla si, "shtrehëz", "shtëpi e sigurt" dhe "ndihmë" nuk ishin gjithmonë terma, koncepte të njohura për personat e trafikuar (ose popullatën në tërësi). Brunovskis & Surtees (2007) gjetën se në momentin e identifikimit, shumë viktima nuk e kuptonin qart se çfarë nënkuptohej me strehim ose dhënie ndihme.

Kur i pyetën se çfarë kuptonin me strehim, një viktimë shpjegoi që ajo kishte menduar se do të ishte një shtëpi plot me njerëz, fëmijë dhe vajza, dhe plot me kamera. Një viktimë tjetër tha, "nga ai vend që vija unë..., as që e kisha idenë se çfarë është. Më pëlqeu, dhe para se të vija këtu, nuk e dija se për çfarë bëhej fjalë. Në [qytetin tim] nuk ka asgjë të ngjashme me këtë, dhe as që mendoja se mund të kishte një gjë e tillë". Gjithsesi, të tjerët raportonin se imagjinonin që strehëza do të ishte një 'qilar me tra', një 'gënjeshër', ose një 'shtëpi me shumë njerëz' (Brunovskis and Surtees 2007).

Kjo nënvizon faktin se termat dhe konceptet shpesh janë specifike dhe sipas kontekstit, dhe meritojnë që të shpjegohen për t'u siguruar që këto terma kuptohen drejt nga grupi i synuar. Gjuha dhe mentalitetet kulturore mund të pengojnë një kuptim të drejtë të shërbimeve që ofrohen. Gjithashtu,

vihet në pah nevoja për një informacion të qartë e të gjithanshëm rreth opsioneve të ndihmës gjatë identifikimit, si edhe një informacion me një bazë më të gjërë rreth opsioneve të ndihmës në komunitetin në përgjithësi.

Mjetet që do të përdoren për të ofruar informacionin, duhet të marrin parasysh nivelet e njohjes së gjuhës, dhe ato arsimore të të intervistuarve, si edhe plotësinë dhe mundësinë e shfrytëzimit të informacionit. Në disa raste, një informacion i papërshtatshëm gjatë identifikimit nuk ka të bëjë shumë me nëse jepet informacioni, se sa ka të bëjë me mundësinë e viktimës për ta përceptuar dhe kuptuar atë informacion. Që shumë viktima gjatë identifikimit tronditen, hutohen, dëshpërohen apo frikësohen mund të ketë të bëjë me faktin që ato nuk kanë qenë në gjendje të kuptojnë informacionin e dhënë. Brunovskis and Surtees (2007) gjetën se shumë viktima shfaqën një kapacitet të kufizuar për të kuptuar opsionet, dhe për rrjedhojë, për të marrë vendime për shkak, ndër arsyet e tjera, të tronditjes dhe traumës gjatë identifikimit. Kjo ve në pah rëndësinë e konsiderimit të procedurave të ofrimit të informacionit duke e vënë veten në pozicionin e viktimës, duke gjykuar se si dhe kur duhet të jepet informacioni dhe kur do të ishte më e përshtatshme nga pikëpamja e gjendjes fizike dhe psikologjike të secilit person të trafikuar. Nga personat e trafikuar nuk mund pritet që ata të marrin vendime rreth të ardhmes së tyre, përse kohë nuk kanë kuptuar mirë mundësitë e disponueshme për to.

Përse i përket përcjelljes së informacionit verbalisht, është e rëndësishme të mendohet mirë se çfarë duhet thënë, sesi duhet të përsëritet informacioni i dhënë njëherë, dhe si duhet konfirmuar që përfituesit e mundshëm e kanë kuptuar se çfarë pritet prej tyre, se çfarë po u shpjegohet dhe ofrohet. Në intervista dukej sikur disa persona të trafikuar vërtet mund ta kishin marrë informacionin, por kishte dalë nevoja e përsëritjes dhe e theksimit të pikave kryesore, si edhe e përcjelljes së informacionit gradualisht dhe në një kohë, kur ishte më e përshtatshme dhe e kapshme. Ofrimi i materialeve me shkrim është i rëndësishëm, veçanërisht kur shumë viktima kanë nevojë për një farë kohe para se ta përpunojnë informacionin e marrë, të peshojnë mundësitë dhe të marrin një vendim në lidhje me ndihmën. Ofrimi i materialeve me shkrim, u lejon, gjithashtu, përfituesve të mundshëm që t'i referohen këtij informacioni përsëri, në një fazë më të vonshme dhe të jenë të ndërgjegjshëm për të gjithë menynë e ndihmës. Për më tej, viktimat mund të marrin informacion mbi ndihmat gjatë fazave të ndryshme, gjatë dhe pas përvojës së tyre të trafikimit. Ka rëndësi që të mobilizohen të gjitha pikat e kontaktit për marrjen e informacionit, që ai të jetë specifik për jetën pas-trafikim të tyre.

Po ashtu me rëndësi është fakti se kush e bën shpërndarjen e informacionit, duke patur një sërë ndërmjetësish të mundshëm, përfshirë punonjësit e terrenit,

personelin mjeksor, personelin e transportit dhe personelin e ambasadave dhe të zyrave konsullore. Pajisja e këtyre individëve me aftësi, me të dhëna dhe materiale informuese për të drejtat e viktimave dhe për mundësitë e ndihmës në një mënyrë të gjithanshme dhe të qartë, është vendimtare. Personat e trafikuar, idealisht, duhet të përfshihen në përcaktimin se çfarë informacioni duhet të paraqitet dhe si duhet të paraqitet më mirë dhe si të shpërndahet midis personave të trafikuar (Brunovskis & Surtees 2007).

Një pikë që lidhet me sa më lart, është çështja se shumë persona të trafikuar ishin kthyer në shtëpi, pa u identifikuar ndonjëherë, dhe për rrjedhojë, nuk ishin të ndërgjegjshëm për statusin e tyre si persona të trafikuar. Kështu, mesazhet rreth ndihmës për viktimat e trafikimit nuk kanë të ngjarë të kenë ndonjë kuptim për këta individë, pasi ata, jo domosdoshmërisht, e shikojnë veten si viktimë të trafikimit, dhe nuk ka të ngjarë që të kuptojnë se gëzojnë të drejtën për atë formë mbështetjeje. Më tej, shumë viktima vijnë nga zonat rurale dhe mund të mos kenë mundësi përdorimi të televizorit apo të radios në fshatin e tyre të lindjes, gjë që do të thotë se shumë nga ata nuk kanë mundësi përdorimi të informacionit mbi opsionet e ndihmës. Kjo nënvizon rolin që duhet të luajnë ndërmjetësit e komunitetit – drejtues, personel mjeksor, mësues, drejtues fetarë – si në identifikimin ashtu dhe në ofrimin e informacionit të disponueshëm personave të trafikimit.

Aftësitë identifikuese

Gjatë diskutimit të përvojave të tyre gjatë identifikimit, personat e trafikuar përmendën situata në të cilat ata nuk ishin identifikuar, madje edhe në rastet kur ata vetë kishin kërkuar ndihmë. Kjo vjen, pjesërisht, nga mekanizmat (jo të përshtatshëm) ekzistues për identifikimin në shumë vende, si në vendet e SEE-s, ashtu dhe në vende përtej këtij rajoni. Në shumë vende mungojnë procedurat e përshtatshme të identifikimit dhe të filtrimit, dhe shpesh nuk filtrohen si duhet migrantët e parregullt, azil-kërkuesit, që nuk kanë marrë statusin e refugjatit dhe të dëbuarit, për të përcaktuar nëse në mes tyre mund të ketë viktima të trafikimit, apo jo.²⁵

²⁵ Ky nuk është i vetmi rast në SEE, por është njohur si rast edhe nga BE-ja. Për shembull, në ligjin irlandez nuk ka dispozita mbi identifikimin e VeT, asnjë polici qeveritare nuk e ka për detyrë që të merret me identifikimin e VeT, nuk ka tregues apo udhëzues kombëtarë për procesin e identifikimit, dhe ato tregues që ekzistojnë – për fëmijët e larguar – nuk janë të përshtatshëm për të rriturit. Po kështu, në Britaninë e Madhe nuk ekzistojnë udhëzime kombëtare për shërbimet e imigrimit në drejtim të identifikimit të VeT, kur mbërrijnë në territorin e tyre, megjithëse, së fundi, janë bërë përpjekje për të rritur ndërgjegjësimin e personelit kufitar, dhe në 2005, qeveria nxoi udhëzimet e përkohshme mbi identifikimin e të miturve. Po të njëjtat probleme ekzistojnë në vendet e tjera të BE-s (IOM 2005a: 68, 88).

Një arsye tjetër mund të jetë niveli i kapaciteteve të aktorëve specifikë identifikues. Disa viktime nuk ishin identifikuar jashtë vendit të tyre, pavarësisht se ishin në procesin e kërkimit të azilit. Në disa raste, kjo kishte ndodhur për shkak se nuk ishin identifikuar si viktime të trafikimit dhe/ose sepse personeli nuk ishte në nivelin e duhur për të kuptuar rastet që kishin nëpër duar dhe çfarë veprimi duhej të ndërmerrenin për to. Në rastin e një të miture nga SEE, autoritetet e BE-s nuk arritën ta identifikojnë drejt, dhe e kategorizuan si migrante të paligjshme dhe e dëbuan. Vetëm kur mbërriti në vendin e saj – pas disa orë marrjeje në pyetje – rasti i saj u njoh si rast trafikimi dhe u referua për ndihmë. Po kështu, një viktimë mashkull, i cili iu drejtua policisë dhe u foli për situatën në të cilën ndodhej, nuk u identifikua nga autoritetet:

U tregova pasaportën dhe kur ata panë që unë nuk kisha vizë, më futën në furgonin e policisë. Ndejtën edhe për nja një gjysmë orë, duke pritur diçka, dhe pastaj më çuan në stacionin e policisë ... Jo, nuk më pyetën fare [se çfarë më kishte ndodhur]. Nuk më pyetën se kush tjetër ishte me mua, apo sesi kisha mbërritur deri atje. Përkthyesi më tha se po të dëshiroja të qendroja dhe të kërkoja azil, ata mund të më gjenin një vend ku të qendroja, por unë u përgjigja se jo, dua të shkojë në vendin tim ... [ditën tjetër] na dërguan në aeroport, të shoqeruar me policë. Ishim nja shtatë a tetë vetë, gjithsej.

Në raste të tjera, viktimat nuk ishin të ndërgjegjshme që përvoja që kishin kaluar në lidhje me trafikimin, mund t'u jepte atyre të drejtën të qendronin, të paktën përkohësisht, në vendin e destinacionit, kështu që nuk u tregonin autoriteteve historitë e tyre të plota. Një vajzë e re, që ishte e identifikuar në BE, paraqiti kërkesën për azil pa përmendur përvojën e saj trafikimit, shpjegoi situatën e saj, si vijon:

Po, qendrova për katër muaj për letrat e mia dhe kur më erdhi përgjigja negative, meqenëse kishin frikë se unë do të ikja nga vendi ku më kishin lënë [në BE], më futën në burg deri në kohën kur më kthyen në [shtëpi] ... jo, nuk desha të flasë me asnjëri për problemet e mia. Unë vetëm kërkoja që të më bëheshin letrat dhe nuk më shkoi në mendje që t'i tregoja ndonjë personi atje mbi përvojën time të trafikimit; por dhe askush nuk më pyeti për këtë.

Në sektorin e anti-trafikimit, mesa duket ekzistojnë, gjithashtu, probleme me identifikimin. Brunovskis & Surtees (2007) gjetën, në modelimin që bën të zonës së prostitucionit në Serbi, një numër të madh prostitutash rruge,

që kishin qenë trafikuar, por asnjëherë nuk ishin identifikuar nga policia përkatëse, që mbulon zonën e prostitucionit, e cila është e ndryshme nga policia anti-trafikim. Për më tej, kriteret e identifikimit nuk ecin/përmirësohen me të njëjtin ritëm të veprimeve të trafikantëve, në një kohë kur trafikantët rregullisht i përshtasin metodat e tyre në përgjigje të ligjeve dhe politikave të reja të shtetit, përshtatje këto, që lëvizin shumë më shpejt se masat anti-trafikim të zbatuesve të ligjit. Ndryshimet strategjike të trafikantëve që operojnë në SEE, kanë përfshirë edhe dhënien e shumave të vogla viktimave (për t'i bindur të mos përpiqen të largohen),²⁶ duke u premtuar se do të përshpejtohen procedurat e azilit ose duke premtuar martesë me viktimat, me qëllim ligjërimin e statusit të tyre,²⁷ strategji këto që për një kohë të shkurtër duket se i kompromentuan përpjekjet e identifikimit.

Një gjetje mbresëlënëse ishte që, shumë njerëz nuk ishin identifikuar, pavarësisht se ato iu ishin drejtuar dretpërdrejt pikërisht atyre autoriteteve, të cilët duhej të ishin në gjendje, të paktën, që t'i referonin rastet drejt çfarëdo forme ndihme. Një grua e moshuar, e verbër, ishte trafikuar dhe shfrytëzuar në ish Bashkimin Sovjetik për lypje për gjashtëmbëdhjetë vjet, por asnjëherë nuk u identifikua si e tillë, pavarësisht se u ishte drejtuar policëve gjatë kohëve të ndryshme të shfrytëzimit të saj:

Jam ndaluar nga policia disa herë dhe më kanë mbajtur prapa hekurave ... kisha frikë dhe mendova se do të më burgosnin ... më mbajtën disa ditë, derisa erdhi shefi i policisë. I tregova se ç'më kishte ndodhur dhe se kush po më mbante me forcë dhe që kishte dhe pasaportën time. Ai u tha policëve të tjerë, "lirojeni këtë plakë të ikë. Ajo nuk është

²⁶ Në Kosovë, në 2003 dhe 2004, viktimat e huaja raportojnë se kishin marrë rreth EUR 200 apo 300 në muaj nga trafikantët e tyre si rrogë, e cila paguhej rregullisht. Në shumë raste, kjo shërbente si një dekurajim për viktimat që të mos iknin nga pozicioni i trafikimit. Po kështu, në Maqedoni në 2003 dhe 2004, viktimave u paguhej një shumë e vogël parash, gjë që provoi në shumë raste të ishte bindëse që viktimat të mos kërkonin ndihmë dhe të iknin. Këto pagesa, megjithatë ishin shumë larg shumave të premtuara gjatë rekrutimit, janë, gjithsesi, të rëndësishme për viktimat duke patur parasysh që pjesa më e madhe e tyre trafikohen pikërisht nga dëshira për të punuar jashtë vendit dhe për të fituar para (Surtees 2005: 247, 316, cf. Andreani & Raviv 2004, Hunzinger & Sumner-Coffey 2003).

²⁷ Në BH në 2003 dhe 2004, viktimat raportojnë për taktika kur ato detyroheshin të martoheshin me pronarët, për të rregulluar statusin e qendrimit të tyre në atë vend. Kjo, zakonisht, bëhej pas një kohe, kur lindte rreziku që viktimat të kërkonin ndihmë, dhe qëllimi i kësaj ishte thjesht për të forcuar, shtuar kontrollin mbi këto viktima. Një tjetër strategji që përdoret, është detyrimi që ushtrojnë mbi viktimat e trafikimit që të kërkojnë statusin e refugjatit, në mënyrë që të vazhdohet shfrytëzimi i tyre gjatë kohës, kur përpunohet kërkesa e tyre për azil (Surtees 2005: 114, 131-2).

hajdute dhe nuk ka pse të mbahet këtu". Më thanë të shkoja ku të dëshiroja. U përpoqa t'u shpjegojë se nuk mund të shkoja gjëkund, sepse nuk dija ku isha dhe ku të futesha. Dhe atëherë, shefi u tha policëve të më çonin atje ku më kishin marrë. E kështu, ata më lanë përsëri në mëshirë të fatit. Rrija dhe qaja. Ku të shkoja? As para, as pasaportë. Në darkë erdhën pronarët, dhe filloi rutina e zakonshme. Kisha frikë të ikja, se pronarët më kishin kërcënuar me vdekje ... e kam treguar historinë time disa herë, edhe kur u shfrytëzova nga vetë policët. Por ata nuk pranonin se isha shfrytëzuar. Vetem këtu, në këtë strehim, më kuptuan më në fund dhe filluan të më ndihmojnë.

Po kështu, një burrë i trafikuar jashtë vendit për punë, shpjegoi sesi ishte ndaluar nga policia e vendit të destinacionit, e cila nuk tregoi asnjë interes për përvojën e tij të shfrytëzimit:

[U ndalova] nga policia në stacionin e autobuzit të [kryeqytetit të vendit të destinacionit], në çastin kur shkova të blejë biletën për të udhëtuar drejt [shtëpisë]. Na ndaluan dhe na kërkuan dokumentet, të cilat nuk i kishim. Policët nuk kishin fare dëshirë të dëgjonin se ç'po përpiqeshim t'u thonim për [shfrytëzimin tonë]. Ishin më shumë të interesuar në faktin se kishim thyer ligjin e regjistrimit ... kërkuan që të paguajmë gjobën.

Nuk ishin vetëm autoritetet e zbatimit të ligjit ata që nuk arrinin të identifikonin viktimat që kërkonin ndërhyrje. Një burrë tjetër shpjegoi sesi, kur ishte shtruar në spital, doktori që e ndiqte rastin e tij, nuk e kishte ndihmuar, duke anashkaluar situatën shfrytëzuese në të cilën ndodhej viktimat:

E dini, kur shfrytëzohesha në [atë vend destinacioni], më ra njëherë të fikët dhe pronari më çoi në spital. Atje doktori më pyeti përse nuk kisha numër sigurimi. I shpjegova që pronari më mbante me forcë dhe nuk më lejonte të ikja nga vendi ku punoja. Doktori e kuptoi situatën në të cilën ndodhesha ... në atë çast e ndjeva veten të liruar e se do të mund të shkoja në shtëpi ... qendrova në spital për tri ditë, ditën e tretë doktori më njoftoi se kura kishte mbaruar dhe se kostoja do të mbulohej nga një organizatë bamirësie. Kur dola nga dera e spitalit, pronari po më priste. Më çoi përsëri tek i njëjti vend, ku punoja më parë.

Një burrë tjetër, që kishte mundur të largohej, hyri në autobus për të shkuar sa më larg që të ishte e mundur nga vendi i shfrytëzimit të tij, dhe vetëm pastaj, kërkoi ndihmën e policisë. Megjithatë, ndërhyrja e tyre ishte e pamjaftueshme:

Por, ky ishte një stacion policie larg vendit ku unë shfrytëzohesha dhe ata më thanë të shkoja tek vendi i shfrytëzimit tim dhe te policia e atij rajoni, meqenëse ishin ata përgjegjës për rajonin. Unë nuk kisha pasaportë dhe kisha frikë se mos më kapnin trafikantët ... nuk kisha as dokumente dhe as para.

Po, ata nuk deshën të më ndihmonin. I pyeta se çfarë mund të bëja që të merrja pasaportën dhe m'u përgjigjën se duhet të shkoja në ambasadën [e vendit tim në kryeqytetin e vendit të destinacionit] dhe të kërkoja të nxirrja një pasaportë të re. Isha i cflitur. Pa dokument dhe pa të holla. Nuk kisha asgjë për të ngrënë. M'u desh të kaloja fshat më fshat duke lypur, gjatë rrugës sime drejt [kryeqytetit].

Në një numër rastesh, viktimat ua tregonin historitë e tyre rojeve kufitare, të cilët i lejonin të kalonin pa dokumente, por pa i identifikuar si persona të trafikuar dhe pa u ofruar ndihmë. Një viktimë, e trafikuar në ish Bashkimin Sovjetik, shpjegoi se çfarë duhej të ishte bërë ndryshe në rastin e saj:

Në rast se punonjësit e doganës do të më kishin trajtuar më seriozisht dhe po të më thonin se isha viktimë e trafikimit, unë mund të kisha marrë në telefon në linjën e komunikimit (helpline) menjëherë pas mbërritjes sime, dhe do të kisha kërkuar ndihmë. Nuk do të kisha harxhuar kaq shumë kohë duke kërkuar ndonjë person që të më kuptonte dhe të më shtrinte dorën.

Në të kundërt, do të ndodhte si në rastin e mëposhtëm, kur ajo dhe fëmija e saj zbriten nga treni dhe merren në pyetje:

Na mbajtën në zonën e doganës dhe filluan të na pyesnin. Unë fillova të qajë, u tregova mbi gjithçka kisha kaluar ... iu luta që të më linin të shkoja në [shtëpi]... më mbajtën atje për një kohë të gjatë derisa rastisi që në dhomë hyri shefi i doganës. Ai i urdhëroi të më linin të ikja dhe unë ika.

Megjithëse, në fund të fundit ajo u lirua, ajo u kthye në shtëpi pa u ndihmuar (dhe për këtë arsye, pa qenë e mbrojtur) dhe nuk dinte se kishte të drejtë të përfitonte ndihmë, pas kthimit në shtëpi. Vetëm pasi u arrestua për vjedhje (i vetmi mjet jetese i saj dhe i tre fëmijëve të saj) që ajo, më në fund, u identifikua si viktimë e trafikimit:

Hera e parë që u identifikova si viktimë e trafikimit ishte nga drejtoresha e jetimores së fëmijëve [në vendin e lindjes] ... m'u desh të bëja një

vjedhje se nuk kisha asnjë rrugëdalje tjetër. Kisha mbetur rrugëve. Kur më arrestuan, fëmijët mbeten vetëm dhe ata u referuan nga shteti te jetimorja e fëmijëve. Drejtoresha e kësaj jetimoreje erdhi në burg që të bisedonte me mua. I fola për jetën time dhe përse isha futur në burg.

Deri në një farë mase duket se disa viktimat nuk besoheshin se ishin viktimat të trafikimit dhe nuk identifikoheshin si të tillë. Ndërkohë që ky ishte një problem për shumë femra viktimat të trafikimit, duket se ky qendrim ka qenë i përgjithshëm për meshkujt viktimat të trafikimit. Mosarritja e identifikimit (dhe e ofrimit të ndihmës) të viktimave meshkuj, në disa raste çoi që trafikimi i tyre të zgjatej e të përfundonte në arrestimin ose ndalimin e tyre, të dyja këto qendrime që lanë pasoja afat-gjata mbi këta njerëz. Një burrë na tregoi sesi pas katër vjetësh në një situatë trafikimi në Shtetet e Pavarura të Komonuellthit, ai kishte arritur të shkonte në një vend fqinj, ku u ndalua nga policia, por pa u identifikuar asnjëherë si viktimë e trafikimit:

Shkova në [kryeqytet] me tren. Pas disa javësh më ndaloi policia se nuk kisha dokumentet me vete. I kaloja netët në stacion të trenit. Një natë atje erdhi policia. Më morën në polici bashkë me një tjetër person [të huaj], i cili mbante një pistoletë me gaz. Ai u tha se e kishte blerë pistoletën nga unë. Si rezultat, na arrestuan të dyve. Kështu kalova katër muaj në polici. Policët më rrihnin duke u përpjekur që unë të pranoja që pistoletat kishin qenë e imja. Ishte në një gjendje shumë të vështirë, sepse nuk kisha as dokumente. Ua shpjegova historinë time, por ata nuk më besuan.

Në të njëjtën mënyrë, një viktimë mashkull përshkroi sesi, pavarësisht se u kishte dhënë shpjegimet e veta mbi situatën e tij dhe të disa shokëve, ata nuk u identifikuan, dhe në fakt, u mbajtën në burg si migrantë të paligjshëm:

Disa policë qeshnin me ne, duke na thënë se ishim idiotë, se vetëm budallenjtë mund të përfundonin në një situatë të tillë shfrytëzimi ... disa policë nuk e kuptonin që ne ishim detyruar me forcë që të punonim, dhe se na kërcënonin me vdekje ... ata nuk besuan që pasaportat na ishin mbajtur nga shfrytëzuesit ... shumë nga ata mendonin se ne ishim hajdutë, se ne po përpiqeshim të iknim nga vendi për të fshehur identitetin tonë të vërtetë ... vetëm një oficer policie e mori seriozisht të gjithë informacionin që i dhamë ... unë dyshoj se policët as që e morën mundimin të inspektonin vendin e largët ku ishim mbajtur të shfrytëzuar ... besoj se një arsye për këtë mund të jetë dhe përfshirja e policisë vendore në të gjithë veprimtarinë e trafikimit.

Është, gjithashtu, interesante të vihet re sesi identifikimi i kohëve të fundit i 'viktimave të mundshme' ose i 'individëve në rrezik' (që mendohet se janë në proces trafikimi), megjithëse një shembull i identifikimit proaktiv, nuk po paraqitet pa problemet e veta. Gjithmonë e më tepër në SEE, gratë dhe vajzat po identifikohen në tranzit, dhe në ato raste kur ka shenja të sigurta se janë futur në procesin e trafikimit, u ofrohet shpesh ndihma në kuadrin e anti-trafikimit. Megjithatë, identifikimi i 'viktimave të mundshme' ka një karakter të fortë gjinor, dhe meshkujt që kalojnë kufirin shumë rrallë konsiderohen si 'viktima të mundshme', edhe kur janë në moshë të mitur. Gjatë punës sonë kërkimore, u intervistuan dy të mitur meshkuj, të cilët u kapën duke dashur të kalonin në drejtim të BE-s. Ndërkohë që ishte shumë e qartë se ishin në rrezik të trafikimit dhe kjo vinte nga gjendja e pambrojtur e familjes së tyre, këta të mitur u quajtën migrantë të parregullt (në vend që të quheshin 'viktima të mundshme'), dhe i kthyen në shtëpi. Kjo vjen në kundërshti me identifikimin e vajzave dhe të grave, të cilat, në situata të ngjashme, do të kishin marrë, përgjithësisht, një ndihmë. Në të njëjtën mënyrë, një numër i madh i trafikimit të viktimave (kryesisht meshkuj) për punë, të kapur po në të njëjtin shtet, gjithashtu nuk u identifikuan si të trafikuar, dhe as si 'viktima të mundshme', por u dëbuan si migrantë të paligjshëm.

Në disa raste, mosarritja e identifikimit të viktimave çoi në ri-trafikim ose shfrytëzim të vazhdueshëm. Në një numër rastesh, viktimat iknin nga një situatë trafikimi për t'u futur në një tjetër situatë shfrytëzimi. Pa të holla, pa informacion rreth ndihmës dhe pa mjete për t'u kthyer në shtëpi, ata nuk kishin rrugëdalje të tjera:

Takova një qytetar [të zonës] ... më mori në apartamentin e tij ... për të ishte shumë mirë, meqenëse unë i bëja të gjitha punët e shtëpisë – hekurosja, laja, pastroja... nuk mund të largohesha nga apartamenti ... pastaj mbeta shtatzënë ... Isha katër muajsh kur 'burrin tim' e futën në burg dhe unë isha e lirë ... lu drejtova policisë dhe ata më referuan tek një strehim për nënat beqare.

Në një rast tjetër, një burrë, i shfrytëzuar për punë, u 'ndihmua' nga një tjetër për të shpëtuar nga vendi i shfrytëzimit, por më vonë u shfrytëzua përsëri si punëtor krahu në fermën e këtij tjetri, që ishte me kilometra larg nga zonat e banuara dhe pa rrugë për t'u larguar. I shfrytëzuar u mbajt në atë fermë për shumë muaj, u detyrua të punojë, pa qenë e mundur që të largohej dhe pa marrë asnjë pagesë për punën e bërë.

Ndalimi dhe arrestimi në vend të identifikimit

Përbën problem fakti që në disa vende personat e trafikuar vazhdojnë të trajtohen si kriminelë dhe fajtorë, në vend që të trajtohen si viktimat të krimit. Në një numër mbresëlënës rastesh, viktimat raportojnë se ishin ndaluar nga policia, madje edhe burgosur, si rezultat i situatës së tyre të trafikimit. Disa shiheshin si kriminelë për shkak të qendrimit të tyre të paligjshëm, apo veprimtarive të paligjshme që kryenin në vend, dhe shpesh arrestoheshin ose dëboheshin si fajtorë për prostitucion, punë në të zezë ose si shkelës të ligjeve të imigrimit, dhe nuk identifikoheshin si viktimat të trafikimit. Disa ishin burgosur sepse kishin dokumente të rreme. Kjo ndodhte në SEE, por gjithmonë e më shumë edhe në BE, Turqi dhe ish Bashkimin Sovjetik. Një grua shpjegoi sesi ishte futur nën arrest në një vend të BE-s, ku e kishin trafikuar:

Trafikantët më blenë dhe po më çonin në një vend [tjetër]. Kisha pasaportë të rreme. Policia më zbriti nga treni. Shoqerohesha nga një ndërmjetëse dhe ajo më urdhëroi të mos thoja asnjë fjalë. Por punonjësi i policisë më futi në një dhomë më vete dhe më kërkoi që t'i thoja të vërtetën, sepse ai kishte ndeshur tashmë me disa raste vajzash kur ato nuk rrëfenin të vërtetën dhe iknin me ndërmjetësit e tyre, dhe më vonë ishin gjetur të vrara në një cep të pyllit ... ose ktheheshin në njerëz të droguar ... Unë u frikësova aq shumë sa që i thashë të gjitha ... më mbajtën në burg për tre muaj. Merresha në pyetje. Më trajtuan mjaft mirë. Ata rrëzuan akuzën për pasaportë të rreme, por kjo mori nja tre muaj kohë. Më pas u lirova dhe m'u ofruan të holla për shpenzimet e udhëtimit [tren për në kryeqytet], ku mund të merrja një pasaportë në [ambasadë].

Kjo viktimitë e kishte shumë të qartë sesi duhej të trajtohej rasti i saj:

Nuk duhej të më akuzonin për falsifikim pasaporte ... u desh të kalonte shumë kohë për ta hedhur poshtë atë akuzën e parë ... duhet të kishin ndaluar ndërmjetësen (atë e lanë që të ikte) dhe ta dënonin atë për veprime të paligjshme, e jo mua. Duhej të më kishin dërguar tek ndonjë strehim i specializuar për viktimat e trafikimit dhe duhej të më kishin ndihmuar që ta merrja urgjentisht pasaportën time, dhe pastaj të më dërgonin drejt e në shtëpi.

Në situata të tjera, viktimat u identifikuan si të trafikuar, por megjithatë ishin ndaluar dhe arrestuar, dhe shpesh, edhe dëbuar. Në disa raste, ata ishin

mbajtur në burg dhe në stacione policie, para se të transferoheshin në një strehëz, apo para se të ktheheshin në shtëpi. Një grua tregoi se ishte mbajtur për disa ditë në dhomat e paraburgimit, pavarësisht se ishte njohur si viktimë e trafikimit. Autoritetet nuk e referuan për ndihmë, por e mbajtën mbyllur dhe pastaj e dëbuan nga vendi [i destinacionit]. Një grua tjetër, dha shpjegime sesi ishte mbajtur në një apartament, dhe u lirua vetëm kur erdhi policia sepse në ndërtesë kishte shpërthyer gazi. Kur mbërriti policia, ajo ende nuk ishte e identifikuar si viktimë, “na futën në burg dhe pastaj na dëbuan”. Në të njëjtën mënyrë, një grup grash, të trafikuar për shfrytëzim seksual, u mbajtën në burg ndërsa dhanë dëshmitë dhe deklaratat, dhe vetëm pas përfundimit të këtyre procedurave ligjore u transferuan për tek shtrehimi për gratë e trafikuar:

Na futën në një qeli burgu. Kishte vetëm një dritare të vogël. Disa herë ajo hapej nga jashtë dhe punonjësit e policisë na ngulnin sytë dhe tregonin me gisht, duke thënë, “shikojini këto vajza ... shikojini sa të bukura janë”. E ndjeja veten sikur isha në një kopësht zoologjik. Prandaj dhe kur në çuan në seancat dëgjimore në gjykatë, unë nuk ndihesha e sigurt, se kisha dëgjuar që kishte patur raste kur vajzat ishin grabitur edhe nga mjediset e policisë. Më dukej se do të më grabisnin dhe do të më vrisnin. Ishte shumë e rëndë për mua nga ana psikologjike.

Në rastet e tjera, personat e trafikuar mbaheshin për faj të ‘krimeve’ që kishin bërë, ndërkohë që ishin të trafikuar, dhe vetëm më vonë u konsideruan si viktima:

Pa pasaporta ... e kaluam zonën e doganës gjatë natës. Zbritëm nga treni në afërsi të kufirit dhe dolëm jashtë. Kaluam nëpër një pyll. Kur sapo shkelëm në territorin e [vendit] u kapëm nga rojet kufitare, të cilët na kthyen përsëri tek pika e doganës. Na mbajtën atje për tri ditë. Ne u treguam të vërtetën. Na trajtuan mirë, na blenë ushqim dhe na thanë se duhej të pritnim një oficer policie ... krijuam besim tek majori, i cili e kuptoi drejt gjendjen tonë ... na dërguan tek një punonjës tjetër policie në qytet, ku na u desh të tregonim nga e para. Oficeri dërgoi një grup të zyrës federale të sigurisë në vendin ku shfrytëzoheshim. Për fat të keq, kur mbërritën ata në vendin e caktuar, nuk gjetën asnjë njeri dhe as pasaportat tona ... na çuan në një ‘qendër dizintoksikimi’, ku na mbajtën për dy ditë. Atje na dhanë ushqim. Pas kësaj na dërguan në një vend të izoluar hetimi. Atje qendruam për tri muaj ... na kishin dënuar ... ata thanë që, pikësepari nuk kishte prova se kishim qenë viktima, dhe së dyti, kishim shkelur ligjin.

Viktimat, përgjithësisht, e identifikonin kohën që kishin kaluar në burg dhe/ose në para-burgim, si një përvojë traumatike:

Nuk është mirë të qendrosh në burg ... kjo ka një ndikim negativ mbi mua ... qendrimi im në burg ishte një torturë. Mendoj se viktimat e trafikimit duhet të vendosen menjëherë në strehëza, në një vend të sigurt, por jo në burg.

Duhej të më kishin dërguar drejt e në strehim. Ka rëndësi që viktimës t'i jepen nja dy tri ditë, që ajo apo ai të ndihet se është në duar të sigurta. Një gjë e tillë është e pamundur në një stacion policor. Atje vetëm sa rritet përvoja traumatike. Në rastin tim, unë kisha frikë se mos më mbanin në burg për falsifikim pasaporte. Kjo gjë më bëri të ndihesha jashtëzakonisht nervoze.

Dua që të qetësohem nga ana psikologjike. Jam shkatërruar psikologjikisht, sepse kam qenë në burg. Ishte një traumë më vete, e barabartë me përvojën traumatike që kalon, kur shfrytëzohesh. Kur shfrytëzohesha isha në një gjendje të vërtetë skllavërie, ndërsa kur isha prapa hekurave të burgut, shpriti im ishte krejtësisht i vvarë. Ndjeja një dëshpërim të madh.

Fakti që disa viktimat ishin ekspozuar edhe ndaj kushteve të këqija dhe keqtrajtimit, ndërkohë që mbaheshin në paraburgim, shërbente veçse për t'ua shtuar stresin dhe traumën:

Kushtet në polici ishin të tmerrshme. Kishte shtatë vajza në një dhomë. Ushqeheshim si qen, mbaheshim me dryna, tamam si në burg. Vajzat që kishin ca të holla, ua jepnin policëve që të na blinin ushqim. Vajzave u vinte keq për mua, dhe më jipnin të haja. Po të mos kisha marrë ushqimin e vajzave, do të kisha mbaruar nga uria.

Normalisht, nuk na rrihnin. Vetëm kur na gjenin cigare. Në atë rast do të na vinin hekurat në duar dhe do të na varnin për hekurash, me duart lart.

Pengesat gjuhësore

Problemet gjuhësore përbëjnë një pengesë serioze për një identifikim të efektshëm, siç u vu në dukje nga shumë viktimat të intervistuar:

Polici po më thoshte diçka që unë nuk po e kuptoja ... unë nuk arrita të kuptojë as që duhej të rrija atje e të prisja për një farë kohe, në mënyrë që të vinte një zonjë nga një organizatë jo-qeveritare ... isha pak e trembur, sepse prita thuajse dy orë, pa kuptuar se ç'po ndodhte.

Në atë kohë nuk kuptoja mirë gjuhën [e tyre]. Kuptova vetëm se ishte një qendër emergjence dhe se do vinin ca njerëz të flitnin me mua mbi si do veprohej më tutje.

Fakti që oficerët e policisë më flitnin vetëm në gjuhën [e tyre], ishte shumë i bezdisshëm.

Në kohën e identifikimit unë desha të flitja me një person që e njihje gjuhën [time]. Të kisha një njeri që mund të më flitte në një gjuhë që e kuptoja ... nuk po kuptoja se ç'po ndodhte rreth meje.

Mendova se do të më ri-shitnin përsëri. Nuk kuptoja asgjë në gjuhën e tyre ... nuk ndihesha mirë dhe e sigurt në vetvete ... kisha nevojë për një përkthyes.

Nuk pata më frikë kur dëgjova të flitej në gjuhën [time]. Por, kur dëgjoja gjuhën [e vendit të destinacionit] unë dridhesha e tëra ... prandaj jam e kënaqur që policia gjeti njerëz që flasin [gjuhën time].

Në rastet kur sigurohej përkthim, nuk është se ndodhte ndonjë çudi e madhe. Një arsye është sepse përkthimi shoqërohej me disa probleme praktike – kostoja dhe disponueshmëria e shërbimeve. Dalin probleme edhe në lidhje me nivelet e të ndjerit mirë të viktimës. Disa nga viktimat shpjeguan se nuk ndiheshin mirë kur komunikonin nëpërmjet përkthimit, se ndiheshin të turpëruara me përkthyesin (sikur të ishte dikush nga komuniteti i tyre), që do ta merrte vesh situatën e tyre.

Atë deshën të komunikonin me mua, por unë nuk desha. Ende kisha frikë. Sa gjëra kisha përjetuar unë... nuk desha t'i ndaja me asnjë njeri tjetër. Ishte jeta ime, dhe aq më tepër nëpërmjet një përkthyesjeje, e cila ishte nga [vendi im]. Mendova se jeta ime nuk është punë e saj.

Në situata të tjera, viktimat ndiheshin sikur trajtoheshin keq dhe, madje, sikur gjykoheshin nga përkthyesi. Një vajzë, e cila u identifikua bashkë me një shoqe të saj, shpjegoi sesi shoqja e saj ishte keqtrajtuar deri në atë masë sa, kërkoi një përkthyes tjetër:

[Shoqja ime], megjithatë, siç më tregoi vetë, u trajtua keq nga përkthyesi, i cili ishte thirrur atje nga policia. Oficeri i policisë nuk po kuptonte se çfarë po thoshte përkthyesi. Por ky problem nuk zgjati shumë, sepse [ajo] iu ankua policit dhe ata morën një përkthyes tjetër.

Edhe viktimat të tjera raportuan për përvoja negative:

[policia gjeti një përkthyes] por ajo nuk përkthente se çfarë thoshin policët. Kur unë thoja diçka, ajo qeshte dhe me siguri u thoshte policëve diçka tjetër, se të gjithë qeshnin pastaj me njëri-tjetrin.

Në disa raste, aftësitë gjuhësore të aktorëve identifikues ishin të kufizuara, gjë që mund të krijonte keqkuptime. Një grua, e trafikuar në BE, shpegoi sesi fillimisht, pa përkthim, ajo e kishte të vështirë të kuptonte veprimin dhe qëllimet e autoriteteve të zbatimit të ligjit, që e identifikuan atë:

Policia na vizitonte rregullisht [në strehim] dhe vërtetë që na ndihmuan ... kur na jepnin para ose ushqim, unë, fillimisht, nuk desha të merrja, sepse nuk e kuptoja se përse do të na duheshin paratë.

Në të njëjtën mënyrë, një djalë i mitur, i identifikuar në tranzit, e përshkroi përkthyesin e punësuar nga policia:

Ai punonte në polici, ishte përkthyes. E fliste gjuhën [time], por jo aq mirë. Kur filloi të shkruajë, bëri gabime dhe nuk ishte i qartë.

Disa viktimat raportuan, gjithashtu, se shërbyen vetë si përkthyes gjatë marrjes në pyetje të personave të tjerë të grupit me të cilët ishin identifikuar, diçka që mbart probleme serioze si për viktimën, ashtu dhe për personat e tjerë që intervistohen. Që një viktimë të detyrohet të përkthejë mund të jetë shumë frikësuese dhe e lodhshme:

Ata ndërhyjnë dhe filluan të më pyetnin mua. Meqë vajza nuk e dinte gjuhën, ata më pyetnin mua gjithë kohës. Më shqetësonin. Sikur isha unë ajo që pyetej. Më pyetnin mua gjatë gjithë kohës. Kisha frikë.

Për viktimat e tjera, ka rreziqe në drejtim të cilësisë dhe nivelit të përkthimit, mungesa e sëcilës mund të çojë në keqidentifikim ose keqinterpretim. Një tjetër problem i mundshëm është që viktimat/përkthyeset nuk mund të jetë objektive në rolin e saj si përkthyes dhe ka mundësi që të mos ta përçojë me korrektësi bisedën. Në disa raste, viktimat u identifikuan dhe u ndaluan

në grup, duke përfshirë në atë grup edhe gra që punonin vullnetarisht në prostitucion, gra që kishin marrëdhëne me 'bosin' dhe/ose gra që luanin rolin e ndërmjetëses ose të mbikqyrëses. Në këto raste, kur kërkohet që të përkthejnë këto gra, viktimat nuk do e ndjejnë veten aspak të sigurta për të treguar përvojën e tyre dhe/ose nuk ka të ngjarë që bashkëpunëtorja të përkthejë me saktësi ata çfarë thuhet. Si rezultat, viktimat mbeten të paidentifikuara.

Përkthimi i keq mund të ketë pasoja shumë serioze, përfshirë edhe faktin që rrezikojnë të mos identifikohen si duhet, ose të keqinterpretohet situata e vetë viktimës. Dhe kjo mund të mbetet kështu për një kohë të gjatë dhe në vazhdim:

Ua thashë të gjitha. Ua thashë në gjuhën [time]. Nuk e flisja gjuhën [e vendit]. Ishte dhe përkthyesi atje ... Ia tregova të gjithë historinë time. E kisha të nevojshme të flisja; përndryshe jeta ime do të ishte në rrezik ... nuk isha tetëmbëdhjetë vjeç. Këto procedura [për të miturit dhe personat e trafikuar] nuk u ndoqën si duhet, sepse përkthyesi nuk ishte aq i mirë. Ai nuk përktheu çdo fjalë që i thashë.

Unë denoncova [trafikantin], por, mesa dukej, përkthyesi nuk përktheu mirë atë që thashë unë. Po të kishte përkthyer mirë, ata do të më mbanin në [vendin e destinacionit].

Unë pata një problem edhe me përkthyesin. Sepse, unë flas shumë shpjet, përkthyesi ishte nervoz, nuk po më kuptonte dhe nuk përktheu me saktësi. E gjitha kjo ishte shumë dëshpëruese, por unë nuk mund të flitja më ngadalë. Kur bëhem nervoze, flas shumë shpejt.

Mjedis jo i favorshëm në identifikim

Nganjëherë, mjedisi i identifikimit favorizonte frikën e viktimës dhe mund të ketë parandaluar ose penguar një identifikim dhe ndërhyrje të përshtatshme.

Në mjedise tradicionale të trafikimit – si bare, klube dhe restorante – përpjekjet për identifikim ndikohen, ndonjëherë, nga afria me shfrytëzuesit/trafikuesit. Për shembull, në disa situata, autoritetet e zbatimit të ligjit, të ngarkuar me detyrën e monitorimit të këtyre lokaleve (si terren i mundshëm i prostitucionit dhe trafikimit) i intervistonin gratë në bar, në prani të shfrytëzuesve të tyre. Në këto kushte, viktimat e kishin të vështirë të flitnin, shpesh duke qenë shumë të frikësuara për të thënë diçka në prani të bosit të tyre. Një raport i Amnesty International mbi situatën në Territorin e Kosovës nën Administrimin e OKB-s gjeti që shumë gra kishin raportuar se i frikësoheshin policisë sepse, mesa

kuptonin ato, policët kishin marrëdhënie të afërta me 'pronarët' e tyre. Një koment i njëres prej grave të trafikuar ve në dukje këto dy çështje:

Shumë policë vinin çdo ditë atje dhe ishin miq me pronarin e barit. Një polic i OKB-s erdhi dy herë. Herët e tjera vinin më shumë policë nga policia e Kosovës [policia lokale]. Një polic m'u afrua dhe më tha të dilja jashtë me të. Më bëri pyetje, por unë nuk mund t'i thoja asgjë për shkak të kërcënimeve të pronarit. E dashura e tij e fliste gjuhën time, dhe pronari më bëri që unë të shkruaja në një letër gjithçka i kisha thënë policit. Bëheshin dhe regjistrime, pronari, vajzat dhe polici të gjithë rrinim bashkë, kështu që gjithsecili dëgjonte se çfarë thoshte tjetri (AI 2004: 24)

Edhe në mjedise të tjera trafikimi, prania e shfrytëzuesit ishte problem. Një grua, e trafikuar jashtë vendit, tregoi sesi arriti të marrë në telefon në shtëpi dhe t'u japë adresën e lokalit ku punonte, në mënyrë që të vinin dhe ta shpëtonin. Megjithatë, mënyra sesi i zhvillua faza e parë e marrjes në pyetje, në prani të ndërmjetësit, arriti të kompromentonte identifikimin e saj:

Mbrëmjen tjetër erdhi policia. I pashë nga ballkoni, hapa pak derën time për t'i takuar ata menjëherë. Kur u futën brenda ne ishim të gjitha të mbledhura në një dhomë, të gjitha vajzat dhe ndërmjetësi, dhe u morëm në pyetje. Isha e frikësuar për të dhënë përgjigje, dhe e vetmja përgjigje që jepja ishte, "më merrni me vete". Ata, ndoshta, e kuptuan sesi ishte puna, përveç faktit që kishin të shënuar mbiemrin tim. Më morën nga ai vend.

Në një situatë tjetër, mënyra sesi u realizua bastisja e bordellos, ishte e lodhshme për të intervistuarit dhe nuk krijoi rrethanën e nevojshme që gruaja të fitonte besim dhe siguri nga fakti se po identifikohet:

U frikësua kur policët po na afroreshin me armë në dorë. Kishte shumë policë. Ishin të policisë federale, pastaj erdhën ato të qytetit [kryeqytetit] dhe nga një [seksion tjetër] policie, plus inspektorët, plus prokurori publik. Ne ishim në dhomat tona, me klientët. Policët erdhën i ranë derës. Ne nuk e hapëm. Por, papritur, ata e thyen derën dhe na kapën në befasi. Na nxorrën në fotografi.

Po kështu, një tjetër vajzë e re – e trafikuar si 'gruaja'/shërbyese në një familje – shpjegoi se ishte kapur nga policia dhe transportuar në stacionin e policisë bashkë me 'burrin' e saj/shfrytëzuesin dhe familjen e tij.

Ishte ai burri, e shoqja, e motra, nipi, kjo vajza dhe unë ... unë pata një frikë të madhe ... dhe e shoqja, fjalët që më thoshte në makinë, gënjeshttrat që duhej të tregoja ... unë thashë, mirë, dhe as nuk e dëgjova më. Ajo deshte që unë të gënjeja, por unë nuk gënjeva ... Po, ai burri më pa me një vështirm të keq, më kapi nga krahu dhe më bërtiti, 'sajo ndonjë gjë'. U frikësova dhe i thashë dakord.

Por edhe mjediset më pak tradicionale ku mund të bëhet trafikimi, përbënin një problem më vete. Në një rast, një grua që po mbahej nga trafikuesi/burri i saj u intervistua nga policia pas një rrahjeje veçanërisht brutale dhe në publik. Që intervista u realizua në shtëpinë e saj, në prani të të shoqit, pengoi aftësinë e saj për të folur lirshëm qoftë mbi temën e dhunës familjare, qoftë mbi trafikimin. Në një situatë tjetër, një grua dha shpjegime të hollësishme mbi kthimin e saj nga jashtë, duke përfshirë identifikimin si e trafikuar në portin e vendit tranzit, por shpjegoi se nuk dëshironte të fliste mbi shfrytëzimin e saj në mjedisin ku ndodhej:

Kryesisht, unë kisha frikë se mos takoja trafikantët, por nuk u thashë se kisha shumë frikë ... nuk desha të flisja me njeri ... Isha në një gjendje dëshpërimi, nuk kisha askënd me të cilin të mund të shprehesh. Nuk desha të shpjegoja se çfarë më kishte ndodhur, kur isha [jashtë vendit].

Vitkimat e tjera raportuan se prania e shumë njerëzve ndikoi në dëshirën e tyre për të shpjeguar se çfarë u kishte ngjarë. Një viktimë e mitur shpjegoi sesi i duhej të jepte deklaratën në prani të pesë punonjësve të policisë, një atmosferë kjo që ishte frikësuese dhe jo e favorshme për të. Në një tjetër rast, një viktimë tregoi sesi intervista e saj u bë me derë të hapur, duke mundësuar që të gjithë policët, madje edhe ata të policisë rrugore, të kishin mundësi të dëgjonin. Gjithsesi, ndërhyrja e punonjësve shtetërorë socialë i dha fund asaj gjendjeje: "[Punonjësit socialë] thanë menjëherë, 'të gjithë jashtë, ç'është kështu? Nuk mund të veproni në këtë mënyrë.'"

Disa viktimat treguan sesi ato vetë kishin gënjyer në identifikim, sepse nuk po kuptonin se çfarë po ndodhte përreth dhe nuk e ndjenin veten të sigurt në mjedisin e identifikimit:

Po më pyeste gjatë gjithë kohës, kështu që unë fillova të gënjejë. Më duhej ta bëja... Kështu që unë thashë, "Nuk është e vërtetë, përse duhet të lëshojë deklaratë". Ai tha, "Do të të dëboj". Unë i thashë, "Më dëbo nëse ke dëshirë, unë nuk kam frikë nga ti. Nuk pyes". U zemërova. Gjithçka filloi me inat, me lotë. As nuk e mora më vesh se çfarë po

thoja në atë kohë. Dhe pastaj, asgjë. Dhe pastaj, përsëri deklaratat mbi çfarë bënim atje. Nuk e di. Në fund, i thashë të dilte jashtë. Pas kësaj, ai më tha se do të shkonim në [kryeqytet], dhe kjo më tronditi fare.

Na thanë se do të merreshim në pyetje në atë vend, dhe se duhej të mendonim nëse po ushtronim prostitucionin, ose jo. Mohuam vazhdimisht: “Jo, jo, ne nuk bënim prostitucion”. Nuk e di pse e mohuam, ndoshta prej bosit. Ne mbrojtëm bosin... nuk e di se kë mbrojtëm dhe pse e mbrojtëm.

Pra, për shumë viktima, krijimi i një mjedisi të favorshëm dhe të qetë do të thoshte që të intervistoheshin në një hapësirë private, larg shfrytëzuesit dhe jo me ton të rëndë. Ekzistojnë edhe mjete të tjera me anë të të cilave aktorët identifikues mund dhe arrijnë të krijojnë një atmosferë dhe kontekst të favorshëm për zbulimin e të dhënave dhe për sigurimin e bashkëpunimit. Një numër viktimesh të intervistuar e ndjenin se prania e një personi tek i cili kishin krijuar besim, si për shembull, i ndonjë punonjësi social, mund të lehtësonte e të zgjidhte shumë probleme dhe shqetësime me të cilat ndesheshin. Të trajtuarit me respekt dhe ndjeshmëri ishte, për shumicën e viktimitave, një problem qendror dhe ndihmës për krijimin e mjedisit të qetë e të favorshëm. Një i mitur, viktimë, i cili ishte shfrytëzuar seksualisht, tha se përvoja e identifikimit për të nuk ishte dhe aq e vështirë, ndoshta në sajë të mjedisit që i kishin krijuar autoritetet e zbatimit të ligjit (të specializuar në anti-trafikim), që ishin duke hetuar rastin e tij:

Një oficer policie erdhi me makinë për të më çuar në qendër. Atje ishte një psikolog nga një [OJQ]... njerëzit e qendrës më trajtuan shumë mirë. Psikologu foli me mua, dhe pastaj foli me nënën time. Ata më thanë se kishte shumë djem, që ishin përdorur nga ky i huaji, dhe për ta mbyllur çështjen me sukses, ata kishin nevojë për ca të dhëna. Më siguruan se informacioni do të mbahej i fshehtë. E kisha shumë të lehtë të flitja me psikologun ... njerëzit që më merrnin në pyetje ishin shumë të sjellshëm dhe miqësorë me mua.

Kur e pyetën se sa e rëndësishme ishte që të kishe pranë një njeri të besuar, si për shembull, një psikolog në këtë fazë të identifikimit, ai shpjegoi: “Po [është e rëndësishme], veçanërisht kur ndodhesh në polici. Sepse atje ndihesh i trembur, ke frikë nga policët, dhe për më tepër, të vjen turp të flasësh për ca gjëra”.

Viktimat ndiheshin sikur merreshin në pyetje gjatë identifikimit

Për shumë viktime, procesi i identifikimit ishte i pakëndshëm dhe agresiv. Ato raportuan se u dukej sikur po kalonin nëpër atë, që ata e quajtën “marrje në pyetje”. Personat e trafikuar shprehën pakënaqësinë e tyre mbi mënyrën sesi u flitej dhe si trajtoheshin gjatë fazës së identifikimit:

Po çmendesha nga gjithë ato pyetje. Dëshën të dinin gjithçka, dhe më thonin që kisha qenë shumë e re kur isha larguar, pyetnin se, “çfarë kisha bërë atje, kush ishte djali që më dërgoi, sa para fitoja për një natë. Kështu që unë u lodha dhe ua thashë të gjitha, dhe se nuk desha të shkoja në shtëpi.

Të them të vërtetën, unë u ndjeva keq. Isha 22 vjeç kur më shfrytëzuan, e kisha kuptuar edhe vetë. Por ndihesh keq kur të tjerët ta thonë në sy. Kishte shumë policë në dhomë, dhe silleshin ashpër ... Të them të vërtetën, ata u sollën pak ashpër. Gjithë ato pyetje dhe shprehje që përdornin, “kush ishte djali”, “sa para bëje”, këto lloj gjërash.

Disa viktime folën, gjithashtu, edhe mbi mospërfilljen e aktorëve identifikues gjatë procesit të intervizimit:

Ishte e qartë që ata nuk pyesnin fare sesi po ndiheshin unë. Në të vërtetë askush nuk mund të kuptojë realisht se çfarë ndodh me ne dhe sesi ndihemi. Vetëm një person si ne e di se çfarë do të thote të vuash, e di se ç’kemi hequr.

Ndjenja e marrjes në pyetje lidhej dhe me faktin se shumë intervista fillonin shpejt dhe drejtpërdrejt preknin problemin e trafikimit dhe të shfrytëzimit. Intervistuesit menjëherë fillonin nga pyetjet dhe, si rezultat, viktime ndihej e bllokuar dhe nga ideja se po merrej në pyetje. Një mënyrë më e kujdesshme e fillimit të intervistës do të ishte, sipas një numri të madh viktimash, thelbësore për krijimin e ndjenjave të sigurisë e të qetësisë, gjë që do të mundësonte çlirimin nga frikat e tyre që në fillim të procesit:

Mendoj që vajzat si ne nuk duhet të priten nga policët, por nga punonjësit socialë, që dijnë si të sillen me njerëz si ne. Jemi të kthyera [pas trafikimit] dhe jemi copë copë. Ne nuk i besojmë më as lëkurës sonë. [Duhet] të ketë dikush që të mendohet para se të na drejtohet me pyetje, dhe jo të na marrë në pyetje menjëherë pas mbërritjes sonë.

Viktimat folën për situatë, kur procesi i identifikimit ishte më i zbutur dhe më pak i dhimbshëm, pikërisht për shkak të qendrimeve dhe trajtimeve pozitive nga ana e aktorëve ndihmues – si nga ana e agjencive të zbatimit të ligjit, ashtu dhe nga sektori social. Ajo çfarë bie ndoshta më shumë në sy, është se kjo ndjeshmëri ndaj rasteve që trajtohen nuk ishte aspak e vështirë për t'u treguar, mjaftonte ndonjë gjest i vogël për të krijuar siguri, qetësi dhe shpresë tek viktimat e intervistuar. Në shumë raste kjo do të thoshte që, viktimat të pyeteshin se si ishin, si ndiheshin, duke u lejuar një farë kohe për t'u çliruar para fillimit të pyetjeve, apo t'u ofrohej ndonjë ushqim apo pije freskuese, e kështu me radhë. Kur kupton se po tregohet kujdes për ty, se personi që ke përballë të ka kuptuar drejt se sa ke vuajtur, është shumë domethënëse për viktimat.

Nga pikëpamja praktike, është me rëndësi të shënohet se, përveç që i krijon tronditje viktimës, metoda e marrjes në pyetje rezulton shpesh kundërproduktive dhe nuk të jep informacionin e kërkuar. Një viktimë tregoi se sa jo efektive kishte qenë marrja në pyetje për rastin e saj:

Ai e kuptoi se nuk mund të më bënte asgjë, kështu që filloi të më flasë më me ashpërsi, të më marrë në pyetje. "Si ka mundësi që i dashuri yt blinte pije. Po kjo, po ajo". I thashë: "Përse po më pyet për të njëjtat gjëra njëmijë herë". Ai e kuptoi se isha vërtet e zemëruar, e pastaj edhe ai u zemërua, se nuk dinte çfarë të bënte.

Për t'u vënë në dukje në këtë rast është se, ajo e shikonte oficerin me një sy të ftohtë dhe arriti të kuptojë se ai po punonte në interes të personave të trafikuar – "Më vonë, e kuptova se nuk ishte djalë i keq, ai me të vërtetë kërkonte t'i ndihmonte gratë. E di si është puna, kur nuk e njeh menjëherë njeriun, nuk mund ta gjykos". Por, qëllimet e mira të oficerit ishin kompromentuar nga mënyra sesi kërkoi të zhvillojë seancën e pyetjeve. Ky shembull, gjithashtu, nënvizon tensionin që mund të ekzistojë midis zbatuesit të ligjit dhe viktimës, kur ai kërkon të identifikojë viktimat, dhe në disa raste, kur viktimat nuk dëshirojnë të identifikohen. Drejtpeshimi i bisedës dhe negociimi për uljen e këtij tensioni dhe përdorimi i një metode më të ndjeshme dhe të përshtatshme për identifikimin e viktimave, është një proces jashtëzakonisht i ndërlikuar.

Nuk dijnë kujt t'i drejtohen për ndihmë

Një nga çështjet më të prekura nëpër të gjitha intervistat ishte fakti që shumë viktima nuk dinin se kujt t'i drejtoheshin për ndihmë, pasi ishin larguar nga situata e trafikimit. Ky ishte përherë rasti, pavarësisht nga seksi, mosha, kombësia,

forma e trafikimit, apo dhe nga vendi i destinacionit. Për shumë viktime, kërkimi i ndihmës nga policia apo nga autoritetet e tjera të zbatimit të ligjit nuk ishte i mundur, pasi nuk i besonin policisë dhe për shkak të statusit të tyre, shpesh, të paligjshëm. Këto çështje u trajtuan më lart në këtë kapitull. Dhe disa viktime, që kishin kërkuar ndihmë nga autoritetet e zbatimit të ligjit, as nuk u identifikuan, dhe as nuk u ndihmuan (pikë kjo që është shqyrtuar më lart).

Kisha frikë sepse nuk isha e sigurt nëse polici kishte ardhur për ta informuar pronarin se do të vinin të më kërkonin, apo nëse kishte ardhur për të më shpëtuar.

Absolutisht nuk dija kujt t'i drejtohem për ndihmë ... nuk kisha besim tek policia ...dhe mendoja se përveç policisë nuk ekzistonte asnjë tjetër që të mund të më ndihmonte.

Sipas të intervistuarve, nuk kishte shumë mundësi identifikimi dhe ndihme:

Nuk dija asgjë për ndihmën e disponueshme për viktimat e trafikimit. Nuk dija kujt t'i drejtohesha në vendin e destinacionit, në rast se do të kisha nevojë për ndihmë. Mendoja se i vetmi vend ishte policia. Atje nuk kisha kurajo të shkoja se [trafikantët] na thonin vazhdimisht që i kishin blerë edhe policët. Më kërcënonin me vdekje në rast se shkoja në polici. Kisha frikë.

Jo, nuk dija se mund të kishte gjekund ndonjë ndihmë të mundshme për mua.

Mundësia e përfitimit të ndihmës ishte veçanërisht e 'padukshme' për viktimat, kur ndodheshin në vendet e destinacionit. Në fakt, disa viktime merrnin në telefon (helpline) në vendet e tyre të origjinës, sepse nuk e dinin ku do të mund të kërkonin mbështetje në vendin e destinacionit, edhe kur ekzistonin këto linja komunikimi. Një nga arsyt mund të jetë se në disa vende agjencitë ndihmuese kanë mundësi të kufizuara qasjeje tek viktimat, për shkak të kuadrit specifik ligjor të anti-trafikimit në ato vende. Për shembull, në disa vende, ofruesve të shërbimeve nuk u lejohet qasja në burg apo në dhomat e paraburgimit për të bërë filtrimin e migrantëve të parregullt, të të miturve të pashoqeruar dhe të prostitutave të arrestuara si një kontingjent i mundshëm i viktimave të trafikimit. Në të njëjtën mënyrë, nuk ekzistojnë programe pune në terren (p.sh. puna me fëmijët e rrugëve, prostitutat, etj.), gjë që i pakëson mundësitë e identifikimit.

Ndihma që ofrohet nga OJQ-të, agjencitë ndërkombëtare, aktorët shtetërorë dhe të tjerët ishte një surprizë e mirëpritur për shumë viktime të një numri të madh vendesh:

Nuk kisha frikë kur kisha rretherrotull rojet kufitare ... më thanë të mos shqetësohesh, se do ta rregullonin transportimin tim për në shtëpi ... më thanë se unë do të mund të kaloja disa ditë në një strehim special për viktimat e trafikimit, që ishte në [vendi tranzit] dhe që i përkiste një OJQ-je.

Nuk duan të identifikohen dhe as të ndihmohen

Një tjetër element, që meriton vëmendje është mënyra sesi vetë viktimat e përjetojnë dhe e kuptojnë procesin e identifikimit. Disa mund të mos e shikojnë këtë proces si zgjidhja e situatës së tyre në jetë, dhe jo gjithmonë e përceptojnë 'shpëtimin' si një fakt pozitiv. Kjo ka shumë mundësi të jetë rasti, kur viktimat kanë gjetur mënyrat e negociimit të përvojës së tyre të trafikimit – d.m.th. të kursejnë para dhe t'i dërgojnë ato në familje, të bëjnë plane për të shpëtuar nga duart e trafikantëve, por të vazhdojnë të qendrojnë jashtë vendit, të krijojnë një marrëdhënie me një klient, të martohen dhe të qendrojnë në atë vend – 'shpëtimi' dhe identifikimi do t'i kompromentonin këto strategji. Një vajzë tregoi, në lidhje me identifikimin e saj, se ai nuk ishte aspak çfarë kërkonte ajo. Kur ishte pyetur se ku deshte të shkonte tani, ajo ishte përgjigjur thjesht, "Jo në stacion, jo në një shtëpi të sigurt apo në ndonjë vend tjetër. Desha të kthehem në punën që bëja këtu, ose në [kryeqytet], ose në ndonjë vend tjetër. Unë thjesht nuk desha që të merresha në pyetje, por ata më rrinin aty...".

Një tjetër vajzë, e identifikuar jashtë vendit tha se identifikimi i kishte prishur të gjitha planet e saj. Fillimisht, ajo ishte trafikuar, por pas pak kohe ajo kishte hyrë në negociata me pronarin/trafikantin për të diskutuar kohën e largimit, dhe për një kohë të shkurtër do të kishte mundur të ikte në shtëpi me ca të holla me vete. Por tani që ishte identifikuar, pronari/trafikanti nuk do ta paguante më, dhe kthimi i saj në shtëpi ishte vonuar shumë, sepse iu desh të qendronte për një kohë të gjatë në strehim. Kur u intervistua, ajo ishte ende në strehim, në pritje të kthimit në familje, nja katër muaj më vonë nga ç'kishte planifikuar ajo vetë:

Pse ndodhi gjithë kjo? Më shqetësonin. Kisha planifikuar të shkoja në shtëpi në muajin gusht. Nuk desha të rrijë më shumë. Por gjithçka ndodhi kaq papritur ... po, identifikimi m'i prishi planet. Kisha bërë në plan të punoja edhe pak, por policia më gjeti më shpejt.

Përveç kësaj, viktimat mund të mos jenë dakord që kushtet e shpëtimit janë domosdoshmërisht më të mira se ato të trafikimit. Ky argument ka një

rezonancë të veçantë në situatat kur viktimat ndalohen dhe merren në pyetje dhe nuk intervistohen në mënyrën e duhur, ose kur ato trajtohen në qendra apo me programe, të cilat, sipas atyre, nuk i përgjigjen nevojave që kanë. Viktimat mund të bëjnë fare mirë llogari se çfarë mund t'u ofrojë identifikimi dhe ndihma, dhe kur nuk janë të kënaqura me këto opsione, mund të refuzojnë që të identifikohen (Brunovskis and Surtees 2007). Ndjenja e pasigurisë se ku do të dërgohen, mund të përbëjë, gjithashtu, një problem:

Kisha më shumë frikë [në identifikim] sepse nuk mund të ktheheshim më mbrapsht, atje ku punonim. Dhe sepse nuk e dija fare se ku do të shkoja, apo në cilin vend do të të çojnë.

Që identifikimi mund të jetë mjaft i lodhshëm dhe ndërhyrës, është dhe një tjetër shpjegim përse disa viktimat e refuzojnë identifikimin:

Kur policia e portit më pyeti me çfarë merresha [jashtë vendit], u thashë se praktikoja prostitucionin vullnetarisht ... Isha tepër e lodhur, e uritur, nuk pyesja për asgjë. Thjesht nuk desha të më torturonin me pyetje.

Po ashtu, disa viktimat nuk e konsideronin veten si viktimat të trafikimit, por më shumë si migrantë të parregullt, ose të pafat, dhe refuzonin idenë e viktimës së trafikimit (Brunovskis & Surtees 2007; Pearson 2002, Surtees 2005). Në një intervistë, që në fillim u bë e qartë që e intervistuar nuk e shikonte veten si një viktimë të trafikimit, madje tentoi të bindte punonjësit kërkimorë se ajo ishte thjesht një person që kishte probleme në mjedisin e saj familjar. Një ofrues shërbimesh shpjegoi se ky rast nuk ishte i pazakonshëm:

Një situatë që ndeshet shpesh është ajo kur ne dhe prokurori mendojmë se vajza është viktimë e trafikimit, por ajo nuk është e ndërgjegjshme për këtë. Kishim rastin e një vajze ... qendroi nëntë muaj këtu. Të gjitha faktet në deklaratën e saj vinin në dukje se ajo ishte e trafikuar dhe shfrytëzuar, megjithëse ajo mund ta kishte lejuar këtë gjë për të bërë para. Nuk e ndjente veten si viktimë e trafikimit deri në fund të qëndrimit, madje edhe kur u kthye në shtëpi.

Vajza të tjera – ato, që për shembull, mbahen nga disa individë si 'gratë e tyre' – po ashtu mund të mos e njohin situatën në të cilën ndodheshin, si situatë trafikimi, dhe mund të kenë ndjenja simpatie dhe varësie nga 'burri'/shfrytëzuesi i tyre, gjë që i parandalon të kërkojnë të largohen nga gjendja ku ndodhen (Surtees 2005; Andreani & Raviv 2004).

Po ashtu, në intervistat me meshkuj të trafikuar, terminologjia “viktimë e trafikimit” dhe e gjithë lënda shoqerore që nënkupton kjo dukuri, ishte jashtëzakonisht problematike, dhe ata e refuzonin atë term totalisht:

Si mund ta thoni këtë, unë nuk mendoj se jam viktimë e trafikimit. Është qesharake të mendosh se unë qenkam një viktimë.

Mendoj se asnjë njeriu nuk do i pëlqente që t’i vihej ky emër. Tingëllon si një ofendim komik. Njerëzit përreth teje mund të tallen me të, veçanërisht nëse bëhet fjalë për djem të rinj, pa një përvojë jetësore dhe që nuk mund ta kuptojnë se ka edhe shfrytëzim të burrave.

Për të gjitha këto arsye, disa persona të trafikuar nuk e shikojnë domoshmërisht identifikimin si një çudibërës. Mund edhe të zemërohen për shkak të humbjes së të ardhurave. Mund të kundërshtojnë, madje edhe të kenë frikë në rast se kthehen menjëherë në shtëpi. Ata mund të ndjejnë shqetësim nga fakti se janë ndarë nga trafikuesi²⁸ i tyre, veçanërisht nëse trafikuesi ka qenë edhe shfrytëzues edhe i dashur/burrë. Si rezultat, viktimat mund të mos sillen ashtu siç do të besonin aktorët identifikues. Në vend që të jenë mirënjohës, apo të ndihen të çliruar, ata mund të tregohen armiqësorë, dyshues, të frikësuar dhe mosbesues, siç u vu në dukje në seksionin e mëparshëm. Është e rëndësishme që të njihet nga aktorët anti-trafikim fakti se, jo të gjitha reagimet ndaj identifikimit do të jenë pozitive, prandaj ata duhet të kenë kujdes kur veprojnë apo reagojnë ndaj personave të trafikuar, të cilët janë veçanërisht armiqësorë dhe rezistues edhe gjatë fazave të mëvonshme të jetës së tyre pas-trafikim.

Edhe kur viktimat nuk duan të mbeten në situatën e tyre të trafikimit, kjo nuk do të thotë gjithmonë se duan të identifikohen apo referohen për ndihmë. Një vajzë përshkroi sesi u identifikua ajo dhe një shoqe e saj nga policia dhe u referuan tek një strehëz për ndihmë. Policët u thanë atyre se kishin patur shumë fat:

²⁸ Marrëdhënia midis trafikantëve dhe personave të trafikuar është pambarimisht e ndërlikuar, dhe ndikon jo vetëm mbi gjendjen ekonomike, por edhe mbi gjendjen vetjake të viktimës. Kohët e fundit, në disa vende, trafikantët kërkonin që t’i lidhnin viktimat me veten e tyre në një mënyrë shumë personale, si ‘grua’ dhe ‘të dashur’, duke e bërë më të vështirë ikjen dhe shpëtimin e viktimave të tyre. Për shembull, në vende të ndryshme në rajonin e SEE-s, përfshirë Shqipërinë dhe Serbinë, viktimat janë rekrutuar dhe/ose shfrytëzuar nga dikush, me të cilin ato kanë qenë në marrëdhënie intime, përfshirë të dashurit, të fejuarit dhe bashkëshortët. Në vendet e tjera, si në Kosovë, BH dhe Maqedoni, vajzat mbaheshin individualisht nga burrat, si ‘gra’, dhe detyroheshin që përveç punëve shtëpiake brenda shtëpisë, të ofronin dhe sbërbime seksuale (Surtees 2005).

Ata më thanë vetëm, "Sa me fat jeni që po shkoni atje. Do të dëshironim edhe ne të rrinim ca ditë në atë vilë të bukur..." por unë nuk desha të shkojë, desha të isha e lirë dhe të rrija vetëm.

Pas gjithë këtyre që u përmendën, refuzimi për t'u identifikuar mund të jetë një zgjedhje e përkohshme nga ana e viktimave. Brunovskis and Surtees (2007) gjetën që viktimat marrin vendime të ndryshme rreth identifikimit dhe ndihmës gjatë fazave të procesit dhe si reagim ndaj faktorëve të ndryshëm. Domethënë,

Vendimet rreth pranimit apo refuzimit ndikoheshin nga faktorët kohë, gjendje dhe niveli i kërkuar i përfshirjes. Viktimat merrnin vendime të ndryshme në faza të ndryshme të jetës së tyre pas-trafikim, me evoluimin e gjendjeve të tyre individuale dhe në përgjigje të angazhimit të kërkuar nga ana e ofruesve të ndryshëm të ndihmës. Kjo flet për një proces vendim-marrës shumë më kompleks, nga sa sugjerohet zakonisht. Në këtë mënyrë, kur flitet për 'refuzim ndihme', është më saktë të flitet mbi një vazhdimësi të marrjes së vendimit, periudhë përgjatë së cilës kalon pjesa më e madhe e viktimave, mbi një sërë problemesh që rrethon procesin e vendim-marrjes mbi ofertën e shërbimit dhe mbi interesat e nevojat e tyre vetjake (Brunovskis and Surtees 2007).

Duke patur parasysh sa më sipër, refuzimi fillestar i identifikimit mund të mos jetë përfundimtar, dhe ka rëndësi që të mendohet mbi mënyrat sesi të bëhet e mundur (nga pikëpamja e etikës dhe e ruajtjes së fshehtësisë) ndjekja e problemit me personat e trafikuar, dhe që t'u jepen atyre opsionet e identifikimit në një fazë më të vonë, si në vendin e tyre ashtu dhe jashtë tij.

Paragjykimet, mospërfillja dhe trajtimi i keq

Shumë viktima përmendën përvoja shumë pozitive në identifikim pikërisht, sepse nuk vuajtën nga paragjykimet gjatë bisedimeve të tyre me aktorët anti-trafikim. Siç u diskutua në seksionin e mëparshëm, shumë aktorë identifikues luanin rol qendror në drejtim të krijimit të ndjenjave të sigurisë dhe të qetësisë, nëpërmjet shfaqjes së ndjeshmërisë dhe sjelljeve jo paragjykuese të tyre.

Nga ana tjetër, disa viktima raportuan që ishin paragjykuar dhe ishin trajtuar negativisht gjatë identifikimit nga ana e aktorëve anti-trafikim. Në disa raste, viktimat e lidhnin këtë qëndrim me faktin se kishin punuar si prostituta:

Na futën në një qeli burgu. Ajo kishte një dritare të vogël ... ata policët ishin pa kulturë. Na gjykonin si prostituta.

Polici [që më identifikoi] nuk ishte i sjellshëm ... jo, jo e kisha takuar tri javë më parë, kështu i thashë ... unë isha me personelin [e organizatës] dhe ai nuk e dinte se unë po shkoja ... kur hyra ia kujtova se kush isha, dhe unë e thashë në mes të të gjithëve se sa në pozitë të vështirë më kishte futur ai. Por tani flet ndryshe ... se tani janë njerëzit nga organizata... është ndryshe puna tani. Por atëherë ai veproi sikur nuk ishim njerëz.

Në fund të bisedës dhe të deklaratës sime, një grua [police] m'u afrua dhe vuri dorën mbi një tavolinë të vogël ... dhe tjetrën mbi shpinën e karrikes sime. Më afroi fytyrën, më pa në fytyrë dhe tha: "A e njeh atë vajzën tjetër që ishte me ju. Me siguri që po, se ju jeni të gjitha të lidhura, të gjitha njëlloj jeni"... [u ndjeva] tmerrsisht keq. Më vuri nofkën prostitutë.

Nuk është se përdorën fjalë të këqija, por thonin: "Të gjitha njëlloj jeni. Mbuloni njëra-tjetrën. Mbroni pronarët tuaj." Mendoj se kaq është e mjaftueshme. Kur dikush mendon se është i tëri faji yt. Nuk ndjehesha fajtore për çfarë kishte ndodhur. E di se kë duhet të bëjë me faj. Por kur dikush ta ve ty fajin, ti me të vërtetë ndihesh keq. Ta thotë drejt e në sy që ti je një prostitutë. Ose në gjuhën tonë: "lavire". Mendoj se është e tmerrshme.

Këto vëzhgime kanë dalë edhe nga një studim mbi trafikimin e brendshëm në BH, sipas të cilit disa të intervistuar konfirmuan se njëri nga mesazhet kyç në fushën e anti-trafikimit dukej se ishte "viktimat këshillohen që të mos punojnë më si prostituta", duke nënkuptuar se prostituimi i tyre ishte vullnetar (Reiter 2005: 18). Paragjykimet dhe mospërfilljet në identifikim u manifestuan jo vetëm nga zbatuesit e ligjit, por edhe nga profesionistë të tjerë. Një viktimë tha se kur ishte takuar me punonjësit socialë, pyetja e parë që i bënë ishte nëse ishte e 'sëmurë' apo e 'infektuar', duke iu referuar kështu sëmundjeve të transmetuara seksualisht, si rezultat i shfrytëzimit seksual të saj.

Është me rëndësi që të vihet në dukje, sidoqoftë, që paragjykimet dhe qendrimet negative nuk lidheshin vetëm me punën në prostitucion. Një djalë tregonte rreth vetes dhe shokëve, me të cilët kishte ikur nga trafikimi, sesi ishin tallur nga autoritetet, kur u kishin kërkuar ndihmë për t'u kthyer në shtëpi. Ai

shpjegoi sesi kishin qeshur e tallur policët me të dhe sesi i shanin – idiotë, budallenj – sepse kishin përfunduar në një situatë shfrytëzuese. Ata nuk kuptonin gjendjen e tyre dhe nuk treguan asnjë keqardhje përsa kishin vuajtur ata djem.

Përveç rasteve të mospërfilljes, viktimat folën edhe për disa raste të trajtimit të ashpër, të kërcënimeve dhe të abuzimeve:

Kur na morën atje, na mbajtën deri në mëngjes dhe pastaj filluan të na pyesnin. Pastaj, polici filloi të na kërcënojë ... ishte i tmerrshëm. Na e mbylli gojën. Qendruam nga ora pesë e gjysmë e mëngjesit deri natën.

[Në atë çast kisha nevojë] të më kuptonin, se duhet të silleshin si qenie njerëzore, ndryshe nga sa silleshin ... do të desha të na flitnin dhe jo të na frikësonin me pesë vjet burg. E di që nuk është e mundur. Ka një ambasadë dhe ata mund të të kthejnë. Burgimi mund të ishte për një një muaj, jo më shumë.

[Polici] goditi shoqen time, sepse ajo po thoshte se e kishte parë atë personin për herë të parë, kur ne po iknim drejt [vendit të destinacionit].

[Polici] po ulërinte, "Kush ju mori [jashtë vendit]", "ç'keni bërë atje", "çfarë deshe në kufi ku të kapën" ... më tërhoqi bluzën, dhe unë gati sa nuk rrëzoja nga karrigia: "Më thuaj kush të dërgoi [jashtë vendit], ose do të të godasë me këtë radion në kokë". Në dorë kishte radion, të cilën e përdor policia kur komunikojnë me njëri-tjetrin.

Po, na morën në pyetje ... Po, për një kohë shumë të gjatë [mbi dymbëdhjetë orë]. Nuk na dhanë as një gotë ujë. Ishin të tmerrshëm, të frikshëm.

Nuk na rrahën. Thjesht na kishin marrë në pyetje. Kërkonin të dinin me hollësi se çfarë bënim ne në atë apartament. Nuk mund të mos flitnim. Po të mos flitnim, ata fillonin të na bërtitnin. Ishim shumë të frikësuar ... unë nuk ndihesha mirë. Na ndanë dhe na mbyllën me çelës. Na merrnin me radhë në pyetje.

[Policia] nuk më trajtoi dhe aq mirë. Ngrinin zërin, më bërtisnin. Nuk kuptoja asgjë. Përgjigjesha në gjuhën time, por ata vazhdonin të bërtisnin dhe unë vazhdoja të mos kuptoja [gjuhën e tyre]. Kisha frikë.

Në disa raste problemi kishte të bënte më pak me keqtrajtimin sesa me moskokëçarjen. Një viktimë foli për një moment, kur ajo po përpiqej me të

gjitha mënyrat që të identifikohesh, ndërsa oficeri, si shumë i zënë që ishte për ta dëgjuar, nuk e dëgjonte fare dhe i tha të ikë:

Njëherë na ndodhi që na kapi policia dhe na mori nga rruga, dhe unë desha t'i tregoja, por gruaja e ndërmjetësit më kërcënoi se do të na vriste neve ose familjarët tanë, në rast se hapnim gojën. Por unë desha të flitja me policin, kur ai na përzuri të gjithave jashtë. I thashë se kisha diçka për të thënë, por ai u përgjigj se nuk ishte koha, dhe pastaj nxitonte të ikte dhe unë nuk arrita të flasë.

Është për të ardhur keq, kur viktimat rastisin të takojnë persona, që megjithëse e kanë për detyrë t'i ndihmojnë, sillen kaq negativisht. Meriton të theksohet se trajtimi që merr viktimat në identifikim mund të ndikojë, në një fazë tjetër, në dëshirën e saj për t'u identifikuar ose bashkëpunuar më vonë me autoritetet, si dhe mbi dëshirën e saj për të pranuar ndihmën (Brunovskis & Surtees 2007). Prandaj, duhet mbajtur parasysh se ndikimi i këtyre qendrimeve mund të ketë një efekt të rëndë dhe afat-gjatë mbi personat e trafikuar.

Korrupsioni

Për shumë nga viktimat e intervistuar për qëllimet e këtij studimi, korrupsioni përbënte një shqetësim përgjatë gjithë përvojës së trafikimit dhe të pas-trafikimit. Ai luante shpesh një rol mbi mënyrën si ishin trafikuar, nëse kishin mundur të shpëtonin apo jo, dhe se kur e në ç'mënyrë ishin identifikuar.

Shumë viktimat shpjeguan që, korrupsioni ishte pjesë e situatës së tyre të trafikimit dhe si i tillë, pengonte identifikimin e tyre dhe shërbente për ta zgjatur më tej gjendjen e trafikimit. Një viktimë nuk ishte identifikuar në një vend të BE-s, ku ishte shfrytëzuar, pavarësisht se ishte e mitur në kohën e trafikimit dhe në kontakt me aktorët e mundshëm identifikues:

Punoja në rrugë dhe atje kishte vajza që shkonin me punonjës policie. Ka oficerë policie që punojnë si ndërmjetës, ka dhe vajza të shitura.

Një djalë, i cili ishte burgosur për kalim të paligjshëm kufiri në përpjekjen e tij për të shpëtuar nga trafikimi, shpjegoi sesi një zyrtar i korruptuar u kërkoi para për t'i liruar nga burgu:

Polici më dha leje që të marrë në telefon shtëpinë. Ai tha se nëse secili nga ne i paguante nga 100 dollarë, do të na linte të iknim...por ne nuk kishim të holla... dhe as prindërit tanë ... ngaqë nuk kishim të paguanim, na mbajtën në paraburgim tre muaj.

Edhe viktimat e tjera e ngritën çështjen e korrupsionit:²⁹

Mendoj që policia duhet të punojë më mirë ... policët nga ai fshati [në vendin e destinacionit] ishin të korruptuar. Normalisht, ata duhej të na kishin nxjerrë nga ai vend [i shfrytëzimit], të na jepnin dokumentet dhe pak të holla.

Policia e vendit ishte e korruptuar. Trafikantët i jepnin para policit që punonte te tregu. Polici kërkonte ryshfete nga trafikantët, sepse unë isha në moshë të mitur dhe ishte e ndaluar që të miturit të punonin në treg. Kur nëna ime kontaktoi policinë në [vendin tim], polici i tregut e mori vesh dhe trafikantët më mbajtën të mbyllur në shtëpinë e tyre për gati një javë. Dhe pastaj, përsëri më detyruan të shkoja të punoja në treg.

Do t'i këshilloja [viktimat e trafikimit] që të mos shkojnë në polici, sepse ata nuk të ndihmojnë realisht. Ata e përdredhin gjithë historinë në një mënyrë të tillë, saqë ty do të të duhet të lodhesh ta provosh pafajësinë tënde. Unë e pata pjesën time të përvojave të këqija si [jashtë vendit], ashtu dhe në fshatin tim. Policët punojnë për ato para, dhe nëse ti shkon dhe ata e shikojnë që nuk po i paguan, ata thjesht të injorojnë.

Isha i mitur, kur u nisa për [jashtë vendit] pa lejen e prindërve. Njerëzit që më morën me vete paguan nën dorë në kufi, dhe ja sesi u gjenda në [atë vend].

Një viktimë tjetër tregoi sesi 'punëdhënësi' i saj ishte i lidhur më policinë, dhe se ajo e dinte që në fillim se çdo deklaratë që do të bënte, nuk do ta çonte gjekundi, por thjesht do t'ia zgjatte situatën e saj të shfrytëzimit e nuk do të arrinte që autoritetet të nisnin procedurat ligjore:

Lëshova disa deklarata në [kryeqytet]. Ata më pyetnin dhe unë përgjigjesha. Por nuk bëra asnjë kallzim kundër [trafikantit], sepse ai kishte miq midis radhëve të policisë ... e dija që nuk do t'i ndodhte gjë atij, dhe se me aq do të mbaronte gjithçka. Këtë gjë e thashë edhe atje. Ai ka miq, dhe kaq, nuk mund të bëje asgjë më tepër. Mesa di,

²⁹ Kjo përputhet me gjetjet e bëra në një vlerësim të ndihmës për viktimat në SEE, ku edhe organizatat anti-trafikim raportonin se korrupsioni përbënte një problem. Njëri tha, "përvoja jonë e kaluar tregoi se për shkak të sistemit të korruptuar që shtrihet poshtë deri tek organet më bazike të zbatimit të ligjit, viktimat, shpesh, trajtohen keq dhe disa herë vetë policët e korruptuar i dërgojnë përsëri te 'pronarët' e tyre" (Surtees 2006a: 25).

ai vazhdon të punojë me vajza, por jo më me [të huaja], me [të vendit] kësaj radhe.

Në një rast kur viktimat, në fakt, u identifikua dhe u lirua si pasojë e ndërhyrjes së policisë, përsëri korrupsioni ishte një problem. Pasi kontaktoi policinë në vendin e saj të lindjes me kërkesën për t'u shpëtuar, ndërhyri policia lokale, por bëri shumë pak për të trajtuar siç duhet situatën e saj reale të trafikimit. Policia shkoi në apartamentin ku mbahej e mbyllur gruaja dhe e paralajmëroi trafikantin se mund të arrestohej – “policia [lokale] erdhi në apartamentin tonë dhe i tha pronarit se do të kishte shumë probleme”. Megjithatë, trafikanti nuk u ndalua, por thjesht u lirua kjo grua, duke i dhënë asaj pak para për t'u kthyer në shtëpi. Është me rëndësi, sidoqoftë, që të nënvizohet se nuk ishte vetëm policia e prekur nga korrupsioni. Një viktimë raportoi sesi kur ajo kërkoi ndihmë nga ambasada e saj në [vendin e destinacionit], i thanë që mund të kthehej përsëri në ambasadë vetëm kur të kishte ca para për ryshfetin e personelit të ambasadës.³⁰

Korrupsioni rezulton të ketë një ndikim shumë të gjërë mbi identifikimin. Edhe në ato raste kur nuk kishte korrupsion, përvojat e kaluara apo hamendjet mbi korrupsionin – bazuar mbi çfarë kishin pësuar në shtëpi dhe jashtë vendit – ndikoi mbi dëshirën e tyre për të kërkuar dhe pranuar mundësitë e identifikimit.

4.4. Përmbledhje

Viktimat ishin identifikuar nga një grup i gjërë aktorësh anti-trafikim (zbatuesit e ligjit, punonjësit në terren, personeli i ambasadave, OJQ-të, ON-të, punonjësit socialë, klientët dhe vetë viktimat), si edhe nga njerëzit dhe profesionistët, të cilët, përgjithësisht, nuk janë të përfshirë në identifikim, si për shembull, punonjësit e transportit, qytetarët e thjeshtë dhe organizatat fetare. Në të njëjtën kohë, kishte një numër rastesh të identifikimit të munguar, që zgjatte shfrytëzimin dhe abuzimet, si rrjedhojë e kësaj mungese.

Për shumë viktimat përvoja e identifikimit ishte e lodhshme dhe e ndikuar nga një mori emocionesh dhe reagimesh. Viktimat flitnin si për reagime

³⁰ Për disa viktimat, korrupsioni luajti një rol në aspektet e mëvonshme të ndihmës dhe mbrojtjes së tyre. Një viktimë e ritregoi se sa i korruptuar ishte sistemi gjyqësor në vendin e saj të origjinës:

Që nga fillimi fare ajo deshte të bëhej avokatja ime dhe më shpjegoi se unë nuk duhej të kisha shumë shpresë, meqenëse ka korrupsion në vendin tonë dhe se [gjyqaqtësi] mund të ketë qenë i paguar, dhe për këtë arsye ai nuk do të dëshironte të administronte drejtësinë.

pozitive, ashtu dhe negative ndaj aktorëve të identifikimit, të ndodhura në faza të ndryshme të procesit të identifikimit. Nuk ishte e pazakonshme, për shembull, që viktimat të ndiheshin edhe të lehtësuara që ishin identifikuar si viktima të trafikimit, por edhe të frikësuara dhe dyshuese ndaj aktorit identifikues. Po ashtu, nuk ishin të rralla rastet, kur ndjenjat negative (frika dhe dyshimi) i hapnin rrugë atyre të lehtësimit, sapo viktima ndihej e sigurt dhe fitonte besim tek personat identifikues.

Përveç tregimeve mbi çfarë dhe si ndiheshin, viktimat folën mbi problemet dhe çështjet me të cilat përballeshin gjatë procesit të identifikimit, si në vendin e tyre, ashtu dhe jashtë tij. Këto probleme kishin të bënin me pamundësinë e viktimave për të patur një informacion të plotë dhe të gjithanshëm rreth situatës dhe opsioneve të tyre gjatë identifikimit; me aftësitë e kufizuara të disa aktorëve të kundër-trafikimit; me përvojat e viktimave në lidhje me trajtimin e ngrohtë ose jo gjatë identifikimit; me përvojat e marrjes në pyetje dhe të mbajtjes në para-burgim, në vend që të realizohej identifikimi si viktimë e trafikimit; me disa raste të korrupsionit; me disa raste të keqtrajtimit dhe të moskokëçarjes; me problemet që lidheshin me pengesat gjuhësore dhe kulturore në procesin e identifikimit; me mjediset e papërshtatshme ku ishte bërë identifikimi i disa viktimave; me faktin që viktimat nuk dinin kujt t'i drejtoheshin për ndihmë; dhe me çështjet që lidhen me mosdëshirën e disa viktimave për t'u identifikuar.

5. Përvojat e kthimit dhe të referimit të personave të trafikuar

Procesi i kthimit – kur administrohet me korrektësi – përfshin një numër hapash, të ndërmarrë për të siguruar kthimin e sigurt dhe dinjitoz të çdo viktime individuale. Idealisht, kthimi duhet të përfshijë përgatitjen e dokumenteve, lidhjen e marrëveshjeve të udhëtimit, informimin e personave të trafikuar mbi hapat në procesin e kthimit dhe mundësitë e ndihmës në vendin e origjinës, shqyrtimin e rrezikut (për vendet tranzit dhe ato të origjinës), komunikimin dhe bashkërendimin midis vendeve të origjinës, të tranzitit/të destinacionit, transportimin e ndihmuar dhe procesin e udhëtimit (përfshirë edhe kthimin me shoqerim, në rast nevojë dhe ndihmën në tranzit), pritja dhe referimi me mbërritjen në vendin e origjinës dhe transportimi brendapërbrenda vendit të origjinës. Një procedurë e pasigurt e kthimit krijon rreziqe për viktimat, të cilat, në raste ekstreme mund të rezultojnë në ri-trafikim.

Gjatë intervistave, personat e trafikuar u pyetën rreth përvojave të tyre vetjake të kthimit – çfarë ishte pozitive dhe çfarë, sipas atyre, ishte negative – në ndihmë të identifikimit se ku mund të ekzistojnë mangësitë e mundshme në proceset e sotme kombëtare dhe transnacionale të kthimit dhe të referimit të personave të trafikuar. Ky seksion do të diskutojë jo vetëm sesi ishin kryer kthimet, por edhe sesi personat e trafikuar e kishin përjetuar procesin e kthimit, dhe se cilat ishin problemet dhe çështjet me të cilat ndesheshin.

5.1. Si ktheheshin personat e trafikuar

Personat e trafikuar janë kthyer në shtëpitë e tyre në një numër mënyrash të ndryshme – disa të ndihmuar, disa të pandihmuar. Kur viktimat ktheheshin në shtëpi nëpërmjet programeve të ndihmës, procesi i kthimit zbatohet në mënyra të ndryshme nga aktorë të ndryshëm. Shtrirja e mbështetjes, e ndihmës dhe e informacionit ndryshonte, ashtu si ndryshonte mjeti i transportimit dhe mundësitë për referimin dhe pritjen në vendin e tij të origjinës. Në disa raste, kthimi i ndihmuar ndërmerrej në disa mënyra që mundësonin jo vetëm sigurinë e viktimës, por fitonin edhe besimin e saj. Kjo, përgjithësisht, do të thoshte jo vetëm të shoqeruarit në shtëpi apo pritjen në vendin e mbërritjes, por do të thoshte edhe informimin dhe këshillimin e plotë të viktimës nëpër të gjithë procesin e kthimit. Një viktimë shpjegoi se ishte kthyer në shtëpi me anë të një procesi korrekt dhe të sigurt:

Në stacionin e policisë u ndjeva se kisha shpëtuar në çastin kur vura në dorë çertifikatën time të lindjes. Aty kuptova se ata nuk ishin të korruptuar ... më thanë të mos shqetësohesha, se ata do ta dërgonin informacionin, se policia po më ndihmonte. Dhe ata më thanë se nuk do të qendroja gjatë në atë vend ... u shoqerova nga një polic deri në qytetin tjetër. Atje më çuan në stacionin e policisë dhe një tjetër polic më mori në dorëzim. Pastaj ne hypëm në një tren për në [vendin tim].... Kur kalova kufirin për në [vendin tim], atje më priste një përfaqësues i [policisë anti-trafikim të rrethit] dhe arritëm me tren në [kryeqytet]... më shoqeroi deri në shtëpi. Ai më paralajmëroi se [trafikantët] mund të më kërkonin dhe më këshilloi të qendroja për pak kohë me disa kushërinj të largët. Ai tha, gjithashtu, që mund të qendroja në një qendër të specializuar në [kryeqytet], që ndihmonte viktimat e trafikimit. Më tha që atje mund të gjeja ndihmë për të gjitha problemet e mia. Ai më çoi në këtë strehëz. Jo, nuk kisha frikë, sepse isha e shoqeruar nga një polic. E dija se nëna ime po më priste në shtëpi, dhe kjo gjë më ngrohu shpirtin.

Megjithatë, në disa raste, mangësitë në procesin e kthimit të ndihmuar, i la zbuluar viktimat ndaj problemeve të mundshme, duke i lënë të pambrojtura dhe të shqetësuara. Disa herë kjo do të thoshte që viktimat të mos pritej kur kthehej në shtëpi, të mos merrte garancitë e nevojshme rreth sigurisë së saj/të tij fizike, duke mos u informuar plotësisht rreth procesit, ose duke mos iu ofruar informacioni i mjaftueshëm kur ato ndesheshin me vështirësitë:

[Rreth udhëtimit të pashoqeruar] isha shumë e frikësuar se dikush mund të më afrohej dhe të më zbriste nga aeroplani. Nuk dija anglisht. Kjo shërbeu për krijimin e një atmosfere jo miqësore.

Kur mbërrita në [vendin tim], asnjëri [nga organizata] nuk po më priste. Po kërkoja se mos dikush ishte duke më pritur.

Po ashtu, kthimet e ndihmuara nuk zhvilloheshin në mënyrën më dinjitoze. Një i mitur u shoqerua nga policia, kur e kthyen në vendin e tij të origjinës, një proces ky, të cilin e përshkroi si të kënaqshëm – “E kuptova se ai ishte serioz dhe krijova besim tek ai”. Por me mbërritjen e tij në vendin e origjinës, megjithatë, policët pritës i vunë hekurat në duar:

Në [kryeqytet] na morën përsëri në [qendrën e pritjes për të miturit], ku kaluam rreth tri orë. Pastaj, erdhi një oficer policie ...dhe më vuri hekurat në duar ... m'u duk e çuditshme. Polici tha se kishte frikë se mos përpiqeshim të iknim me vrap. Unë i thashë se nuk kisha ku të shkoja, ku të drejtohesha, por, në të kundërt, desha thjesht të arrija i gjallë tek prindërit e mi. Unë as nuk e dija se ku mund të shkoja. Përveç kësaj, nuk kisha as para.

Kur kthimet ishin të pandihmuara, këto kryheshin në një numër mënyrash të ndryshme, disa prej të cilave mund të të nxirrnin të zbuluar para një rreziku tjetër. Në disa situata, viktimat mbështeteshin në vendin e destinacionit – me dokumente dhe sigurimin e biletave të udhëtimit – por nuk merrej parasysh situata e sigurisë dhe transportimi nuk bëhej me shoqerim. Disa viktimat udhëtonin për në shtëpi në mënyrë të pavarur, pa ndonjë mbështetje. Shumë viktimat udhëtonin drejt shtëpisë me tren ose autobus, pa dokumente të ligjshme dhe, shpesh, pa të holla për transportin. Një i mitur shpegoi sesi ishte kthyer në shtëpi nga ish Bashkimi Sovjetik:

[Kalova] pa pasaportë. [[Burri që më ndihmoi] foli me disa persona të doganës dhe u shpjegoi se çfarë më kishte ndodhur. Punonjësit e doganës më lanë të kalojë kufirin pa pasaportë. Burri më dha pak para dhe unë arrita të shkojë në [kryeqytet] me autobus.

Në disa situata shumë dramatike, viktimat ishin kthyer në kushte që mund të quhen, me plot kuptimin e fjalës, shumë të vështira. Një numër viktimash meshkuj, të trafikuar në vendet e ish Bashkimit Sovjetik kishin bërë me këmbë me qindra kilometra drejt shtëpisë, sepse ikën pa u identifikuar dhe atyre u ishte mohuar ndihma, kur e kërquan atë në vendet e destinacionit.

5.2. Si ndiheshin personat e trafikuar dhe si e përjetuan procesin e kthimit dhe të referimit

Kur flitnin për kthimin në shtëpi nga jashtë vendit, viktimat raportonin një mori emocionesh dhe reagimesh. Shumë nga këto ndjenja ishin negative – frikë, ankth, zhgënjim, stres dhe mërzitje, nervozizëm dhe turbullim – që rezultonin jo vetëm nga vetë procesi i kthimit, por edhe nga mënyra si administrohej ai. Në të njëjtën kohë, viktimat raportonin emocione më pozitive që lidheshin me kthimin e tyre në shtëpi, përfshirë gëzimin dhe çlirimin, si dhe ndjenjat e sigurisë fizike e mendore. Dhe, po ashtu si ndodhte në fazën e identifikimit, shumë viktima përfshiheshin me emocione të vetvetishme dhe, shpesh, kundërshtuese. Një viktimë shpjegoi, “Kisha ndjenja nga më të ndryshmet. Në njërën anë, isha e kënaqur që më në fund po shkoja në shtëpi. Nga ana tjetër, unë nuk kisha fituar para”. Po kështu, një viktimë tjetër e përshkroi në këtë mënyrë, “Po më mbyste ankthi dhe lumturia”. Dhe shumë viktima të tjera përfshiheshin nga ndjenjat e besimit dhe të mosbesimit në këtë fazë të jetës së tyre të pas-trafikimit. Seksioni i mëposhtëm përshkruan disa nga ndjenjat kryesore të viktimave rreth procesit të kthimit dhe të referimit.

Frika dhe ankthi

Disa persona të trafikuar e përshkruan procesin e kthimit si diçka mjaft të frikshme. Në disa raste kjo vinte nga rreziku i interceptimit (dhe ndoshta ri-trafikimi) nga ana e trafikuesve të tyre, si dhe nga frika e takimit të trafikantit me mbërritjen në shtëpi: “Kisha frikë se mund t’i takoja [trafikantët] gjatë rrugës sime, ose se do të më pritnin afër shtëpisë”.

Në disa raste të tjera, kjo ndjenjë vinte ngaqë viktimat i frikësoheshin arrestimit nga autoritetet. Një grua, e trafikuar në ish Bashkimin Sovjetik, udhëtonte për në shtëpi pa para dhe pa dokumente. Ajo arriti të kalonte katër vija kufitare, dhe në secilën nga to shpjegonte se çfarë i kishte ndodhur, dhe se nuk kishte as para dhe as dokumente: “Më duhej t’i shpjegoja secilit se çfarë kisha hequr dhe përse nuk kisha pasaportë me vete. Nuk kisha rrugëdalje tjetër”. Një tjetër viktimë u shpreh: “Isha disi e shqetësuar. Kisha frikë se mos policia mund të më zbriste nga autobuzi dhe unë nuk kisha para për të blerë biletë tjetër”.

Shumë viktima ishin në ankth rreth procesit të kthimit pikërisht, sepse kishin shumë pak opsione dhe shumë pak siguri me kthimin e tyre në shtëpi. Shumë viktima ishin të shqetësuar rreth çështjeve që lidhen me kthimin, përfshirë dhe nevojën për t’u kthyer në shtëpi me ca para në xhep, mungesën e

mundësive në vendin e tyre, hakmarrjet nga trafikantët dhe refuzimin e mundshëm të tyre nga familja/komuniteti.

Ndodhi për herë të parë, kur dëgjova se unë nuk mund të merrja dokumentet e qendrimit dhe se me duhej të largohesha nga qendra ku isha vendosur [jashtë vendit]. Humba ndjenjat dhe kur u përmenda fillova të bërtasë, të shajë dhe të thyejë çdo gjë që më zinte dora. Nuk desha të largohesha nga qendra, nuk kisha ku të shkoja.

Jo, nuk desha të kthehesha, e thashë njëherë. Nuk ndihem mirë në familjen time. Pastaj, ajo më tha se ishte një organizatë për gra dhe vajza, dhe se unë do të qendroja atje ... Të them të vërtetën, nuk i besova.

[Emocionet rreth kthimit] dridhesha e tëra... kisha frikë se nuk dija sesi do ta filloja fazën e re të jetës sime ... Gati sa s'po kaloja një krizë të rëndë nervore ... m'u deshën disa ditë që të vija në vete ... dëshpërimi më përfshiu të tërën.

Ndjeva frikë ... nuk e dija sesi do të pritesha nga nëna ime. U kërkova të mos më dërgonin në shtëpi. Nuk desha të jetoja me nënën time.

Nuk e dija se çfarë do të më ndodhte, vija rrethrotull duke mos ditur se ç'do të bëhej me mua, kush do të vinte të më merrte, ku do të më çonin, nëse policia do të angazhohej apo jo, çfarë do të ndodhte më vonë. Pra, vija vërdallë, pa ditur çfarë do të ndodhte kur të mbërrija atje, dhe atje do të mbërrija për nëntëdhjetë minuta... e vetmja gjë që mund të bëja ishte të qaja në aeroplanin e udhëtimit.

Po qaja [në avion], sepse nuk e dija se çfarë do të ndodhte dhe frikësohesha se mos policia do të krijonte skena të pakëndshme mes turmës në aeroport.

Ndjenjat e sigurisë dhe të qetësisimit

Disa viktimat folën për përvoja shumë pozitive të kthimit dhe të referimit, të cilat mundësuan ndjenjat e sigurisë dhe të qetësisimit. Marrja e një informacioni të plotë rreth procesit të kthimit, si dhe rreth mundësive në vendin e tyre të origjinës, përbënte një aspekt të rëndësishëm për fitimin e ndjenjës së sigurisë.

Për shembull, në intervistat me të miturit, të cilët do të ktheheshin të nesërmen, u bë e qartë se atyre nuk u ishte folur rreth procesit të kthimit

dhe se çfarë do të përfshihej në atë proces. Për rrjedhojë, punonjësi kërkimor i ofroi atij informacionin e duhur jo vetëm rreth procesit të kthimit, si i tillë, por edhe rreth mjetit të transportit. Punonjësi i shpjegoi se çfarë do të thoshte të fluturoje (do të ktheheshin me avion), se do të hanin dhe do të pinin në avion, se mund ta ulnin grilën e dritares, po të kishin frikë. Dhënia e këtij informacioni shumë bazik– informacion që shpesh merret si i dhënë – e qetësoi djalin rreth procesit të kthimit.

Për shumë viktime, të qenit të shoqeruar deri në shtëpi u jepte një nivel sigurie dhe mbrojtjeje, të cilën ata e konsideronin qetësuese:

Një punonjës policie ... po më shoqeronte në [vendin tim]... ai erdhi posaçërisht për mua ... udhëtuam me tren ... ndihesha e sigurt me të.

Kjo ishte veçanërisht e rëndësishme për viktimat, të cilat ndiheshin nën kërcënimin e trafikantëve të tyre, si dhe për ato që kishin përvoja shumë të pakta udhëtimi, dhe ndiheshin nervoz rreth procesit të transportimit.

Zhgënjimi, stresi dhe shqetësimi

Për disa viktime procesi i kthimit ishte stresant, sepse ato ndiheshin të zhgënjyera rreth domosdoshmërisë së kthimit në vendin e tyre. Shumë nga to u shprehën se thjesht nuk dëshironin të ktheheshin në vendin e origjinës.

Po të ishtë për mua? T'ju them të vërtetën, jo se nuk jam e kënaqur këtu, por po t'i kisha dokumentet për në Evropën Perëndimore, do të ishte shumë më mirë. Sepse këtu, edhe nëse punon, nuk mund ta përballosh jetesën me vetëm një rrogë. Punon shumë, por rroga është e vogël, nuk mjafton.

Një viktimë, e trafikuar nga rajoni i SEE-s në një vend të BE-s ishte shumë e pakënaqur që po kthehej në vendin e saj, madje edhe pas kthimit, dukej që ishte shumë e lidhur me jetën në vendin e destinacionit. Në kohën e intervistës, të realizuar në vendin e saj, ajo sapo ishte ftuar të kthehej në vendin e destinacionit për një program të shkurtër, dhe ishte aq shumë e rrëmbyer nga kjo ide, sa nuk ishte në gjendje të mendonte për asgjë tjetër, veçse për kthimin e përkohshëm në vendin e destinacionit. Në një rast tjetër, një viktimë, e cila kishte qenë në BE për thujse një vit dhe kishte filluar të ndërtonte jetën e saj në vendin e destinacionit, ishte e zhgënjyer dhe e stresuar nga detyrimi për t'u kthyer në vendin e origjinës:

Ata nuk ishin njerëz, nuk më lanë të qendrojë [jashtë], edhe pse e dinin që nuk kisha vend ku të mund të kthehesha ... megjithëse doktoresha ime u tha që nuk mund të kthehesha. Ishte shumë e zhgënjyer edhe ajo. U tha se nuk isha psikologjikisht dhe fizikisht gati për t'u kthyer. Ajo u shpjegoi se kisha nevojë për një ndihmë profesionale, se kishte shumë frikë për mua ... ia tha asistentes, që ndiqte rastin tim ... por ata nuk pyetën fare. Nuk e morën parasysh rastin tim. Jam shumë e mërzhitur.

Të qënit i/e detyruar për t'u kthyer në shtëpi pritej me vështirësi edhe për arsye të tjera. Viktimat, që ishin larguar për një kohë të gjatë nga shtëpia, nuk e dinin se çfarë i priste atje, përfshirë edhe sesi do të trajtoheshin nga familja dhe/ose komuniteti, edhe as nuk shikonin ndonjë perspektivë për të bërë një jetë të qendrueshme dhe të shëndetshme. Të miturit, që kishin kaluar adoleshencën dhe rininë e tyre në një vend të huaj, shpesh çorientoheshin nga ideja e kthimit në një vend dhe komunitet, të cilin ata nuk e njihnin. Për shumë vetë, vendi i origjinës së tyre ishte më shumë i huaj, se sa vendi i destinacionit, ku kishin ndërtuar jetën e tyre dhe përfitonin nga ndihma dhe mbështetja.

Nervozë dhe të paqartë rreth procesit të transportimit

Për disa viktime, të cilat shoqeroheshin, ose informoheshin plotësisht për procesin, faza e transportimit kalohej me një farë stresi. Megjithatë, për të tjerët, procesi real i kthimit – transportimi nga vendi i destinacionit ose i tranzitit – ishte shkatërrues për nervat e tyre. Disa viktime kishin ankth dhe ishin nervoze edhe kur udhëtonin ligjërisht e me dokumente të rregullta.

Asnjëri nuk më shoqëroi ... Isha pak e shqetësuar. Kisha frikë se mos policia më zbriste nga treni. Mendoja se mos rojet kufitare do t'i gjenin dokumentet e mia, të lëshuara nga ambasada, si të dyshimta. Më dukej se policia do të më zbriste nga treni dhe do të më torturonte. Bëra një udhëtim të gjatë e të pagjumë ... konduktori i trenit më tha që nëse më pyesnin për pasaportën time të vërtetë, t'ua tregoja të gjitha. Ai më qetësoi duke më thënë se rojet kufitare nuk kishin të drejtë të më zbritnin nga treni. Këto fjalë ishin një çlirim i madh për mua.

Fluturova për në shtëpi pa u shoqëruar nga asnjëri ... punonjësit socialë më këshilluan të rrija e qetë, të mos nervozohesha rreth kalimit të kufirit me dokumente të përkohshme udhëtimi. Ata më thanë,

gjithashtu, që policia kufitare nuk kishte të drejtë të më ndalonte sepse kisha këtë ... më qetësuan, pasi ndihesha mjaft nervoze. Mendoza se dokumenti i përkohshëm i udhëtimit nuk është dokumenti i duhur, serioz.

Shumë persona të trafikuar nuk ishin të familjarizuar me procesin e udhëtimit, gjë që mund të shpjegojë pjesën më të madhe të nervozizimit dhe shqetësimit të tyre. Pjesa më e madhe e tyre nuk kishin udhëtuar shumë jashtë vendeve të tyre para periudhës së trafikimit. Marrëveshjet e udhëtimit, në kontekstin e trafikimit, përgjithësisht rregulloheshin nga trafikantët dhe rekrutuesit, dhe kjo ndoshta ishte arsyeja përse shumë viktime e gjetën procesin e udhëtimit ngatërrues dhe çorientues. Meqenëse shumë nga to, të paktën në një fazë të caktuar, kishin lëvizur në mënyrë të parregullt ose me dokumente apo viza të parregullta, ato shpesh nuk e dinin se çfarë nënkuptonte procesi i transportimit dhe i kalimit të kufirit. Shpesh, nuk i njihnin procedurat e udhëtimit, si nëpër tranzit apo në check-in, apo rregullat bazë të udhëtimit me avion, si për shembull turbulencat e ajrit:

Nuk më lanë të udhëtoja vetëm, pikërisht sepse ishte hera e parë që udhëtoja me aeroplan. Ishte një ndihmë e madhe nga ana e tyre.

[rreth institucioneve që merren me transportimin] Nuk më thanë asgjë të veçantë. Më veshën, më dhanë rroba e këpucë. Më dhanë dhe 300 dollarë dhe më çuan në aeroport. Avioni im kalonte nëpër një [vend tjetër]. Në tranzit na priste një person kontakti, i cili na përcolli në aeroplanin tjetër. Por ai nuk ishte me mua gjatë gjithë kohës.

[shqetësimet rreth kthimit] Pak. Asnjëherë nuk kisha fluturuar më parë ... shqetësohesha në lidhje me udhëtimin tim me aeroplan.

Kisha pak frikë aeroplanin, kur filloi të dridhet. Por mbërrita në [vendin tim] shumë shpejt.

Të gëzuar dhe të çliruar

Shumë viktime ishin edhe të lumtur dhe të çliruar kur vinte koha për t'u kthyer. Ishin të çliruar sepse do të ishin larg trafikantëve, të lumtur se po largoheshin nga vendi i shfrytëzimit të tyre, të gëzuar se do të takonin familjet dhe do të ishin, më në fund, në shtëpitë e tyre. Për shumë viktime, ndjenja e çlirimit se po shkonin në shtëpi, ishte emocioni mbizotërues:

Nuk më kishin thënë asgjë për ndonjë rrezik ... isha aq e gëzuar, sa as që më shkonte mendja për ndonjë rrezik.

Isha jashtëzakonisht, pabesueshmërisht e lumtur. Nuk mund ta pranoja si të vërtetë ... më kujtohej sesi rrija në burg, sesi shikoja qiellin nëpër hekurat dhe grilat e qelisë, zogjtë që fluturonin lart në qiell.

E kam disi të vështirë ta përshkruajë atë që ndjeja. Isha e lumtur, sigurisht se po shkoja në shtëpi, se arrita të dalë nga ajo situatë, pasi kuptova se çfarë do të mund të më kishte ndodhur.

Mezi po prisja të vija në [vendin tim] në atë çast.

Ndërkohë që shumë, në mos shumica e viktimave, ishin të kënaqura dhe të gëzuara që po ktheheshin në shtëpi, nuk ishte e rrallë që kjo kënaqësi përzihej edhe me emocione të tjera negative, si frika apo nervozizmi.

Besimi dhe mosbesimi

Për shumë viktimë, mungesa e besimit ishte problemi i tyre kryesor në lidhje me procesin e kthimit. Disa viktimë përshkruan se nuk kishin besim se gjithçka do shkonte mirë kur të ktheheshin, madje disa kishin frikë se mos rirafikoheshin. Edhe në ato raste kur viktimë kishte marrë informacion të plotë, ato jo gjithmonë prireshin të besonin në ato çka u thuhej:

Ata më dhanë informacion. Por unë nuk i besova derisa hyra në aeroplan.

Një viktimë, e identifikuar në vendin e saj të origjinës, duhej të transferohej me veturë nga punonjësit socialë për në strehëzën e caktuar. Edhe pse asaj i ishte dhënë informacioni i plotë në gjuhën e saj, dhe transportimi ishte brendapërbrenda vendit, ajo nuk u besonte autoriteteve. Nga njëra anë, ajo foli mbi si e kishte pranuar ndihmën që i ishte ofruar, duke u kapur pas mundësisë së dhënë. Nga ana tjetër, ajo tregoi se e frikësuar dhe mosbesuese ishte gjatë procesit të transportimit. Kthimi i saj u bë shumë shpejt pas identifikimit dhe ajo nuk besonte plotësisht që agjencia ndihmëse do ta çonte në një vend të sigurt:

Por, pastaj kisha dyshime se nuk e dija se ku do të më çonin. Kisha frikë se do të më dërgonin në ndonjë apartament dhe se do të më duhej të bëja ato veprime përsëri.

Por, nga ana tjetër, ishin të shumta viktimat që kishin besim të plotë në agjencitë që i ndihmonin me kthimin dhe shprehnin shumë pak shqetësim mbi problemet e rrezikut. Ndjenja e besimit (dhe e mosbesimit) ishin shumë vetjake dhe individuale.

5.3. Problemet në procesin e kthimit dhe të referimit

Procesi i kthimit dhe i referimit nënkupton një sërë veprimesh për të siguruar një kthim të sigurt dhe dinjitoz të personave të trafikuar. Përvojat e personave të trafikuar zbuluan shumë probleme, me të cilat ndesheshin ata gjatë përgatitjes për kthim ose dhe gjatë vetë kthimit – para-nisja, tranziti dhe/ose mbërritja e tyre në shtëpi.

Informacion rreth procesit të kthimit dhe të referimit

Për viktimat ishte e rëndësishme marrja e një informacioni të plotë dhe sqarues rreth procesit të kthimit dhe më pas të referimit të tyre. Një vajze të re iu ofrua ndihmë nga një organizatë në vendin e saj të origjinës, ndërkohë që qendronte në një strehëz jashtë vendit. Ajo zgjodhi këtë referim, pavarësisht se kishte pak frikë dhe dyshim, pikërisht sepse ishte e informuar plotësisht rreth procesit të kthimit dhe më pas të referimit, i cili i dha asaj më shumë siguri dhe besim:

Para largimit, i telefonova [personelit në vendin e origjinës] dhe u tregova datën se kur do të udhëtoja, dhe ajo do të më priste në aeroport. Më vonë ajo më shpjegoi me me hollësi [rreth opsioneve] dhe unë i kuptova ... personeli i strehëzës pagoi biletën, na çoi në aeroport dhe na futi në aeroplan.

Kishte dhe shumë persona të tjerë të trafikuar që nuk ishin të shqetësuar për kthimin, pikërisht sepse kishin informacion të plotë rreth hapave dhe procesit:

Nuk u shoqerova nga ndonjë njeri. Punonjësit socialë më çuan në aeroport dhe atje ndoqa procedurat e regjistrimit të biletës dhe pastaj fluturova për në shtëpi ... Isha e informuar nga punonjësit socialë se duhet të isha e kujdesshme në aeroport, kur të mbërrija në [vendin tim]. Më kishin thënë t'i drejtohesha policisë në rast rreziku. Nuk pata ndonjë problem në aeroport ... po, isha pak e shqetësuar, por nuk kisha frikë.

Shumë viktima raportuan se nuk kishin informacion të përshtatshëm për vetë procesin e kthimit – sesi do të kryhej dhe se çfarë do të ndodhte në vendet e tyre të origjinës në lidhje me ndihmën dhe referimin e mundshëm.

[rreth agjencive në vendin e saj të origjinës]... Jo, nuk dija absolutisht asgjë për to.

Jo, nuk dija asgjë rreth ndihmës. Ata përmendën ndihmën vetëm për kthimin [në vendin e origjinës].

Për shumë vetë, kjo mungesë informacioni e bëri kthimin e tyre stresant, çorientues, madje dhe të frikshëm. Ky nuk ishte rasti vetëm në SEE, por edhe në vendet e BE-s. Disa të mitur nga SEE, që ishin kapur në tranzit, kishin marrë një informacion fare minimal rreth kthimit të tyre në shtëpi (përfshirë referimet e mundshme), dhe kur u intervistuan, e vetmja gjë që dinin ishte se do të ktheheshin në shtëpi me aeroplan mbrëmjen tjetër. Kthimi i tyre ishte shtyrë njëherë, pa marrë ndonjë shpjegim nga personeli i qendrës, ku ishin strehuar. Gjithashtu, ishte e çuditshme që asnjëri nuk kishte marrë pak kohë për t'i informuar sesi do të kryhej kthimi i tyre, dhe as sesi do të ishte udhëtimi i tyre me avion. Për këta të mitur, ky udhëtim dukej se do të ishte mjaft çorientues dhe ndoshta stresant.

Ndërkohë që shumë viktima të identifikuara jashtë vendit, ishin informuar mbi shërbimet dhe ndihmën e disponueshme për ta në vendin e tyre të origjinës, ky informacion nuk ishte gjithmonë i plotë:

Nuk dija asgjë rreth shërbimeve të disponueshme. Njerëzit nga [organizata në vendin e destinacionit] me thanë se ka organizata të tilla në [vendin tim] ... por ata nuk më dhanë as numër telefoni dhe as adresë. As unë nuk i kërkova, sepse nuk po mendoja për të ardhmen. Po i lutesha Zotit që të mbërrija gjallë në [shtëpi].

[rreth kthimit të saj] Erdhi një përfaqësues i [organizatës] dhe më mori me vete. [personeli në vendin e destinacionit] thjesht më tha se do të udhëtoja me makinë me përfaqësuesin dhe se do të më ndihmonin atje ... nuk më dha hollësi të tjera.

Po, më folën për kthimin, më thanë se do të më prisnin në aeroport dy gra nga [një organizatë] dhe se do të më vendosnin diku ... ato nuk kishin shumë informacion. Ato nuk e dinin se ekzistonin shtëpitë e sigurta, si për shembull strehëzat. Nuk dinin asgjë.

Informimi i viktimave mbi të drejtat dhe mundësitë e tyre në vendin e origjinës, përfshirë dhënien e emrave dhe të kontakteve për organizatat që mund të ndihmonin me kthimin në vend, është një kërkesë minimale (Kvinnoforum 2003: 15). Për lehtësimin dhe administrimin e referimeve, atje ku është e përshtatshme dhe kur kërkohet nga viktimat, duhet të merret parasysh përgjegjësia e aktorëve identifikues, qofshin këta zbatuesit e ligjit apo ofruesit e shërbimeve. Është, gjithashtu, e rëndësishme që të bëhet një ofertë nga ana e OJQ-s ose ON-s për pritjen e viktimës.

Ka tregues që shumë ofrues shërbimesh e shpërndajnë informacionin rreth ndihmës dhe shërbimeve të disponueshme vetëm nëpërmjet rrjetit të ngritur me organizatat bashkëpunuese, në vend që të informojnë rreth të gjithë serisë së mundësive të ndihmës që ofrohet në vendin e origjinës. Individët informoheshin më shpesh rreth organizatës partnere që do t'i priste dhe ndihmonte ata, dhe nuk u ofrohej lista e aktorëve dhe agjencive të ndryshme, me të cilët mund të merrnin kontakt në rast vështirësie apo kërkesë për ndihmë. Përveç kësaj, pjesa më e madhe e informacionit përqendrohej vetëm mbi agjencitë e specializuara për trafikimin dhe nuk përfshinte më gjërësisht shërbimet dhe agjencitë e tjera, qofshin ato OJQ apo ON. Zgjerimi i rrjetit të agjencive të mundshme ndihmuese do të ishte me dobi, veçanërisht kur personat vijnë nga jashtë qyteteve të mëdha, dhe kanë pak mundësi të kenë qasje për tek ndihma e specializuar. Për këtë kategori personash, informacioni mbi shërbimet shtetërore apo OJQ-të që nuk janë domosdoshmërisht të lidhura me trafikimin, do të ishte, në një afat më të gjatë, më me shumë interes. Po ashtu, është e rëndësishme që viktimave t'u jepen kontaktet e policisë dhe të autoriteteve të tjera përkatëse, në rast se kanë probleme me trafikantët, kur kthehen në vendin e tyre.

Nëpërmjet intervistave, doli e qartë se viktimat kishin nevojë të përgatiteshin psikologjikisht për kthimin e tyre pranë familjes dhe/ose komunitetit të tyre, për çështjet dhe problemet e mundshme që mund të hasnin dhe për mënyrat sesi t'i përballonin ato. Ofrimi i informacionit në këtë aspekt ishte për ta thelbësor. Një viktimë përshkroi ankthin e saj rreth kthimit në shtëpi:

Askush nuk u kujdes për ne, na kërkuan dokumentet, morën emrat, na thanë se po na dërgonin në [një vend], ndan femrat nga meshkujt, dhe kaq. Na jepnin për të ngrënë tri herë në ditë, vetëm ushqim të ftohtë. Po kush kishte nge të mendonte për ushqimin? Isha në hall se çfarë do të bëja kur të kthehesha, ku do të shkoja. Nuk mund të shkoja tek shtëpia e prindërve, se kur ika, nuk u thashë asgjë.

Në disa raste, ia vlen të përmendet që informacioni u ishte ofruar viktimave, por stresi dhe trauma e tyre ishte aq e rëndë, sa frenonte aftësinë e tyre për ta asimiluar informacionin mbi procesin e kthimit dhe opsionet e ndihmës më pas:

Më thanë të mos shqetësohesh. Më shpjeguan me hollësi sesi duhet të sillësh në aeroport. Më thanë se në rast rreziku, mund t'i drejtohesha policisë. Nuk kisha frikë se mos i takoja trafikantët në aeroport. Unë shqetësohesha shumë, sepse nuk e dija sesi do të më priste im shoq ... më thanë se do të më priste një punonjëse sociale dhe se ajo organizatë do të më ofronte ndihmë të mëtejshme. Po më shpjegonin se çfarë lloj ndihme do të merrija, por, sinqerisht, nuk po ua vija veshin se kisha shumë ankth. Po lutesha të mbërrija në shtëpi, dhe aq.

Ky fakt nënvizon nevojën e disponueshmërisë së materialeve me shkrim (në një gjuhë të përshtatshme për moshën, në gjuhën amtare të viktimës dhe sipas nivelit arsimor), së cilës mund t'i referohet viktimat si para, ashtu dhe pas kthimit të saj në shtëpi.

E lidhur ngushtë me çështjen e nevojës së informimit të viktimave, është edhe çështja që informacioni i dhënë të jetë korrekt dhe i saktë, të mos premtojë opsione dhe mundësi, të cilat nuk realizohen në vendin e origjinës. Për shembull, ofrimi i një informacioni realist rreth numrit të ditëve që nevojiten për të përpunuar dokumentacionin është i rëndësishëm, në mënyrë që viktimat të mos ndihen se i kanë gënjyer dhe të jenë të përgatitura psikologjikisht për kohën se kur do të bëhet kthimi në shtëpi. Intervistat me viktimat vunë në pah që disa ofrues shërbimesh në vendet e destinacionit u kishin bërë premtime viktimave në një përpjekje për t'i qetësuar dhe siguruar mbi të ardhmen e tyre. Megjithatë, kur nuk ishin realizuar ato mundësi në vendin e origjinës, kjo krijoi probleme më të mëdha, përfshirë dhe humbjen e besimit tek ofruesit e shërbimeve (cf. Brunovskis and Surtees 2007).

Transportimi dhe kthimi ngjan me trafikimin

Kishte viktimat që shpjeguan se për to, faza e transportimit, nganjëherë, ngjante me përvojën e tyre të trafikimit. Siç kishte ndodhur me rekrutimin dhe trafikimin, procesi i kthimit nënkuptonte lëvizje nëpër vende të ndryshme, me premtime për ndihmë dhe jetë të mirë. Si rezultat, shumë viktimat treguan se gjatë transportimit ndiheshin mjaft të stresuara për lëvizjet që duhet të bënin, madje edhe kur ishin të informuara plotësisht mbi gjithë ecurinë e procesit.

Një viktimë, e trafikuar dhe pastaj e ndihmuar në BE, u mbështet për kthimin në vendin e saj nga një organizatë, tek e cila ajo kishte besim të plotë.

Megjithatë, kishte dyshime si deri në çastin kur u nis për t'u kthyer, ashtu dhe gjatë gjithë kthimit:

Kur mbërrita në një aeroport tjetër, një burrë po më priste me një shenjë në dorë dhe ai më pyeti nëse isha unë ajo gruaja që do të shkonte tek qendra në [kryeqytet]. Unë thashë po dhe vetëm atëherë u qetësova. Më tha se ku duhej të ndërroja avionin, sepse nuk ishte një fluturim i drejtpërdrejtë, dhe kjo më përforcoi besimin se nuk po më gënjenin.

Në të njëjtën mënyrë, një grua, e cila ishte shoqeruar deri tek strehëza, tregoi sesi procesi i kthimit i kishte shtirë frikën se mos po ri-trafikohej. Ajo e pranoi ndihmën e ofruar dhe ishte plotësisht e informuar mbi si do të rridhnin ngjarjet, kur ajo të mbërrinte në vend. Megjithatë, ajo, po ashtu, tregoi se nuk ishte plotësisht e bindur se gjërat do të shkonin siç i kishin thënë:

Kisha dyshime rreth vendit ku do të më çonin. Kisha frikë se mos më çonin në ndonjë apartament dhe se do të më duhej të filloja të bëja po ato veprime. I shihja me sytë e mendjes ato pikturat. Pastaj zemra filloi të më rrihte fort, prapë kisha frikë. Më thanë se mund të flija në makinë, nëse dëshiroja. Kisha dhimbje koke dhe ata më dhanë një tabletë. Mendimet më kalonin nëpër kokë se mos më kishin dhënë ndonjë ilaç për gjumë, që ata të bënin çfarë të kishin qejf ... desha të ikja nga ata, gjatë rrugës për në [kryeqytet]. Ndaluam pranë një karburanti. Unë kisha cigare me vete, por i pyeta nëse mund të shkoja të blija cigare. Më lanë. Dola nga makina dhe po shikoja se në ç'anë të ikja. Pastaj, e mendova edhe njëherë dhe kuptova se ishte policia që i kishte dërguar ata për të më shoqeruar. E ku do të shkoja, po të ikja?

Një viktimë tjetër, e trafikuar jashtë vendit, ishte frikësuar gjatë transferimit të saj nga stacioni i policisë në shtrehimin ku do të ndihmohej, e frikësuar se mos po transportohej në situatën e saj të mëparshme të trafikimit:

Kisha frikë [në stacionin e policisë], por po rrija e heshtur dhe i lutesha Zotit. Pas dy javësh një polic më tha se do të transferohesha në një vend tjetër. Kështu që u frikësova. Mendova se po më çojnë tek pronari im. Pastaj erdhi të më takojë një punonjëse sociale, e cila më shpjegoi se do të dërgohesha në një strehëz për viktimat e trafikimit.

Po të njëjtat komente u bënë në një studim tjetër dhe, në disa raste, shpjeguan se përse disa viktima zgjidhnin refuzimin e ndihmës së ofruar për to.

Zakonisht, viktimat e trafikimit për qëllime shfrytëzimi seksual mashtrohen me premtime falso se do të shkojnë diku, ku dhe do të ndodhë shfrytëzimi. Vetë veprimi i transportimit mund të shkaktojë dyshime tek viktimat. Një viktimë fliste për transportimin nga punonjësit e policisë nga një vend tek tjetri. Kur u pyet se çfarë ndjeu gjatë këtij procesi, ajo shpjegoi se ishte i frikshëm dhe se ajo mendonte vazhdimisht se tani do të trafikohej përsëri: “Pas kësaj, ata më sollën në një stacion policie në [qytetin e afërt], edhe në atë çast nuk u besova. Kushedi se ku po më çonin. Kur pashë shenjën e policisë, atëherë u ndjeva më e lehtësuar. Më thanë se do të më merrnin në stacionin e policisë dhe se do të kisha ushqim, ujë dhe mund të rrija e qetë e të mos shqetësohesha, se do t’i gjenin njerëzit që i kishin bërë keq” (Brunovskis and Surtees 2007).

Kthimi i pa-identifikuar

Ka rëndësi që viktimat të mos ekspozohen si persona të trafikuar gjatë procesit të kthimit. Njoftimi i autoriteteve nuk është pa probleme në vendin e origjinës, ku viktimat mund të fajësohen e të konsiderohen si migrantë të paligjshëm ose si viktima të trafikimit, ose të detyrohen të marrin pjesë në procedimet kriminale. Statusi i një individi, si një viktimë e trafikimit, nuk duhet t’i zbulohet vendit të origjinës nga vendi i destinacionit, pa lejen e viktimës, veçanërisht kur ka probleme të korrupsionit dhe të fajësimit, të cilat mund të kenë ndikime afat-gjata mbi viktimën e trafikimit.

Gjatë intervistave, viktimat folën për kthimet e identifikuar, të cilat, për shumë nga ato, ishin aspektet më me ankth të procesit të referimit.

Tek pika e kontrollit policor, kur kaluam kufirin...ata deshën të pyesnin për ne: “Ju jeni vajzat e trafikuar? Me kë shkuat atje?”, por, ajo shoqja ime u tha që nuk ishte puna e tyre, dhe kur erdhi [shafi], ata nuk pyetën më.

Në lidhje me kthimet identifikuese, kritikizmi i ndeshur më shpesh ishte përdorimi i çantave të IOM për t’u njohur nga personeli i IOM me kthimin e viktimave në shtëpi ose në tranzit. Gjithsesi, kjo krijonte rreziqe të mundshme, duke bërë që viktimat të njiheshin edhe nga trafikantët (Kvinna til Kvinna & Kvinnoforum 2003; Kvinnoforum 2003: 16). Politika e IOM ndryshoi në 2004, duke përjashtuar përdorimin e çantave, për shkak të shkakimit të problemeve të mundshme.³¹ Megjithatë, intervistat me viktimat informuan se disa OJQ

³¹ Korrespondenca me email me Richard Danziger, Shef i Shërbimit të Kundër-Trafikimit, IOM, janar 2007.

vazhdojnë të përdorin mekanizma të ngjashme për të identifikuar viktimat në kthim – bluza me logo të organizatave, shenja të tjera identifikuese, etj. Megjithatë shumë organizata njihen gjërësisht si anti-trafikim, kjo praktikë i ekspozon viktimat ndaj identifikimit të pavullnetshëm.

Ekzistojnë mjete të tjera me anë të të cilave mund të identifikohen viktimat gjatë procesit të kthimit, si për shembull shënimet që mund të bëhen mbi dokumentet e udhëtimit, etj. Që të dëbohesh (ose të pritësh nga grupi i dëbimit) nga disa vende, nënkupton se je një person i trafikuar. Gratë e dëbuara nga Italia në Nigeri, përgjithësisht, supozohen se janë prostitute, sepse kanë qenë viktimat të trafikimit dhe me mbërritjen në Nigeri ndalohen, i nënshtrohen testit të HIV, dhe u regjistrohen të dhënat e tyre vetjake për të menjanuar udhëtimet e tjera jashtë (Pearson 2002: 60-61). Studimi gjeti se viktimat shpesh ishin të ndërgjegjshme mbi rëndësinë e menjanimit të vulës së dëbimit që vihej në dokumentet e tyre të udhëtimit:

I dhashë ryshfet rojes së kufirit që deshi të vinte vulën 'dëbuar'. Nxorra nga xhepi pesëdhjetë dollarë dhe i thashë "jo dëbim" dhe ai nuk e vuri vulën. Ish-pronari im tha se në rast se do të merrja një urdhër-dëbimi, unë nuk do të kisha më mundësi të lëvizja [nga vendi im]. Unë ende mendoja të shkoja ndonjëherë normalisht në një vend normal dhe të gjeja një punë normale.

Viktimat mund të jenë 'të identifikueshme' për shkak të veshjeve që mbajnë në momentin e kthimit. Në rastet kur viktimat kthehen në shtëpi me rrobat që përdorin gjatë shfrytëzimit të tyre seksual, kjo mund të bjerë në sy, veçanërisht për njerëzit që rrijnë në pritje – në pikat e kalimit, për personelin e transportimit dhe familjarët e ndryshëm, apo pjesëtarët e komunitetit. Ky lloj kthimi identifikues mund të shkaktojë probleme afat-gjata për rikuperimin dhe ri-integrimin e viktimës, duke patur parasysh paragjykimet e komunitetit ndaj prostitucionit. Shumë vende në rajon kanë disa praktika sociale që kërkojnë t'i turpërojnë prostitutat, dhe, për rrjedhojë, edhe personat e trafikuar për prostitucion. Në Moldavi, për shembull, ekzistonte një praktikë e identifikimit të 'prostitutave' (dhe, për rrjedhojë, shpesh edhe të viktimave të trafikimit), duke e ngjyer me te zezë portën ku duhej të kalonte gruaja. Kjo traditë është e lidhur ngushtë me prostitucionin, pasi gratë që punonin si prostituta shihen si 'të pista' dhe shumë viktimat të kthyera, i nënshtroheshin këtij trajtimi dëbues (ostracizmit) (Brunovskis and Surtees 2007). Kthimi në shtëpi me 'veshjen e rrugës' mund të nxisë reagime të tilla sociale.

Viktimat mund të shiheshin si viktimë e trafikimit (ose si kriminele), kur shoqëroheshin nga oficer policie (me uniformë). Viktimat e ndjenin se një

shoqerim me uniformë i shënjonte ato qartësisht, dhe se ishte nevoja e formave më pak të dukshme të shoqerimit, për shembull, të mbajtjes së veshjeve civile gjatë transportit:

Dy policë më shoqeruan për tek avioni. Ata ishin në makinë, por mua nuk më pëlqente, sepse policët me uniformë më shoqeruan përgjatë gjithë pistës. Njerëzit më vështronin sikur isha një kriminele. Unë mbaja sytë ulur. Ndihesha shumë keq, sikur kisha vrarë njeri.

Diskutimi sesi mund të kamuflohet procesi i kthimit mund të jetë një hap i parë në procesin e rikuperimit dhe të ri-integrimit. Përveç diskutimit të çështjeve të nënvizuara më lart, është e rëndësishme të merren parasysh edhe aspektet e tjera më pak të dukshme, por, gjithsesi, të rëndësishme të 'identifikimit'. Për shembull, një tipar i trafikimit të shumtë është se, viktimat kthehen në shtëpi pa sjellë asgjë për familjet e tyre. Për viktimën që kthehet, blerja e dhuratave të vogla për anëtarët e familjes mund të ndihmojë, të paktën përkohësisht ose pjesërisht, të pranohet identifikimi i saj nga familja.

Rëndësia e kthimeve të ndihmuara

Shumë viktimat mendonin se të qenit të shoqeruar ose të mbështetur gjatë kthimit ishte i rëndësishëm, veçanërisht kur viktimat nuk kishin përvojë me udhëtimin dhe kalimet në kufi. Ndihma në kthim krijonte një ndjesi sigurie dhe qetësie, gjatë një procesi që mund të jetë, përgjithësisht, çorientues dhe i ngatërruar. Në disa raste, kjo do të thoshte që të shoqerohej përgjatë gjithë udhëtimit ose një pjese të tij:

Jo, [murgesha që më identifikoi] dhe dikush tjetër që më shoqeronte. Udhëtuam me autobus. Gjatë rrugës, [murgesha] më tha se çfarë mund të bëja në strehëz, në kurse ose shkollë dhe, ndoshta pas pak kohe mund të gjeja edhe punë.

Një punonjës policie ... po më shoqeronte [në vendin tim të lindjes]. Nuk e di si do t'i kisha kaluar kufijtë, po të mos më ndihmonte ai. Më shpjegoi që, unë isha një viktimë e trafikimit dhe nuk do të kishim probleme me kalimin e kufijve.

Nga [vendi i destinacionit] në aeroportin e [vendit fqinj] shkova me makinë. Shoferi tregonte në çdo pikë kalimi lejen e kalimit të tij dhe ne nuk patëm probleme. Ai ishte shumë i sjellshëm, gjithmonë më

jepte kurajo që të mos kisha frikë. Ai ma bleu biletën dhe priti derisa u nis avioni.

Edhe në rastet e kthimeve të ndihmuara, viktimat, disa herë, ndeshen me probleme, të cilat shkaktonin më shumë ankth tek to. Këtu përfshihen rastet, kur viktimat nuk marrin mbështetje gjatë rrugës ose në destinacion. Një viktimë që kthehej në SEE nga një vend i BE-s mori aeroplanin për në shtëpi, por u orientua nëpërmjet një aeroporti tjetër. Në rastet kur nuk shoqërohej, atë e prisnin dhe e ndihmonin nëpër vendet tranzit.

Askush nuk më shoqëroi. Dikush duhej të më priste [nga një organizatë] në [vendin tranzit], por nuk kishte njeri. Më kapi paniku dhe unë nuk e dija ku të shkoja ... bleva një kartë telefonike dhe mora [organizatën] në [vendin e destinacionit]. Ata më qetësuan dhe më shpjeguan sesi duhet të bëja regjistrimin e biletës sime. Pata fat sepse njëra nga vajzat ishte nga [vendi i destinacionit] dhe më shpjegoi se ku duhej të shkoja.

Ndërkohë që një numër i madh viktimash të intervistuar kishin përfituar mbështetje e ndihmë për kthimin e tyre, një numër i konsiderueshëm viktimash nuk e kishin patur atë mbështetje. Këto të fundit ishin kthyer në mënyrë të pavarur dhe pa ndihmë, një proces ky që u hap rrugën rreziqeve shumëfishe dhe rasteve ndaj të cilave viktimat mbetet e zbuluar, e pambrojtur. Duhet të nënvizohet se kjo duket se po ndodh mjaft shpesh. Viktimat përballeshin me një sërë rreziqesh të ndryshme gjatë procesit të tyre [të pandihmuar] të kthimit. Negociimi i procesit të transportimit dhe të udhëtimit – përfshirë blerjen e biletave, rregullimin e dokumenteve dhe komunikimet me zyrtarët – mund të jetë shumë i lodhshëm. Edhe në rastet kur kthimet bëheshin me dokumente ligjore dhe bileta të rregullta, personat e trafikuar ndesheshin me mjaft probleme. Një viktimë po udhëtonte me tren për në shtëpi, e pashoqeruar, dhe u ngacmua nga dikush në stacion të trenit, gjë që shkaktoi ndërhyrjen e policisë:

Nuk më pëlqeu diçka. [Drejtori] ma bleu biletën dhe më la në stacion të trenit. Pastaj m'u afruan ca djem dhe këmbëngulën që të shkoja me ta në një hotel. Unë u frikësova dhe fillova të bërtasë. Policia e stacionit të trenit u afrua dhe kërkoi që të shpjegohem. Pikërisht atje, për herë të parë, unë dhashë një farë dëshmie... [Drejtori] më pat thënë që të mos kisha frikë nga asnjëri. Në rast se ndodhte ndonjë gjë, supozohej që unë të shkoja në polici ... Po, isha e shqetësuar [rreth kthimit tim]. Kisha frikë se mos më takonin ca njerëz, që bëjnë ca lloj punrash me vajzat nëpër trena.

Në rastet kur viktimave u kërkohet të diskutojnë problemet në lidhje me statusin e tyre të paligjshëm jashtë vendit, hyrja në/dalja e paligjshme nga vendi, ose të udhëtuarit si një i mitur, ua shtonte nivelet e ankthit, por edhe të rrezikut. Një i mitur, i dërguar i pashoqeruar nga punonjësit socialë të kalonte kufirin e vendit fqinj, tha se ndihej nervoz rreth procesit: “Nuk ndihesha i qetë, kisha frikë dhe siklet. Kisha frikë nga kufiri, nëse xhaxhai nuk do të ishte atje të më priste, çfarë do të bëja, kjo ishte e vetmja gjë që së cilës i frigohesha”. Një viktimë tjetër tregoi: “Po, kisha frikë se mos më zbritnin nga treni. Nuk kisha ndonjë informacion mbi si duhej t’i përgjigjesha pyetjeve të rojes së kufirit. Nuk kisha as të holla për të blerë biletë tjetër”.

Në fakt, shumë viktima përballeshin me probleme të tilla. Kthimet e pandihmuara sugjeronin që disa viktima do të etiketoheshin si kriminelë, dhe, për rrjedhojë, do t’i nënshtroheshin dënimit dhe ekspozoheshin ndaj problemeve.

Nuk më ndihmuan. Kur po vija nga jashtë shtetit, unë kisha me vete vetëm një certifikatë [nga policia e huaj], ku shkruhej se unë nuk kisha dokumente ... në kufi më zbritën nga treni bashkë me fëmijën. Na mbajtën në zonën e doganës, na morën në pyetje. Fillova të qajë, u thashë gjithçka ç’kisha kaluar ... iu luta të më linin të shkoja në shtëpi ... më mbajtën për një kohë të gjatë, derisa erdhi shefi i doganës. Ai u dha urdhër të më lironin dhe unë ika. [Ata më trajtuan] shumë keq. Sigurisht, dikush filloi të tallej me mua, qeshte me mua dhe me kombësinë time. Unë i përkas një [minoriteti etnik]. Punonjësit e doganës më thanë: “Mjaft na the përralla, qendro këtu me ne dhe bëj ca para, këtu, në doganë”.

Atje [në aeroport] ishte një banak ku dhashë deklaratën time ... [më pas, polici] më thirri. Për gjithë ç’kisha kaluar ata më vunë një gjobë [prej 300 €] ... ma mbajtën pasaportën për një vit.

Viktimat e tjera, që ishin përpjekur të ktheheshin nëpërmjet kufijve ndërkombëtarë, u arrestuan dhe u ndaluan. Një burrë shpjegoi sesi pas ikjes nga situata e tij e trafikimit, ishte arrestuar në përpjekje për të kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme për të shkuar në shtëpi. Ishte arrestuar dhe futur në burg për tre muaj me akuzën e kalimit të paligjshëm të kufirit. Megjithatë ua pat shpjeguar historinë e tij autoriteteve të ndryshme të zbatimit të ligjit dhe atyre shtetërore, ai nuk ishte falur. Gjithsesi, disa viktima u lejuan të kalonin kufirin, pas shpjegimit të përvojës që kishin patur në shfrytëzim, pavarësisht nga mungesa e dokumenteve. Megjithatë ata nuk ishin ndaluar të kapërcenin kufirin, atyre nuk u ishte dhënë asnjë lloj ndihme: “Ai [një i huaj që kishte ndihmuar] foli me

disa njerëz në doganë dhe u shpjegoi se çfarë më kishte ndodhur. Punonjësit e doganës më lane të kaloja kufirin pa pasaportë. Ai burri më dha ca të holla dhe unë arrtia të hypë në autobus për të shkuar [në kryeqytet]”.

Kthimi i pandihmuar mund të jetë, gjithashtu, i ndërlikuar në rast se kemi të bëjmë me elementet e rrezikut. Një numër viktimash treguan se u frikësoheshin trafikantëve të tyre, dhe për këtë arsye përpiqeshin që të merrnin menjëherë rrugën për në shtëpi. Të qënurit i ndjekur nga trafikantët krijonte një rrezik për ndëshkim, kapje dhe ri-trafikim. Një grua, e trafikuar për prostitucion në BE, u ndihmua nga klienti i saj që të largohej nga ai vend.

Kështu që unë ika një natë dhe kalova një javë në shtëpinë e tij. [Trafikantët] e gjetën se po qendroja me të dhe se nuk kisha pasaportë, por unë shkova në ambasadë dhe mora dokumentin e udhëtimit dhe u ktheva në shtëpi me autobus... paratë e udhëtimit m’i dha klienti. Nuk kisha para, kur ika që andej. Klienti më dha dhe më bleu veshje. Nuk desha të shkoja në polici, kisha frikë. Por, mendova se në ndonjë mënyrë apo një tjetër ata përsëri do të më bënin keq. Po ta merrnin vesh që unë isha kthyer në shtëpi, do të vinin e do të më merrnin dhe të më bënin keq.

Disa lloj kthimesh të pandihmuara – kryesisht dëbimi – mund të kontribuojnë në një rrezikim tjetër, duke qenë viktimat të pambrojtura.

Na futën si kafshët në furgonin e policisë dhe na lanë në stacionin e policisë.

Atje asnjëri nuk e bënte këtë punë [ndihma për viktimat]. Nuk ishte një qendër ndihmëse, ishte një kamp refugjatësh. Të çonin me polici tek aeroplani, dhe atëherë ishte e gjitha. Dokumentet e mia, pasaportën time ata ia dhanë pilotit, dhe më thanë se do t’i merrja kur të zbrisja [në aeroport].

Si ofruesit e shërbimeve në SEE ashtu dhe viktimat vunë në dukje rastet e dëbimit të personave të trafikuar.³² Një problem që lidhet me kthimin e pandihmuar – qoftë me dëbimin apo vetëkthimin – është se viktimat, shpesh, nuk janë të ndërgjegjshme për rrugët e mundshme të ndihmës, dhe mund të mos e dijnë as se ekziston dhe as të përfitojnë në kuadër të kësaj ndihme.

³² Për shembull, 2978 gra bullgare u dëbuan nga vendet e BE-s në vitin 2003, dhe 2908 u dëbuan në 2004, një përqindje e të cilave mund të kishin qenë viktimat të trafikimit. Sipas policisë kufitare, rreth dhjetë përqind e grave të dëbuara mund të ishin viktimat të trafikimit, por që nuk ishin identifikuar si të tilla para ekstradimit (Surtees 2005: 167).

Në disa vende të SEE-s është normale që viktimat, të cilat kthehen në mënyrë të pavarur, kalojnë një farë kohe në shtëpi para se të përfitojnë ndihmë.

Krijimi i një procesi mbështetës dhe mbrojtës kërkon një vëmendje ndaj nevojave individuale të secilës viktimë, përfshirë gjendjen e tyre psikologjike dhe kapacitetin për të negociuar fazën e transportimit. Në rastet e të miturve, ata gjithmonë duhet të shoqerohen dhe mbështeten.

Marrja në pyetje dhe trajtimi i keq

Kalimet e kufirit ishte gjithmonë pjesa më e lodhshme e procesit të kthimit për viktimat. Disa nga to ndaloheshin dhe merreshin në pyetje tek pikat e kalimit kufitar, një përvojë kjo shumë çorientuese dhe e pakëndshme. Duhet të vihet në dukje se të tilla 'intervista'/'marrje në pyetje' kanë ndodhur edhe kur viktimat kishin qenë të identifikuar si të trafikuar dhe po udhëtonin me dokumentet e tyre të rregullta sipas marrëveshjeve që ishin bërë për transportimin e tyre:

Kur arrita [në vendin tim], policia më ndaloi. Ata filluan të më bënë pyetje, madje më bënë që unë të ulesha e ta shkuaja historinë time. Më çuan në një bazë ushtarake dhe përsëri kërkuan që të shkruaja mbi çfarë më kishte ndodhur. Kjo histori zgjati gjysmë dite. Më dhanë diçka për të ngrënë, por nuk desha asgjë. I telefonova vëllait, i cili është ushtarak dhe i kërkova që të vinte dhe të më mernte. Erdhi dhe më mori me vete.

Unë nuk e dija se do të më duhej të kaloja nëpër kontrollin e policisë në [aeroport]. Gruas së aeroplanit i kërkova pasaportën time, dhe ata më thanë se i kishte marrë polici. I kërkova policit që ishte në fund të shkallëve, dhe ai më pyeti për emrin, ia thashë. Më urdhëroi ta ndiqja, sepse duheshin mbushur dokumente të tjera për rastin tim. E ndoqa dhe ai më dërgoi në komisaratin e zonës. Atje filluan të më pyesnin përsëri, "çfarë të ka ndodhur" dhe një milion gjëra të tjera, "kush të çoi [jashtë vendit]", "çfarë bëje atje". Nuk desha të përgjigjesha, përse duhej të përgjigjesha? A mos duhej t'u tregoja unë atyre se çfarë më kishte ndodhur dhjetë vjet më parë?... [ai] filloi të bërtasë, "kush të çoi ty në [atë vend]]", "me çfarë je marrë", "çfarë deshe në kufi, ku të kapëm".

Dola nga avioni dhe ai polici ... më drejtoi për një rrugë të ndryshme nga ajo e pasagjerëve të tjerë. Nuk e dija se ku po më çonte. Ai polici ia dha letrat e mia një burri tjetër. Më zuri frika. Pastaj m'u afrua një

polic ... mori letrat e mia dhe tha: "Hajde me mua!", unë e pyeta: "Ku po më çoni?" ... I thashë se nuk kisha bërë asgjë: "Do të jetë ndonjë gabim unë nuk kam bërë gjë. Nuk e di së ç'po mendoni për mua, por unë vërtet nuk kam bërë asgjë". Dhe ai m'u kthye: "E di, që ti nuk do që ta bësh, siç e bëjnë të tjerët! E di, se ku ke qenë dhe se çfarë kërkoje". Unë isha ënjtur nga të qarët. Nuk dija më se çfarë mund t'i thoja. Si të bëja që ai të më besonte? Si t'ia shpjegoja se çfarë më kishte ndodhur? Dhe ai ecte para meje, duke murmuritur nëpër dhëmbë gjithë kohës: "Do ta shikosh, ti". Më çoi para një xhami në banak. Atje më kërkuan të firmosja diçka. Firmosa.

Një tjetër viktimë tregoi sesi ishte mbajtur mbyllur nga policia për tri ditë, dhe ndërkohë e merrnin në pyetje çdo ditë rreth përvojës së saj të trafikimit:

Na mori policia. Na morën në pyetje. Jo vetëm mua, por të gjitha vajzat, që ishin me mua në aeroplan. Kur më erdhi radha, më pyetën sesi kisha arritur në [vendin e destinacionit], u thashë me gomone. Më pyetën, gjithashtu, me kë, nuk desha t'u përgjigjem këtyre pyetjeve, dhe ua thashë këtë gjë. Mendova se shumë vetë do të rrezikonin jetën, po të jepja këto informacione. U thashë që nuk dua të përgjigjem dhe se dua të kthehem në shtëpi. Më ndejtën në kokë për nja dy orë, duke më pyetur për emrin e atij personi që më kishte marrë në [vendin e destinacionit]. Dhe përgjigja ime ishte, "Nuk do t'ju përgjigjem, nuk jua them". Pas kësaj ata morën në telefon policinë e qytetit, që të informonin prindërit e mi e të vinin të më merrnin. Im atë mbërriti tri ditë më vonë. Tri ditë isha e rrethuar nga policë që vazhdonin të më bënin pyetje. I vetmi problem i tyre ishte që të nxirrnin emrin e djalit. Nuk pyesnin fare për mua, sepse i vetmi hall që kishin ishte që t'i detyronin vajzat të bëjnë denoncimin. Po se çfarë do t'u ndodhte atyre vajzave, po të bënin denoncimin, as që deshën t'ia dijnë fare. Por unë mendoja shumë më larg se atë. Isha në merak, pikësëpari, për sigurinë e prindërve të mi, se sa për veten.

Takimi me ofruesit e shërbimit ose me personelin e shtrehimit, shpesh ndihmonte për të menjanuar këto vështirësi:

Mbaj mend se atje, para vendqendrimit të policit ishte [drejtoresha e OJQ] që po na priste. Dhe unë thashë me vete, jo nuk ishte e mundur që ajo të ishte atje. Dhe ajo na u afrua dhe na pyeti nëse ishim ne vajzat që po udhëtonim nga [vendi i destinacionit]. Gjatë kontrollit të

policisë, kur kaluam kufirin, pa ardhur [drejtoresha], policët deshën të na pyesnin: “Ju jeni vajzat e trafikuarat? Me kë keni ikur?” Por, shoqja ime u tha se ajo nuk ishte puna e tyre, dhe kur erdhi [drejtoresha], ata nuk thanë më asgjë tjetër.

Po në të njëjtën mënyrë, një viktimë tjetër shpjegoi sesi ndërhyrja e personelit të strehimit pritës ishte thelbësor për diskutimin e saj me autoritetet në kufi, dhe me të vërtetë, ajo ndërhyrje bëri që autoritetet ta ndryshonin qendrimin ndaj saj:

Kur më erdhi mua radha, i tregova oficerit dokumentin tim të udhëtimit dhe ai vetëm sa m’i hodhi sytë. Pastaj më pyeti se ku e kisha pasaportën time, përse kisha qenë në [BE], dhe unë i thashë se e kisha humbur atë në [atë vend]. Ai ma ktheu dokumentin tim të udhëtimit dhe më vështroi me dyshim dhe filloi të më bëjë përsëri pyetje – përse ke shkuar atje – duke nënkuptuar, leri këto që po më thua. I thashë se unë nuk kam pse të diskutojë më me ty, por shko e tako ato dy vajzat, që po mbanin një çantë me emrin e [OJQ] të shkruar mbi të. Ato po më prisnin mua. Dhe pastaj ai më tha, “Njëherë do të flasësh me mua, dhe pastaj shko e flit ti me mjekët e doktorët që po të presin atje”. Unë fillova të qajë dhe po bëhesha hysterike ... Ndërkohë, ajo gruaja [nga strehimi] erdhi dhe e prezantoi veten dhe vendin ku punonte, i tha se ishin ato që po interesoheshin të më çonin në shtëpi, dhe se gjithçka ishte bërë me ndërmjetësimin e tyre. Pastaj oficeri e kuptoi se çfarë bëja atje dhe tha që duhet të realizonim një intervistë, por pa bërë presion, se nuk ishte nevoja që unë të thoja emra, por thjesht të shpjegoja përse nuk kisha një pasaportë duke pasë kaluar aq shumë muaj në atë vend. Kështu kaloi biseda jonë.

Kthimi i vonuar i viktimave të huaja

Për shumë viktima, periudha para kthimit të tyre ishte shumë e gjatë, personat e trafikuar mbaheshin përsa kohë që përpunoheshin dokumentet, bëheshin rregullimet e transportimit dhe procedurat e tjera. Për shumë vetë, kjo pritje ishte shumë çfilitëse:

Pritja po më vdes. Kam qenë duke pritur për një kohë të gjatë. Thonë po, do të bëhet... edhe pak, edhe 20 ditë, do ta bëjmë kështu, do ta bëjmë ashtu.

U shqetësova, se qendrova shumë gjatë.

Fakti që shumë nga këto viktime mbaheshin në kushtet e strehimeve të mbyllura – pa liri lëvizjeje dhe me një sërë kufizimesh të tjera – shërbente për ta shtuar ankthin e shumë përfitueseve.

Do të ishte mirë që të dilnim për një kohë të shkurtër, të paktën, por të qendrosh mbyllur për dy muaj e gjysmë, të bën të luash nga mendtë.

Për disa viktime dukej se vonesat lidheshin vetëm me përpunimin e dokumenteve, një proces ky, që mund të përshpjektohet nëpërmjet bashkëpunimit të zyrtarëve vendorë dhe atyre të vendeve të destinacionit:

Kisha rreth katër muaj në atë strehim. Më thonin se prokurori kishte thënë se unë do të ikja për një muaj. Mendoja se nëqoftë kështu, një muaj do të kalojë shpejt. Mendoja se do të isha e para që do të largohesha, meqenëse isha nga ai vend. Por, nuk ishte e thënë ... vajzat e huaja luajtën nga mendtë, dhe filluan të bëjnë zullume. Ajo gruaja e strehimit ndoshta kishte lidhje me policinë dhe e rregulloi që të huajat të iknin më shpejt.

Kur filloi të më ikë truri, i thashë atyre grave: “hajde tani, ç’prisni, m’i rregulloni dokumentet e udhëtimit”.

Dhe, si e shpjegoi një viktimë, asnjëherë nuk ishte e qartë se përse bëheshin aq shumë vonesa, dhe për këto pyetje të saj, merrte shumë pak shpjegime nga personeli apo policia:

Jo, nuk ishte e qartë [përse qendrova aq gjatë]. I pyesja, përse. I pyesja gjithmonë. Më thonin, për shkak të kontrolleve ose, sepse nuk ishin përgatitur ende dokumentet e udhëtimit. U thoja se nuk ishte e mundur, se atyre nuk u duhen tre muaj për të nxjerrë dokumentet e udhëtimit. Në tre muaj, ata mund të nxirrin dhjetë dokumente udhëtimi.

Në situata të tjera, vonesat bëheshin për shkak të përfshirjes së rastit në procedurat ligjore, megjithëse nuk ishte gjithmonë e qartë se si dhe përse. Në rastin e një gruaje, që kishte qendruar në një strehim për gati pesë muaj, as viktimë dhe as personeli nuk arrinin të shpjegonin se përse kthimi i saj ishte vonuar aq shumë muaj. Në një situatë tjetër, një viktimë kishte qenë në një strehim të mbyllur për dy vjet e gjysmë bashkë me fëmijën e saj të vogël, ndërkohë që përpunoheshin letrat e kujdestarisë, dhe ndiqeshin

procedurat ligjore. Edhe në këtë rast, vonesat ishin në mospërputhje me kohën reale që nevojitej për dokumentet.

Disa kthime ishin vonuar për shkak të procedurave tepër burokratike. Një burrë – i ndaluar dhe i burgosur pasi kishte kaluar në mënyrë të paligjshme një kufi – u ndesh me shumë vështirësi përderisa, më në fund, u lirua. Rasti i tij, pasqyron problemet që lindin prej vonesave burokratike, të cilat pa arsye vonojnë, madje, pengojnë kthimet:

Jo, nuk dija asgjë [rreth marrjes së dokumenteve të reja]. Më thanë se e vetmja mundësi për të gjetur pasaportën time ishte gjetja e individëve që na kishin shfrytëzuar ne ... para se të liroheshim nga ai burg, ata e vizituan edhe njëherë vendin e shfrytëzimit tonë, por nuk gjetën njeri atje. Na liruan nga burgu. Në bazë të ligjit, shteti duhet të na jepte ca të holla që të mund të shkonim në vendin tonë. Ne morëm ca letra me të cilat duhet të paraqiteshim në bankë, për të tërhequr të hollat. Megjithatë, në bankë refuzuan të na i jepnim paratë, sepse nuk kishim dokumente. U kthyem në burg, por shefi tha se nuk mund të na ndihmonte. Na tha, gjithashtu, se duhet të rregulloheshim vetë. Përfunduam përsëri në pikën e kalimit kufitar. Rojet kufitare na premtuan se do të përpiqeshin të lidheshin me kolegët e tyre na anën tjetër të kufirit, në mënyrë që të na linin të kalonim kufirin pa dokumente identifikuese, por mbi bazën e çertifikatës së burgut të lirit tonë. Pritëm nja dy orë dhe pastaj na erdhi përgjigja që, jo, nuk mund të na linim të kalonim pa dokumentet e duhura.

Kur u pyet nëse kishte menduar t'i drejtohej ambasadës, ai u përgjigj se nuk e kishte shkuar nëpër mend: "Ne as që dyshonim se një gjë e tillë mund të ndodhte. Po ta dija, sigurisht që do të shkoja në [kryeqytet] për të nxjerrë dokumentet e mia. Por, nuk dinim gjë. Dhe asnjëri nuk na tha gjë". Në fund, ai përsëri tentoi të kalonte në mënyrë të paligjshme kufirin:

Shkuam në një tjetër pikë kufitare, atje te kryqëzimi, ku kalojnë të gjithë autobuzët dhe automjetet e tjera. Ikëm larg nga pika e doganës, nja 14 km, dhe e kaluam kufirin gjatë natës. Notuam nëpër një kanal ... uji ishte shumë i ftohtë, por arritëm ... kisha frikë, por çfarë të bënim?

Kthimi i vonuar i viktimave shkakton ankth të panevojshëm dhe është një çështje që meriton vëmendje serioze. Në rastin e fundit që u diskutua më lart, vonesa shtoi rreziqe serioze fizike dhe, ndoshta, i ngatërroi procedurat ligjore.

Shqyrtimet e rrezikut dhe elementet e sigurisë

Viktimat e trafikimit mund të ndiqen nga trafikantët e tyre për t'i ndëshkuar ose për t'i kthyer në vendin e tyre të punës shfrytëzuese. Në disa vende, trafikantët kanë ditur të interceptojnë viktimat e tyre gjatë rrugës— në pikat kufitare, pas dëbimit të viktimave ose me mbërritjen e tyre në shtëpi. Kthimi mund të përbente një rrezik nëse anëtarët e familjes së viktimës, apo dhe miqtë e tyre, kërcënoheshin, pasi shumë shpesh ndërmjetësi apo dhe vetë trafikanti, duke qenë pjesë e rrethit familjar apo shoqëror të viktimës, e dinte se ku mund të gjendej viktimat e tij, pasi një person i trafikuar, zakonisht, menjaherë nga shoqëria, në një kohë kur qeveria nuk është e aftë ose nuk dëshiron të ofrojë mbrojtje, etj. (OSCE/ODIHR 2004: 81). Në disa raste, kjo do të thotë që viktimat të mos kthehet në shtëpi; në rastet e tjera, kjo do të thotë që viktimat do të kërkojnë që të shoqërohet, kur kthehet në shtëpi, si të merren masa sigurie në vendin e origjinës. Shumë viktimat kishin shqetësime serioze rreth procesit të tranzitit dhe të kthimit, sepse kishin frikë se mos interceptoheshin nga trafikantët e tyre, se mos ri-trafikoheshin ose mos i hasnin trafikantët e tyre në shtëpi. Një viktimë shpjegoi: “çfarë t’ju them, isha e tmerruar. Nuk desha të kthehem në [vendin tim]. E dija se njerëzit nga të cilët kisha shpëtuar, do të më pritnin kokën”.

Në pjesën më të madhe të intervistave të realizuara, viktimat kishin mbërritur shëndoshë në familjet e tyre. Por shumë nga ato, gjithashtu, kishin patur probleme gjatë rrugës dhe/ose pas mbërritjes:

Kisha shumë frikë se, ekzistonte një mundësi shumë e fortë që të kapesha në [kryeqytet], tek stacioni i trenit. Me qëllim që të menjanoja rrezikun e kapjes nga trafikantët në stacionin e trenit të [kryeqytetit], unë zbrita nga treni një stacion më shpejt [rreth 20 km larg kryeqytetit]. Nuk kisha para me vete. Eca për një kohë të gjatë, dhe pastaj hypa në një trolebuz. Isha e palarë, dhe të gjithë m’i hidhnin sytë. Më vinte turp ... dhe kur mbërrita [në shtëpi] trafikantët po më pritnin atje. Po i bërtitnin nënës sime, dhe pastaj m’u kthyen mua. Nuk mund të thoja asgjë. Më kërcënuan se do të më vritnin, në rast se nuk kthehesha mbrapsht.

Një numër viktimash raportoi se ishin të përgatitura për problemet e mundshme që mund të ndeshnin gjatë rrugës dhe si t’i trajtonin ato. Në këto raste, duket se janë bërë disa lloj shqyrtimesh të rrezikut (për fat të këq, në mënyrë jo formale) dhe viktimat ishin të përgatitura me të dhëna sesi duhej

të vepronin në rast problemesh. Siç tregoi një viktimë, “Më thanë të mos shqetësohesha. Më shpjeguan me hollësi sesi duhet të sillësh në aeroport. Më thanë se në rast rreziku, unë mund t’i drejtohesha policisë”.

Shqyrtimet e rrezikut u ndërmorën për shumë pak viktima, të paktën mesa dinte viktima vetë. Kjo ishte e vërtetë edhe në rastet kur ishte identifikuar një rrezik akut. Shkëmbimi i kufizuar i informacionit midis shumë agjencive në vendin e origjinës dhe të destinacionit duket se përbën një pengesë për ndërmarrjen sistematike të shqyrtimeve të rrezikut. Përveç kësaj, protokollet për shqyrtimet e standardizuara dhe sistematike të rrezikut, përgjithësisht mungojnë ose zbatohen rrallëherë. Shqyrtimi i rreziqeve të kthimit është veçanërisht jetësor, kur viktimat rrezikohen të kthehen në situatën e shfrytëzimit, ose në të cënueshmërisë, ose tek familjet që janë bashkëpunëtore në trafikimin e tyre. Një viktimë e mitur u kthye në shtëpi pa ndonjë ndërhyrje nga shteti apo nga punonjësit socialë të OJQ-s, pavarësisht se vajza kishte qenë e trafikuar nga nëna e saj, dhe më parë kishte qenë abuzuar nga njerku i saj:

Desha të qendroja më gjatë [në strehëz], por nëna nuk më la ... do të dëshiroja të qendroja më gjatë, pas gjithë asaj që më kishte bërë [nëna imë] ... jam e sigurt që nuk do të isha kthyer në shtëpi, po të ishte për mua. Njerku im abuzonte me mua. Jo, nuk do të isha kthyer.

Megjithatë, procesi i shqyrtimit të rrezikut nuk është jetësor vetëm për të miturit. Një viktimë mashkull, i trafikuar në BE arriti t’i shpëtonte shfrytëzuesit të tij dhe shkoi menjëherë në polici. Atje lëshoi një deklaratë kundër trafikantëve të tij dhe pastaj u kthye në shtëpi, por e bëri këtë veprim shumë shpejt dhe pa i vënë veshin problemeve të mundshme të sigurisë, që mund të dilnin pas kthimit të tij. Është me rëndësi që të vihet në dukje se, që nga ajo kohë ky njeri ka qenë përherë nën kërcënimin e trafikantëve, dhe është detyruar të jetojë nëpër pika të ndryshme, për t’u fshehur nga shfrytëzuesit e tij.

Ka raste kur viktimat nuk duhet të kthehen në vendet e tyre të origjinës – ku, ato, personalisht, vihen në rrezik ose ndeshen me mjedis fajësues dhe diskriminues. Disa viktima të intervistuar, duhej t’ju ishte dhënë statusi i qendrimit jashtë vendit, të paktën përkohësisht, për shkak të problemeve dhe rreziqeve që lindnin me kthimin e tyre në shtëpi. Vetë fakti që një numër syresh janë nën mbrojtjen e shtetit në vendin e tyre të origjinës, dhe të tjerët janë në pritje të rivendosjes jashtë vendit, mbështet idenë e rëndësisë së nevojës së kryerjes me themel të shqyrtimeve të rrezikut dhe të mundësisë së qendrimit jashtë shtetit.

Pritja në vendin e lindjes

Për shumë viktime, përvojat e pritjes pas kthimit të tyre në shtëpi nuk kanë qenë gjithmonë pozitive, megjithëse arsyet për t'u shqetësuar ndryshonin nga një situatë në tjetrën. Në disa raste, viktimat ishin në ankth sepse mungonte organizimi i pritjes – nuk ishin pritur nga organizata, ishin detyruar të përballeshin vetëm me autoritetet, ose nuk kishin patur mundësi për përfitimin e ndihmës. Në raste të tjera, gjithsesi, pritja ishte e lodhshme pikërisht për mënyrën sesi priteshin nga agjencitë dhe institucionet. Një e mitur, që po kthehej, foli mbi mënyrën sesi e kishte dorëzuar policia kufitare tek OJQ ndihmuese:

Polici pas xhamit më tha: “Do të shkojë mirë, thjesht hidh firmën këtu”. Unë vura firmën dhe pyeta, “Ku do të shkojë?”. Ai tha: “Do të dorëzohë unë tek ata”. ‘Ata, kush?’, e pyeta. Pastaj u dukën katër djem me këmisha të zeza ... ku ishte shkruar emri i OJQ-s, por unë nuk e pashë. Në atë minutë nuk shihja asgjë ... Isha në mes të tyre, dy para meje dhe dy prapa... Po më mbanin. Unë ika nga rrethimi i tyre dhe vrapova drejt nënës sime.

Një tjetër çështje që lidhej me pritjen, ishin reagimet e ndryshme të viktimave ndaj pranisë së anëtarëve të familjes në vendin e pritjes. Siç u shpreh një ofruer shërbimesh, “Disa herë ka kushërinj që i presin në aeroport, dhe këto kanë frikë të tregojnë gjithë historinë e tyre, dhe ka raste të tjera, kur refuzojnë të vijnë me ne. Zakonisht, thonë se kanë qenë në burg, se përndryshe si do të mund të shpjegonin pse nuk kishin sjellë para në shtëpi, dhe as kishin marrë në telefon?” (Brunovskis & Surtees 2007)

Një tjetër problem me rëndësi në lidhje me pritjen ishte se, kush do ta informonte familjen rreth kthimit, dhe si do të arrinin viktimat ta mbanin sekret kthimin e tyre. Një viktimë e mitur u çudit, kur takoi nënën dhe kushërinjtë e saj në aeroport, kur u kthye në vend, meqenëse nuk i ishte thënë gjë para se të nisej për në vendin e saj:

Në gjithë atë rrëmujë, unë pashë nënën time ... nuk e kam idenë [kush e kish informuar familjen time]. Unë di vetëm se nëna ime ishte duke më pritur ... nuk e dija që familja ime ishte e njoftuar.

Meqenëse para kthimit të saj, mesa duket nuk ishte bërë shqyrtimi i rrezikut apo i familjes, informimi i familjes mund ta kishte vënë viktimën përsëri në rrezik. Ndërkohë që kjo familje nuk ishte përfshirë në trafikimin e vajzës, ky fakt nuk ishte bërë i njohur agjencisë pritëse në atë kohë.

5.4. Përmbledhje

Kthimi i sigurt dhe dinjitoz i viktimave të trafikimit nënkupton një sërë veprimtarish, dhe në ato raste kur këto procedura nuk ndiqen, kthimet mund të përbëjnë rrezik për viktimat. Në rastin më ekstrem, kjo mund të rezultojë në një ri-trafikim.

Kur flitnin mbi përvojën e tyre të kthimit dhe të referimit, viktimat u shprehën se kishin emocione dhe reagime negative – frikë, ankth, zhgënjim dhe shqetësim, nervozizëm dhe hutim – të cilat rezultojnë jo vetëm nga procesi i kthimit, por edhe nga mënyra sesi ishte administruar ai proces. Në të njëjtën kohë, viktimat folën edhe për emocione pozitive në lidhje me kthimin, përfshirë gëzimin dhe çlirimin, si edhe ndjenja të sigurisë dhe të qetësisë. Shumë viktime raportuan mbi emocione njëkohësisht pozitive dhe negative e shpesh kundërtëse, si për shembull kënaqësi dhe çlirim se po ktheheshin në shtëpi, por edhe frikë e nevojizëm mbi atë çfarë i priste në shtëpi.

Viktimat përballeshin me një sërë çështjesh në procesin e kthimit, çështje që dilnin në kohën e para-nisjes, në tranzit dhe/ose me mbërritjen e tyre në shtëpi. Këto përfshinin mungesën e qasjes ndaj një informacioni të plotë dhe të gjithanshëm mbi procesin e kthimit dhe të referimit; faktin që procesi i transportimit, disa herë, dukej se imitonte transportimin që kishin përjetuar kur ishin trafikuar; rëndësinë e kthimeve jo-identifikuese dhe të ndihmuara; marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin nga autoritetet në tranzit ose me mbërritjen në shtëpi; kthimin e vonuar të viktimave të huaja; çështje që lidheshin me shqyrtimet e duhura dhe të sakta të rrezikut dhe mendime mbi sigurinë; dhe përvojat e pakëndshme e, madje, të ankthshme të pritjes dhe të referimit në vendet e tyre të origjinës.

6. Përvojat e ndihmës dhe të mbrojtjes së personave të trafikuar

Për stabilizimin e menjëhershëm të personave të trafikuar drejt një rikuperimi dhe ri-integrimit afat-gjatë në shoqëri, është jetësor ofrimi i një ndihme të duhur dhe të përshtatshme për to. Si i tillë, diskutimi i aspekteve të ndryshme të ndihmës dhe të mbrojtjes ishte në qendër të bisedimeve me viktimat, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë përvojave të tyre vetjake, të përjetuara si jashtë vendit, ashtu dhe në vendin e tyre të origjinës. Në një përpjekje për të kuptuar këto përvoja, u përqendrua mbi tri fusha kryesore – si ishin ndihmuar dhe mbrojtur personat e trafikuar, si ndiheshin ata gjatë marrjes së ndihmës dhe cilat ishin për ta problemet, çështjet apo dhe praktikatat e mira. Objektivi ishte që të sigurohej që vëzhgimet dhe rekomandimet rreth ndihmës dhe mbrojtjes, të bazoheshin fort mbi përvojat e fituara dhe mbi mendimet e vetë personave të trafikuar.

Viktimat trafikoheshin për në, dhe nëpërmjet një numri të madh vendesh destinacioni, dhe për rrjedhojë, përvojat e tyre ishin shumë të larmishme dhe pasqyronin situatat edhe përtej kufijve të SEE-s. Përveç kësaj, ndryshueshmëria e historikut të secilës prej tyre, si edhe i situatës së tyre të trafikimit, do të thoshte se ata kishin shumë nevojë për ndihmë dhe mbrojtje. Intervistat u kryen me persona të ndryshëm të trafikuar, dhe në fazat e ndryshme të marrjes së ndihmës – në lidhje me mbështetjen në rast emergjence, mbështetjen më afat-gjatë, mbështetjen të orientuar drejt ri-integrimit. Pavarësisht nga dallimet

midis vendeve të ndryshme – në aspektin social, ekonomik, politik dhe kulturor – dilnin vazhdimisht në pah disa tema, kur flitej me viktimat në lidhje me si i shikonin, i kuptonin dhe i përjetonin ata ndihmën dhe mbrojtjen e ofruar.

6.1. Si ndihmoheshin dhe mbroheshin personat e trafikuar

Ndihma dhe mbështetja ofrohej në vendet e tranzitit dhe të destinacionit, si edhe në vendet e origjinës nga ana e OJQ-ve, ON-ve dhe OQ-ve. Disa ndihma ishin specifike për viktimat e trafikimit (ofruar nga agjencitë e anti-trafikimit), ndihmat e tjera, jo. Shtrirja dhe cilësia e shërbimeve ndryshonte nga vendi në vend, dhe, madje, nga agjencia në agjenci.

Ndihma në vendet e tranzitit dhe të destinacionit ishte afat-shkurtër për viktimat e huaja, megjithëse kjo ka ndryshuar disi me zbatimin në disa vende të mundësisë së marrjes së lejeve të përkohshme të qëndrimit për viktimat e huaja. Ndihma, përgjithësisht, përbëhej nga mbajtja në strehim (zakonisht, por jo përjashtimisht, në strehime të mbyllura) dhe ofrimi i shërbimit të emergjencës drejt stabilizimit dhe kthimit të viktimave në vendin e tyre të lindjes. Në ndryshim nga kjo, ndihma në vendet e origjinës, përbëhej, përgjithësisht, nga ndihma afat-shkurtër dhe më afat-gjatë, por përqendrohej mbi mbështetjen e ri-integrimit. Kjo ndihmë bazohej tipikisht mbi ofrimin e strehimit, të paktën gjatë fazave të para të mbështetjes, me objektivin më afat-gjatë që individi të (ri)integrohet në familje dhe/ose në komunitet.

Për disa viktimë, shërbimi në shtëpi, shpesh jepej pas ofrimit të shërbimit në vendin ku ishin identifikuar më parë. Megjithatë, shumë viktimë nuk ishin identifikuar kur ishin jashtë shtetit, dhe, për rrjedhojë, nuk merrnin ndihmë apo mbështetje. Për këto viktimë, ndihma në vendin e origjinës ishte takimi i tyre i parë me ofruesit e shërbimit dhe, në këto raste, viktimave u duhej ofruar, përgjithësisht, edhe pak ndërhyrje afat-shkurtër për raste krizash, para se të përqendrohej mbi nevojat më afat-gjata.

6.2. Si ndiheshin viktimat dhe e përjetonin fazën e ndihmës dhe të mbrojtjes

Në lidhje me si e përjetonin viktimat këtë fazë të ndërhyrjes, ato folën për ndjenja pozitive dhe negative, disa nga të cilat i përjetonin njëkohësisht. Personat e trafikuar përshkruan ndjenja negative – që nga frika dhe tronditja e paqartësia, që nga dyshimi deri të ankthi dhe turpi. Ka rëndësi të vihet në dukje se ato, gjithashtu, kishin patur edhe ndjenja pozitive në këtë fazë, më

të zakonshmet nga të cilat ishin ndjenjat e qetësisë dhe të sigurisë, ndjenja se i përkisnin dikujt, apo vendit të tyre, nuk ndiheshin më të vetmuara, por të çliruara dhe mirënjohëse. Dhe, siç ishte rasti në secilën nga fazat e mëparshme të jetës pas-trafikim, viktimat folën shumë për ndjenjat e tyre të besimit dhe të mosbesimit.

Në shumë raste, viktimat raportuan se kishin patur më shumë ndjenja negative në fazat fillestare të ndihmës, kur kishin më pak besim dhe ndiheshin më pak të qeta rreth ndihmës që do të merrnin dhe rreth ofruesve të shërbimit. Gjithsesi, këto ndijime, përgjithësisht dhe mjaft shpejt, transformoheshin në ndjenja më pozitive, sapo që krijohesh besimi dhe siguria. Si të tilla, emocionet që do të trajtohen më poshtë, shpesh ishin më specifike për disa periudha të jetës së pas-trafikimit të viktimave, dhe lëkundeshin me kalimin e kohës por dhe si pasqyrim i përvojës individuale të viktimës gjatë kohës së përfitimit të ndihmës.

Frika

Nuk duhet të vijë si e çuditshme që viktimat shpesh ishin të frikësuar, kur pranonin fillimisht ndihmën, si në vendet e destinacionit, ashtu dhe në ato të origjinës. Thuajse pa përjashtim, frika ishte një nga emocionet zotëruese që përjetonin personat e trafikuar në fazat fillestare të ndihmës. Për shumë viktima të trafikimit, frika ishte e lidhur me frikën nga trafikanti – se mos trafikanti do t'i gjente, do t'i detyronte të ktheheshin tek ata përsëri, frika nga ndëshkimet kundër tyre ose familjeve të tyre, dhe frika se mos ato nuk ishin mjaftueshmërisht të mbrojtura:

Unë desha të qendroja [në strehëz] edhe për pak kohë, sepse trafikantët më kanë kërcënuar se do të më vrasin menjëherë sapo të kthehem në shtëpi, në rast se provoj të ikë.

Nuk mund të shkojë në shtëpi. Personi që më trafikoi, dhe të cilin unë e denoncova, jeton ngjitur me shtëpinë e prindërve të mi.

Më folën për familjen që më kishte birësuar në [atë qytet] dhe vetëm mendimi se mund t'i bënin gjë, më frikesontë pa masë. Bosi im kishte një motër [në atë qytet] dhe ai vinte shpesh atje. Ai vjen [në atë qytet] çdo dy javë. Dhe mund të më shohë, kur të unë do të shkojë në shkollë.

Pata frikë kur u lirua [rekrutuesi]. Në atë kohë unë as që mendoja të largohesha nga strehëza ... unë vetë e kuptova se jeta ime ishte në rrezik. Mendoj të largohem nga kjo strehëz pas disa muajsh, dhe

mendoj të shkojë tek disa të njohuritë e mi në [qytetin tjetër]. Ndoshta do të më lejnë ta kalojë dimrin atje. Kam frikë se, rekrutuesit do të mund të më gjejnë e do të më vrasin.

Frika, në disa raste, si një ndjenjë më e përgjithësuar, rridhte nga viktimizimi dhe shfrytëzimi i tyre afat-gjatë:

Ishte e vështirë në fillim, sepse unë isha mësuar të gënjeja. Stepesha të thoja të vërtetën nga frika se do të më rrihnin keqas. Më rrihin thuajse çdo ditë dhe për një kohë kaq të gjatë, sa më kishte hyrë frika në palcë. Por, kur e kuptova se asnjëri nuk po kërkonte gjë nga unë, u qetësova. Pas një viti isha krejt ndryshe, madje edhe shtova në peshë këtu.

Ndodhte që kjo frikë të bënte që njerëzit të refuzonin ndihmën; në raste të tjera, frika luante një rol edhe në qëndrimin e viktimave ndaj ndihmës (Brunovskis and Surtees 2007). Një grua, e trafikuar jashtë vendit, fillimisht shkoi në shtëpi, tek familja e saj, por më vonë u pranua të qëndrojë në strehëz për shkak të frikës së saj:

Qendrova në shtëpi nga muaji nëntor deri në muajin mars, nuk mund të rezistoj më shumë. Isha në një ankth të vazhdueshëm. Kisha frikë e gjithmonë isha në tension. Policia më tha se mund të më merrnin në një qendër, dhe unë pranova.

Këtë frikë shumë viktimat arrinin ta mposhtnin me kalimin e kohës – me krijimin e besimit, me shërimin nga tronditja dhe trauma, me krijimin e stabilitetit dhe të qetësisë, dhe në disa raste, me ofrimin e një mjedisi të sigurt. Një viktimë, përshkroi se në fazën fillestare të ndihmës ndihej, “Keq... e pasigurt....e shqetësuar”, por më vonë fitoi qetësi:

[Tani] ndihem mirë... tani arrita të kuptojë që ka organizata që më duan vetëm të mirën ... Ndoshta, problemi ishte tek unë. Isha shumë e frikësuar. Nuk besoja se kishte dhe kujdes pa interes, ndihmë falas ... m'u desh pak kohë ta kuptoja.

Megjithatë, viktimat, po ashtu, vunë në dukje se frika edhe mund të kthehet përsëri, në rastet e ndryshimit të situatës. Një viktimë, e cila kishte përfituar ndihmë në BE për shumë kohë, dhe i kishte të gjitha arsyet që t'i besonte ndihmës, tregoi se sa e frikësuar ishte ajo kur filluan të diskutohen planet e kthimit të saj në shtëpi:

Unë fola në telefon me [drejtoreshën e OJQ-s në vendin tim]. Ajo më shpjegoi se programi i ndihmës është për vajzat që ta marrin veten pasi kanë kaluar situata të ngjashme me të miam, dhe të ri-integrohen në shoqëri. Pra, më shpjegoi gjithçka mbi ndihmën. Është e vërtetë se isha e tmerruar në fillim, por i thashë vetes, shko dhe shiko vetë sesi është.

Pranimi i faktit që viktimat frikësohen për ca kohë, pasi dalin nga trafikimi i tyre, formon një bazë të rëndësishme për mënyrën sesi do të programohet ofrimi i ndihmës dhe sesi do të reagohet ndaj saj.

Tronditja, paqartësia dhe çorientimi

Shumë persona të trafikuar e përshkruanin fazën e parë të ndihmës – e cila, përgjithësisht, por jo gjithmonë, realizohej jashtë vendit – si një kohë kur ato ishin mjaft të tronditura, të paqarta dhe/ose të çorientuara, pikërisht për shkak të situatave që sapo kishin përjetuar:

T'ju them të vërtetën, isha shumë e lodhur, dhe nuk besoj se po kuptoja se çfarë po ndodhte. Mendjen nuk e kisha fare në vend. Ishte muaji mars, bënte ftohtë, dhe e vetmja gjë që unë desha më shumë, ishte një banjë e nxehtë dhe gjumë.

Fillimisht ata më ndihmuan që ta kalojë këtë situatë njëherë. Isha në gjendje shoku, shihja ëndrra të këqija. Kisha frikë të qendroja atje. Mendoja se trafikantët po më ndiqnin, do të vinin e do të më gjenin..., ishte shumë çliruese të flisje me punonjësit socialë.

Por, çuditërisht, viktimat gjithashtu raportojnë se nuk e kishin fare të qartë modelin e ndihmës, dhe shumë nga këto viktime thanë se nuk e kuptonin se çfarë do të thoshte në të vërtetë ndihma, dhe përse ofrohej ajo. Paqartësi të viktimat kishte si në vendet e destinacionit, ashtu dhe në ato të origjinës, dhe, mesa u kuptua, vinte nga informacioni i mangët dhe i paqartë, që u ishte dhënë, nga tronditja dhe trauma, nga aftësia e kufizuar e të kuptuarit dhe nga përvoja e pakët e modeleve të ndihmës (Brunovskis and Surtees 2007).³³

³³ Si një pasqyrim i këtij hutimi, kur e kishin pyetur se çfarë kuptonte me një strehim, një viktimë shpjegoi se ai do të ishte mbushur me njerëz, fëmijë dhe vajza e me shumë kamera. Një tjetër viktimë tha, "Andej nga vija unë, nuk mund ta kisha fare idenë se për çfarë bëhej fjalë. Në [qytetin tim] nuk kishte asgjë të ngjashme, dhe as që nuk e dija se mund të ekzistonin gjëra të tilla". Ndërsa viktimat e tjera thanë se, imagjinonin që strehimi të ishte një "qilar me hekura", "një mashtrim" ose "një shtëpi me shumë njerëz". Nga ana tjetër, kjo paqartësi kishte bërë që disa viktime të refuzonin ofertat për ndihmë (Brunovskis and Surtees 2007).

Kur arrita në fillim në strehim në [qytet jashtë vendit], unë nuk e kuptoja realisht se përse duheshin këto strehime. Vërtet që nuk e merrja vesh qëllimin e ndihmës dhe, praktikisht, nuk kuptoja se edhe unë vetë isha një viktimë e trafikimit.

Në atë kohë, unë nuk merrja vesh fare se çfarë deshën këta njerëz nga unë, dhe nuk e kuptoja se përse unë paskështa të drejtë të merrja ndihmë.

[rreth shërbimeve dhe ndihmës] nuk mbaj mend me saktësi. Ajo po më tregonte diçka... rreth fjetjes dhe ushqimit ... nuk mbaj mend gjë tjetër.

Asnjëherë nuk kisha dëgjuar për një qendër si kjo... më dukej si një vend krejt i panjohur, në fillim qendrova se nuk desha të shkoja në shtëpi. Tri ditët e para ndenja pa folur fare, sepse nuk kisha asgjë të qartë në kokë. Nuk po kuptoja se çfarë po ndodhte përreth.

Viktimat e tjera raportuan se në fillim ndiheshin edhe të paqarta edhe të çorientuara, dhe se u duhej pak kohë që t'i përshtateshin modelit specifik të ndihmës, të cilin, një përfituese e konsideronte më pak të pëlqyeshëm dhe të përshtatshëm, se sa ai që i ishte ofruar kur ishte jashtë:

Kur erdha këtu, të them të drejtën, u trondita ... u trondita, fillimisht, nga vajzat..., e kam fjalën për sjelljen e tyre ... por e dini vetë sesi është ... kur shkon diku, duhet t'u përshtatesh gjërave, rrethanave. Shiko, unë isha tetë muaj [në një strehëz] jashtë vendit... atje kisha dhomën time, guzhinën dhe banjën. Nuk ishte shumë e madhe, por kur mbyllja derën, nuk mund të hynte më askush.

Tronditja, paqartësia dhe çorientimi dukej se ishin reagimet fillestare e të shkurtëra ndaj ofertës së ndihmës, të cilat, me kohë, zbuteshin sapo viktimat ndiheshin në gjendje që të përpunonin dhe të kuptonin ndihmën dhe mbrojtjen që u ofrohej atyre. Nivelet e tronditjes dhe të paqartësisë ishin shumë individuale dhe shpreheshin sipas kontekstit, gjithmonë të lidhura me përvojat individuale të trafikimit dhe me mjediset nga vinin viktimat.

Dyshuese për ndihmën

Për shumë persona të trafikuar, ndihma e ofruar ishte një gjë e re për ta dhe nxiste ndjenja dyshimi. Në disa vende, një numër i konsiderueshëm viktimash nuk kërkuan ndihmë derisa kaloi disa kohë pas trafikimit të tyre, pikërisht sepse kishin dyshime mbi shërbimet e disponueshme dhe organizatat

ndihmuese. Në disa raste, ky dyshim [si nga ana e viktimës, ashtu dhe nga ana e familjes], ka bërë që viktimat të refuzojnë ndihmën (Brunovskis and Surtees 2007). Në rastet e tjera, viktimat pranuan ndihmën, por me shumë frikë, dhe, shpesh, vetëm për pak kohë. Një grua u ndihmua vetëm pas disa vjetësh, sepse ajo ishte dyshuese mbi ndihmën e ofruar, kur u kthye fillimisht në shtëpi, dhe e pranoi ndihmën vetëm kur kishte shumë nevojë për të: “Po, thjesht, ishte hera e parë që po dëgjoja për të. Dhe unë nuk guxoja, nuk dija”. Ajo shpjegoi, dhe kjo ishte me shumë interes, se si mund të tejkalohet ky dyshim. Ajo ishte identifikuar fillimisht nga policia, e cila nuk i kishte ofruar ndonjë ndihmë për referim, kështu që viktimia iu drejtua një qendre për punë sociale, e cila, nga ana e saj, ia referoi viktimën një linje komunikimi (helpline), megjithëse e paspecializuar për çështjet e trafikimit. Për këtë grua – e mitur në kohën e identifikimit – qenia e një punonjësi social si ndërmjetës që kontakton ofruesin e shërbimit në emër të viktimës, e kishte ndihmuar për zbutjen e dyshimeve që kishte patur, dhe e kishte ndihmuar që të pranonte më lehtë e më shpejt ofertën e ndihmës.

Për disa, ky dyshim dhe ngurrim kishte të bënte me faktin se ato nuk ishin ekspozuar më parë ndaj faktorit ‘ndihmë’, qoftë e ofruar kjo nga aktorët shtetërorë ose jo-qeveritarë. Shumë të intervistuar raportuan se, nuk kishin dëgjuar më parë rreth një ndihme të tillë, veçanërisht në vendin e tyre të origjinës, dhe ishin skeptike dhe dyshuese, kur kjo ndihmë iu ofrua atyre për herë të parë:

U ndjeva pak e befasuar, kur erdha në strehëz, këtu në [vendin tim]. Nuk besoja se mund të kishte një diçka të tillë ... madje edhe në [vendin e destinacionit], ndihma më dukej e dyshimtë ... nuk e kuptoja se përse ofrohej.

Ende nuk isha e sigurt se çfarë lloj bamirësie dhe ndihme kishim në [vendin tonë], përse po ndihmohesha në atë vend, në strehëz, përse më jepeshin paratë, ndihma. Në atë kohë nuk u besoja më zanave të përrallave.

Disa nga dyshimet lidheshin me një formë specifike të ndihmës, shembulli më mbresëlënës ishte ai që lidhej me ndihmën psikologjike:

Nuk kisha kohë të flisja me psikologun. Ndershmërisht ju them, nuk e kuptoja përse kisha unë nevojë për ndihmën e psikologes. Në fund të fundit, unë nuk jam një pacient mendor.

Nuk di se çfarë t'i them psikologes. Nuk kuptoj se çfarë pune bën një psikolog.

Unë kisha dëgjuar se vetëm njerëzit me probleme mendore shkojnë te psikologu.... në përgjithësi, unë nuk e di se çfarë pune bëjnë psikologët.

Të paktën për mua, nuk është e qartë se përse duhet ndihma e psikologut ... nuk kisha shumë dëshirë të flisja me të në lidhje me përvojën time. Thjesht, nuk desha. Nuk ndihesha rehat, sepse nuk e kuptoja mirë se çfarë kërkonte nga unë.³⁴

Në rastet e tjera, dyshimi dukej se vinte ngaqë shërbimet bëheshin falas, dhe shumë viktime thanë se ato nuk u besonin gjërave që jepeshin falas, dhe sepse kjo nuk ishte normative në vendin e tyre (cf. Brunovskis and Surtees 2007).

Po, kur më thanë për ekzistencën e një qendre të tilë, ku të gjitha shërbimet ofroheshin falas ... unë pata frikë ... nuk i besoja bamirësisë ... pastaj, kuptova që qendra ishte sponsorizuar me fonde të huaja. Por njerëzit jashtë janë shumë më të sjellshëm sesa këtu, dhe ata nuk kërkojnë bakshishe për shërbimin që bëjnë.

Në fillim, nuk besova. Në përgjithësi, mund të them se nuk besoja që sot dikush mund të japë ndihmë falas dhe të jetë zemërgjërë.

Më thanë se mund të qendroja atje bashkë me fëmijët për pak kohë. Ne do të trajtoheshim me fjetje dhe ushqim. Nuk e besova në fillim. Ditët e sotme është një gjë e rrallë që të marrësh shërbime pa para. Mendova se më vonë do të më kërkonin diçka. Më shpjeguan edhe se është një organizatë e huaj, që po ndihmon këto vajza. Mendova se mos ndoshta do të duan të më marrin ndonjë organ. Ishte e çuditshme për mua që të përfitoja ndihmë falas, meqenëse kjo ndodhte për herë të parë në jetën time.

Për mua, ishte e çuditshme. Nuk mund të imagjinoja se mund të merrja diçka falas... asnjëherë në jetën time nuk kam patur një rast të tillë...

³⁴ Disa viktime arritën të kuptojnë me kohë rëndësinë e mbështetjes psikologjike;

Jo, mendoj se ndihma e psikologut është shumë e rëndësishme. Arrita ta kuptojë këtë vetëm pas disa takimesh me psikologun. Vetëm më vonë kuptova nga vajzat e tjera që mund t'i drejtoheshe psikologut, nëqoftë se të dhemb shpirti.

madje unë u trondita nga mendimi se, nuk do të më duhej të bëja ndonjë veprim si shpërblim.

U çudita pak [që ndihma jepej falas], por ai tha se ishte një organizatë ndërkombëtare, dhe mendja më shkoi menjëherë se mos ishte ndonjë organizatë fetare.

[Punonjësi social] shpjegoi se të hollat vinin nga vendi ku unë kisha patur probleme, dhe se unë meritoja të ndihmohesha. Por, përsëri unë nuk e kuptoj sesi dikush mund të japë para pa marrë gjë. Kjo është pjesa që unë nuk kuptoj.

Pas gjithë këtyre vëzhgimeve, mund të thuhet se dyshimi mbi shërbimet falas, mund të ketë të bëjë, të paktën pjesërisht, me kontekstin e veçantë të rastit. Në disa vende, viktimat dukej se ishin më të familjarizuara me ndihmën falas të shtetit apo të OJQ-ve.

Një gjetje me rëndësi ishte fakti që viktimat ndiheshin dyshuese, sepse ndihma e propozuar nuk ofrohej ndryshe nga si ofrohej ajo kur ishin rekrutuar dhe trafikuar. Një studim që është bërë në tri vende mbi arsyen përse viktimat refuzojnë ndihmën gjeti se, viktimave u dukeshin sikur disa tipare të ndihmës imitonin përvojën e tyre të trafikimit, gjë që ndikonte drejtpërdrejt mbi aftësinë e tyre për të besuar në këto shërbime dhe organizata. Disa u frikësuan, kur pranuan ndihmën, ngaqë po i dërgonin në një vend që nuk e njihnin dhe nuk mund t'u besonin ofruesve të shërbimit dhe as policisë. Një viktimë shpjegoi se ajo pati frikë gjatë fazës së transportimit: "Më vonë, më transportuan te stacioni i policisë në [qytetin] pranë, dhe në atë moment e humba krejt besimin tek policët. Kushedi se ku po më çonin". Intervistat që u kryen me viktimat për qëllimet e këtij studimi, vërtetuan gjetjet e mëparshme. Viktimat që u lëvizën nga qendrat e përkohshme për te qendrat më të përhershme, ishin të tronditura dhe dyshuese në lidhje me lëvizjen që po bëhej.

Qendrova për rreth dy muaj në [atë qendër]. Pas dy muajve, nëpërmjet një përkthyesi, më thanë se duhet të shkoja në një qendër tjetër, sepse nuk mund të qendroja më atje ... U thashë që nuk desha të lëvizë, kisha frikë, nuk isha e sigurt se ku do të më çonin ... Ata u përpoqën të më shpjegonin sesi funksiononin këto qendra, çfarë do të bëja atje, dhe se do të kujdeseshin shumë mirë për mua. Unë u thashë se më duhej të mendoja dhe ta shikoja atë vend me sytë e mi, dhe të takoja personat që punonin atje. Nëqoftë se kjo nuk do të ishte e mundur, unë nuk do të pranoja. Ata më shoqeruan për tek qendra tjetër, ku

duhej të qendroja unë. Shkova bashkë me punonjësen sociale dhe me përkthyesen.

Shërbimet falas dhe ndihma, gjithashtu, dukej sikur ua kujtonte viktimave premtimet e marra nga trafikantët para periudhës së trafikimit. Tha një punonjëse sociale, “Kur shpjegojmë se [ndihma] është falas, ato e refuzojnë sepse ishin trafikuar në të njëjtat kushte” (Brunovskis and Surtees 2007).

Viktimat shpjeguan sesi u ishte ngjallur ideja e ri-trafikimit, kur u ishte ofruar ndihma:

Me të vërtetë që pata pak frikë. Në një rast po mendoja se mos ndoshta po shkoja prapë ku kisha qenë e nga kisha ikur ... kur e pashë atë shtëpinë e madhe ... dhe ajo ishte strehëza, por unë nuk kisha parë kurrë një strehëz në vendin tim. Ngurroja se nuk dija se ç’do të më ndodhte atje.

Atje kishte kompjuter. Kishte gjithë ato lehtësira. Por, mua përsëri më kalonte nëpër kokë mendimi se do të më shisnin përsëri.

Nuk i besova atij. Nëna më kishte thënë të mos flisja shumë me njerëzit që nuk i njihja ... ajo është në ankth. Edhe tani më thotë ndonjëherë se ai [profesionisti që ofron ndihmën] thjesht kërkon të të çojë jashtë. Nëna ime thotë se ajo nuk i beson askujt dhe se nuk u beson as dokumenteve [profesionisti më ndihmoi me nxjerrjen e tyre], sepse në ditët e sotme çdo gjë mund të falsifikohet.

Edhe në rastet kur viktimat nuk i frikësoheshin ri-trafikimit, ato, gjithsesi, kishin shpesh dyshime rreth ndihmës.

Isha shumë e dëshpëruar. Nuk kisha asgjë, dhe mbaj mend që ajo më dha ca para për pastrimin e dhomës sime dhe unë ngrita kokën dhe e pashë. Nuk mund t’i besoja asnjëri ... mendoja se njerëzit duan nga unë diçka në shkëmbim, kështu që e pashë dhe e pyeta: “çfarë do që të bëjë unë tani për ty”? Dhe ajo tha se nuk deshte që unë të bëja ndonjë gjë për të, por të studioja dhe të sillesha mirë. Nuk mund t’u besoja atyre fjalëve në atë kohë. Më vonë, ajo afrohet dhe më thotë se duhet të dilnim në pazar e të blinim gjëra që mund të jenë të nevojshme për një vajzë. E pashë sikur po më fliste një e luajtur nga mendtë, por shkova me të dhe ajo bleu vetëm sende të mira. E pyeta: “çfarë kërkon nga unë?” Dhe, përsëri, ajo më përmendi studimin dhe sjelljen.

T'ju them të vërtetën, unë nuk u besova, sepse nuk desha që të shkoja prapë tek ai vendi [vendi i shfrytëzimit]. Por, ata më shpjeguan se do të qendroja në [kryeqytet], në një qendër, dhe se do të ndihesha mirë, por nuk besova. Mendova se po më gënjenin, sepse më kishin thënë se në ato qendra i rrihnin vajzat... këtë gjë ma kishin thënë vajzat, me të cilat rrija në kamp.

Ndërkohë që marrja e një farë ndihme fillestare jashtë vendit, shpesh shërbente për krijimin e besimit dhe zbutjen e dyshimeve të viktimës kur ktheheshin në shtëpi; ndihma, gjithsesi, nuk ishte çudibërëse. Disa viktima vazhduan të kenë dyshime në lidhje me ndihmën në shtëpi, pavarësisht nga përvoja pozitive e ndihmës që kishin marrë jashtë, në vendin ku ndodheshin, dhe si rezultat, nuk e pranuan [ose jo menjëherë] ndihmën e ofruar. Edhe ato që e pranuan, mbetën dyshuese dhe të shqetësuara për pak kohë. Kjo ndjenjë dyshimi ishte diçka që, përgjithësisht, ofruesit e shërbimeve ishin në gjendje ta tejkalonin, sapo që t'ua bënë të qartë se ndihma ishte e vërtetë dhe qëllim-mirë. Tejkalimi i dyshimit të viktimave, me qëllim që ato të arrinin të pranonin ndihmën, nuk ishte as i menjëhershëm dhe as i thjeshtë.

Ankthi dhe nervozizmi pas-trafikimit

Pasi ishin larguar nga trafikimi, shumë viktima ndiheshin në ankth dhe/ose pa kurajo. Këto ndjenja shfaqeshin në disa mënyra – si zemërim, irritim, mërzitje dhe/ose depresion. Përshkrimi që bëri një grua ditëve të saj të para të marrjes së ndihmës, i pasqyron qartë këto ndjenja:

...kryesisht unë vetëm flisja, e flisja se për çfarë kisha nevojë. Tërbohesha kur nuk arrija të flisja dhe ato më thonin të qetësohesha, nuk isha në gjendje të qetësohesha e të kontrolloja zemërimin tim. Qaja pa pushim. Ndjeja shumë dhimbje në shpirt. Provova të vrisja veten, dhe ndihesha vetëm..., e kështu me radhë.

Siç shpjeguan viktimat e tjera, personat e trafikuar silleshin në mënyra shumë të ndryshme, si reagim i përvojave të tyre shumë të ndryshme të trafikimit dhe të situatave të tyre vetjake, por ankthi dhe nervozizmi ishin të pranishëm në të gjitha rastet:

Do të desha të them se është shumë e vështirë për personelin e strehimit që të punojnë me të gjithë përfituesit ... secila nga përfitueset ka karakterin e saj ... disa vajza përpiqen që të kontaktojnë pronarët e

tyre ... shumë nga to e gjejnë të vështirë të fillojnë një jetë të re ... të tjerat janë mësuar të bëjnë para të lehta ... është e vështirë që të marrin veten fizikisht dhe psikologjikisht, të paktën gjatë periudhës së parë.

Vajzat ishin nervoze, të irrituara, disa nga to edhe të frikësuara. Disa nuk flitnin fare, disa flitnin shumë.

Kur arrita atje, unë mallkoja gjithë kohës. Zihesha me njerëzit, ose kaloja në hysterizëm. [Drejtoresha] tha se nuk ishte mirë dhe unë e dëgjova, sepse ajo më tha se pak nga pak gjërat do të përmirësoheshin, dhe unë i thashë vetes sime të mos sillesha ashtu më, dhe gjithçka u bë normale.

Jam e lodhur nga problemet, dhe mendoj gjithë kohës sesi të ikë nga këtakëtu. Strapacohem në punë, vij në shtëpi përpiqem të fle, por për mua është vetëm si një ëndërr e keqe. Dua të vdesë.

Nuk mund t'i besoja asnjëri. Shaja gjithë ditën. Madje, dikujt ia drejtova edhe thikën.

Ky ankth dhe nervozizëm ishte, shpesh, reagimi i parë, i cili zbutej me kohë dhe në përgjigje të qendrimeve dhe ndërhyrjeve profesionale të aktorëve anti-trafikim dhe të ofruesve të shërbimeve. Por, në momentet e para ai shkaktonte tension dhe vështirësi jo vetëm për personelin, por edhe për përfituesit e tjerë të programeve të ndihmës.

Të gjykuara dhe të turpëruara

Një numër viktimash raportuan se e ndjenin veten të turpëruara dhe të gjykuara, ndjenja këto që u shkaktonin atyre shumë ankth dhe mërzi gjatë procesit të ndihmës dhe përtej tij. Për shumë viktimë kjo ndjenjë "turpi" u vinte nga përvoja e trafikimit, e cila shpesh kishte të bënte me prostitucionin.

Disa njerëz qeshin dhe thonë që ti je një lavire rrugësh. Por ata nuk e dijnë se çfarë ka në zemrën tonë, dhe sa netë kalon pa gjumë, me sa burra ke qenë e detyruar të flesh ose të bësh gjëra të tjera. Të tjerët mund të të kthejnë edhe shpinën. Nëse shkon në shtëpi, të gjithë do të tregojnë me gisht dhe ti e di se sa e vështirë është të mbash kokën lart dhe të vesh buzën në gaz, kur të gjithë e dijnë se çfarë ke bërë.

Ka njerëz që thonë se është më mirë [të vrasësh veten] sesa të jetosh me këtë turp gjatë gjithë jetës tënde. Sepse është turp të rrih nëpër rrugë. Vetëm unë e di se si ndihesh kur rri në rrugë e shikon makinat të kalojnë pranë. Është turp. Çfarë do të ndodhte sikur im shoq ta merrte vesh? Se do të vijë një kohë kur ai do ta marrë vesh.

Turpi ishte problem për viktimat edhe kur do t'u duhej t'i tregonin familjes së tyre se çfarë u kishte ngjarë ndërkohë që ishin larg shtëpisë.

Në fillim, unë thjesht nuk desha t'u tregoja. Kisha turp. Më vinte turp edhe nga vetja ime. Kur ika prej andej, unë mora dokumentet e trafikantit me vete. Por unë nuk desha të shkoja në shtëpi, kështu që shkova tek gjyshja. Por ajo i gjeti dokumentet dhe njoftoi prindërit. Kur folam me prindërit, fillova të qajë dhe im atë kuptoi se kishte ngjarë diçka dhe unë ia tregova atij të gjitha.

Për shumë viktime ishte e rëndësishme që të siguroheshin që nuk ishin ato përgjegjëse për trafikimin e tyre. Kur u pyetën se çfarë këshille do t'u jepnin viktimave të tjera, një numër prej tyre u përqendruan mbi nevojën e luftimit të ndjenjave të frikës dhe të turpmit

Shikoj vajzat që punojnë në rrugë afër apartamentit tonë. I shoh kur dal në ballkon. Është shumë e rëndë për mua. Qaj. E di se çfarë heqin... Do ta këshilloja të shkojë në polici. Nuk është faj i saj. Është faji i tyre. Nuk ishte faji im, që bëja ato gjëra.

[Më ndihmuan], fjalët e personelit të [OJQ-s]. Më tha se ajo që më kishte ndodhur mua, nuk ishte se e kërkova vetë, dhe atëherë kuptova se ishte dikush që kujdesej dhe mendonte për mua.

Për disa viktime të tjera, vetë marrja e ndihmës u shkaktonte ndjenjat e turpmit:

Akoma kam turp të kërkojë ndihmë ... edhe nëna ime ngurron e i vjen turp të kërkojë.

Asnjëherë nuk do të kërkojë ndihmë unë vetë, sepse më vjen turp ... do ta pranojë ndihmën, kur vetë organizata të ma ofrojë këtë ndihmë.

[rreth marrjes së linjës helpline] nuk kisha kurajo. Më vinte turp të telefonoja dhe të kërkoja ndihmë ... nuk jam e mësuar të kërkojë ndihmë ... prandaj këtë gjë e bëri kushërira ime ... Po, preferoj të mos

kërkoj unë vetë ndihmë... Më vjen turp të kërkojë ndonjë gjë...Kjo është natyra ime.

Më pëlqeu kur punonjësja sociale më tha që të mos hezitoja ose të mos më vinte turp për të kërkuar ndihmë dhe se unë mund t'u drejtohesha menjëherë atyre ... në fakt mua më duhej ndihmë për të mbledhur informacion për një dokument, që ma kërkonin në shkollë. Punonjësja sociale më ndihmoi.

Jo, nuk njihja të tjerë përveç [OJQ-s], por më vonë mora vesh për një [tjetër OJQ]. Mora vesh edhe për Drejtorinë e Çështjeve Sociale, por nuk desha t'i kontaktojë ata ...se më vinte turp.

Ndijimi se i përket dikujt, se nuk je vetëm

Ndërkohë që shumë viktima u përqendruan mbi ndjenja dhe emocione negative, të tjerat vunë theksin mbi faktin sesi modeli i ndihmës që u ishte ofruar, i kishte ushqyer ata me ndjenjën se i përkisnin dikujt, gjë e rëndësishme për procesin e stabilizimit dhe të rikuperimit. Kur e pyetën se cili ishte për të aspekti më pozitiv i ndihmës, një grua e trafikuar në BE, por e ndihmuar, gjithashtu, edhe në vendin e saj të lindjes, shpjegoi rëndësinë e ndjenjes së mosqenit vetëm:

T'ju them, në përgjithësi, si ndihesha këtu dhe atje... , unë një gjë vura re, nuk isha vetëm, se kishte njerëz që më kishin pranuar siç isha. Kam kaluar atë përvojë të hidhur, por gjeta mbështetje. Vura re që sa herë ndihesha vetëm, kisha dikë pranë meje, që më thoshte, "ngreje kokën, nuk je vetëm". Ishte dikush, që më dëgjonte.

Edhe viktimat e tjera kishin përvoja të ngjashme:

Shkova për shoqeri. Shkova edhe për t'u larë atje, se këtu ku jam nuk kemi kushte dinjitoze jetese ... E bëra për të qenë në shoqeri, për t'u ndjerë më mirë, dhe për të kaluar kohën në një vend ku mund ta hiqja mendjen nga problemet e mia. Duke u shoqeruar me vajzat, që kishin kaluar të njëjtën përvojë, si unë. Ne kishim një orë për veten tonë, kur do të dëgjonim muzikë, do të flisnim, qeshnim dhe e hiqnim mendjen nga hallet.

Po, kuptova se nuk isha e vetmja që ... e kuptoj tani, e kuptova shumë kohë më parë se mund t'i ndodhte gjithkujt, pavarësisht nga raca apo gjërat

e tjera. Në atë kohë mendoja se po më ndodhte vetëm mua, se isha aq fatkeqe dhe ndihesha se po merrja fund ... dhe fakti që ne mund të kënaqeshim dhe shoqeroheshim me njëra-tjetrën, duke ditur se çfarë kishim hequr.³⁵

Ndërkohë që për disa viktime të qenit bashkë me personat e tjerë të trafikuar ishte e dobishme, të tjerat mendonin se mjedisi ua shtonte ankthin:

Nuk mund të flitja me vajzat, edhe pse kishim kaluar nëpër të njëjta situata. Disa herë qaja, kur kujtoja ç'kisha kaluar. Më pyesnin se çfarë kisha, por unë nuk mund të shprehja çfarë kisha në shpirtin tim

Të gjitha vajzat rrinin të tërhequra dhe ne nuk komunikonim me njëra-tjetrën.

Deri në një farë mase, nevoja dhe dëshira për të qenë me personat e trafikuar dukej se ishte e lidhur me kohën – viktimat e gjenin praninë e të tjerave veçanërisht të rëndësishme në fazën fillestare të fazës së trafikimit. Për të tjerat, ishte e rëndësishme që të shkëputeshin nga shërbimet e trafikimit dhe viktimat e tjera, si pjesë e procesit të ri-integrimit dhe rikuperimit të tyre. Një komunitet që përbëhet vetëm nga persona të trafikuar mund t'ua kujtoj viktimave 'dallimet' dhe problemet e kaluara, gjë që mund të çojë në një ndjenjë të izolimit social, duke shkuar kështu kundër objektivit të rikuperimit dhe ri-integrimit (Bjerkan & Dyrliid 2006b: 10).

Qetësia dhe siguria

Shumë viktime folën për ndikimin qetësues që shumë ofrues shërbimesh dhe organizatash ndihmuese patën mbi to, si në fillim, me pranimin e ndihmës, ashtu edhe me kohë.

Takova për herë të parë [punonjësen sociale], e cila erdhi të më marrë në stacionin e policisë. Ajo më tha se po shkonim në një qendër

³⁵ Edhe Bjerkan & Dyrliid (2006b: 19-20) gjetën se, përgjithësisht, ndjenja e komunitetit dhe e bashkësisë vlerësohej pozitivisht nga gratë në programet e ri-integrimit. Shumë përfitues vlerësuan se shkarkonin hallet e veta nëpërmjet bisedave dhe ndarjes me të tjerat të shqetësimeve të veta:

Vajzat shkëmbejnë përvojat e tyre të trafikimit – secila nga ne ndanim me njëra-tjetrën historitë tona. Kur u tregojta të tjerave mbi përvojat tona, unë ndihesha shumë mirë.

Vajzat në strehëz komunikonin me njëra-tjetrën dhe ndanin mendimet. Ndhiesha më mirë kur flitja me njerëzit që mund të më kuptonin – kur jam në gjëndje të ndajë mendimet dhe përvojat me dikë.

ndihmuese, dhe atje unë do të isha e sigurt. U ndjeva mirë, sepse ajo nuk më kërkoi që t'i tregoja se çfarë më kishte ndodhur, sepse isha e lodhur shumë dhe e vetmja gjë që do të deshja ishte, të bëja një banjë dhe të pushoja. Ajo më tha se ashtu do të bëja dhe unë u qetësova.

Ndihesha e sigurt atje. Ishte mirë. Pas stresit që pata, ishte mirë të përfundoje fare papritur në një vend aq paqësor, ku mund të flije, të kishe diçka për të ngrënë, ku të shpjegohen gjërat dhe të thuhet se do të arrish shëndosh e mirë në shtëpi. Ndihesha në paqe.

Mora në telefon dhe vajzat e linjës helpline ishin aq të sjellshme dhe të qeta. Ato më ftuan të shkoja në zyrë dhe të takoja punonjësen sociale, dhe ato më thanë, gjithashtu, që do të më paguheshin shpenzimet e udhëtimit. Kisha frikë, kur erdha në takim e parë me punonjësen sociale. Mendoja se do të më shikonin sikur të kisha qenë një monstër. Por, gjithçka shkoi shumë mirë. Më pëlqeu sjellja e punonjëses. Ishte e qetë dhe dashamirëse.

Për disa viktimat, kjo siguri kishte ardhur menjëherë, kurse për të tjerat pas disa kohësh. Koha e nevojshme për të krijuar qetësinë dukej se ishte lidhur, të paktën pjesërisht, me përvojat e veçanta të shfrytëzimit. Në rastet kur viktimat kishin vuajtur nga abuzimi dhe/ose nga abuzimi i besimit, u duk se kërkoheshin më shumë përpjekje dhe ndërhyrje nga vetë ato për të gjetur qetësinë dhe sigurinë. Kur viktimat kishin një situatë negative familjare/vetjake para trafikimit, krijimi i ndjenjës së qetësisë dhe të sigurisë kërkoi më shumë kohë dhe nuk ishte pa ndërlikime.

Për shumë viktimat, struktura e programeve – qofshin programe rezidenciale apo ditore – ofronte një hapësirë të sigurt për të folur dhe ndërvepruar. Një viktimë – viktimë si e dhunës seksuale, ashtu edhe e trafikimit – shpjegoi që vizitat e saj për pjesëmarrje në programet ditore, që zhvilloheshin për viktimat e dhunës, i dhanë sigurinë që i mungonte në jetën e saj të përditshme:

Ishte sistemi që ata kishin. Të gjithë flitnin pa ndërprerje. Asnjëri nuk të ndërpriste. Nuk pihej cigare, nuk dilje jashtë, por mund të shkoje në tualet, nëse kishe nevojë. Nuk kishte njerëz të huaj. Nuk gjykohej njeri. Çdo grua pranon shoqërinë e grave të tjera. Ato e kuptojnë se nuk ishte faji i tyre për atë ç'ka kishin përjetuar, e kështu me radhë. Dhe ato rregullat që trajtoheshin në takimet e punës, më pëlqenin. Dhe unë vazhdoja të shkoja atje.

Por, të ndjerit të sigurt, jo gjithmonë do të përkthehej në të qenit të qetë dhe shumë viktimë luftonin vetminë dhe mallin (për familjen ose miqtë), ndërkohë që merrnin pjesë në programet e ndihmës rezidenciale, ku qasja tek familja dhe komuniteti ishte, përgjithësisht, e kufizuar, si në rastet kur ndihmoheshin në vendin e lindjes, ashtu dhe jashtë tij:

Qava dy javë rresht. Ishte e rëndë. Megjithëse kisha probleme në shtëpi, unë vazhdoja të mendoja, dhe ende mendoj, për shtëpinë. Këtu jam e sigurt dhe çdo gjë është mirë, por mendoj për familjen gjatë gjithë kohës.

Të çliruara dhe mirënjohëse

Për shumë viktimë, ndihma që merrnin ishte thelbësore dhe ato tregonin se ndiheshin shumë të çliruara dhe mirënjohëse. Shumë nga të intervistuarat kishin kuptuar se ndihma – me të gjitha problemet e saj – ishte e një rëndësie jetësore për rikuperimin e tyre, ato ishin mirënjohëse për këtë ndihmë dhe mbështetje që kishin marrë, si në vendin e tyre, ashtu dhe jashtë tij (cf. Bjerkan & Dyrliid 2005, Brunovskis & Surtees 2007).

Ramë dakord që të takoheshim në një vend, afër stacionit të autobuzit. Kisha frikë se mos nuk do të takoheshim dot. Më dukej sikur isha në një ëndërr. Nuk mund ta besoja se ishte dikush që kishte ndërmend të më ndihmonte.

Në atë kohë unë kisha nevojë për një mik, për dikë që të më kuptonte, të më mbështette, të më thoshte së gjërat në jetë nuk janë gjithmonë të nxira. Kisha nevojë për mbështetje dhe të mos mendoja më për të kaluarën.

Jam shumë krenare për ata njerëz. Lavdi zotit që ka dhe njëri të tillë në botë. I faleminderit [drejtoreshës], i faleminderit shumë që kishte organizuar një vend të tillë, ku njerëzit si unë, mund të qendrojnë të qeta. U faleminderit atyre që kanë dhënë para dhe që mendojnë edhe për ne. Ne kemi me të vërtetë nevojë për ndihmë. Jo vetëm unë, por të gjitha vajzat këtu. Jam shumë e kënaqur dhe do të jem mirënjohëse deri në fund të jetës sime [drejtoreshës] dhe të gjithë personelit që punojnë në organizatë.

I jam mirënjohëse kësaj organizate që ekziston e punon. Po të mos ishte për të, nuk e di se sa do të kisha duruar në atë [situatë]. Dhe kushedi se çfarë tjetër do të më kishte ndodhur në atë vend.

Edhe studimet e tjera kanë vënë në pah se viktimat shpesh ndejnë mirënjohje për ata që i mbështesin e i ndihmojnë pas trafikimit. Bjerkan and Dylid (2006b: 14) vëzhgojnë sesi një përfituese e theksoi në mënyrë të veçantë marrëdhënien e saj me këshilltarët: “Të ndihmojnë shumë! Nuk e di se çfarë do të bëja pa to – kujt do të mund t’i kërkoja këshilla.” Në të njëjtën mënyrë, Brunovskis and Surtees (2007) gjetën se mirënjohja ishte reagimi mbizotërues pothuajse tek të gjithë personat që ishin ndihmuar nëpërmjet programeve falë faktit, të paktën pjesërisht, se shumë përfituese kishin opsione shumë të pakta për rikuperim dhe shpesh mbështeteshin tek shërbimet edhe për një ndihmë fare bazike, madje edhe thjesht për të mbijetuar.

Besimi dhe mosbesimi

Meqenëse viktimat kishin qenë mashturar, duke abuzuar keqas me besimin e tyre, mungesa e besimit ishte një pengesë e vazhdueshme për ofrimin e ndihmës, problem ky që vihej në dukje vazhdimisht si nga aktorët e anti-trafikimit, ashtu dhe nga personat e trafikuar. Mungesa e besimit shoqeronte vazhdimisht përpjekjet për ofrimin e ndihmës dhe lidhej me një sërë problemesh të tjera, si dyshimi dhe frika.

Kur fola për herë të parë me [punonjësen sociale] unë nuk e dija nëse duhej t’i besoja apo jo. Por pastaj thashë me vete, do të ishte më mirë sikur të shkoja e të shikoja me sytë e mi, dhe kuptova se ajo që thoshte punonjësja sociale ishte e vërtetë.

Në përgjigje të këtyre rrethanave, bëhet e qartë që formimi i besimit është i një rëndësie shumë të madhe për përfitimin e ndihmës dhe të mbrojtjes. Dhe në intervista me viktimat, ato diskutuan se çfarë do të ishte për ta mënyra më e mirë që të fitonin besimin, dhe se çfarë mund të bëhej për ta krijuar atë besim. Për disa viktimat, krijimi i besimit ishte një çështje kohe:

Në takimin e parë me punonjësen sociale, unë fola shumë pak, madje edhe ato që thashë ishin gënjeshtër. Kisha nevojë për të besuar plotësisht dhe pastaj të thoja të vërtetën. Pas kësaj, mbaj mend, u ndjeva e çliruar dhe fillova të shpresojë se ata do të më ndihmonin. Punonjëset e qendrës kontaktuan një qendër në [kryeqytet] dhe unë rashë dakord që të shkoja atje, sepse nuk mund të qendroja më gjatë në [atë program].

Për të tjerat, besimi lidhej me njerëz të veçantë, dhe në një rast, madje me një kombësi specifike:

[Punonjësja sociale] ishte gjakftohtë dhe fliste me një zë të qetë. Ajo ma gjeti zemrën. E ndjeva se mund ta hapja zemrën time duke folur me të. Më pëlqeu mënyra sesi më fliste, ajo e kuptoi me të vërtetë hallin tim. Është gjithmonë e sjellshme me mua, megjithëse mua më referuan në një [organizatë tjetër]. Ajo më shpjegoi shumë qart se çfarë lloj ndihme kisha në dispozicion dhe kush do të ma ofronte. Ndodh shumë rrallë që unë të kërkojë ndihmë, por ajo e frymëzoi besimin tim. Ajo gjithmonë e mbante fjalën e dhënë.

Më pëlqeu ai vend. Më pritën shumë mirë. Nuk kuptoja [gjuhën e vendit], por atje i gjithë personeli dhe ata që takoje, gjithmonë të pritnin me buzëqeshje. Por, përsëri unë nuk desha të flisja. Në atë kohë akoma nuk e kisha krijuar besimin.

Sepse njëherë më thanë që atje kishte personel nga [vendi im] që punonin me programin dhe që do të kujdeseshin për mua dhe që do të m'i nxirrnin dokumentet e udhëtimit. Krijova besim.

Disa viktimat pranuan fillimisht ndihmën sepse kishin një besim të përgjithësuar tek institucioni ndihmues. Kjo gjë nuk ishte e rrallë në rastet kur ndihmën e ofronte kisha apo ndonjë organizatë tjetër fetare:

Një ditë m'u afrua një zonjë dhe më pyeti sesi kisha arritur deri atje sa të lypja në rrugë ... i tregova gjithçka. Ajo tha se ishte njeri i fesë dhe kjo më bëri që unë të fitoja besim tek ajo.. më mori në shtëpinë e saj dhe më propozoi që të më ndihmonte me nxjerrjen e dokumenteve. Fjeta pa pushim dy ditë në shtëpinë e saj. Pas kësaj, shkuam të kisha e tyre dhe takuam priftin. Prifti më tha se do të më ndihmonte.

Në qendër unë pashë edhe murgesha. Prania e tyre në atë vend më bëri të ndihesha mirë ... nuk e di pse? Veshja e tyre, qendrimi i tyre, mirësia, dhe ndoshta fakti që unë e dija se ato i besonin Zotit, më bëri të ndihem mirë, e sigurt. Murgeshat nuk janë të atilla që të bëjnë dëm.

Në të njëjtën mënyrë, në ato raste kur viktimat referohen nga dikush (përfshi këtu edhe viktimat e tjera të trafikimit), tek i cili kanë besim është një faktor themelor për marrjen e vendimit të pranimin të ndihmës dhe të fitimit të qetësisë:

Kur po kthehesha, takova një miken time, e cila kishte qenë edhe ajo e shfrytëzuar... Ajo kishte hyrë në programin e ndihmës të [kësaj organizate] si përfituese dhe më rekomandoi që të mos kisha frikë, por t'i drejtohesha kësaj organizate për ndihmë ...Po, [i besova] sepse mikja ime kishte përfituar nga shërbimet që ofronte kjo organizatë.

Për shumë viktime, ndjenja e besimit lidhej me plotësimin e premtimeve³⁶ dhe krijohej vetëm pasi kishin marrë ndihmën e premtuar. Në shumë raste, duket se besimi real mbahej i ndrydhur nga viktimat për disa kohë:

Të më trajtonin mirë ... të mos premtinin shumë. Por, nëse premtojnë, duhet ta mbajnë fjalën.

Ata thjesht bënë atë që më kishin premtuar. Ata asnjëherë nuk premtinin atë që nuk ë bënëin dot. Ishin gjithmonë të gatshëm të më takonin, pavarësisht se kishin një grumbull me punë.

U treguan të sinqertë më mua. Mbajtën premtimet e tyre. Më respektuan.

Dhe kështu fillova ta besojë, sepse gjithçka thoshte, ndodhte realisht dhe unë e kuptova se nga unë nuk kërkonte gjë tjetër, veçse të studioja dhe ta dëgjoja. Kështu që i thashë vetes se, ndoshta do të fitoja në jetë një mundësi të dytë.

Disa viktime e lidhnin besimin thjesht me dëshirën që të kuptoheshin dhe të trajtoheshin mirë nga të tjerët:

Fakti që ato i kuptonin problemet tona, që na premtuan ndihmë dhe që në fund të fundit na e dhanë atë ndihmë.

Më trajtuan shumë mirë, më kuptuan. Më respektuan.

Mënyra sesi më trajtonin, më respektonin, dhe sesi i merrnin parasysh nevojat e mia dhe sesi më ndihmonin...

³⁶ Në disa raste, besimi kompromentohej seriozisht nga premtimet e pambajtura;

Më thanë se nuk ishte e mundur të blinin një apartament për mua ... Nuk duhej të më kishin dhënë shpresa se do të më blinin një apartament këtu. Ata njerëzit [jashtë vendit] nuk u treguan të drejtë me mua ... Unë i pyeta ata disa herë nëse ishte e mundur një gjë e tillë në [vendin tim], se nuk besoja për një mundësi të tillë. Por, ata ma konfirmuan. Ata thjesht deshën të më qetësonin pak në atë çast, por kështu shkaktuan më shumë dëm.

Në rastin e disa viktimave, ruajtja e fshehtësisë ishte e një rëndësie të jashtëzakonshme, dhe ata i besonin njeriut, kur e ndjenin se ai person do të ruante fshehtësinë dhe ngjarjet intime:

Ajo nuk është një tip që mund t'i thotë të tjerëve atë që i kam treguar unë.

Sapo që krijohet besimi, lehtësohet referimi i mëtejshëm dhe mbështetja. Një grua u ndihmua në një program, i cili më vonë u mbyll, dhe ajo iu referua një programi tjetër. Kur e pyetën rreth besimit që kishte në këtë organizatë të re, ajo shpjegoi:

Kisha besim. Nissha nga fakti që unë i besova qendrës dhe mund të vazhdoja t'u besoja edhe të tjerëve. Dhe vetë fakti që qendra më dha informacion mbi këtë [organizatë] se, mund t'i drejtohesha njëlloj si të tjerëve, më bëri t'u besoj 100%. Kështu që shkova tek kjo [organizatë e re] pa bërë asnjë lloj pyetje.

Një tjetër tregoi:

Unë nuk desha t'u drejtohem organizatave të tjera në [vendin tim], por [kjo organizatë] më ishte rekomanduar nga [organizata ku isha, jashtë] dhe e bëri në një mënyrë të tillë, që më krijoi menjëherë besim.

Po kështu, një mashkull, viktimë e trafikimit për punë, shpjegoi sesi kishte pranuar referimet e punonjësit të policisë, i cili e kishte ndihmuar për kthimin e tij:

Kur u ktheva te zyra e prokurorit të [atij qyteti], punonjësi i policisë më paraqiti tek një [zyrtar qeveritar] dhe më tha se ai burri do të më ndihmonte për shumë probleme ... [Ky zyrtari] më shpjegoi se punonte për një organizatë, e cila ndihmonte viktimat e trafikimit të merrnin dokumente, të merrnin ushqim, veshje edhe arsim... nuk mendova se ndonjë mashtrues do të vinte në zyrën e punonjësit të policisë për të më mashtruar ... më pëlqeu fakti se ishte serioz ... ishte shumë miqësor me mua ... gjithmonë shumë i sjellshëm ... I besova ... nuk kisha frikë, sepse kishte qenë polici ai që më njohu me të.

Megjithatë, kishte të intervistuar që nuk arritën të krijojnë besim, dhe një numër viktimash folën për mungesën të besimit tek individët dhe tek institucionet, duke menduar se ato mund të mbështeteshin vetëm tek vetja për

të ecur përpara në jetë. Midis të intervistuarve kishte persona që kishin refuzuar disa forma të ndihmës, thjesht për mungesë besimi. Një viktimë e mitur, kur u pyet se çfarë duhet të bëjë një person apo institucion për të fituar besimin, u tregua shumë pesimiste, “Nuk e di. Unë thjesht nuk i besoj asnjëri ... Besoj se është vetja ime që mund të më ndihmojë”. Ajo shpjegoi, gjithashtu, sesi nëna e saj, e cila e kishte shtyrë që të mos pranonte ndihmën, mendonte se ndihma është “e papranueshme”; “Ajo mendon se nëqoftë se ndihmohesh sot, pastaj do të duhet ta paguash më vonë ndihmën që të është dhënë ... ajo nuk u beson njerëzve që nuk i njohim”. Ky qëndrim rezultoi dhe nga një studim mbi arsyen përse viktimat refuzojnë ndihmën, ku çështjet e besimit dhe të mosbesimit rezultuan si motive bazë në procesin e vendim-marrjes së viktimave dhe të familjeve të tyre (Brunovskis & Surtees 2007).

6.3. Çështjet dhe pengesat në procesin e ndihmës dhe të mbrojtjes – vendet e destinacionit, të tranzitit dhe të origjinës

Ky seksion merr në shqyrtim kontributet e viktimave në çështjet kritike të ofrimit të ndihmës dhe të mbrojtjes në vendet e origjinës, të tranzitit ose të destinacionit. Vëzhgimet dhe kontributet nuk janë njëlloj të rëndësishme për të gjitha vendet. Disa nga çështjet e mëposhtme kanë të bëjnë veçanërisht me programet rezidenciale, të cilat, ndërkohë që janë të zakonshme në SEE, nuk janë i vetmi lloj i ndihmës së disponueshme. Po kështu, disa gjetje nuk janë veçanërisht tipike për vendet e destinacionit, dhe rekomandimet mund të mos jenë njëlloj të zbatueshme në vendet e origjinës. Megjithatë, shumë nga gjetjet prekin probleme me peshë për një gamë të gjërë organizatash në një numër të madh vendesh.

Pengesat kulturore dhe gjuhësore

Për disa viktimë, ndihma jashtë vendit të tyre ndikohej nga hendeqet kulturore dhe gjuhësore, disa herë me personelin, disa herë me përfitueset e tjera të programit. Në disa raste kishte të bënte me atë që mund të quhet lëngimi për shtëpinë – kërkonin të kishin dikë me të cilin të mund të flitnin në gjuhën amtare, brenda kuadrit të vet social dhe kulturor. Një viktimë, e ndihmuar në një program me përfituese të kombësive të ndryshme, foli për lehtësimin e saj, kur ra në kontakt me njerëz që ishin nga vendi i saj:

Pas asaj, erdhën edhe dy vajza të tjera, edhe ato ishin nga [vendi im], më ndihmoi shumë fakti që kishte vajza nga vendi im. Është ndryshe kur ke dikë nga vendi yt, gjatë gjithë kohës kisha përshtypjen se nuk po kuptohesh, kur të tjerët janë nga një tjetër kombësi, apo kur nuk e flasin gjuhën tëndë.

Për rrjedhojë, në ato raste kur viktimat nuk mund të komunikojnë me të tjerët, ndihma mund të jetë izoluese. Një e intervistuar shpjegoi se sa të huaj e gjente veten në strehëz, kur njerëzit e së njëjtës kombësi mblidheshin veç dhe flitnin në gjuhën e tyre:

Ishte e vështirë për mua, kur ato të gjitha flitnin me njëra-tjetrën. Unë nuk e di gjuhën [e tyre]. Flitnin në [atë] gjuhë, kështu që unë mbetesha menjanë. Kur je vetem, rri e mendon, por kur nuk ke ç'të mendosh më? Ishte një çmenduri.

Pengesat gjuhësore midis personelit dhe përfituesve mund të kenë edhe ato ndikim mbi ndihmën e ofruar. Një grua e huaj, e ndihmuar në SEE, nuk kishte marrë ndonjë ndihmë psikologjike, për shkak të mungesës së mundësisë së përkthimit, dhe, ashtu siç tha dhe vetë ajo, asaj iu desh t'i kalonte vetë momentet e këqija të saj. Viktimat e tjera përshkruan përpjekjet e tyre të mundimshme për të komunikuar me personelin dhe përfitueset e tjera; mungesa e komunikimit ndikoi qartësisht mbi mënyrën sesi mund të administrohej ndihma e çfarëdo lloji natyre:

Ka shpesh momente të këqija. Por, unë arrij t'i kaloj ato. I kuptoj disi të tjerët, dhe ata më kuptojnë disi, kaq është komunikimi ynë. Pak nga pak filluan të më kuptojnë. Arritëm të kuptojmë në njëfarë mënyre njëra-tjetrën.

Në fillim ishte e vështirë. I kërkoja vëllait tim të përkthente të gjitha fjalët e mia.

Ndërkohë që përdroreshin disa herë përkthyesit, zakonisht përkthimi ishte një luks dhe jo gjithmonë i mundshëm nga ana financiare. Një grua kishte një mundësi të kufizuar të shfrytëzonte përkthimin, por që u realizua me aftësitë gjuhësore të pakta të vetë personelit: "Ishte edhe një grua, që punonte në [vendin tim të origjinës]. Ajo e fliste pak [gjuhën time]. Ajo përktheu dy herë".

Po në të njëjtën mënyrë, kultura mund të krijojë pengesa në programet e ndihmës, një pikë kjo që u prek nga një viktimë, e ndihmuar në një vend të huaj:

Nuk ndihesha e qetë. Nuk e ndjeja se po më kuptonin dhe unë kisha nevojë të flisja me dikë. Por, erdha këtu dhe këtu gjeta dikë me të cilën mund të flasë. Më në fund, po ndjej se dikush mund të më kuptojë. Ndihem më mire, kur e di që dikush po më dëgjon. Në [atë gjuhë] nuk mund të shprehesha. Nuk i njihja të gjitha fjalët. .. [Nuk ishte] vetëm për shkak të gjuhës, ndoshta edhe pse nuk ishim nga i [njëti vend].

Një viktimë tjetër theksoi se sa e rëndësishme ishte për të që, qoftë përkthyesit, apo personeli apo përfitueset të ishin nga vendi i saj i origjinës, ose që të paktën dikush të kuptonte ose të ishte në kontakt me disa nga zakonet kulturore e sociale të vendit të saj: "Ajo kujdesej për ne, ishte nga [vendi im], por kishte rreth gjashtë vjet që ishte me qëndrim në [një vend të BE... Ajo, me të vërtetë, ishte një vajzë e ëmbël. Na trajtonte shumë mirë".

Siç është vënë re në shumë programe kundër dhunës familjare, ndërhyrjet hartohen duke u bazuar mbi këndvështrimet e profesionistëve, që vijnë përgjithësisht, nga klasa e mesme, të cilët gjykojnë sesi duhet të ndërtohen programet (në bazë të modeleve të normalizuara të të ushqyerit, të gjuhës, të rritjes së fëmijëve, të veshjes, etj.). Kjo do të thotë që, ndihma e ofruar jo gjithmonë, apo jo plotësisht, pasqyron nevojat, vlerat dhe këndvështrimet e rezidentëve apo të përfituesve të huaj. Dhe më tej, pengesat nuk kanë të bëjnë vetëm me gjuhën, por edhe me mënyrat e komunikimit në rrethana të ndryshme kulturore (Arora 2004: 8). Po kështu, studimet mbi gratë imigrante dhe refugjate kanë vënë shpesh në dukje ngatërresat në dhënien e informacionit dhe problemet në ofrimin e shërbimeve, kur ekzistojnë pengesat gjuhësore dhe kulturore. Për shembull, një studim mbi ofrimin e shërbimit për gratë imigrante, të abuzuara në Kanada, zbuloi se haseshin pengesa të ndryshme për shkak të gjuhës dhe kulturës, pengesa këto që përjetoheshin si nga personeli, ashtu dhe nga përfitueset. Sipas disa kulturave, ndarja e përvojave/problemeve me të tjerët nuk është e pranueshme, në një kohë kur pikërisht ky komunikim formon bazën e shumë programeve të ndihmës. Madje, dhe trajtimi individualistik i disa programeve mund të jetë problematik për ato gra, të cilat vijnë nga shoqëria dhe kultura, në të cilat jeta e personit perceptohet në kuadrin e familjes dhe të komunitetit, dhe orientimi drejt një jete të pavarur është në kundërshtim me atë mentalitet (Arora 2004: 13-15; Fulbright 2004). Është e rëndësishme të vihet në dukje, dhe siç është vënë re në fakt në kontekstin e shërbimeve të shëndetit mendor, dëshira për të përfituar nga kujdesi ndikohet nga variablat e tjerë të rëndësishëm kulturorë, si mosha dhe gjinia (Hollifield 2002: 421). Po këto probleme u ndeshën edhe me viktimat. Një viktimë e trafikimit nga SEE foli

për hendekun që ndjente me personelin jashtë vendit, të cilët, gjithsesi, ajo i pëlqente shumë se e kuptonte që ato e mbështetnin. Por, për të ekzistonte një hendek i padukshëm kulturor midis saj dhe personelit jashtë vendit.

Meqenëse kultura ndikon mbi mënyrën e ofrimit të shërbimit, del nevoja e një kujdesi më të madh në drejtim të dinamikës specifike sociale dhe kulturore të përpjekjeve për rikuperim dhe ri-integrim. Duke qenë se shumë viktimat qendrojnë përkohësisht, madje edhe përgjithmonë në vendet e destinacionit, kjo pikë merr vlera të veçanta. Në fushat e tjera, ofrimi i shërbimit nënkupton ndihmën për trajtimin e anktheve shumëfishe në një vend/kulturë të re, si për shembull, mundësia e përfitimit nga shërbimet rreth të cilave ato nuk kanë asnjë dijeni, informimi mbi kuadrin ligjor që ekziston në atë vend të huaj, shfrytëzimi i shërbimeve të përshtatshme gjuhësore dhe kulturore, duke marrë parasysh normat kulturore rreth fshehtësisë, fajësimit dhe turpit, duke i përkushtuar vëmendjen e duhur kontrollit të familjes dhe të komunitetit mbi vendimet që merren, e kështu me radhë (Cooper et al 2004: 30-32). Në lidhje me disa forma specifike të ndihmës, pengesat kulturore janë veçanërisht kritike. Ndihma psikologjike është një nga shembujt më domethënës, ku duhet të merren parasysh variablat kulturorë, dhe ku duhen angazhuar në mënyrë të efektshme dhe të përshtatshme personat që vijnë nga sfonde të ndryshme sociale e kulturore (Hollifield 2002: 421).

Qasja tek informacioni mbi ndihmën dhe shërbimet

Vendimtare për një fuqizim të metodës që duhet të përdoret është që, vetë viktimat të angazhohen aktivisht dhe të informohen plotësisht për vendimet që do të merren dhe opsionet që do të ndiqen në jetët e tyre të pas-trafikimit. Kjo do të thotë që, atyre duhet t'u zbulohet informacioni për një sërë çështjesh, përfshirë format e ndryshme të ndihmës së disponueshme në vendin e origjinës dhe në atë të destinacionit, opsionet që janë brenda këtyre programeve, mënyra si do të vlerësohet ndihma, si në fazën e tanishme, ashtu dhe në atë të mëvonshme. Disa viktimat raportuan se ishin informuar plotësisht rreth mundësive të ndihmës. Një grua, që kthehej nga BE ishte në një kontakt të drejtpërdrejtë me një program ndihme në vendin e saj të lindjes dhe ishte e aftë që të merrte vendimet e saj para kthimit:

Fola me [drejtoreshën] në telefon. Ajo më shpjegoi programin e ndihmës: që ai i ndihmon vajzat të rimarrin veten pas përvojave që kanë kaluar, për t'u ri-integruar në shoqëri. Ajo më shpjegoi gjithçka rreth ndihmës. Është e vërtetë që unë isha trembur në fillim, por i thashë vetes të shkojë vetë dhe ta provojë sesi është.

Në të njëjtën mënyrë, një grua, e cila u kthye në shtëpi dhe kontaktoi një organizatë, ishte e kënaqur me informacionin që kishte marrë: “Ajo më shpjegoi shumë qart se çfarë ndihme do të ishte e disponueshme dhe se kush do ta ofronte atë”. Ky informacion i plotë ishte i rëndësishëm për viktimat, për stabilizimin dhe hartimin e planeve dhe për marrjen e vendimeve për të ardhmen.

Megjithatë, të intervistuarit e tjerë jo gjithmonë kishin qasje tek informacioni i rëndësishëm për rikuperimin e tyre, duke mos arritur të marrin informacionin e nevojshëm rreth mundësive të ndihmës, si jashtë ashtu dhe brenda vendit të tyre:

Para se të trafikoheja, nuk e dija se ekzistonin shërbime të tilla. Edhe kur mbërrita, nuk e dija. Isha me fat që nëna ime gjeti informacionin e duhur rreth këtyre shërbimeve. Kur u trafikova, nuk mendoja se dikush mund të më shpëtonte, pa folur për policinë që janë vete të korruptuar.

Është e vështirë t’i gjesh se ku ka shërbime të tilla ... Viktimat nuk dijnë se ku duhet të kërkojnë ndihmë.

Gjatë disa intervistave në vendet e destinacionit, viktimat kërkuan nga punonjësit kërkimorë që t’u ofronin informacion rreth opsioneve të ndihmës dhe të dhënat e kontaktit në vendet e tyre të origjinës, sepse përfitueset nuk kishin qenë ende të informuara nga aktorët e anti-trafikimit rreth këtyre mundësive të ndryshme. Në më shumë se një rast, personat e trafikuar kishin qenë me muaj në programin e ndihmës, pa ditur se cilat ishin ofertat në vendin e tyre. Duhet të përmirësohen procedurat për të ofruar më shumë informacion rreth mundësive të ndihmës në vendin e origjinës të viktimave, në mënyrë që të shtohen mundësitë e ri-integrimit të suksesshëm të tyre (cf. Brunovskis & Surtees, Rosenberg 2006, Surtees 2005, 2006a).

Disa viktimat kishin marrë informacion jo të plotë ose të pamjaftueshëm, siç ishte rasti i një gruaje të huaj, që ndihmohej jashtë vendit të saj, dhe kthimi i sëcilës ishte vonuar për shumë kohë. Për të ishte e rëndësishme që informacioni i dhënë të ishte i saktë dhe i plotë, edhe sikur të bëhej fjalë për “lajme të këqija”. Ajo parapëlqente të dinte paraprakisht sesi ishte situata reale, edhe kur kjo do të thoshte një vonesë e mundshme prej disa muajsh.

I pyeta se kur do të mund të shkoja në shtëpi. Ata më thanë – nesër. Qendrova edhe dy vjet ... Po, i pyeta përse qendrova kaq gjatë. Kur erdhën në mëngjes, i pyeta nëse duhej të përgatitesha për të shkuar në shtëpi. Ata më thanë: “Nuk do të shkosh në shtëpi, do të rrish këtu”. U thashë: “Por ju thatë se do të shkojë në shtëpi.” Ata u përgjigjën:

“Nuk do të shkosh në shtëpi, përderisa të gjejmë se çfarë duhet të bëjmë” ... Më thanë se do të kishtë gjyq. Por, as gjyqi nuk u bë fare.

Edhe kur ofrohej pak informacion, shumë viktimat nuk mendonin se ai ishte i mjaftueshëm:

Nuk më thanë se ishte një shtëpi e sigurt. Më thanë vetëm se është një shtëpi private, ose se do të shkoja në një hotel. Ata thanë se as ata nuk e dinin se ku ishte ajo shtëpi. Më thanë të mos kisha frikë. Më premtuan se çdo gjë do të shkonte mirë. Më thanë se nuk është burg; nuk është diçka që bëhet kundër vullnetit tim, se gjithçka që po bënin ishte për të mirën time. Më thanë se do t'i kisha të gjitha kushtet e nevojshme – fjetjen, ngrënien, nuk do të torturohesha, dhe se mund të qendroja sa të doja.

Ndërkohë që në disa vende viktimat kanë një pamje shumë të qartë sesi do të jetë programi i ri-integrimit të tyre dhe u angazhuan plotësisht në procesin e vendim-marrjes, nuk ishte e njëjta gjendje për programet e tjera. Në pasqyrim të kësaj, të marrim rastin e një gruaje, e cila, kur u pyet se sa gjatë do të rrinte në strehëz, tha se këtë gjë nuk ia kishte thënë ende ofruesi i shërbimit: “Ata e dijnë, por ne nuk dijmë gjë. Nuk e di nëse do të qendrojë atje dy apo tre muaj, apo dhe dhjetë muaj”. Më vonë, gjatë intervistës ajo u shpreh, “E di që nuk mund të qendrojë gjatë këtu. Nuk e di se sa gjatë, por e di që koha është e kufizuar. Nuk kam se ku të shkojë. Kam nevojë për punë”.

Një tjetër problem ishte se viktimat kishin informacion të kufizuar rreth programeve të tjera dhe organizatave që mund të ishin në gjendje të ofronin pak ndihmë – organizata specifike për trafikimin ose jo, shërbime shtetërore dhe jo-shtetërore. Dhe informacioni që ato merrnin, u vinte nëpërmjet ofruesve të shërbimit, dhe jo duke u angazhuar ato vetë drejtpërdrejt për gjetjen e rrugëve të mundshme të marrjes së ndihmës. Kjo do të thotë që, në disa raste viktimat kufizoheshin me shërbimet e vetëm një organizate dhe rrjetit të saj, dhe nuk u ofrohej e tërë gama e shërbimeve dhe e opsioneve të mundshme në vend (cf Bjerkan 2005, Surtees 2006a). Një burrë, i trafikuar në ish Bashkimin Sovjetik, u identifikua dhe u ndihmua nëpërmjet një kishe, dhe me kthimin e tij në shtëpi, njihte vetëm shërbimet që ofroheshin nëpërmjet rrjetit të asaj kishe:

Nuk kisha ide se cilave organizata mund t'u drejtohesha për ndihmë. Unë njihja vetëm kishën, tek e cila isha referuar nga disa fetarë në [vendin e destinacionit]. Nuk e dija se përveç organizatave shtetërore, ekzistonin edhe OJQ-të.

Meqenëse të gjitha organizatat – qeveritare dhe jo-qeveritare – punojnë me burime të kufizuara, është i rëndësishëm bashkëpunimi dhe bashkërendimi midis organizatave. Përfshirja e një numri më të madh profesionistësh nga të gjithë sektorët e anti-trafikimit shërben për të siguruar një identifikim më të gjërë, duke i mundësuar viktimat që të përfitojnë nga një numer më i madh shërbimesh. Në shumë situata, bashkëpunimi midis agjencive jo vetëm që shtoi opsionet e ndihmës për viktimat, por edhe menjanoi dublimin e shërbimeve. Viktimat shpjeguan sesi ofrimi i ndihmës kishte aktivizuar edhe mbështetjen e agjencive të ndryshme. Rasti i një gruaje është një pasqyrim i mirë i kësaj pike. Ajo ishte mbështetur për ngritjen e një biznesi të vogël nga një organizatë, që ishte e profilit. Biznesi po shkonte mirë, derisa një sëmundje në shtëpinë e saj, e detyroi që kursimet t'i përdorte për kujdesin mjekësor. Organizata e referoi rastin një organizate tjetër, e cila e ndihmoi për kurën mjekësore, duke mundësuar që ajo të vazhdojë me biznesin e saj, i cili ishte jetësor për mirëqenien e saj dhe të familjes. Rëndësia e bashkëpunimit dhe e bashkërendimit (dhe qasja tek informacioni) u diskutua edhe nga përfitueset:

Vura re se [kjo organizatë] dhe [organizata tjetër] bashkëpunojnë mirë ... ata ishin shumë të ndjeshëm ndaj rastit tim dhe nevojat e mia u morën parasysh nga të dyja organizatat.

Më pëlqen të shikojë sesi bashkëpunojnë organizatat me njëra-tjetrën, dhe fakti që organizata të ndryshme mund të ofrojnë ndihma të ndryshme.³⁷

Nuk është vetëm një çështje bashkëpunimi dhe bashkërendimi brenda-përbrenda vendit, por edhe në nivel transnacional. Ofruesit e shërbimit, sipas një studimi të bërë në SEE, raportojnë për mungesën e një informacioni të plotë dhe të përditësuar në lidhje me disponueshmërinë dhe shtrirjen e shërbimeve të ri-integrimit në vendet e origjinës, duke i penguar këta ofrues shërbimesh që t'i këshillojnë viktimat rreth tërësisë së opsioneve: "Kemi nevojë për kontakte më të mira me organizatat në vendet e tjera, veçanërisht në BE. I njohim OJQ-të në rajon, por tani kemi nevojë të bëjmë lidhjet me vendet e BE" (Surtees 2006a).

³⁷ Në kundërshti me këtë, disa viktimat komentuan mungesën e bashkëpunimit midis agjencive dhe sesi disa herë përfitueset bëheshin pre e tensioneve dhe e konkurrencave midis agjencive:

Vura re një praktikë të keqe. Ata flasin keq për organizatat e tjera në prani të përfitueseve. Ata thanë se [kjo organizatë] është duke monopolizuar viktimat. Se asnjëri nuk mund t'i afrohej asaj dhe as përfitueseve të saj. Se [ajo organizata] po i detyronte përfitueset që të punonin në shkëmbim të ndihmës që merrnin. Se ata i mbyllnin përfitueset e tyre si në burg, etj. Ishte me të vërtetë e çuditshme.

Zotërimi i informacionit rreth shërbimeve në vendet e origjinës do të thotë që, agjencitë mund të bëjnë zgjedhje më të informuara në procesin e referimit dhe mund të këshillojnë viktimat për të gjitha shërbimet e disponueshme për to me kthimin në shtëpi, pavaresisht nëse ato mund t'u ofrohen nga agjencia pritëse, apo të kontaktohen nëpërmjet procesit të referimit. Komunikimi i kufizuar midis programeve do të thotë që, viktimat mund të referohen pa u informuar agjencia pritëse rreth rastit, ose pa i dhënë asaj informacionin përkatës rreth rastit (Surtees 2006a).

Po ashtu, e rëndësishme është qasja tek informacioni rreth ndihmës dhe mbështetjes që ekziston brendapërbrenda komunitetit. Viktimat u pyetën se deri në ç'masë ishin të dukshme dhe të arritshme mundësitë e ndihmës – për viktimat dhe komunitetin në përgjithësi.

Mendoj se viktimat e trafikimit nuk dijnë se ku të kërkojnë ndihmë. Tani në [atë qytet] njerëzit nga [ajo organizatë] shkojnë në shkollë për të diskutuar, për të shpërndarë broshura ... Kjo është një gjë e mirë ... Për fat të keq unë nuk e kisha këtë informacion, kur isha në shkollë. Mendoj se do të ishte me dobi për mua.

Nuk dija asgjë për [ndihmën]. Edhe tani unë nuk di asgjë rreth ndihmës. Në shtëpi nuk kemi as aparat TV dhe as radio. As gazeta nuk lexojmë ... nuk do të isha në gjendje të merrja vesh për ndihmën në rast se [ofruesi i shërbimit] nuk do të më kishte kontaktuar i pari.

Nuk dija asgjë për shërbimet që ekzistonin [në shtëpi].

Kur u pyetën vetë viktimat sesi do ta jepnin ato informacionin mbi opsionet e ndihmës, shpesh kishin shumë ide të qarta sesi mund të realizohej kjo, dhe sesi do të duhej të ishte vepruar më mirë në vetë rastin e tyre:

Unë do t'ja kisha shpjeguar në një mënyrë shumë të thjeshtë se çfarë lloj ndihme kishte në dispozicion, dhe duke e marrë për dore do ta kisha sjellë tek organizata me të cilën punoja ... Do t'ia kisha paraqitur personelin e vendit të strehimit ... Do t'i kisha lënë pak kohë sa të familjarizohej me vendin, në mënyrë që ajo t'u besonte gradualisht fjalëve të mia.

Një metodë e tillë është përdorur nga disa organizata, të cilat i ftojnë viktimat tek godina, në mënyrë që ato vetë të shikojnë realisht se çfarë ofrohet për to, por edhe që të takojnë përfitueset e tjera. Përgjithësisht, vetëm pas kësaj faze u kërkohet atyre që të vendosin, dhe nëse refuzojnë, do t'u ofrohet

përsëri mundësia që të kthehen në një kohë më të vonë. Një psikologe e komentoi këtë strategji, "Një gjë është t'u flasësh për ndihmë, dhe tjetër gjë është t'ua tregosh ta shohin me sytë e tyre" (Brunovskis & Surtees 2007). Është e nevojshme që të flitet me viktimat rreth çfarë lloj informacioni kanë nevojë, në çfarë lloj formati, duke i kushtuar vëmendje gjuhës sipas grup-moshës, dhe nivelit përkatës arsimor. Po ashtu, është me rëndësi që t'u lihet atyre pak kohë për ta përpunuar informacionin dhe për të marrë vendime të informuara dhe të studiuara me kujdes.

Qasja tek drejtësia

Shumë viktime të trafikuar ranë dakord që të përfshihen në procedimet ligjore kundër trafikantëve të tyre, megjithëse arsytet për këtë ishin të ndryshme. Në një numër rastesh, nevoja për kompensim ishte motivimi parësor. Një viktimë shpjegoi, "Kisha ndërmend vetë të dëshmoja kundër kriminelëve. Unë desha që ata të më kthenin paratë që më kishin marrë gjatë shfrytëzimit tim. Në [vendin tim] ju mund të gjeni një shtëpi fshati për 300-800 dollarë. I dua paratë e mia". Në rastet e tjera, hakmarrja ishte argumenti më i rëndësishëm për gratë që i bënte ato të dëshmonin kundër trafikantëve. Bjerkan & Dyrliid (2006a: 9) shënojnë:

Kur takuam "Jasminën", gjyqi kundër trafikantëve të saj kishte vazhduar për një vit dhe ende nuk po i shihej fundi. Pavarësisht nga vështirësitë dhe procesit jashtëzakonisht të zgjatur, Jasmina insistoi se ajo nuk ishte e penduar që kishte rënë dakord për të dëshmuar. Ajo tha se motivimi i saj kryesor për të marrë pjesë në proces ishte hakmarrja. Trafikantja që e kishte çuar atë jashtë vendit, e kishte penguar viktimën që të shikonte vajzën e vet për disa muaj. Ndërkohë, vajza e Jasminës ishte lënë me gjyshen e saj, që ishte një e alkoolizuar. Jasmina e dinte se trafikantja ishte nënë e një fëmije të vogël, dhe ajo e konsideronte si një hakmarrje të përsosur që ta bënte të vuajë trafikanten, ashtu siç kishte bërë trafikantja me të duke e ndarë me forcë nga fëmija i saj.

Në situata të tjera, viktimat binin dakord të dëshmonin nga dëshira për të qenë të sigurta (dhe të tjerët të ishin të sigurt) dhe të mos shqetësoheshin për ndëshkimin që mund t'u vinte nga trafikanti i tyre:

Nuk është se unë e ndërrova mendjen menjëherë. Por, kur mendova gjithë ato tmerre që kisha kaluar, unë kuptova se do të isha më e sigurt, në rast se këta persona do të futeshin në burg.

Po të futeshin kriminelët në burg, unë do të isha më e qetë.

“Iulia” u kontaktua nga policia vendore dhe iu kërkua që të dëshmonte kundër trafikantëve të saj, shpejt pasi të kthehej në shtëpi ... Arsyeja e saj kryesore për atë veprim, ishte që t’i ndalonte ata që të mos vazhdonin veprimtaritë e tyre. Ajo arriti të marrë vesh që, po të njëjtët njerëz kishin rekrutuar dhe shfrytëzuar një numër të madh vajzash e djemsh, dhe e ndjeu si detyrim që të mos i linte këta persona të vuanin, apo të kalonin të njëjtat situata (Bjerkan & Dyrliid 2006a: 10).

Nuk ishin të shpeshta rastet, kur viktimat kishin marrë pjesë në gjyqe dhe kur gjykatat kishin dhënë vendimet e tyre. Një viktimë shpjegoi: “Dëshmova kundër [trafikantëve] dhe unë e fitova gjyqin. U gëzova që ata morën dënimin që meritonin”. Por, është e arsyeshme të thuhet se qasja tek drejtësia për viktimat ishte jashtëzakonisht e kufizuar, dhe shpesh në disa mënyra që nënkuptonin rreziqe reale për jetën dhe pasoja për viktimat. Kur viktimat ishin të përfshira në procese kriminale dhe gjyqësore, shumë nga to nuk ishin të kënaqura me mënyrën sesi ishte zhvilluar procesi. Një viktimë tregoi se çfarë duhej bërë ndryshe, “Të marrin një ndihmë më të kualifikuar ligjore, të kenë një mbrojtje më të mirë shtetërore të dëshmitarëve, që dëshmojnë kundër trafikantëve”. Një viktimë tjetër ishte tepër i zhgënjyer nga sistemi gjyqësor, i cili nuk arriti as të ndjekë penalisht trafikantin dhe as të mbrojë atë dhe familjen e tij. Ai shfaqti keqardhje që kishte lëshuar një deklaratë në polici:

Ata duhet të ndihmohen më shumë. Të paktën, duhet të sigurojnë që mbrojtja e ofruar nga policia të jetë reale sepse, për shembull, motra ime merrte telefonata nga trafikantët, dhe i thonin se unë u kisha prishur biznesin e tyre prej qindra milionësh, një gjë e tillë nuk mund të harrohet. Ne duhet të trajtohem ndryshe nga ana e policisë ... Ne ndihmojmë shtetin për hiçgjë. Unë për veten time nuk do ta bëja përsëri. Mendova se po bëja një gjë të drejtë, sepse ai djalë u kishte bërë shumë të këqija shumë njerëzve, dhe mund të kishte vazhduar. Por, duke dëshmuar kundër tij, unë dëmtova veten, sepse që atëherë, më është dashur të lëvizë nga njëri vend tek tjetri. Kjo është e vetmja pendesë që kam ... [gruaja ime] megjithëse më e re se unë, ishte më e zgjuar se më tha të mos dëshmojë në polici. Unë bëra me kokën time, dhe ja ku jemi. Asgjë nuk mund të ndryshohet tani.

Viktimat mendonin se rastet e tyre nuk ishin trajtuar mirë nga avokatët e tyre. Po të marrim, për shembull, rastin e një viktime, e cila thoshte që avokati

i saj i bërtiste gjithmonë dhe nuk e linte të fliste, se i thoshte që ajo nuk bënte mirë asgjë, dhe se ai ishte i prirur që të besonte më shumë trafikantin, se sa atë. Përveç kësaj, kjo grua shpjegoi se avokati nuk i merrte parasysh interesat e saj dhe nuk vlerësonte drejt përvojat që kishte kaluar:

Disa kohë më vonë, kur gjyqi vazhdoi për nja gjysmë viti, avokati u përpoq të më bindte që të tërhiqja dëshminë time, duke thënë, “Megjithatë ajo është kushërira jote, të të vijë keq për të”. Unë u trondita. Ai po më shtynte që ta tërhiqja akuzën, dhe unë, në fund të fundit, deklarova në gjyq se më vinte keq për kushërirën time.

Një tjetër ankesë e viktimave ishte që ato nuk merrnin informacionin rreth rasteve të tyre nga zbatuesit e ligjit ose gjyqësori, dhe nuk mbaheshin në korrent të zhvillimeve procedurale:

[Qendrimi i policisë] ishte sikur po më thoshte...“më le rehat, kam punë të tjera shumë më të rëndësishme për të bërë, sesa të merrem me të tuat”.

E vetmja gjë që unë dua të bëjë, dhe i kam thënë vetes se duhet ta bëjë një ditë, është të marrë në telefon punonjësin e policisë në [vendin e destinacionit], i cili trajtoi rastin tonë, se jam kurioze të marrë vesh se çfarë ndodhi.

Jo, nuk më kontaktuan. Shkova të pyesë nëse kishte ndonjë të re. Unë u thashë se ku po shkoja, dhe çfarë po bëja. Më thanë se nuk kishte gjë....se do të më kishin thirrur po të kishte gjë.

Viktimat shprehën mërzitjen e tyre rreth zgjatjes së hetimeve të trafikimit dhe procedimeve gjyqësore, shumë nga të cilat vazhduan me vite.

Kjo po vazhdon për më shumë se një vit, nuk po i duket fundi. Herë mungon avokati, e herë ai tjetri nuk paraqitet.

Po, dua që këta njerëz të dënohen. Kur po kthehesha për [në shtëpi], unë lëshova një deklaratë në polici. Por nuk pata ndonjë përgjigje deri më sot. Punonjësi social tha se [policia anti-trafik] do të merrej me rastin tim. [Punonjësja sociale] dhe unë shkuam atje. Dhashë dëshminë time dhe pastaj më thirrën në policinë e rrethit disa herë për të vazhduar me dëshmi, dhe kaq ishte. Kanë kaluar katër vjet që nga ajo kohë dhe asnjë rezultat.

Përshtypje të tjera negative ishin krijuar pasi procesi ligjor u përjetua nga shumë viktime si një proces i ngatërruar, i pakuptueshëm dhe përtej kontrollit të tyre:

Unë pata ndjenjën se gjykatësi flet një gjuhë tjetër, përdor fjalë që unë nuk i kuptoj, por pastaj harroj ta pyes avokatin tim se çfarë kishte thënë. Kur dëshmovava në polici, më morën pasaportën dhe nuk ma kanë kthyer ende.

Prokurori refuzoi dosjen time ... policia e krimit të organizuar e plotësoi atë. Ata thanë se gjithçka do të jetë mirë, por kur çështja mbërriti në gjykatë, prokurori e refuzoi ta merrte në shqyrtim ... E mora në telefon [oficeren e policisë] për ta pyetur për rastin tim. Ajo më tha se ishte çuditur se përse ishte refuzuar për t'u marrë në shqyrtim, se ajo e kishte përgatitur mirë atë dhe kishte mbledhur prova të mjaftueshme. Ajo më tha se nuk e dinte se përse prokurori e kishte refuzuar hapjen e çështjes.

Ndërkohë që nevoja e ndjekjes së procedurave ligjore mund të jetë veçanërisht e domosdoshme për viktimat me pak arsim, ajo mbetet problem edhe për personat e trafikuar, në përgjithësi, por edhe për popullatën në tërësi. Mbështetja për të kuptuar dhe ndjekur procesin ligjor është i një rëndësie themelore dhe mund të luajë rol jo vetëm për ndjenjën e sigurisë së viktimës, por edhe për ndjenjën e saj/të tij të besimit në vetvete.

Disa viktime e ndjenin se në disa raste mungesa e drejtësisë ishte e lidhur me korrupsionin. Një viktimë foli për ryshfete në çështjen që u gjykua kundër trafikantëve të saj. Çështja u mbyll me disa gjoba, në vend që të jepeshin dënime me burg: "Dënimi që dha prokurori ishte 18 vjet, por gjykatësi vendosi për një gjobë prej 1000 USD për secilin trafikant – dhe atyre u dha amnistia ... nuk u dënuan, nuk morën asnjë dënim ... 1000 USD për ta nuk është asgjë".

Për disa viktime, mungesa e drejtësisë kish sjellë pasoja në jetën reale të tyre, në drejtim të frikës së një ndëshkimi të mundshëm nga trafikantët. Shumë nga to u shprehën se kishin frikë gjatë gjithë kohës, gjë që sjell një ndikim shkatërrues si për individin ashtu dhe për familjet e tyre:

Kam frikë ... se njerëzit kundër të cilëve dhashë dëshmi mund ta marrin vesh se ku ndodhem ... Nuk është shumë e vështirë ta gjejnë se ku jam... Më kanë kërcënuar edhe herë të tjerë... Një vajzë nga një strehëz më tha se disa herë vajzat paguhën nga trafikantët për ta nxjerrë jashtë strehëzës atë që ka dëshmuar kundër tyre. Dhe unë kam frikë. Vëllai i trafikantit ka vuajtur një dënim në burg. Unë nga ata pres gjithçka.

Kam frikë kudo që jam: në shtëpi, kur shkoj te kopështi i vajzës, edhe tani që erdha për intervistën, më shoqëroi mamaja.

Nuk desha të shkoja në polici. Kisha frikë. Por mendova, në një mënyrë apo në një tjetër, ata njëlloj do të më kapin. Nëqoftë se ata kuptojnë se unë jam kthyer në shtëpi, ata do të kërkojnë të më marrin prapë e të më bëjnë ndonjë gjë të keqe. Prandaj, mendova është më mirë të shkojë në polici dhe t'u them atyre gjithçka. Kështu bëra dhe ata u ndaluan. Pastaj u liruan. I thashë policit se ata ishin ndërmjetësit, ua thashë të gjitha. Policia i mbajti brenda për një natë, dhe pastaj erdhi i një mik [i huaj] i tyre dhe foli me policinë. Ky miku u tha se ata punonin për të dhe policia i liroi përsëri. Dhe pas kësaj, policia nuk bëri asgjë.

Ishte shumë e vështirë dhe unë kam frikë të shkojë në shtëpi. Kam frikë se ata janë ende të lirë. Ata ende mbajnë vajza atje për prostitucion. Më ka thënë një mikja ime. Ata rrijnë rehat në shtëpitë e tyre, asnjëri nuk u bën gjë, dhe vajzat kanë frikë.

Jo. Nuk ndihem aspak e sigurt. Unë pres çdo ditë që [trafikantët] të vijnë të më marrin, do të më vijë e gjithë familja e atij që u arrestua ... nuk kam asnjëri kujt mund t'i kërkojë ndihmë apo të më mbajë të fshehur. Duhet të bëjë diçka vetë.

Çështje të sigurisë

Viktimat dhe aktorët e anti-trafikimit theksojnë nevojën e studimit të rreziqeve për sigurinë fizike të personit, kur ofrohet ndihma në vendin e destinacionit, ose të tranzitit, si edhe kur viktimat kthehen në shtëpi. Viktimat dhe familjet e tyre mund të përballen me ndëshkim nga ana e trafikantëve, kur dëshmohet kundër tyre, ose kur lëshohet deklarata në polici. Viktimat, gjithashtu, mund të jenë në rrezik të dhunës ose ri-trafikimit me kthimin e tyre në shtëpi, veçanërisht kur trafikanti vjen nga i njëjti vend/rreth.

Viktimat përshkruan ndjenjat e tyre të pasigurisë dhe të mungesës së garancisë, kur përballeshin me mundësinë e rënies në kontakt me trafikantët e tyre (ose me familjet apo aleatët e trafikantëve).

Kur më thanë se do të shkoja në [vendin tim], mendova se çfarë mund të më ndodhte. E dija se disa prej tyre ishin ende të lirë, dhe unë kisha frikë se mos bija përsëri në duart e tyre.

Dje fola me këshilltaren time dhe i thashë se kisha filluar të kisha frikë. [Trafikantët] e dijnë që unë jam në [kryeqytet]. Kjo gjë është shkruar në deklaratën time – që unë jam në një strehëz në [kryeqytet]. Unë nuk desha që gjykata ta merrte vesh këtë gjë. Është e vërtetë që inspektorët e policisë më çuan atje, por ata nuk e dijnë më saktësi se ku ndodhem. [Kryeqyteti] është i madh, por sidoqoftë ... Nganjëherë, kur mendoj rreth kësaj dhe ec rrugës, kthej kokën me frikën se mos i kam mbrapa. Nuk jam mirë.

E di se çfarë kërcënimi janë për mua, se çfarë lloj njerëzish janë, dhe prandaj kisha aq frikë.

Kjo më la mua në rrugë për më shumë se dy vjet. Jetova me qira për më shumë se një vit, dhe pastaj shkuam tek nëna e sime shoqeje, por edhe që andej na u desh të lëvizim, sepse trafikantët e gjetën se ku po qendronim. Pra, lëvizëm edhe njëherë tek një kushëri i gruas. Nuk e di se sa gjatë qendruam atej. Mendoj se e vetmja mundësi që na ka mbetur, është të ikim jashtë. Ime motër më tha se ata njerëz kishin kërcënuar se do të më shtypnin me makinë, po të më gjenin.

E shikoni, unë banoj shumë afër me [trafikantët]. Midis nesh është vetëm një fshat, dhe çdo lëvizje që bëhet, merret vesh. Është vështirë, është shumë e vështirë. Sa herë që shkoj në shtëpi, pavarësisht se sa kënaqësi më jep mendimi se po shkoj në shtëpi për pushime, unë ndjej diçka në zemrën time dhe kam frikë të shkojë në shtëpi. Asnjëherë nuk mund ta dish se çfarë të pret. Edhe kur nuk dal në qytet apo në disko, ata përsëri mund të të kapin edhe kur shkon të blesh bukën. Nuk është fare e vështirë, thjesht të fusin në makinë. Ata nuk kanë frikë.

Ai djali është në burg, dhe është dënuar me 15 vjet, vetëm se ai ka apeluar gjyqin ... nuk mund të them se nuk jam e kënaqur, por djali i ka kushërinjtë jashtë dhe unë asnjëherë nuk do të jem 100% e sigurt. Një ditë unë do të dalë nga strehëza, se kështu është, unë do të dalë një ditë. Nuk është se jam e trembur, por e di që nuk do të jem e sigurt atje, jashtë strehëzës.

Shumë viktima ngritën shqetësimin rreth problemeve që mund të hasnin familjet e tyre dhe anëtarët e komunitetit:

Mendoj për nënën dhe motrën time dhe kam frikë se mos u ndodh ndonjë gjë atyre, për shkakun tim. Tamam ashtu siç e kapën dhe ma

rrahën nënën për vdekje, ashtu mund të futen në shtëpi natën, t'i rrahin prapë, dhe asnjëri nuk ka për të marrë vesh gjë.

Një problem që doli nga intervistat ishte, niveli i informacionit që merrnin viktimat rreth sigurisë dhe rreziqeve, që mund t'u kanoseshin në rast se dëshmonin. Një grua, që kishte rënë dakord të jepte dëshminë e saj në gjykatë, ishte krejt e painformuar në lidhje me problemin e sigurisë së saj dhe të rrezikut, me të cilin mund të përballlej: "Po, do të dëshmojë kundër tij me kënaqësi, nuk kam arsye përse të kem frikë. Nuk kam bërë gjë që të trembem. Drejtësia është në anën time". Kjo thuhej pavarësisht nga problemet që kishin patur viktimat e tjera, në po të njëjtin vend, gjatë procedimeve penale kundër trafikantëve të tyre, duke vënë në pikëpyetje nëse ajo kishte qenë plotësisht e informuar mbi rreziqet që mund t'i kanoseshin sigurisë së saj.

Ka rëndësi të theksohet se, jo të gjitha problemet e sigurisë lidhen me ndëshkimin dhe dhunën e trafikantëve. Viktimat mund të jenë të zbuluara ndaj dhunës edhe nga fqinjët, dhe anëtarët e komunitetit pas kthimit të tyre nga prostitucioni i detyruar. Një viktimë tregoi se ishte përdhunuar nga disa burra të komunitetit të saj në një festë fshati, sepse, siç i kishin thënë ata, ajo kishte bërë seks me burrat e botës, e pse të mos bëntë të njëjtën gjë me ta (Brunovskis and Surtees 2007). Një viktimë tjetër, e trafikuar në BE, shpjegoi sesi një shoqe e saj kishte qenë përdhunuar në komunitet, pas kthimit të saj atje: "Një vajzë, që kishte ardhur nga jashtë shtetit më tha se ishte përdhunuar nga fqinjët, të cilët i kishin thënë, 'nëse flen me [të huajt], pse na refuzon neve?'"

Në një numër rastesh, kërcënimet dhe dhuna kundër viktimave ishin shumë reale:

Trafikantja më takoi rrugës tek po shkoja në stacionin e policisë dhe më kërcënoi me një thikë. E dija se nuk bënte shaka, sepse ajo i kishte rënë edhe burrit të saj me thikë. Më kërcënoi se do të më vriste, nëqoftë se unë nuk do ta tërhiqja dëshminë time. Unë informova punonjësën e policisë rreth kërcënimeve, dhe ai më kërkoi të lëshojë një deklaratë mbi kërcënimet e marra dhe kjo gjë do të shënonte fundin e tyre. Më premtuan se do ta mbanin në komisariat për disa ditë, por nuk e bën këtë, sepse nuk kishin prova. Në rast emergjence, u mendua se unë duhet t'i drejtohesha policisë vendore. Kur më vunë një avokat personal, unë i tregova edhe atij për kërcënimet që kisha marrë, por ai nuk ua vuri veshin fjalëve të mia. Ai tha, "Nuk do të të vrasë..., mos ki frikë...harroje". Polici më kërcënoi edhe ai, duke më drejtuar pistoletën e duke më urdhëruar që të tërhiqja dëshminë kundër trafikantes. Unë u ankova

pranë avokatit edhe për këtë kërcënim të policit; ai hodhi ca fjalë në një letër dhe më tha t'ia jepja policit. Kur polici e lexoi shënimin, të ashtuquajturin 'apel' (avokati nuk kishte vënë as firmën poshtë shënimit), ai më qeshi në fytyrë dhe më tha të zhdukesha që andej.

[Trafikanti] tha: "Ti ma fute vëllain tim në burg, por shpejt a vonë, unë do të të vrasë".

[Kur mbërrita në shtëpi], ata po më prisnin. Ishin rreth shtatë [trafikantë]. Po i bërtitnin nënës sime, dhe pastaj m'u kthyen mua. Nuk arrita të them asnjë fjalë. Më kërcënuan se do të më vritnin, në rast se nuk kthehesha me ta. Ata thanë se më kishin blerë dhe se unë duhet t'u ktheja paratë.

Disa viktime përshkruan rastet kur u përballen me probleme të sigurisë, dhe në një rast, me dhunën, si pasojë e përfshirjes së tyre në procedimet ligjore kundër trafikantëve të tyre:

Jo, [gjyqi] nuk zgjidhi asnjë problem. Ata të gjithë janë të lirë. Sapo që të më nxjerrin jashtë [nga strehëza] ata do të më gjejnë dhe do të më vrasin.

Kjo më ve para një rreziku të madh. Unë pata aq shumë probleme kur shkova në gjykatë. Sa herë që shkoja, më duhej të kaloja nëpër disa korridore të fshehta, të shoqerohesha me roje... Ju thashë pra, kishim probleme çdo herë që shkoja atje. Tek hyrja, gruaja e tij më sulmoi. Aty më shpëtoi avokati im. Kisha aq shumë frikë, isha aq e ngatërruar e nuk po merrja vesh se çfarë deshte ajo [në atë vend]. Unë e kisha parë atë vetëm nja dy tri herë dhe u çudita kur e pashë në [qytet]. Ajo më tërhoqi nga krahu, por avokati më mbrojti. Por, përsëri më sulmoi para derës së gjyqtarit. Dhe pastaj më lejuan të hyjë brenda para orarit që më kishin lënë, për të bërë deklaratën ... Eh mirë, dakord, e di se asgjë nuk do të më ndodhë në gjykatë. Por ata më frikësojnë me fjalët që thonë ... ata thonë me njëri-tjetrin: "Shiko sesa mirë po e mbrojnë. Por kjo nuk ka për të zgjatur shumë. Do ta gjejmë e do ta vrasim". E di që ka masa sigurie në gjykatë, por ato fjalë më futin frikën.

[Në shtëpi] kam frikë. Sepse po marr pjesë në një çështje gjyqësore kundër tyre. Prokurori nuk pranoi të hapë dosjen time dhe [trafikantët] kapën nënën, e rrahën për vdekje dhe e kërcënuan... policia nuk bëri gjë.

Problemet e sigurisë shtoheshin nga një mungesë e përgjithshme e mbrojtjes së viktimave, madje edhe gjatë seancave gjyqësore. Disa të intervistuar kishin patur mbrojtje.

Edhe policia nuk na lejoi të hynim në sallën e gjyqit, sepse nuk kishte siguri... ne ecnim gjithmonë nëpër ca kalime të fshehta për në sallën e gjyqit. Na mbanin të fshehur diku. Në fund ne nuk po ia dilnim dot, ata thirrën shefin e inspektoriatit dhe ai na caktoi disa inspektorë policie si shoqerues.

Shumë të tjerë nuk e kishin këtë mbrojtje.³⁸

Kur shkova në polici, e bëra atë gjë vetëm me një kusht. E dija se po të thoja diçka rreth familjes së tij, unë do të rrezikoj që të ndiqesha nga ata. Kështu që i thashë policisë që unë do të jepja deklaratën vetëm nëse ata do të më siguronin mbrojtje. Më thanë se do ta bënin, por pasi lëshova deklaratën nuk bën gjë fare. U thashë se po ndiqesha nga trafikantët dhe ata m'u përgjigjën që t'u drejtohesha atyre nëse ndodhte ndonjë gjë. Dhe unë i pyeta, si mund të mendohet se mund të vijë në polici, po të më kenë shtypur me makinë? Më thirrën prapë në polici, por unë nuk shkova më. Nuk kishte asnjë kuptim që të shkoja atje. Unë nuk duhet të kisha shkuar fare në polici e t'u tregoja rastin tim.

Të paktën të marrin masa e të sigurojnë që mbrojtja e ofruar nga policia të jetë reale, sepse, për shembull, motra ime merrte telefonata nga trafikantët, të cilët i thonin se unë ua kisha shkatërruar biznesin e tyre prej qindra milionësh, dhe se kjo gjë është një diçka që nuk mund të falet.

Në një rast, rreziqet për sigurinë erdhën si rezultat i dhunimit nga ana e zbatuesve të ligjit të anonimatit të viktimës, dhe i dhënies së informacionit mbi rastin në fjalë në media:

[Punonjësi i policisë] dha një deklaratë për shtyp. Dha emrin tim të plotë ... Të gjitha gazetat u mbushën me lajmin. "Një vajzë u shpëtua nga

³⁸ Nga 364 viktima të trafikuar, të përfaqësuara nga Qendra për Parandalimin e Trafikimit të Grave (CPTW) në Moldavi, vetëm 3 nga to ishin nën masat e sigurisë shtetërore gjatë procesit të hetimit kriminal dhe para trupit gjykues, dhe viktimat shpesh detyroheshin të binin në kontakt me trafikantët e tyre gjatë procedimeve gjyqësore (CPTW 2006: 14-5). Aktorë të tjerë të anti-trafikimit u shprehën, gjithashtu, mbi mungesën e përgjithshme të mbrojtjes së viktimave/dëshmitareve në pjesën më të madhe të vendeve, megjithëse disa viktima kishin mbrojtje që sigurohej sipas rastit, dhe që vinte më shumë si rezultat i përpjekjeve vetjake të disa policëve seriozë, të profesionistëve ligjorë dhe gjyqësorë.

grupi kriminal ... emri i vajzes është ... banore në ... kaq vjeç ... e martuar ... ka një djalë ... me emrin ...” Unë u trondita. Nuk mund të vazhdoja më si më parë... më vinin në shtëpi, më ngacmonin dhe më kërcënonin. Ndodhën shumë gjëra. Ata u mbajtën nën kujdestari vetëm 48 ore dhe u lanë të lirë. Nuk kishte prova.

Në mungesë të shqyrtimeve të rreziqeve për individin dhe për situata të tjera të mundshme, është e vështirë të bësh një vlerësim se deri ku shtrihen rrethanat, që përbëjnë rrezik për viktimat. Për më tej, janë bërë shumë pak kërkime mbi rreziqet reale për viktimat dhe mbi rastet e ndëshkimit dhe të dhunës kundër viktimave, si mbi ata që ndërmerren veprime kundër trafikantëve të tyre, ashtu dhe mbi ata që nuk ndërmerren veprime të tilla. Ajo që del e qartë është se, shumë viktima – si jashtë vendit ashtu dhe me kthimin në shtëpi – nuk ndiheshin të sigurt për jetën. Për shumë nga to, kishte probleme shumë reale, që duheshin të merreshin parasysh nga policia dhe nga ofruesit e shërbimeve në faza të ndryshme të jetëve të tyre pas-trafikim. Shqyrtimet e rreziqeve duhen bërë në vijimësi dhe në përgjigje të situatës në ndryshim të viktimës. Rreziqet do të luhaten në varësi të situatës, të kohëve, të vendit dhe angazhimit në procedimet kriminale. Është e rëndësishme që ofruesit e shërbimeve dhe zbatuesit e ligjit të parandalojnë rreziqet e ardhshme të mundshme, ndërkohë që ndërmerren veprime të ndryshme. Ofrimi i lejeve të përkohshme (dhe të përhershme) të qëndrimit është një mjet me anë të të cilit mund të trajtohen rreziqet imediate të sigurisë,³⁹ dhe, në disa vende të SEE-s, viktimave të huaja u janë lëshuar lejet e përkohshme të qëndrimit, ndërkohë që janë marë vendime mbi hapat e mëtejshëm. Në disa raste, kjo ka përfshirë opsionet e qëndrimit afat-gjatë, si dhe mundësinë e programeve të ndihmës sociale.

Trajtimi efektiv i çështjeve të sigurisë dhe të garancisë përbën një pengesë të rëndësishme në rajonin e SEE-s. Autoritetet e zbatimit të ligjit mund të mos kenë burime për të garantuar sigurinë e domosdoshme për të gjitha rastet dhe/ose mund të mos jenë seriozë në këtë drejtim. Mbrojtja e dëshmitarëve është e nevojshme si në vendin e destinacionit, ashtu dhe në atë të origjinës në periudhën gjatë dhe pas gjykimit, megjithëse nevojat për mbrojtje janë më afat-gjata dhe intensive, kur bëhet fjalë për dëshmitar në vendin e lindjes.

³⁹ Mundësitë për TRP janë të disponueshme në shtatë vende të SEE-s dhe legjislacioni i BE-s, Direktiva e Këshillit 2004/81/EC mbi Lejen e Qëndrimit kërkon që vendet e BE të ofrojnë opsionin e qëndrimit për personat e trafikuar.

Për disa viktima, vendimi për të pranuar ndihmën në një program strehimi ishte i lidhur ngushtësisht me kërcënimet që merr ajo/ai dhe familja, ose me shqetësimet më të përgjithshme mbi sigurinë fizike të tyre:

Para se të vija në qendër, [trafikanët] çdo natë rrinin jashtë shtëpisë sonë.

Edhe sikur të kisha thirrur policinë dhe t'u thoja se unë do të isha në shtëpi, çfarë do të arrinte të bënte... unë këtu në fshat dhe ajo atje në qytet?

Po të kisha të holla, sapo të dilja jashtë do të kisha punësuar ndonjë agjent të policisë speciale që të më ruante mua. Sepse, edhe tani që ai djale është në burg, unë nuk do të jem e sigurt, kur të dalë nga qendra.

Ndërkohë që shumë viktima vunë në dukje problemet që lidheshin me sigurinë e tyre, duhet, po ashtu, të nënvizohet se shumë viktima të tjera nuk u përballën me kërcënime apo ndëshkime, dhe ishin kthyer shëndosh e mirë në shtëpi. Në mungesë të shqyrtimeve sistematike të rreziqeve, është e vështirë që të përcaktosh përmasën se deri ku shtrihet ky problem për viktimat. Ajo që del qart në pah është se, nivelet e rrezikut nuk janë të njëjta për të gjitha viktimat, dhe ka shumë raste kur siguria nuk përbën problem. Ndërkohë që shumë aktorë anti-trafiking argumentojnë se është më mirë të gabosh dhe të tregohesh i kujdesshëm me mendimin se po parandalon situata me rrezik të lartë. Kjo nuk vjen pa kosto në kurriz të viktimave. Atje ku nuk janë serioze situatat e sigurisë e të garancisë, një mbitheksim i tyre mund të pengojë rikuperimin dhe stabilitetin e viktimave. Në këtë rast, viktimat pa shqetësime serioze mbi sigurinë, do të shqetësoheshin pa qenë nevoja për sigurinë e tyre, deri në atë masë sa të mos mund të ktheheshin në shtëpi, në jetën e tyre "normale". Është e nevojshme që të drejtpeshohen me kujdes rreziqet e mundshme të sigurisë, duke i kushtuar vëmendje jetës së përditshme të viktimave dhe nevojës së tyre për t'iu kthyer normalitetit.

Modelet, rregullat dhe kufizimet e programeve

Të gjitha programet kanë rregulla dhe rregullore. Ato formulohen për të lehtësuar funksionimin normal të programit, për të menjanuar problemet e sigurisë dhe të garancisë, për të parandaluar konfliktet midis banorëve të strehëzave, për të korigjuar sjelljet problematike dhe për të penguar që viktimat të ndiqen nga trafikantët e tyre. Megjithatë, duket se ka situata ku ekzistojnë rregulla dhe kufizime që mund të mos jenë në përputhje me profilet dhe nevojat e përfitueseve.

Kohët e fundit janë zhvilluar diskutime mbi nevojën e marrjes parasysh dhe të vlerësimit të disa rregullave dhe kufizimeve që ekzistojnë në programet rezidenciale, si për personat e trafikuar, ashtu dhe për viktimat e formave të tjera të dhunës (Brunovskis & Surtees 2007; Brunovskis & Surtees, del në 2008). Dhe në intervistat që u realizuan me viktimat, rregullat e strehëzave dhe kufizimet u përmendën vazhdimisht si një sektor me rëndësi, dhe shpesh, si një sektor problematik. Me rëndësi për këtë studim, ishte mënyra sesi personat e trafikuar i konceptonin dhe i zbatonin këto rregulla dhe kufizime.

Rregullat dhe rregulloret lidheshin me një sërë çështjes, përfshirë oraret dhe afatet, komunikimet dhe kontaktet jashtë programit dhe lirinë e lëvizjes. Informimi i viktimave në lidhje me rregullat ishte, shpesh, diskutimi i parë që bënin viktimat, kur vendosnin të merrnin pjesë në programet me bazë strehëzat:

[Punonjësi social] hyri në strehëz me ne dhe atje ishte ajo gruaja që punonte në strehëz dhe ata folën mbi çfarë bëhej në atë vend, mbi ushqimin dhe gjërat e tjera, që ne duhet të gatuanim dhe të bënim vetë pastrimin. Ata na shpjeguan rregullat e strehëzës ... nuk duhet të përdorni telefonin, nuk duhet të futni pijet alkoolike brenda. Jo, ju nuk duhet të sillni pije këtu, nuk duhet t'i thoni njerëzve se ku është strehëza e kështu me radhë ... Unë e dorëzoja [celularin] tim personelit të atjeshëm.

[Për rregullat] Jo telefonata, jo dalje jashtë, jo pije alkoolike. Ishte për të mirën tonë.

Seksionet e mëposhtme pasqyrojnë reagimin e viktimave ndaj disa rregullave e rregulloreve më të përhapura, duke i kushtuar vëmendje mënyrave sesi përceptoheshin e përjetoreshin ato nga viktimat.

Oraret dhe afatet

Pjesa më e madhë e strehëzave kishin orare fikse – për vaktet e ushqimit, veprimtaritë dhe fjetjen. Logjika pas këtyre orareve ishte, si dhe me shumë rregulla të tjera, mbajtja e një regjimi normal të jetës në strehëz dhe funksionimi normal dhe pa probleme. Megjithatë, për një numër të intervistuarish (pjesa më e madhe të rritur), këto orare ishin kufizuese, dhe sipas mendimit të tyre, shpesh të panevojshme. Shumë viktimat i gjenin rregullat si për fëmijë – u kërkohej që të flinin pasdite, ose u thonin se çfarë duhet të hanin dhe çfarë jo:

Më tha, për shembull, "Këtu ke vetëm mëngjesin, drekën dhe darkën. Duhet të hash, ta mbarosh ushqimin. Më vonë – nuk ka ushqim".

Ishte shumë mirë në strehëz. Por problemi ishte që ne duhej të zgjoheshim rreth orës nëntë deri dhjetë. Pastaj duhet të shkonim të flinim pasdite, nga ora dy deri në orën katër. Pastaj, në darkë duhet të flinim në orën njëmbëdhjetë. Kjo nuk më pëlqente, për shembull. Nuk na linin të shikonim TV gjatë orëve të pushimit. Kjo nuk më pëlqente.

Një numër viktimash folën për oraret e fiksuara, kur duhet të ushqeheshin, dhe e lidhur me këtë, pamundësinë e konsumimit të ushqimeve jashtë orarit:

Një tjetër gjë që më bënte të ndihem keq, ishte se një ditë unë ndihesha e uritur, por e kishim mbaruar drekën. Unë shkova dhe mora pak gjalp, dhe një vajzë që punonte në qendër më tha ta çoja në vend, atje ku e kisha marrë. U krijua një farë tensioni. Në fund, vajza më shpjegoi se unë, fillimisht, duhet të kisha marrë leje.

[mbi përgatitjen e ushqimit]. Pastaj, për shembull, duhej të haje atë që nuk kishe dëshirë të hajë. Kur unë ha atë, më vjen të përzier. Nuk kam ngrënë yndyrë qëkur isha e vogël. Kur shoh ndonjë që ha yndyrën, unë sëmurem.

Nuk na linin të pinim kafe më shumë se dy herë në ditë. Kjo nuk më pëlqente.

Por, kur kishim dëshirë të hanim diçka tjetër dhe jo atë të menysë, punonjësja sociale nuk na linte të merrnim diçka tjetër. Do të hani atë që keni në meny ... Nëse shkonim të merrnim një shishe uji, ajo vinte pas nesh të kontrollonte se çfarë merrnim. Kishte frikë se mos merrnim ndonjë gjë tjetër. Një ditë po numëronte se sa shishe, kavanoza e furnizime të tjera kishin mbetur.

Ne u ankuam edhe për ushqimin. Dëshironim diçka të ëmbël. Na dhanë një kupë të vogël me krem çokollate. Ku mjaftonte ajo për dymbëdhjetë vajza, nuk ishte asgjë... jo, nuk isha e kënaqur me ushqimin.

Por, nëqoftë se ankoheshim, ata thonin: "Ohu, ju kërkoni kafe çdo tridhjetë minuta". Dikush tjetër po ankohej... kemi të drejtë të kërkojmë. Ai ushqim është për ne.

Nga viktimat pranoheshin më mirë, përgjithësisht, programet ku kishte më shumë mëvetësi në lidhje me veprimet ditore bazë – si gatimi, vendimi rreth orarit të gjumit dhe administrimit të kohës së lirë.

Komunikimi dhe kontaktet jashtë programit

Në vendet e origjinës dhe të destinacionit shumë programe kanë kufizime tepër të forta mbi mënyrën e komunikimit dhe të kontakteve me personat jashtë këtyre programeve. Për shembull, në shumë programe konfiskohen telefonat celularë për periudhën e qëndrimit.

Gjëja e parë që më pyeti [në strehëz] ishte nëse kisha celular, sepse e para gjë që më tha ishte se, celularët nuk lejoheshin. Më erdhi si një goditje. Si do bëja pa një telefon?

Thirrjet telefonike ishin të kufizuara dhe shpesh bëheshin në prani të punonjësës sociale.

Mund të merrnim në telefon shtëpinë vetëm tri herë [në dy muaj e gjysmë] që qëndronim atje.

Unë kam vetëm një kundërshtim – nuk mund t'i telefonoja familjes. Vetëm njëherë në muaj. Nuk ishte e mjaftueshme. Të gjitha gjërat e tjera janë mirë. Do të dëshiroja të flitja më tepër me fëmijët dhe familjen. Të gjitha të tjerat janë fare mirë.

Kemi te drejtë të telefonojmë vetëm njëherë në muaj nga strehëza. Familja mund të telefonojë më shpesh, por ne vetëm njëherë në muaj. Djali më tha se nuk kishte të holla për të më marrë në telefon.

[mbi kontaktimin e familjes në vendin e lindjes] Pesëmbëdhjetë ditë para kthimit unë pata mundësinë të merrja shtëpinë në telefon dhe ta njoftoja babanë se po shkoja në shtëpi.

Shpesh, kjo praktikë shpjegohej me idenë se viktimat duhet të shkëputen nga trafikantët e tyre dhe se siguria e strehëzës mund të dhunohej nëpërmjet telefonatave.⁴⁰ Megjithatë, ndërkohë që këto mund të ishin shqetësime gjatë fazës fillestare të pas-trafikimit, duket se këto rregulla nuk përshtateshin me kohë dhe në përgjigje të nevojave specifike të viktimave individuale. Gjithsesi, kishte një rast kur një viktimë kishte përfituar nga rregullore të shkallëzuara,

⁴⁰ Një viktimë e huaj vuri në dukje një paradoks, kur telefonatat e saj kontrolloheshin nga punonjësit socialë të strehëzës, të cilët nuk e njihnin gjuhën e saj:

Po, sigurisht [dikush është gjithmonë i pranishëm]... Ata duhet ta dijnë se kë ke ndërmend të marrësh në telefon ... nuk më pëlqente [ky veprim], por kur flas në gjuhën time, ata nuk marrin vesh gjë.

që do të thotë, për shembull, nga përdorimi më i shpeshtë i telefonit me kalimin e kohës. Kjo metodë, e cila i ishte përgjigjur objektivit të ri-integrimit, u vlerësua në mënyrë pozitive nga personi i trafikuar: “Po, tani më lejohet të përdorë [celularin]. Për nja një muaj [nuk m’u lejua]... një muaj, ndoshta edhe më pak”.

Kontakti me anëtarët e familjes, gjithashtu, monitorohet mjaft rreptësisht në disa programe, dhe takimet me anëtarët e familjes bëheshin shpesh në prani të personelit të strehimit, madje edhe në prani të autoriteteve të zbatimit të ligjit. Në disa raste, kjo realizohej me kërkesën e përfitueses, dhe në raste të tjera, ishte kërkesë e marrëveshjes për sigurinë. Megjithatë, kjo nuk është përherë e domosdoshme dhe as nuk kërkohet gjithmonë nga përfitueset, dhe këtu mund të lindë pyetja deri në ç’masë mund të realizohet ri-integrimi në kushtet e këtyre kontrolleve kaq të rrepta. Viktimat theksuan rëndësinë e kontaktit me familjet e tyre gjatë procesit të rikuperimit:

Nuk mund të qendroja më atje brenda [në strehëz] dhe desha të shkoj në shtëpi [në qytet]. Desha të rrijë me tezen time dhe të kisha mundësi të takoja babanë dhe vëllezërit e mi më të vegjël, që jetojnë me nënën time. Nuk desha të rrija më gjatë atje.

Për momentin, kam nevojë për kushërinjtë e mi të afërt, për shoqet. Kam një nevojë urgjente të jetoj jashtë këtij vendi, që të ndihem disi ndryshe. Sepse, kur rri gjithë kohës në një vend, gjithë ditën jashtë, fillon të mendosh lloj lloj gjërash. Mërzitem shumë.

Duhet kushtuar vëmendje ndikimit të mundshëm stabilizues dhe qetësues mbi viktimat të kontaktit me familjen e tyre, qoftë fizikisht, qoftë edhe nëpërmjet telefonit. Meriton që të ndalohet mbi një fakt që, disa viktima janë larguar nga programi, ose kanë refuzuar ndihmën për shkak të kufizimeve të kontaktit me familjen dhe miqtë (Brunovskis & Surtees 2007).

Liria e lëvizjes

Në shumë vende, viktimat vendosen në strehime të mbyllura, sipas një logjike që është, përgjithësisht, e ligjshme (viktimat e huaja në vendet e destinacionit nuk kanë dokumente të rregullta për të lëvizur lirisht nëpër atë vend),⁴¹ dhe për shkak të problemeve të sigurisë (rreziku i ndëshkimit nga trafikanti).

⁴¹ Kjo logjikë e ligjshme mori formë më të buta me mundësitë e lejeve të përkohshme të qëndrimit, që janë tani të disponueshme në shtatë vendet e SEE-s, si edhe në një numër vendesh të BE-s.

Megjithatë, në shumë raste, përdoren këto kufizime edhe kur çështje të tilla nuk përbëjnë problem. Siç shpjegoi një viktimë, “Nuk kam ankesa të mëdha, përveçse nuk më lejojnë të dalë jashtë. Nuk ka arsye përse duhet të mbahem e mbyllur. Nuk kam probleme dhe as ndonjë rrezik. Unë nuk jam denoncuar për ndonjë veprim. Kam kërkuar të punojë në një moshë shumë të vogël, sepse mërzitesha të rrija brenda”. Pjesa më e madhe e programeve në SEE përdorin një variacion në modelin e metodës së mbyllur, edhe kur këto programe janë të orientuara drejt ri-integrimit. Kjo vazhdon njëkohësisht me zbatimin e programeve , të cilat përdorin modele më të hapura të kujdesit rezidencial.

Intervistat me viktimat e ndihmuara si në vendet e destinacionit, ashtu dhe në ato të origjinës, zbuluan se të mësuarit me jetën në strehëzat e mbyllura ishte një nga problemet më shumë të cituara nga to, megjithëse niveli i stresit që shkaktonte ky lloj administrimi, ndryshonte nga viktimat në viktimë.⁴²

Desha të largohesha nga ajo shtëpi, edhe sikur të rrija rrugëve. Sepse ishte një lloj sikur të ishe në brug. Nëpër dritare kanë vënë hekura. Nuk të lejnë të dalësh në ballkon ... tamam si në burg. Hekura gjithandej. Rri si në burg.

Unë isha e mërzitur, dhe ju e dini se ç’do të thotë të rrih në një vend të mbyllur. Nuk dija se çfarë të bëja gjithë ditën. Por, u mësova me rregullat.

Për shembull, kishte disa rregulla për lëvizjet jashtë. Nuk mund të dilnim jashtë qendrës dhe ato nuk na linin, vetëm në rast se shkonim në një qendër profesionale. Më dukej vetja sikur isha në stacion policie, si e burgosur.

Na mbanin në atë vend. Megjithëse ishte një vend i rehatshëm, më dukej vetja si një zog në një kafaz të artë ... unë e kisha kuptuar se kisha thyer regjimin ligjor të vizave, nuk kisha pasaportë ... e kisha kuptuar se duhet të respektoja të gjitha rregullat ... sepse kisha hyrë në mënyrë të paligjshme.

⁴² Kjo është vënë re edhe në rajone të tjera, si në Azi, ku personat e trafikuar trajtuan problemin e kufizimeve që përdoren në modelet e kujdesit për ta: “Pasi na shpëtonin, na mbanin në një strehëz për shtatë muaj. Duhej të bënim kontrollë mjeksore, dhe mjekët nuk ishin fare bashkëpunues me ne. Kemi bërë një lloj jete me shumë regjim në strehëz. Disa vajza, gjatë qëndrimit atje, kërkuan madje nga organizata përgjegjëse që t’i çonin mbrapsht në bordello, ose në shtëpitë e tyre” (ILO 2006: 8)

Nuk dukej keq. Pata probleme në fillim me rregullat, që nuk mund të dilja vetëm, siç bëja [jashtë vendit]. Por shpejt u mësova, u përshtata me to.

Nuk mund të dilnim jashtë qendrës ... Kjo është shumë e rëndë nga ana psikologjike ... Një vajzë u çmend praktikisht para syve të mi.

Mendoj se gjëja e parë është liria ... Për dy muaj e dy javë unë isha e mbyllur brenda katër mureve. I bija radiatorit me kokë, dhe i gjuaja murit me grushtat e mi të zhveshur. Thjesht po luaja mendsh. Kur fola me drejtoreshën dhe ajo më tha se duhej të rrija edhe për një dy tri muaj më shumë, e humba krejtësisht. Protestova.

Nuk të linin të dilje jashtë oborrit, po të mos ishe e shoqeruar nga ato. Tamam si në burg. Kështu që ne rrinim ulur gjithë ditën, hanim, shikonim televizor.

Një vajzë, – 16 vjeç kur ishte në programin e ndihmës – shpjegoi sesi për të vizita te mjeku ishte bërë shumë e rëndësishme, sepse e mundësonte të dilte jashtë strehëzës:

Eh, kur duhet të shkoja te doktori isha e lumtur, se do të dilja në ajër të pastër. Mezi e prisja atë ditë. Shkonim me taksì dhe ktheheshim me taksì ... Ishte mirë kur shkoje te doktori. Isha aq e kënaqur që do të dilja jashtë.

Për disa të intervistuar, modeli i mbyllur ndikonte mbi vendimin e tyre nëse do të pranonin ndihmën ose jo:

Ishte si një apartament. Ndoshta gjëja negative ishte se nuk të lejonin të shkoje gjëkund ... Do të ishte mirë që të dilje për pak kohë, të paktën, por që të mbyllesh brenda për dy muaj e gjysmë, është një çmenduri. Unë mund të mos kisha rënë dakord që të vija [po ta dija se kishe liri të kufizuar]. Ndoshta..., nuk jam e sigurt.

Po. Unë thashë: "Nuk do të shkojë tek ai strehim, nuk mund të rri në një vend të mbyllur. Mjaft kam ndenjur në vende të mbyllura. Mjaft më me keqtrajtme". Ata më thanë: "Nuk është keqtrajtim, do ta kalosh mirë kohën në strehëz, do të rrih sa kohë të duash ti, pastaj do të të transferojnë, ata do të vendosin se ku duhet të shkosh". [Unë thashë] "Nuk dua të shkojë atje".

Këto vëzhgime përputhen me kërkimet e tjera studimore, të cilat gjetën se kufizimet në programet e ndihmës, si liria e pakët e lëvizjes, disa herë shkaktonte jo vetëm probleme në vetë programin, por edhe në refuzimin e viktimës për të marrë ndihmën e ofruar (Brunovskis & Surtees 2007). Edhe studimet e tjera kanë vënë në pikëpyetje përdorimin e modeleve të mbyllura për të gjitha rastet, veçanërisht në rastet kur rreziqet nuk ishin të larta dhe ku nevojiteshin shërbimet e ri-integrimit (Brunovskis & Surtees 2008; Reiter 2005: 17; Rosenberg 2006). Përveç kesaj, është me vlerë të vihet në dukje se studimi *'Parimet dhe udhëzimet e rekomanduara mbi të drejtat e njeriut dhe trafikimin njerëzor'* (*Recommended Principles and Guidelines on Human Rights and Human Trafficking*) ve qartësisht në dukje nevojën e mbrojtjes të së drejtës së viktimës për lirinë e lëvizjes, dhe të ndërmarjes së masave anti-trafikim, që nuk bien ndesh me këto të drejta (UNOHCHR 2002).

Në disa vende, ekzistojnë opsione të qëndrimit që janë më pak kufizuese, duke lejuar më shumë liri për përfituesit. Disa programe përdorin një model të shkallëzuar strehimi, nëpërmjet të cilit trajtohen fazat e ndryshme të jetës pas-trafikim për viktimat – një strehim për raste emergjencash, për një qëndrim të shkurtër dhe ndërhyrje emergjente, strehëza për kujdesin parësor, me qëndrim prej dy deri tre muajsh dhe shtëpi më vete për viktimat që marrin pjesë në procesin e ri-integrimit (Kvinnoforum 2003: 11). Një shtetase e SEE-s, e trafikuar në BE, ishte fillimisht në rrezik dhe për rrjedhojë, e kishte të ndaluar të lëvizte lirshëm, por ky kufizim u hoq pak nga pak me kalimin e kohës. Ajo shpjegoi sesi e kalonte kohën atje:

Koha kalonte shpejt. Bëja pak sport, ushtrime, ata organizonin programe të llojeve të ndryshme. Mund të bënim ndonjë shëtitje jashtë. Ne duhet të njoftonim se ku do të shkonim dhe sa do të vonoheshim. Nëse kishim dëshirë të shkonim në park, ne njoftonim se do të shkonim në park. Për një kohë mjaft të gjatë, nuk na linin, sepse nuk ishte e sigurt për ne. Trafikantët jetojnë në [atë vend], kështu që ishte më mirë të mos na gjenin. Prandaj dhe ne njoftonim personelin e strehimit se, ku do të shkonim dhe çfarë do të bënim. E vërteta është që ata e dinin se çfarë bënim dhe ku shkonim.

Një numër viktimash jashtë vendit, të cilat u ndihmuan nëpërmjet programeve, kishin më shumë liri se sa në vendet e tyre të origjinës, ku objektivi i ndihmës ishte ri-integrimi dhe tranzicioni drejt një jete të pavarur. Është e rëndësishme që të vihet re marrëdhënia e zhdrejtë midis këtyre objektivave

dhe modelit të mbyllur të ndihmës. Një viktimë foli për kohën që kalonte, kur ndihmën e merrte jashtë vendit:

Rregullat nuk ishin aq të rrepta. Mund të dilnim jashtë dy herë në javë. Për shembull, unë dilja jashtë dy ditë gjatë fundjavës me miqtë e mi të qendrës. Na jepnin para që të dilnim. Vetëm se na kërkonin të dinin se ku shkonim, në cilin vend dhe se me çfarë do të udhëtonim, me autobus apo tren, dhe se duhet të ktheheshim në kohën e caktuar. Kjo varej se kur dilnim. Në rast se kishim ndonjë problem, ose nuk mund të ktheheshim, gjithmonë do të vintë dikush që të na merrte me makinë.

Përcaktimi i modeleve të ndryshme strehimesh (të mbyllura, të hapura, ose kushte specifike) duhet, sigurisht, të bazohet mbi shqyrtimet e rrezikut për viktimat individuale të trafikimit, si dhe mbi kuadrin ligjor specifik. Megjithatë, ato duhet të bazohen edhe mbi objektivin tërësor të programit, nëse është program emergjence, ndërhyrjeje në rast krize apo ri-integrimi më afat-gjatë.

Përdorimi i masave dhe dënimeve

Një numër programesh merrnin masa dhe jepnin dënime në rastet, kur rregullat nuk respektoheshin. Këto sanksione ndryshonin nga programi në program, siç ndryshonin shkeljet për të cilat mund të dënoheshin përfituesit:

Po, kishte marrje masash. Në rast se bëjë ndonjë gabim, ju duhet të rrrinit gjithë ditën mbyllur në dhomë ... Për shembull, nëqoftë se e bën keq një gjë, ose grindesh me vajzat e tjera. Unë u zura njëherë me një vajzë.

Po, për shembull, nëqoftë se thyen diçka, ose refuzon të bësh një punë në strehëz, atëherë do të shkosh të rrish në dhomën tënde.

Të gjitha ne jemi ndëshkuar me masa. Mbylleshim në dhomë, ose na ndalonin të dilnim jashtë.

Në rast se ktheheshim vonë, nuk do të kishim më leje... Përderisa të ndryshonin mendjen e tyre.

E parë nga këndvështimi i disa viktimave, masat ishin një përbërës thelbësor për mirë-funksionimin e një strehëze. Në të njëjtën kohë, jo të gjitha rregulloret përceptoheshin si njëloj të rëndësishme, dhe shumë viktimat përmendnin rastet kur ato ishin dënuar, sipas tyre, për shkelje të vogla dhe të parëndësishme:

Ato më kapën një ditë duke parë jashtë dritares, dhe më paralajmëruan që të mos e bëja më. Ishte shumë e çuditshme që të përjaljmëroheshe

për një gjë kaq të kotë. Por, tani jam qetësuar. Por, prapë nuk është e drejtë. Ajo s'është gjë tjetër veç një dritare dhe ti thjesht po shikoje jashtë. Edhe kur i lëmë dritaret hapur, ato mendojnë se ne po shikojmë jashtë. Por kjo nuk do të thotë që nëse e le dritaren hapur, unë rri e shikoj gjithë ditën jashtë.

Për shembull, nëse dëshiroje të dilje jashtë, duhet të regjistrohesh në një regjistër dhe të shënoje orën e kthimit. Edhe po të vonohesh me disa minuta, për shkak të trafikut, ata të dënonin.

Në rastet e tjera, dënimi përceptohej si i rëndë dhe shkaktonte probleme tek përfituesit:

Edhe nëse do të duhej të zihesh me dikë se të ngacmojnë. Unë zihesha me ta dhe pastaj më dënonin me 200 ulje e ngritje. E kështu fitova krizën e apendisitit.

Rregullat janë: ngrihu në mëngjes, rregullo krevatin, fshij e pastro dhomën, bëj ushtrimet e mëngjesit. Nëse nuk i bën të gjitha këto, atëherë të dënojnë... të detyrojnë të bësh diçka më të rëndë se rregullimi i dhomës, apo ushtrimet e mëngjesit; ose të mbajnë rrogën javore.

Negociimi i rregullave dhe i rregulloreve

Përfitueset kundërshtonin rregullat të cilat, sipas tyre, nuk kishin asnjë kuptim, ose që për to, ishin tepër kufizuese. Për shembull, një viktimë, e cila nuk kishte ndonjë rrezik specifik, sipas policisë, e kishte të ndaluar, sipas rregullave, që të kalonte pak kohë me t'ëmën, e cila banonte në të njëjtin qytet, ku ishte e vendosur dhe strehëza. Madje edhe kontakti telefonik ishte i kufizuar, dhe ajo mund ta merrte t'ëmën në telefon vetëm një herë në javë. Meqenëse ri-integrimi ishte synimi i atij programi, mos lidhja me familjen e saj nuk ishte produktive.

Unë mund të shkoja tek nëna ime, por duhet të kthehesha në orën dhjetë, në darkë. Më linin të shkoja. Pastaj kthehesha në dhjetë të darkës. Por ai orar më bezdiste, pse në dhjetë? Përse nuk mund të rrija të flija tek nëna ime?... Isha e pakënaqur, sepse nuk dilja dot, nuk mund ta merrja nënën time në telefon kur të desha, dhe sepse më duhej të shkoja në shtrat në orën njëmbëdhjetë. Këtu nuk jemi në ushtri.

Po në të njëjtën mënyrë, një tjetër viktimë shpjegoi sesi kufizimet ndikonin mbi përpjekjet e saj për të ndërtuar marrëdhënie me njerëzit dhe kufizonin pavarësinë e saj, të dyja këto pjesë të rëndësishme të procesit të rikuperimit.

Do të ishte normale që në rast se takoja dikë, t'i thoja se jetoja në një strehëz. Dhe unë do të vija këtu e do të tregoja se kisha njohur një djalë dhe se dua të dalë me të. Dhe kështu, unë e takova atë djalin në një video-klub, takohemi me njëri-tjetrin për gati dy vjet, dhe ai më fton të dalim, por unë nuk mund të shkojë, sepse më duhet të jem këtu në orën dhjetë. Çfarë mund t'i them unë atij, çfarë arsye t'i japë që nuk dal dot, apo përse nuk kam një telefon? Po ua mohojnë njerëzve të gjitha këto gjëra. Ndoshta do të doja të dehesha një natë. Nganjëherë kam nevojë ... Përse duhet të të kontrollojnë dhe të të thonë se nuk mund të veprosh kështu e ashtu. Dilja në [qytetin e afërt], pija dhe pastaj vija në strehim dhe ...Unë as që mbaj mend se çfarë gënjeshtresh thoja.

Është e rëndësishme që të kesh rregullore për mbajtjen e rregullit dhe për shmangien e tensionit dhe të konfliktit. Dhe shumë nga përfitueset e shërbimeve në strehim diskutuan se sa të rëndësishme ishin rregullat për to, duke qenë rezidente në program. Një rezidente shpjegoi se sa e pakënaqur ishte, kur disa nga rezidentet e tjera thyenin rregullat e strehimit; “[Punonjësit socialë] u përpoqën të flasin me to, t’u shpjegojnë e t’u mësojnë gjërat e duhura, por ato vajza thjesht nuk deshën të respektonin rregullat. Për shkak të njërës, vuanim të gjitha ne, dhe mua nuk më pëlqen kjo. Po të ishte puna për të krijuar sherre, do të kisha qendruar fare mirë në shtëpi. Isha e lodhur nga sherret, çdo ditë kisha nga një dhe erdha këtu për të qenë në paqe dhe për të parë punën time”. Në rastet e tjera, të intervistuarit shpjeguan sesi rregullat e programit u jepnin atyre një ndenjë sigurie dhe nuk ishin të tepëruara:

Jo alkool, jo drogë ... nuk duhej të zbulojë gjërat. Nuk mund t'i jepje numrin asnjëriut. Ne kemi një numër fiks, por mund të marrim në telefon vetëm nëse numri nuk të identifikohet. Duhet të dinin se kë do të telefononim, merrnim vetëm me fiksin, numri zero ishte i bllokuar.

Gjëja e parë, nuk mund të ushtrosh [prostitucionin], por ju besohej gjithçka. I vetmi rregull ishte që nuk mund të përfshiheshe në prostitucion. Mund të fillosh shkollë, ose të gjesh një punë, apo ndonjë gjë tjetër.

Megjithatë, për shumë viktime – pjesa më e madhe nga të cilat janë vajza të rritura – disa rregulla dhe rregullore ishin problematike, madje dhe dekurajuese.⁴³

Në tërësi, ishte e rëndësishme për përfitueset që rregullat të mos ishin të tepëruara ose të pa-arsyeshme. Disa persona të trafikuar treguan se për to rregullat e programit ishin të pranueshme, kur ishin në përputhje me rregullat që, përgjithësisht, gjithsecili do t'i kishte po të jetonte në shtëpinë e vet:

Po, gjërat tipike... Rregullat ishin të njëjta – jo alkool, jo drogë, nuk duhej të zbuloje adresën, nuk duhet të dilje shpesh, dhe kur do të dilnim, duhet të njoftonim. Në fillim supozohej që të raportonim gjatë gjithë kohës, gjatë një një muaji e gjysmë dalja ishte vetëm deri në 11 të darkës, por pastaj mund të dilnim më shpesh...kishte disa rregulla bazë, kryesisht kishin të bënin me ato veprime që nuk duhej të bënim, që nuk do t'i bënim as në shtëpi. Nuk ishte dhe aq e rëndë. Kryesisht, kufizime të arsyeshme, jo si ato nëpër strehimet e tjera, ku e tepërojnë.

Rregullat ishin mirë. Jo alkool në apartament. Na folën për rregullat para se të vendoseshim atje. Duhet të ktheheshim në orën njëmbëdhjetë të darkës. "Nëse ke detyra për të bërë në mëngjes, ato duhet të bëhen, nuk ka rëndësi nëse je vonuar apo jo një natë më parë, detyrat duhen kryer të gjitha.". Këto rregulla ishin për të mirën tonë. Ishte shumë mirë. Merrnim të holla. [Detyrimet tona ishin] shkolla, puna. Nuk i kryen tri herë, del jashtë. Po, punonin me ne. Kishim krijuar besim. Për ta nuk ishte e rëndësishme nëse vinim në shtëpi në orarin e caktuar, ata thjesht deshën të shikonin që ne i respektonim rregullat.

Ishte paradoksale të konstatohej se jo gjithmonë rregullat zbatoheshin njëlloj nga punonjëset e ndryshme të programit, gjë që mund të interpretohet që ato rregulla anashkaloheshin pasi konsideroheshin si të rënda, ose dhe të panevojshme:

⁴³ Po kështu, Bjerkan & Dyrlið (2006) vunë në dukje që disa viktime mendonin se rregullat dhe rregulloret ishin kufizuese:

Vesna na tha se e kishte përjetuar si një kohë të vështirë qëndrimin në strehën e rehabilitimit. Ajo kishte një ndjenjë se personeli kërkonte ta kontrollonte atë. Ajo kish arritur të mësonte se shumë gra, që kishin qëndruar në të njëjtën strehëz, kishin përfunduar edhe njëherë jashtë vendit dhe ajo mendonte se kontrolli i ushtruar nga personeli, ishte një përpjekje për të parandaluar që këto ngjarje t'i ndodhnin asaj dhe vajzave të tjera që banonin atje.

Ne u shoqeruar për dy muaj, dhe pastaj na lanë të iknim. Polici që na ruante, tha vetëm fjalën “besim”. Ne iknim dhe ktheheshim, nga ora dy deri në orën pesë të pasdites.

Na i morën telefonat celularë. Mirë, le t’i marrin. Më pëlqenin [dy punonjëse sociale] dhe [psikologja]. Unë shkoja te zyra dhe ne dëgjnim muzikë nga kompjuteri. Na linin të kontrollojmë celularët se mos na kishte ardhur ndonjë mesazh, ose telefonatë. Mund të dërgojmë ndonjë mesazh, dhe pastaj i mbyllim celularët.

Disa viktime, që kishin përvojë me modele të ndryshme strehimesh, si në vendin e tyre, ashtu dhe jashtë, përshkruan dallimet midis kufizimeve që përdoren në programet e ndryshme të ndihmës. Një grua tregoi se sa shumë rregulla kishte në një program dhe sa kufizuese ishin ato:

Jo, telefonat nuk na u lejuan në fillim. Mund t’i hapim celularët njëherë në javë, të kontrollojmë mesazhet, në prani të ndonjë personi që punonte atje. Nuk na lejonin që t’u përgjigjeshim mesazheve. Mund t’i telefonoja nënës sime, ose ndonjërit prej prindërve të mi njëherë, ose dy, tre herë në muaj ... më vonë të lejonin të merrje në telefon ndonjë shoqe, pastaj ndonjë shok, dhe kaq. Dhe nganjëherë punonjëset merrnin telefonatat që vinin në emrin tonë.

Ajo e krahasoi këtë përvojë me përvojën tjetër të saj, të përjetuar në një program të konceptuar në një mënyrë më të hapur:

Kur erdha tek [ky program], gjithçka bazohej mbi besimin. Na lejonin të bënim telefonata, kishim një linjë fikse, kishim celularët, i kishim të gjitha dhe ata na besonin. Na jepnin gjithçka, por na e jepnin në një mënyrë që prisnin të shikonin nëse do ta tradhëtonim besimin e tyre. Kështu, në fillim kryesisht punohej për të parë se çfarë mund të ndodhë dhe si mund të ndodhë. Ne i shpërblenim ato për të gjitha gjërat që na lejonin, sepse më parë, merreni me mend, unë nuk kisha asgjë.

Një tjetër e intervistuar, po ashtu, e krahasoi përvojën e saj në një strehim të mbyllur, ku u vendos ajo menjëherë pas trafikimit, me një program të hapur ndihme:

Mund të dilnim jashtë e të qendronim sa të donim, kishim të dashur. Por nuk na lejohej të zbulonim se ku banonim, ose të sillnim shokun

me vete...por ishte vërtet shumë mirë, këndshëm dhe qetësuese. Krejt ndryshe nga [vendi] që ishte i mbyllur. Ishte një tmerr, një burg i vërtetë. Ishte si një shtëpi, ku ndiheshe keq fare.

Ekzistojnë dallime të nevojshme midis rregullave që zbatohen dhe që, normalisht, bazohen mbi situatën e sigurisë së përfitueseve individuale dhe mbi objektivin e programit. Dhe ka, sigurisht, situata kur është i domosdoshëm një model i mbyllur dhe kufizimet e tjera. Megjithatë, nga intervistat u bë e qartë që kufizimet zbatoheshin për të gjithë përfituesit njëloj, pa i kushtuar vëmendje mbrojtjes dhe nevojave individuale. Procesi kërkimor nxorri në pah të dhëna mbi modelet e ndryshme, të cilat, mund të merren si praktika të mira. Në disa programe ndihma është me shumë faza, fillimisht faza me masa sigurie të forta, që mundësojnë dekomprimimin (çlirimin nga përvoja e kaluar) dhe me kohë të nevojshme që viktima të ndahet psikologjikisht nga trafikanti. Në një fazë më të vonshme – normalisht pas një periudhe prej disa javësh, ose ndoshta një muaji – hiqen disa kufizime, që lejojnë një periudhë më të normalizuar rikuperimi.

Një e intervistuar shpjegoi sesi u përshtaten rregullat e programit me kalimin e kohës, por edhe duke diskutuar me përfitueset e duke i bazuar mbi nevojat dhe situatën e tyre. Në një rast, disa përfituese kishin thyer rregullat e programit – ishin vonuar dhe kishin pirë:

Personeli kuptoi se ... Kështu që ata thirrën një mbledhje, dhe unë po mendoja se ato do të më nxirrnin jashtë nga strehëza se isha kthyer vonë. Por, në vend të kësaj, ato na ulën dhe ne filluam të diskutojmë si njerëz normalë, folëm për nevojat dhe dëshirat e secilës, dhe se sa do të mund të plotësoheshin. Unë i pyeta, përse nuk kisha mundësi të dalë, përse nuk më linin ta kaloja fundjavën në shtëpi, përse të gjithë njerëzit nga [kryeqyteti] e kishin atë mundësi ... Kështu që, ne që në fillim u morëm vesh: mund të shkoja në shtëpi e të kaloja një natë atje. Pastaj [punonjësja sociale] erdhi ditën tjetër dhe tha se kishin vendosur që ne mund të dilnim kur të dëshironim, "Nëqoftë se doni të rrini natën deri në katër të mëngjesit, dakord". I vetmi kusht ishte që gjithsecila të përmbushte detyrimet e veta, domethënë, nuk mund të bëhesh vonë për punë, për shkollë. Filluam të funksionojmë me të vërtetë mirë. Qe një arritje. Është e rëndësishme, kur nuk të kontrollon asnjëri ... të kesh atë liri është me të vërtetë ... pavarësisht se çfarë ka ndodhur në të kaluarën, ti, në fund të fundit, je njeri. Ke patur probleme, ndoshta me veten tënde, por unë kisha nevojë pikërisht për këtë, që të isha e zonja

të dalë vetë nga situata, dhe të mund të shoqerohem, dhe të mos më bëhet jeta ime vetëm strehim.

Siç u vu në dukje nga shërbimet e strehimeve për viktimat e dhunës, nuk ekziston një model, 'një masë unike për të gjithë', dhe se kur njerëzve nuk u pëlqen, apo nuk u përshtaten këtyre modeleve, ato mund të lihen prapa. Disa viktimat mund ta ndjejnë se ndikimi i kombinuar i një numri rregullash kufizuese shkaktojnë lidhje mospërputhjeje ose mospërshtatjeje me mjedisin e kontrolluar, si dhe një ndjenjë pafuqije, të njëjtë me atë të përjetuar në situatat shfrytëzuese, nga të cilat janë larguar. Disa gra kanë nevojë për një kontroll të vazhdueshëm, veçanërisht në fazat delikate, ndërsa të tjerat reagojnë më mirë ndaj modelit të grupit, ku ato mund të gjejnë mbështetje nga të tjerat (Fullbright 2004). Marrja parasysh e të gjithë kësaj dinamike është me rëndësi në zhvillimin dhe përshtatjen e mirë të modeleve të kujdesit për viktimat e trafikimit.

Kompleksiteti i procesit të ri-integrimit

Mjedi social dhe ekonomik ku ri-integrohet (apo integrohet) një viktimë, përbëhet nga disa shtresa të ndryshme – familja, komuniteti dhe shoqëria – të gjitha këto përfaqësojnë interesa dhe vlera të ndryshme, të cilat, nga ana e tyre, ushtrojnë ndikimin e tyre mbi procesin e ri-integrimit (Derks 1998: 15). Intervistat me viktimat zbuluan thjesht se sa i ngatërruar mund të jetë ky proces për shumë viktimat, dhe se ri/integrimiti i tyre rrallëherë është i butë dhe linear.

Në pjesën më të madhe të rasteve, viktimat ktheheshin në të njëjtën situatë sociale dhe ekonomike që e kishin lënë më parë, në atë situatë, e cila kish shkaktuar migrimin e tyre fillestar. Dhe, ndërkohë që ndihma mund të ofrojë mbështetje në drejtim të trajtimit të problemeve të tyre të para dhe pas trafikimit, ajo, shpesh, nuk është e mjaftueshme që të trajtojë të gjithë gamën e problemeve me të cilat përballet viktimat. Në thelb, kthimi në shtëpi do të thotë ri-integrimi në një mjedis, i cili, pjesërisht, mund të ketë qenë në të kaluarën jo mbështetës për të, madje dhe aspak i shëndetshëm. Vetë vështirësitë e trafikimit shtojnë një tjetër shtresë mbi ankthin dhe e gjithë kjo ngarkesë e bën akoma më problematike gjendjen e tyre.

Jam rritur në kushte shumë të vështira. Në shtëpinë e babait dhe të nënës nuk kisha kushte minimale të jetesës, nuk kishim ç'të hanim, as ujë të ngrohtë, pa folur për hallet e kujdesit të prindërve; në shtëpi kam parë vetëm grindje dhe rrahje. Nëna ime është arsyeja kryesore përse kam përfunduar kështu.

Ri-integrimi dhe kthimi priten të shënjojnë nga nivele veçanërisht të larta të pasigurisë dhe tensionit, dhe këto ndjenja, shpesh, i kanë rrënjët në frikën e kthimit në shtëpi pa përmbushur qëllimin kryesor përse ikën nga shtëpia. Një nga problemet më të mëdha të ri-integrimit është që viktimave shpesh u mungon baza e ri-integrimit – nuk kanë punë dhe as të holla, e të mbeten, si dhe më pare, në varfëri (Bjerkan & Dyrliid 2006b). Në të njëjtën mënyrë, mjedisi shoqëror – familja dhe/ose komuniteti – mund të ketë elemente që jo vetëm nuk e mbështesin ri-integrimin, por edhe e minojnë atë.

Më në përgjithësi, duhet të shënohet që personat e trafikuar përballen me probleme të strukturës, si papunësia endemike, kostoja e lartë e jetesës, mungesa e ndihmës nga shteti – të cilat nuk mund të vihen në vend me anë të programeve të ndihmës (përgjithësisht mjaft të kufizuara).⁴⁴ Është me vlerë të theksohet se, pavarësisht nga të kënaqurit e shumë viktimave me mbështetjen që marrin, ato theksuan si problem qendror për çdo lloj ri-integrimi, problemin e nevojës që kanë për punë dhe mbështetje ekonomike, që janë kryesisht dhe shkaktarët kryesorë për migrimin e tyre fillestar.

[mbi shërbimet që nevojiten] një punë e paguar mirë ...nuk ka vende pune në fshatin tim ... e vetmja gjë që më shqetëson është fakti që jam pa punë. Do të ndihesha më e sigurt sikur të kurseja ca të holla për të mbështetur familjen time.

Tani jam me familjen time. Për mua dhe për ta ka rëndësi që nuk jam më me njeriun që më dëmtoi aq shumë. E ndihmoj nënën me punët e shtëpisë dhe vij, herëpahere, të takojë vajzat këtu. Megjithatë, nuk jam e kënaqur. Gjendja jonë ekonomike është shumë e rëndë dhe unë kam nevojë të gjejë punë për veten time dhe për familjen.

⁴⁴ Programet ofrojnë trajnim aftësish, dhe disa herë, mundësi për biznese të vogla për personat e trafikuar. Por këto kurse trajnimi mund të mos jenë të mjaftueshme për të formuar aftësitë e duhura për një punë afat-gjatë dhe mund të mos përshtaten me apo të kërkohen nga ekonomia lokale. Po ashtu, viktimat mund të mos jenë në gjendje të pranojnë opsione trajnimi më afat-gjatë, kur kanë një nevojë imediate për të kontribuar në ekonominë e familjes së tyre. Edhe mundësitë e biznesit të vogël, nga ana tjetër, nuk janë provuar gjithmonë si të suksesshme për personat e trafikuar, dhe në disa raste mund të shtojnë nivelin e cënueshmërisë së tyre. Në rastet kur individët futen në borxh për shkak të biznesit të vogël, kjo mund të çojë në një ri-trafikim të tyre me synimin e larjes së borxhit. Po kështu, bizneset e drejtuara nga viktimat që fajësohen nga shoqëria, mund të mos jenë gjithmonë të suksesshme, me anëtarë komuniteti që nuk do të duan të mbështesin biznesin e saj (të viktimës), ose që kanë cmirë për ndihmën që ka marrë (Derks 1998; Somach & Surtees 2005; Surtees 2000).

Bjerkan & Dyrliid (2006b) gjetën që lloji i trenimit i ofruar grave gjatë rehabilitimit të tyre, mund të kontribuojë për procesin e ri-integrimit. Gratë e trafikuar mund të gëzojnë një respekt gjithmonë e më të madh si nga kushërinjtë e tyre, ashtu dhe nga mjediset ku jetojnë, nëqoftë se ato kthehen në shtëpi me burime financiare ose me ndonjë formë burimesh të tjera, si për shembull me aftësi të fituara për gjenerimin e të ardhurave. Në këto raste, gratë mund të binden se përvoja e tyre e trafikimit është kthyer tanimë në diçka pozitive. Megjithatë, edhe ato që patën mundësi të gjejnë punë, kuptuan se rroga ishte e pamjaftueshme për të mbyllur hallet e tyre, ose që kushtet e punës ishin të tilla sa që nuk mundësonin një jetë normale me familjen.

Po, punoja me orare të zgjatura, nga dymbëdhjetë deri në gjashtëmbëdhjetë orë në ditë. Desha të gjeja një punë me orë normale pune, por nuk gjeta dot.

Tani jam mirë, por me ca vështirësi. Rroga nuk është e mjaftueshme. Më thanë të qendroja në qendër, kur kërkova të ikja e të jetoja në apartament, sepse ishte më mirë në qendër. Por, unë nuk desha. Kur ishim në qendër kishim ushqim shumë të mirë, ndërsa tani mezi e sigurojmë atë.

Po të më ndihmojnë me një farë ndihme, me para ose me ushqim. Rroga nuk të mjafton për të blerë ushqime, megjithëse unë jam vetëm, dhe unë nuk paguaj dritat, ujin dhe as qiranë. Por, mezi kaloj muajin. Shkoj në punë në orën gjashtë të mëngjesit dhe kthehem në gjashtë të darkës, dhe ju e dini se sa janë rrogat këtu.

Një çështje që lidhej me këto probleme ishte se jeta jashtë vendit u kishte lënë disa individëve një shije bollëku, që nuk mund ta arrinin në vendin e tyre të origjinës. Si rezultat, megjithëse personat e trafikuar mund të vendosin të kthehen në shtëpi – në vendin, komunitetin apo familjen e tyre – kjo nuk është gjithmonë një zgjedhje e pranueshme apo e dëshirueshme për to:

Desha të qendroja në [vendin e destinacionit], por desha edhe që të kthehem tek fëmija im ... më pëlqente shumë stili i jetës në [vendin e destinacionit], dhe nuk më pëlqente të largohesha prej andej.

Ishte thjesht e vështirë nga pikëpamja psikologjike që të pranoja ndryshimet në stilin e jetesës këtu, në një fshat të zakonshëm, pa kushte minimale jetese, në një kohë kur kujtoja kushtet luksoze të jetesës në

[BE]... Mendoja se në rast se komunikojta me dikë nga [BE-ja], unë sikur isha më afër civilizimit.

Në një numër të konsiderueshëm rastesh, viktimat përballeshin me tërheqje dhe madje me “dështime” të përkohshme në procesin e ndihmës dhe të ri-integrimit. Ri-integrimi nuk është proces linear ose pa ndërlikime, dhe viktimat mund të kenë nevojë të kthehen tek programi në kohë të ndryshme të jetës së tyre pas-trafikim, duke kërkuar ndërhyrje në rast krize, ose trajtimin e problemeve me rrënjë më të thella. Disa viktimat ktheheshin përkohësisht tek programet, pas një periudhe jete të pavarur, pas një konflikti në familje, pas një krize ekonomike ose tensioni në marrëdhëniet vetjake të tyre. Disa viktimat kërkonin ndihmë edhe pas “përfundimit” të programit. Në shumë raste, kjo ndihmë kishte të bënte me ofrimin e një rrjeti sigurie, i cili u mungonte po të ndodheshin në një mjedis më të gjërë shoqëror. Ky opsion, i kthimit të përkohshëm apo i kërimit të mbështetjes, për shumë viktimat ishte jetësor për rikuperimin e vazhdueshëm të tyre.

Kam qendruar në këtë strehëz për gjashtë muaj, por më pas desha të rrija me të dashurin tim. Qendrova me të një vit. Më duhej të jepja një deklaratë të re në polici dhe takova përsëri [drejtoreshën] dhe ajo kuptoi se diçka nuk po shkonte mirë, dhe më tha se nëse dëshiroja të kthehesha në qendër, mund të shkoja. Kjo gjë më la shumë mbresë.

[Punonjësja sociale] më tha se dera është gjithmonë e hapur për mua ... Më thanë se mund të kthehesha kur të doja. E pranova se, nuk desha të kthehesha tek nëna pas asaj që kishte ndodhur [pas një grindjeje].

[I dashuri i nënës sime] është pronar [i një dyqani] dhe ai nuk mund të pranojë marrëdhënien tone [me të dashurin]. Punoja gjithë ditën, sepse vajzat e tjera iknin, nuk mund ta duronin karakterin e saj. Ajo gjithmonë u bërtiste të tjerëve, ankohej gjithë kohës. Ajo na hoqi nga puna [mua dhe të dashurin tim]. Bashkëjetonim në atë kohë. Por ne grindeshim se ai ishte shumë xheloz. Kështu që ika nga apartamenti dhe u ktheva në strehëz.

Në raste të tjera, problemet që hasnin jo gjithmonë i kthenin viktimat në programet e ndihmës. Më së shumti, viktimat treguan mbi kthimin e tyre tek veprimtaritë që kishin bërë kur ishin të trafikuar – më së shumti në prostitucion – si një “zgjidhje” për problemet që hasnin gjatë ri-integrimit të tyre:

Kishte shumë raste kur desha të lija gjithçka dhe të kthehesha në rrugë, ku do të përpiqesha të bëja ca para për vete. Kaloja këto lloj çastesh, e ndjeja që jeta nuk është dhe aq e lehtë. Atë gjënë e rrugëve e kisha në gjak. Isha mësuar tashmë me të.

Kur isha në shtëpinë e prindërve, nuk kishim ushqim të mjaftueshëm dhe unë shikoja rrugën dhe mendoja zgjedhjet që kisha. Dhe rruga më dukej si një vend ku mund të bëja para.

Nga intervistat doli e qartë se personat e trafikuar hasnin shumë pengesa të papritura – sociale, ekonomike dhe vetjake. Dhe për shkak të cënueshmërisë së tyre – për shkak të trafikimit, por edhe për shkak të gjendjes së tyre para trafikimit – këto kriza të vogla mund të jenë të mjaftueshme që të ndërrohet drejtimi i rikuperimit dhe i ri-integrimit të tyre. Duke qenë të tilla, elasticiteti i programeve – mundësia për kthim, gatishmëria për ofrimin e mbështetjes në një fazë më të vonë, vëmendja ndaj nevojave individuale – merr parasysh, të paktën pjesërisht, faktin që ri-integrimi nuk është një proces i qetë, i shtruar, linear apo i shpejtë.

Nje temë e perhershme që dilte në të gjitha intervistat me viktimat ishte rëndësia e pranisë së dikujt mbi të cilin mund të mbështeteshin ato gjatë procesit të ri-integrimit, element ky që dukej se ishte vendimtar “në rastet e suksesshme”. Shumë viktimë e kishin gjetur këtë element mbështetës, të paktën përkohësisht, tek personeli i programeve ndihmëse, qofshin këto OJQ, apo dhe institucione qeveritare.

Ndihem mirë kur vij e flas me [punonjësen sociale]. I mendoj gjërat gjatë javës dhe pastaj vij e bisedoj me të. I them të gjitha dhe kjo më bën të ndihem mirë. Më kupton dhe unë nuk i mbaj asaj asnjë të fshehtë. Sepse unë nuk kam ndonjë shoqe më të cilën të mund të flisja dhe të cilës t’i besoja.

Po, ajo [punonjësja sociale] më pyet kur vij, “Si kalove në shkollë, pa të shikojmë se ç’kemi për detyrë shtëpie”. Ajo tregon kujdes, edhe të tjerat flasin, por ajo më pyet më gjatë, nëse kam marrë ndonjë notë të mirë në shkollë, e kështu me radhë. Nëqoftë se nuk kam gjë tjetër për të bërë, atëherë më duhet të merrem me mësim, dhe unë i them se po merrem me mësimet, dhe ajo më thotë, “Do ta kontrollojë, mëso këtë e këtë dhe nëqoftë se unë nuk jam këtu në kohën kur duhet t’i kesh mbaruar detyrat, mund t’i kërkosh ndonjë personi tjetër që të vijë e të të shikojë se ç’ke mësuar”.

Kur u grinda me vajzat, psikologia më ftoi në dhomën e saj dhe ne folëm me orë të tëra. Ajo më fliste edhe kur nuk isha në humor. Më mbështette moralisht, dhe kjo më bënte të ndihesha më mirë.

Tani jam e kënaqur që ia thashë [punonjësës sociale] të gjitha, sepse ajo më kuptoi dhe më ofroi një mbështetje shpirtërore. Dhe jam e sigurt që nëse kam probleme në jetë, apo do të kem nevojë për mbrojtje, unë gjithmonë mund të llogarisë mbështetjen e [asaj organizate].

Ndërkohë që vazhdimi i mbështetjes është i rëndësishëm, ajo nuk është një zgjidhje afat-gjatë dhe vëmendje duhet t'i kushtohet krijimit dhe kalimit në rrjete të tjera mbështetjeje. Si të tilla, është me rëndësi për personat e trafikuar që të gjejnë mbështetje edhe jashtë kuadrit mbështetës të anti-trafikimit, idealisht në familje, në miq, në komunitet, të cilat duhet të jenë një pjesë e rëndësishme e të ardhmes së këtyre personave. Programet e mbështetjes duhet të marrin, gjithashtu, parasysh sesi mund të punojnë për të aktivizuar dhe përforcuar marrëdhëniet ndihmuese brenda rrethanave të mbyllura të përfitueseve, gjë që mund të kërkojë ndërmjetësimin familjar, këshillimin, rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit, ose forma të tjera, të ndryshme, të ndihmës për familjen (madje edhe për komunitetin) në tërësi. Vetë viktimat folën për rolin e rëndësishëm që luajnë këto marrëdhënie vetjake në rikuperimin e tyre:

Mendoj se përvoja e trafikimit është diçka që nuk do të mund ta harrosh kurrë. E gjej shumë të dobishme ndihmën dhe mbështetjen që më jep im shoq. Po të mos më kishte mbështetur ai, unë mund të isha çmendur. Është shumë e rëndësishme të kesh një person të afërt, që të kupton e të ndihmon.

Drejtëpeshimi i mëvetësisë dhe i varësisë

Një nga aspektet më të ndërlikuara të ndihmës është gjetja e drejtëpeshimit midis ofrimit të ndihmës dhe moskrijimit të një gjendjeje varësie. Atje ku viktimave u mungojnë format alternative të mbështetjes – dhe kjo është e shpeshtë, të paktën në kontekstin menjëherë pas trafikimit – këtu nuk kemi të bëjmë me një situatë të thjeshtë. Shumë viktimë krijojnë lidhje të forta varësie me ofruesit e shërbimit dhe aktorët e anti-trafikimit, si edhe me një sërë shërbimesh që ata ofrojnë. Shumë viktimë u shprehën se personeli i programit ishte bërë tashmë “familja” e tyre, dhe se ato i donin dhe vareshin nga këta persona:

Kur takova atë gruan e strehëzës, ajo u bë gjithçka për mua që në atë çast. Nënë dhe baba, tek ajo i shihja të gjithë njerëzit e mi.

Po, më thanë se do të më takonte një punonjëse sociale nga [organizata e vendit të origjinës] dhe pastaj do të më ofrohej e gjithë ndihma e nevojshme, derisa të qendroja fort në tokë me këmbët e mia.

Dhe po të kisha ndonjë hall, mund të shkoja në shtëpi [personeli i strehëzës] dhe t'i tregoja asaj, sepse ajo ishte për mua si nënë. Nuk kisha ç'të mësoja nga nëna ime. Ato që mësova, i mësova prej [personelit të strehëzës].

Përpjekja për të krijuar dhe mbështetur pavarësinë tek viktimat është rreptësisht e lidhur me mjedisin, ku ndodhen punonjëset sociale dhe vetë viktimat. Ofrueset e shërbimeve duhet të përpiqen të drejtpeshojnë ofrimin e mbështetjes, pa ofruar mbështetje të tepërt; të bëhen shoqe dhe familje për viktimat, por vetëm për një periudhë afat-shkurtër ose afat-mesme; duke i ndihmuar ato të zgjidhin problemet pa krijuar varësi, duke shprehur gatishmërinë për të ndihmuar në lehtësimin e problemeve të tyre, por duke patur parasysh se ndihma e tepërt minon mëvetësinë e tyre. Bjerkan and Dyrliid (2006b) zbuluan se shumë rezidente të programeve të ri-integrimit vareshin fort nga këshilltarët e tyre për këshilla dhe mbështetje për çështje nga më të ndryshmet. Kjo do t'u jepte shumë pushtet këshilltarëve, të cilët duhet të bëjnë shumë kujdes dhe të tregojnë ndjeshmërinë e duhur në mënyrë që mbështetja të jetë e drejtpeshuar dhe konstruktive.

Disa nga personat e intervistuar, që ishin bërë shumë të varur nga ndihma dhe nga ofruesit e shërbimeve, ndesheshin me detyra të vështira për sa i takon krijimit të pavarësisë së tyre. Le të marrim, për shembull, deklaratën e një gruaje, e cila shprehu dëshirën për t'u ndihmuar për një kohë të gjatë:

Do t'ju lutesha të dërgoni një mesazh njerëzve të mi, sepse unë nuk arrij dot, veçanërisht [koordinatores së një OJQ]. Do të desha t'u kërkoja atyre të më ndihmonin për ca kohë, derisa të dalë nga strehëza për të jetuar vetëm.

Edhe komentet e disa viktimave të tjera, i bëjnë jehonë kësaj varësie:

Nuk më pëlqente që kjo ndihmë kishte një mbarim. Është e pamundur që unë të gjejë ndonjë shtëpi.

Është mirë që unë po ndihmohem, megjithatë unë kam nevojë të ndihmohem çdo ditë. Disa herë unë marr në telefon linjën e komunikimit falas [helpline] dhe u them se kam nevojë urgjente për qumësht për beben time, dhe ato më përgjigjen që kjo nuk është e mundur.

Dua që të më ofrohet ndihma në mënyrë të përhershme, sipas kërkesës sime.

Ka rëndësi që të njihet fakti se kushtet e shfrytëzimit, shpesh, kontribuojnë në varësinë e një viktime. Një viktimë e dhunës familjare dhe e trafikimit, përmendi se kishte qenë e kontrolluar për aq shumë kohë, sa tani ajo e shihte të vështirë të imagjinonte sesi do të mund të shkonte drejt një jete të pavarur: “E kisha lënë jetën time në duart e të tjerëve. Isha shndërruar në atë që ju e quani skllave. Shko atje, bëj këtë e bëj atë, nuk mund ta bësh këtë, duhet ta bësh kështu dhe jo ashtu. Kështu jetoja. Vetëm nën urdhra”.

Një tjetër aspekt i ndërtimit të pavarësisë është që të angazhohen vetë viktimat në një diskutim mbi të ardhmen dhe shpresat e tyre. Gjithsesi, kjo nuk bëhej përherë nga personeli i programit. Një grua, e intervistuar, nuk dukej se ishte e ndërgjegjshme për nevojën e planeve për të ardhmen, dhe kur u pyet se sa gjatë do të qëndronte në strehim, ose rreth planeve të saj për të ardhmen, përtej fazës së ndihmës, ajo shfaqti një mungesë të plotë qartësie: “Nuk e di, nuk di gjë. Askush nuk më ka folur për këtë”. Edhe viktimat e tjera zbuluan një mungesë përfshirjeje në vendimet rreth jetës së tyre pas-trafikim. Një grua, e trafikuar në BE, tregoi sesi policia, pasi i kishte marrë deklaratën, e kishte çuar në strehëz. Kur u pyet nëse ata kishin diskutuar me të rreth kësaj teme, ajo shpjegoi: “Jo, ata nuk më pyetën. Ata më thanë se do të jetë mirë për sigurinë time. Unë nuk dija asgjë. Mund të më kishin thënë ndonjë gjë. Nuk e kam idenë”. Në të njëjtën mënyrë, një grua tjetër përshkroi sesi ishte marrë forcërisht për në strehëz, pas asaj që ajo e përshkroi si “marrje në pyetje” nga policia: “Dhe pastaj, [policia] më detyroi. Në kuptimin e vërtetë të fjalës. Policia më detyroi të futem në strehëz. Unë pështyj mbi strehëzën ... do të pështyj gjithmonë”. Disa viktima ishin detyruar të përfshiheshin në procesin ligjor, pa u informuar se çfarë do të thoshte një veprim i tillë, se cilat do të ishin pasojat e mundshme apo të drejtën që kishin ato për të vendosur vetë: “Po të më kishte thënë ndokush se unë mund të refuzoja të jepja dëshmi, ashtu do të kisha bërë unë. Do të më ndihmonte të ndihesha më e sigurt. Po, unë mora pjesë si dëshmitare, dhe tani jam penduar për këtë. Sepse nuk ndihem e sigurt. Kam frikë për fëmijën tim dhe për vete”.

Megjithatë, shumë organizata përdorin një metodë fuqizimi të viktimave gjatë punës së tyre, duke u përpjekur që t’i orientojnë ato drejt mëvetësisë

dhe pavarësisë. Kjo metodë fuqizimi i ndihmon personat e trafikuar që të rimarrin kontrollin mbi jetën e tyre dhe siguron që gratë dhe burrat të trajtohen si persona të mëvetshëm (Jordan 2002: 30). Për shumë viktime, ndihma kishte lejuar që të formonin besim dhe forcë për të bërë jetë të pavarur:

Jam plotësisht e kënaqur. Gjithçka ishte shumë mirë ... tani, unë e kam veten në dorë.

Kam patur shumë takime me psikologjen. Më pëlqente shumë të takohesha me të. Psikologjia më ndihmoi ta kuptojë veten time më mirë. Të rifitoja besimin ... Ndhem shumë më mirë kur flas me një psikologe. Është shumë e rëndësishme ... madje, e nevojshme ... psikologët të mësojnë si të bëhesh e fortë.

Por [punonjësja sociale] nuk na jep gjithçka gati, si në pjatë. E di se duhet të studiojë. Duhet të sillem mirë se, përndryshe do të duhet të largohem.

Shumë viktime përshkruan se sa kishin qenë të pranishme në procesin e vendim-marrjes mbi nevojat e ndihmës dhe të mbrojtjes, dhe se sa të ndërgjegjshme ishin bërë se objektivi i ndihmës për to ishte tranzicioni drejt pavarësisë dhe mëvetësisë:

Do të largohem, kur të mundem, dhe kur ta ndjejë se mund të qendrojë mbi këmbët e mia. Kjo do të thotë që unë duhet të kem durim dhe të punojë.

Dhe pastaj ato erdhën me një zgjidhje ... Ata thanë se nuk është e detyrueshme. Se asnjëri nuk do të më detyrojë. Ishte vullneti im.

Nuk kishte ndonjë gjë që unë të mos e pëlqeja në mënyrë të veçantë. Të gjitha punonin, ndërkohë që këshilloheshin me mua. Ata më pyetën nëse kisha nevojë për ndonjë gjë.

[Punonjësja sociale] më pyeti nëse desha të vazhdoja, dhe unë i thashë se unë kisha dëshirë të vazhdojë shkollën. Tani shkoj në shkollë dhe çdo gjë është në rregull.

Vetë viktimat shpjeguan sesi, kur përballëshin me probleme, personeli i ndihmonte që t'i kalonin ato duke punuar së bashku dhe jo thjesht duke dhënë këshilla, apo duke vepruar në vend të tyre. Duke punuar së bashku

për të kaluar problemet, viktimat ndihmoheshin për të krijuar mëvetësinë dhe besimin:

Dua të mbarojë shkollën njëherë, e pastaj të shohë se ç'mund të bëjë. Do të desha të bëhesha parukiere, por [punonjësja ime sociale] më tha se do të ishte më mirë që të mbaroja shkollën njëherë. Ajo tha se nuk do të më detyronte, por më këshilloi të mendoja më mirë për të ardhmen time. Shkova në shkollë për tri javë, por pasatj desha të shkojë në shtëpi. Nëna tallej me mua, por [punonjësja sociale] m'u lut që të mendohesha me kujdes, dhe të mos e dëgjoja shumë mamanë. Dhe pastaj mendova, se mos ai ndërmjetësi kishte folur me mamanë për të më tërhequr prapë [në trafikim], dhe kështu unë nuk shkova më në shtëpi.

Njëherë mora në telefon [helpline] dhe i kërkova [punonjësese sociale] një këshillë. Ishte koha kur im shoq e kishte ndaluar alkoolin për pak kohë. Ai ngulmonte që të bënim edhe një fëmijë. Dhe unë e pyeta [punonjësese] se, "si të veproja?". Ajo nuk më tha, "bëj këtë, e bëj atë". Ajo thjesht më pyeti në isha gati që të rritja dhe të mbaja një fëmijë të dytë, në rast se burri im do të merrte një dozë tjetër të fortë pijesh e t'i kthehej përsëri asaj. Më pëlqeu pa masë. Ajo më bëri të kuptoj që unë nuk kisha përse të nxitoja, se ishte e rëndësishme që të krijoje besim tek vetvetja, para se të merrje vendime të tilla.

Shpesh ndodh që vetëm me një shtyrje të vogël nga organizata të dalësh nga gjumi dhe të fillosh një jetë të re. Këto organizata nuk janë të detyruara të na ndihmojnë ... në fakt, shumë gjëra varen vetëm nga ne.

Disa viktimat, kur u intervistuan, kishin ndërmarrë rrugën drejt ose kishin hyrë tashmë në fazën e mëvetësisë. Kur u pyetën nëse do të pranonin ndihmë të mëtejshme, përgjigjet e tyre pasqyruan nivelin e mëvetësisë dhe të besimit, që kish filluar të krijohej tek ato:

Nuk mendoj. Që tani e tutje duhet të ecë vetë. Besoj se të gjitha organizatat më kanë ndihmuar mjaft.

Nuk mendoj që organizatat janë të detyruara të të ndihmojnë për një kohë të gjatë. Mendoj që jam me krahë e me këmbë. Ka viktimat që kthehen me probleme të rënda, ndoshta ato kanë nevojë më shumë

se unë për ndihmë. Kështu që nuk guxoj të çojë as nëpër mend që të kërkojë ndihmë. Unë ndihem mirë thjesht nga fakti se e di që këto organizata janë përreth meje, edhe sikur ato të mos ofrojnë ndihmë.

Kam shumë shpresë të shtojë biznesin tim. Jam e kënaqur që im shoq më mbështet. Jam e sigurt që gjërat më të këqija janë lënë shumë prapa dhe tani gjithçka varet nga unë, nga ne ... Mendoj se ndihma që kam marrë nga organizatat ishte e përshtatshme. U jam mirënjohëse.

Fajësimi, sharja dhe diskriminimi

Shumë viktima të trafikimit ngritën problemin e fajësimit dhe të diskriminimit, si probleme me të cilat përballëshin në fazën e rikuperimit dhe të ri-integrimit. Fajësimi dhe diskriminimi lindin, përgjithësisht, kur mjedisi social – qoftë familja ose komuniteti – nuk e miraton një qëndrim apo veprim individual të personit. Në rastin e viktimave të trafikimit, shpesh mendohet se fajësimi dhe diskriminimi lidhet me prostitucionin. Dhe, sigurisht, shumë viktima e përmëndën këtë fakt. Fakti që ato nuk kishin hyrë me dëshirën e tyre në rrugën e prostitucionit, apo se ishin shfrytëzuar në këtë proces, shpesh nuk ndikonte në drejtim të caktimit të fajit:

Nuk ma thonë në sy, por i kam dëgjuar fjalët e këqija që janë përhapur për mua në fshat.

Njerëzit në komunitetin tonë e kanë të lehtë të të kritikojnë. Ata nuk kuptojnë gjëra të tilla, dhe e kanë më të lehtë të të shajnë se sa të tregojnë keqardhje.

Jo, ata nuk dinin gjë [rreth trafikimit tim], por kishte fjalë që unë kisha punuar si prostitutë atje, meqenëse u ktheva me një fëmijë.

Kam patur probleme në shkollë... janë ca vajza që thonë se jam një lavire ... Është një djalë atje, por kur rrija me të, drejtoresha e shkollës më pyeti, përse e bëja këtë. Por, unë nuk mund të rri vetëm. Të tjerët më shmangen. Drejtoresha më kërkoi falje. Të gjithë ata më thonë që unë duhet të qëndrojë edhe një sëmester. Nëse shkoj në fshat, do të më therrasin lavire; nëse shkoj në shkollë, më thonë të njëjtën gjë, dhe është shumë e rëndë që ta kalosh një gjendje të tillë.

Nuk ndihesha mirë [në shtëpi], duke menduar se çfarë kisha bërë atje ku isha, ndihesha keq. [Familja ime] bënte sikur nuk më vinte re ...

Rrija në dhomë, rrija vetëm dhe qaja shumë. [Nëna ime] më qendronte larg. E dija që edhe sikur të provoja të flisja me të, ajo nuk do të më kuptonte. Nëna dhe babai im kanë lindur dhe jetojnë në një fshat. Në fshat njerëzit flasin. Unë nuk dilja jashtë shtëpisë, qendroja gjithë kohën brenda dhe vetëm disa herë dilja në oborr ... Prindërit e mi nuk deshën që unë të dilja, dhe unë nuk u ve faj. Motra ime e vogël u kthye nga shkolla duke qarë. Shokët e saj të vegjël i kishin thënë, "Jot motër ka bërë këtë, ka bërë dhe atë".

Nëqoftë se duan të më tregojnë me gisht, le ta bëjnë. Ky ndoshta paska genë fati im ... Unë e di se nuk ishte dëshira ime që të punoja në prostitucion ... Këtu njerëzit nuk e bëjnë dot dallimin midis prostitucionit të detyruar dhe atij të vullnetshëm.

Për t'u shënuar është që një turpërim dhe sharje e tillë e viktimave ekziston në mjedisin shumë të afërt të personave të trafikuar, përfshirë familjen dhe miqtë, tek të cilët kthehen viktimat pas shfrytëzimit të tyre. Siç ndodh me komunitetin në tërësi, sharjet dhe fajësimet lidhen me faktin e prostituimit.

Edhe gjyshja ime më quan [lavire] dhe të dhëmb kur e dëgjon atë fjalë nga një njëri kaq i afërt.

Familja ma vuri mua fajin. Ata nuk më kuptuan. Ishte vëllai që më shante gjithmonë. Nëna ime është e moshuar, dhe nuk kupton shumë. Kishte çaste kur desha të largohesha nga shtëpia. Por, unë besoj se është shumë e rëndësishme që familja jote të të mbështesë. Është e vështirë të mbështetesh tek një njeri i huaj, sepse kur nuk të mbështetin prindërit, si mund të të mbështesë një tjetër?

Unë kam një nip të vogël dhe meqenëse unë kam punuar në rrugë, ime motër ma ka ndaluar ta takojë atë. Edhe tani, që kam marrëdhënie më të mira me time motër, nipi im nuk më njeh si tezen e tij.

Megjithatë, anëtarët e familjes shpesh reagojnë në mënyra të ndryshme, dhe disa viktimat raportuan se marrëdhënia e tyre me familjen ishte përmirësuar dhe nuk helmohej më nga fajësimet dhe sharjet:

Më parë nuk shkonim mirë me njëri-tjetrin. Ziheshim, rriheshim. Por, tani është shumë më mirë. Edhe tani grindemi, por jo si më parë ... Kur bëjmë fjalë, unë filloj të qajë dhe nëna ime më afrohet dhe më mbështet. Tani më flasin të gjithë.

Jam e sigurt se nëna ishte e gëzuar që më pa, dhe babai im, po ashtu. Por nga ana tjetër, ata përqeshin që të menjanonin çdo diskutim mbi çfarë kishte ndodhur, ose të bënin ndonjë pyetje... Po, unë ua tregova të gjitha dhe ata u mërzitën dhe u zemëruan shumë, por jo me mua. U zemëruan për çka kishte ngjarë. Nuk mendoja se do të silleshin aq mirë me mua.

I besoja vetem burrit tim. Ai më mbështet shumë ... Ai kujdeset për fëmijën tim.

Në disa situata të tjera, viktimat gjetën mbështetje në mës të kushërinjvë apo anëtarëve të familjes së tyre, dhe jo tek të tjerët:

Mua nuk më shajnë prindërit, por më shajnë gjyshërit dhe tezet e mia. Nëna më mbron gjithmonë, por jo babai.

Vëllai dhe motra më duan. Burri gjithmonë më poshtëron, më thotë prostitutë. Ai është përherë xheloz, megjithëse nuk ka arsye për këtë.

Bëra plane të qendroja me tezen time, sepse ajo i kupton gjërat më mirë se ime ëmë. Dhe unë i shpjegova [tezes sime] përse desha të rrija me të. [Tezja ime] do të më kuptojë nëse i them se çfarë më kishte ndodhur, kurse nëna, as nuk do të m'i hidhte më sytë.

Në rastet kur ndihmoheshin viktimat e trafikimit, kjo, disa herë shtonte reagimet negative dhe diskriminimin e miqve, të fqinjëve dhe të anëtarëve të komunitetit. Kishte nga ata që u vinte inat për ndihmën që u ofrohej "prostitutave", ndërsa të tjerët mendonin se ndihmat jepen vetëm në rastet e personave problematikë për shoqërinë, si për shembull për të alkoolizuarit. Nevoja e mbështetjes mbi ndihmat, mesa duket e ulte personin në sytë e disave, dhe në disa raste, përbënte një problem midis burrave, të cilët, sipas normave sociale, duhet të jenë në gjendje që të përkujdesen për vete dhe për familjet e tyre:

Mendoj se komuniteti ynë nuk e kupton mirë se përse vajzave, që u shfrytëzuan seksualisht, duhet t'u ofrohen ndihma. Ata mendojnë se prostitutat nuk duhet të ndihmohen.

Kam dëgjuar nga vajzat e tjera që në fshatin e tyre, ku njerëzit e kanë marrë vesh se çfarë u ka ndodhur atyre, djemtë e fshatit nuk janë shumë të kënaqur kur shikojnë ndihmat që u ofrohen nga organizatat e

specializuara ... Për shembull, një vajzë që hapi një barake në fshatin e saj, duke qenë e ndihmuar nga një organizatë, në një farë mënyre u refuzua nga fshati i saj. Njerëzit e merrnin nëpër gojë duke thënë, "Do të ishte më mirë sikur të ndihmonin njerëzit që janë me të vërtetë punëtorë, në vend të kësaj prostitute". Mendoj, se në një fshat të vogël është e pamundur të mbash të fshehtë faktin që, dikush është duke të ndihmuar.

Po, të paktën jetojmë, njerëzit nuk të shohin me sy të mirë nëse kërkon ndihmë nga organizatat shtetërore ... Zakonisht, ndihma kërkohet nga pijanecët ose njerëzit që nuk duan të punojnë për të mbajtur veten e tyre.

Pjesa më e madhe e njerëzve nuk të besojnë se ishte krejt e pamundur të ikje nga skllavëria ... Ata mendojnë se në rast se të ndodhin këto gjëra, je budallaqe. Dhe budallenjtë nuk gëzojnë simpatinë e njerëzve ... kështu që, të duhet të dalësh vetë nga situata.

... dhe sharjet. Mendoj se në fshatin tim, njerëzit do të më shajnë duke thënë, "Pas asaj sjelljeje të turpshme, ai nuk meriton të ndihmohet".

Shumë djemve u vjen turp të kërkojnë ndihmë, sepse shoqëria jonë nuk mund të pranojë, apo të miratojë faktin që burrat të kërkojnë ndihmë. Duhet të përpiqen vetë.

Në disa raste ishte e vështirë që të zgjidhje pikëpyetjen nëse fajësimi vinte ngaqë merrje ndihma, nga përvoja e trafikimit, apo ngaqë ishe prostitutë, apo ngaqë i përkisje një minoriteti etnik.

Burri im më shan shumë. Ai më thotë, "Shko, shko atje, tek ata, se atje ndihmohen prostitutat... dhe pse i ndihmojnë prostitutat? Më mirë të ndihmonin njerëzit normalë".

Në rast se njerëzit në mëhallën time do ta kuptojnë se mua më ishte dhënë një apartament, ata, me siguri, do të thonin, "Eh po, një [gruaje nga minoriteti etnik] iu dha një apartament, dhe njerëzit normalë nuk ndihmohen". Prandaj edhe unë nuk do të tregojë sesi e mora këtë apartament. Dhe atyre që u kam thënë sesi e mora, ende nuk më besojnë.

Fajësimi, sharjet dhe diskriminimi duket se, në disa raste, lidhen dhe me faktorin kohë dhe disa viktime raportuan se si mendimi i keq që komuniteti

kishte për to në fillim, pas kthimit të tyrë në shtëpi, kishte ndryshuar me kalimin e javëve, të muajve dhe të viteve: “Njerëzit bëjnë thashetheme dhe flasin keq për mua. Ata mendojnë se kam punuar si prostitutë, se kur u ktheva, isha shtatzënë ... Kohët e fundit, duket sikur është qetësuar disi gjendja”. Brunovskis & Surtees (2007) zbuluan, gjithashtu, se ishte çështje kohe – disa herë edhe vitesh – para se komuniteti t’i pranojë dhe t’i trajtojë ata normalisht. Një viktime, e cila u kthye në komunitetin e saj, gjithmonë i rrinin larg sa herë që ajo shkonte në dyqanin e fshatit, trajtim ky që vazhdoi për dy vjet, para se të normalizohej përfundimisht situata.⁴⁵

Ndërkohë që turpërimi, sharjet dhe diskriminimi ishin çështje problematike për shumë viktima, është e rëndësishme të vihet në dukje se ato nuk ishin gjithmonë rezultat i paevitueshëm i trafikimit, qoftë për shfrytëzim seksual apo për forma të tjera shfrytëzimi. Në disa raste, duhej të kalonte mjaft kohë që familja dhe miqtë të kuptonin dhe ta pranonin përsëri viktimën; në disa raste të tjera ata i pranonin menjëherë:

Burri im dhe prindërit e mi e dijnë këtë gjë ...askush tjetër ...dhe unë nuk dua që të merret vesh ... Në përgjithësi, prindërit, madje edhe burri im më mbështesin dhe u vjen keq për mua.

Motra ime më mbështet plotësisht ...i vjen keq për mua.

Familja ime më kuptoi dhe nuk më bën me faj.

Kur shkova me këshilltaren time në [qytetin tim] për të marrë një kartë të re identiteti, ata më çuan tek motra ime. Për një farë kohe nuk desha t’i thoja gjë. Por, kur kuptova se do të më duhej të qendroja për një kohë më të gjatë në strehëz, atëherë unë ia shpjegova të gjitha. Në çastin e parë ajo dyshoi se mos po gënjeja, se mos kisha bërë ndonjë gabim dhe do të futesha në burg. Më vonë më kuptoi dhe derdhi lotë.

Një çështje që ka qenë shumë e nënvlerësuar deri sot, është sesi mund të tejkalohej turpërimi dhe faji në jetën pas-trafikim të viktimës. Brunovskis & Surtees (2007) kanë diskutuar se ka disa qendime që mund të zbutin peshën e turpërimit, duke mundësuar që familja ose komuniteti të fillojnë “të harrojnë”. Është e nevojshme të trajtohet e të kuptohen më mirë shkaqet e sakta që

⁴⁵ Po kështu, në Kamboxhia, ndërkohë që kthimi fillestar u vu re nga të gjithë, kjo vëmendje u terr me kalimin e kohës. Një grua tregoi se, “kudo që shkoja, i dëgjoja njerëzit të flitnin për mua ...pas nja tre a katër muajsh, pushuan. Tani shkoj në treg për të shitur dru zjarri, si më parë” (Derks 1998: 43, cf. Surtees 2000: 190-191).

shkaktojnë turpërimin dhe rrugët e duhura kulturore, që duhet të përdoren për të zbutur peshën e turpërimit dhe të diskriminimit.

Intimiteti, anonimat dhe fshehtësia

Duke parë rrezikun e turpërimit dhe të fajësimit, shumë viktime kërkojnë që ta mbajnë të fshehtë përvojën e tyre të trafikimit nga familja dhe miqtë, si dhe nga komuniteti, gjë që mund të ndikojë në vendimet e tyre rreth ndihmës:

Këtë vit, në muajin mars, vullnetarët e [një organizate] erdhën në fshatin tonë për të shpërndarë broshura me numrin e linjës së telekomunikimit (helpline). Nëna ime iu afrua atyre dhe u tregoi se çfarë më kishte ngjarë mua. Mori një nga broshurat dhe ma dha. Në fillim, nuk vendosja dot, por e lexova dhe e ri-lexova broshurën disa herë. Kisha frikë se mos historia ime do të merrte dhenë. Më në fund, vendosa ta marrë në telefon atë organizatë, sepse u sigurova që informacioni do të mbetej i fshehtë dhe unë do të mbetesha anonime.

Edhe viktimat e tjera në rajon, shprehën të njëjtat shqetësime në lidhje me fshehtësinë:

Meqenëse [ky] është një vend i vogël dhe unë kisha frikë se mos të gjithë do ta merrnin vesh se ç'më kishte ndodhur.

Nuk kisha ndonjë besim se informacioni do të mbahej sekret ... pata frikë, se mos e merrte vesh i gjithë fshati se ku kisha qenë e çfarë më kishte ndodhur.

Viktimat e trafikimit kanë frikë të pyesin se, ku duhet të shkojnë e të kërkojnë ndihmë. Tremben se nuk janë të sigurt që informacioni për to nuk do të mund të mbahet i fshehtë. Nuk do të kisha kërkuar ndihmë, po të mos ishte për shoqen time, e cila ishte edhe ajo një viktimë.

Për mua është shumë e rëndësishme që të ruhet sekreti im. Nuk dua thashetheme për mua në fshatin tim ... Shumë nga viktimat ngurrojnë të kërkojnë ndihmë, sepse tremben se mos merren vesh historitë e tyre.

Në disa raste këto frika – që historia e tyre do të bëhet publike – mund të bëjë që viktime të refuzojë ndihmën. Domethënë, po të pranonin ndihmën, kjo do t'i identifikonte në sytë e familjes dhe të komunitetit si person i trafikuar (cf. Brunovskis & Surtees 2007). Kjo ka shumë të ngjarë që të jetë rasti sidomos kur organizatat njihen si agjenci anti-trafikim:

Edhe po të dinin vajzat rreth [ndihmës] do të kishin frikë të afroheshin, sepse i gjithë fshati do të fliste. Jam e bindur që, në rast se unë do t'i ofroja ndonjë viktime nga fshati jonë që të merrte ndihmë nga [organizata], ky person nuk do të pranonte, sepse do të kishte frikë se mos i tërë fshati do ta zbulonte. Unë as nuk e di sesi këto vajzat e tjera këtu marrin ndihmë. Sepse e di që, shumë vajza nuk kanë kurajon të kërkojnë ndihmë, sepse fshehtësia e tyre nuk do të respektohej.

Për disa viktime, të kënaqurit me ndihmë lidhej, të paktën pjesërisht, me mënyrën e fshehtë sesi ishte trajtuar rasti i tyre:

Asnjëri nuk e di. As fqinjët e mi, dhe as nëna ime. Dhe jam e lumtur që sekretin im është ruajtur mirë nga këto organizata. Thjesht kam frikë se mos kur t'i bjerë në vesh nënës sime ndonjë gjë, ajo nuk do të jetë në gjendje të mbajë sekretin dhe fshatarët do të fillojnë me thashetheme ... për fat të keq, në fshat lajmet përhapen shumë shpejt dhe jo gjithmonë ato kuptohen drejt ... Janë të prirur të kritikojnë viktimat e trafikimit.

Jam shumë e kënaqur me [shërbimet]. Më pëlqen që drejtoresha e ka mbajtur të fshehtë historinë time. Unë i besoj asaj tërësisht.

Më premtoi se do të më ndihmonte, dhe ashtu bëri. E ka mbajtur të fshehtë historinë time.

Për t'u shënuar janë rastet kur shkelej intimiteti dhe fshehtësia e viktimës brendapërbrenda kuadrit të ndihmës, dhe në shumë raste, me disa mënyra që shkaktonin pasoja të rënda dhe të stërzgjatura për personat e trafikuar dhe familjet e tyre.

Kur u ktheva, unë rezultova pozitive me HIV në një klinike private lokale. Pastaj, i gjithë fshati u mbush menjëherë me lajmin. Fqinjët e morën vesh. Dhe unë pata shumë, shumë probleme. Ata nuk më linin që t'u afrohesha. Më trajtonin si një copë baltë. Ata më poshtëronin. Pata shumë probleme edhe me fëmijën tim në shkollë. Dëshën ta përjashtonin nga shkolla, me pretendime nga më të ndryshmet, megjithëse unë u tregova rezultatit negativ të analizave të tij. Vuajta shumë.

Kur u pyet nëse kishte paraqitur ndonjë ankim, ajo shpjegoi se kishte provuar ta bënte: "Po, me kryemjekun e klinikës, por nuk ndodhi asgjë. Tani është tepër vonë. E si mund ta ndyshosh qëndrimin e një komuniteti të tërë?"

Kurrë nuk do ta mendoja se një gjë e tillë do të më ndodhte mua. Nuk e prisja asnjëherë që të kishte një situatë më të keqe se trafikimi".⁴⁶

Disa viktime kishin hasur probleme kur përvoja e tyre e trafikimit ishte kapur nga media:

Njëherë, një polic i zonës dërgoi një grup gazetarësh në shtëpinë time. Erdhën të më merrnin në fotografi. Unë u thashë të më linin të qetë. Në atë çast erdhi dhe avokati im. I kërkova atij të më ndihmonte që t'i hiqja qafe ata gazetarë budallenj, meqenëse ai ishte avokati im. Ai nuk bëri asgjë, madje edhe qeshte me mua.

[Punonjësi i policisë] dha një deklaratë për shtyp. Atje ishte dhe emri i plotë i imi ... Të gjitha gazetat ishin të mbushuar me njoftimin se ... nuk arrija të besoja se historia ime do të mbërrinte deri te [vendi fqinj]. U trondita.

Probleme të tilla ngrejnë çështje rreth mënyrës sesi duhet të jepet informacioni mbi viktimat dhe rastet e tyre aktorëve të anti-trafikimit. Ndërkohë që ka arsye përse të dhënat mund t'u jepen agjencive dhe institucioneve, po ashtu ka raste kur viktime mund të mos ndihet e qetë dhe e kënaqur, që këto informacione të ndahen me të tjerët:

Po, polici i stacionit të trenit [në atë qytet] e dërgoi informacionin zyrës së prokurorit publik dhe punonjësve të {OJQ-s së atij qyteti}. Kur erdha në [kryeqytet] unë u kontaktova nga një avokat [i zyrës së OJQ-s në kryeqytet]. Ishte një surprizë e pakëndshme për mua që dëshmia ime kishte marrë dhenë në të gjithë [vendin] Nuk ndihesha e sigurt. Më dukej sikur e gjithë bota e kishte mësuar tashmë historinë time ... për mua kishte rëndësi që atë ta dinin sa më pak njerëz që të ishte e mundur.

Po, punonjësi i policisë nga [kryeqyteti] kishte të dhëna mbi mbërritjen time, prandaj dhe më kërkoi të shkoja në polici. Nuk e di si e kishte marrë vesh. Ndoshta ngaqë më kërkonte policia... sigurisht që nuk më

⁴⁶ Shkeljet e fshehtësisë kanë ndodhur edhe gjatë fazës së identifikimit dhe kthimit. Një vajzë, e mitur, përshkroi marrjen në pyetje nga policia në komunitetin e saj, pasi ajo ishte larguar nga trafikimi, si një marrje në pyetje që e zbuloi atë para familjes dhe komunitetit:

Ajo që më shqetësoi më shumë ishte dera e hapur që ndenji ashtu gjatë gjithë kohës, dhe atje kishte policë dhe policë rrugorë që kishin hapur veshët, duke dëgjuar marrjen time në pyetje. Dhe unë i njoh ata të gjithë, dhe ata e njohin vëllanë tim dhe unë u ndjeva keq".

erdhi mirë që policia po më kërkonte... dhe më kërkoi të shkojë në [kryeqytet].

Një avokat i një organizatë [anti-trafikim] kërkoi që unë t'i tregoja se kush më kishte shfrytëzuar, se ku isha shfrytëzuar para se të më blinte babai i fëmijës tim ... Më tha se ishte për të mirën e sigurisë sime ... Më bindi se ky informacion nuk do t'i kalonte policisë. Unë nuk kisha rënë dakord të bashkëpunoja me policinë [vendore]...sepse shumë nga ta janë të lidhur me ndërmjetësit.

Disa viktimat raportuan se mendonin që fshehtësia e tyre ishte shkelur nga punonjëset sociale, të cilat kishin ndarë me ofrueset e tjera të shërbimit atë, që për mendimin e viktimave, kishte qenë informacion intim dhe vetjak:

Doli që [punonjësja sociale] të cilën unë e desha shumë, i besoja shumë, na ishte me dy fytyra. Unë zbulova që I kisha thënë ca gjëra për nënën time, për jetën time ... ajo e përdori atë informacion dhe ua tha të gjithëve. Po, kjo ishte një katastrofë për mua ... Ajo ishte kujdestarja ime. E dëgjova që po tregonte historitë e mia në zyrën e saj. Atëherë vendosa që ajo nuk është më mikja ime. Në rast se unë të them ty diçka të fshehtë dhe intime, ti nuk mund ta shfrytëzosh këtë për t'u dukur më e rëndësishme. Mos kisha nxjerrë unë gjë në shitje? A ka vlerë tregu ai informacion?

Sepse unë flas për disa gjëra dhe kur pastaj më del një person nga hiçi dhe ai e di historinë time.... Ajo supozoj të mbetej midis meje dhe punonjësës sociale.

Kjo nuk është për të thënë se përdorimi i informacionit midis ofruesve të shërbimit nuk është i nevojshëm apo i këshillueshëm. Ajo që është e nevojshme, është përdorimi (i kufizuar) i informacionit mbi bazën se "çfarë duhet të dihet", duke ruajtur parametra të rreptë dhe protokolle për fshehtësinë. Me këto parametra është e mundur që të ruhet fshehtësia, duke menjanuar në të njëjtën kohë ri-intervistimet e panevojshme dhe, ndoshta, ri-traumatizimin dhe viktimizimin e dytë të personit. Në rastet kur u ndoqën këto parametra, praktika e përdorimit të kufizuar të informacionit, u vlerësua drejt nga personat e trafikuar:

Me mbërritjen në [kryeqytet], unë shkova drejt e tek [organizata]. Shkova për t'i falenderuar që më kishin shpëtuar. Fola me [punonjësën sociale], i thashë se çfarë kisha hequr. Nuk kisha përse t'i tregoja

psikologes historinë time nga e para, pasi rasti im ishte dërguar tashmë atje Po [kjo praktikë është e mirë], por vetëm me kushtin e ruajtjes së fshehtësisë.

Duhet të ketë një person përgjegjës për këtë në çdo rreth ku ka [qendër]. Dhe të bëhet në një mënyrë të tillë që askush tjetër të mos marrë vesh rreth [rastit të trafikimit], meqenëse fshehtësia është e vështirë të ruhet nëpër rrethe.

Unë mendoj [përdorimi i informacionit mbi rastin]] po, është gjë e mirë. Përse jo? E pse më duhet ta ri-them nga e para të gjithë historinë. Sigurisht që edhe unë këmbëngul mbi nevojën e ruajtjes së fshehtësisë. Nuk dua që njerëzit nga fshati im të marrin vesh se çfarë kam bërë. Jam e prirur të flasë për rastin tim më shumë këtu në [kryeqytet], sesa në rrethin ku banoj apo në fshat, lajmet hapen menjëherë.

Ndihmë e specializuar për raste të ndryshme dhe të ndërlikuara

Kuadri i ndihmës u ngrit fillimisht në përgjigje të një prototipi të viktimës së trafikuar – një grua e re, e trafikuar për shfrytëzim seksual. Programet janë, përgjithësisht, ndërtuar duke u bazuar mbi modelin e strehëzave dhe të vendosura në kryeqytete. Megjithatë, për shkak të ndryshueshmërisë së viktimave dhe të përvojave të trafikimit në SEE, ka dalë nevoja e ndërtimit ndryshe të programeve të ndihmës, të personalizuara sipas nevojave të veçanta të grupeve të ndryshme të viktimave (viktima nga vendi dhe të huaja, të mitura dhe të rritura, meshkuj dhe femra) dhe sipas formave të reja të trafikimit (shfrytëzim seksual, për punë, për lypje, krime të ndryshme, birësime). Viktimat që shfrytëzohen për punë dhe për lypje jo domosdoshmërisht kanë të njëjtat nevoja për ndihmë si ato që trafikohen për shfrytëzim seksual. Vetë viktimat identifikuan mënyrat sipas të cilave nevojat e tyre jo gjithmonë plotësoheshin në mënyrë shtjelluese apo të mjaftueshme, nga ana e strukturave ekzistuese të ndihmës. Përveç kësaj, ndihma e specializuar shpesh nuk është e disponueshme për rastet më të vështira, si për viktimat me të meta, me çrregullime mendore apo varësi të ndryshme. Rastet e tilla kërkojnë ndihmë që del jashtë synimit të një pakete normale ndihme dhe kërkojnë më shumë vëmendje për shërbime dhe ndihma të personalizuara për viktimat e tilla, përfshirë zhvillimin/krijimin e aftësive intervistuese, ngritjen e shërbimeve të duhura e të përshtatshme dhe ndërgjegjësimin e personelit (Surtees 2005: 15). Viktimat vunë në pah disa nga fushat, ku kërkohej një mbështetje e specializuar dhe e personalizuar.

Ndihmë për viktimat me fëmijë

Viktimat e trafikimit (gra dhe burra) me fëmijë kanë nevojë për lloje të ndryshme të ndihmës, e cila do të merrte parasysh rolin e viktimës si nënë (ose si baba) dhe nevojat e fëmijëve që i kanë në ngarkim. Ofrimi i mundësive të banimit për gratë dhe fëmijët e tyre ishte një faktor i rëndësishëm në lidhje me marrjen e vendimit nga ana e viktimës për të pranuar ndihmën. Një nënë dhe viktimë tha: “[Vajza ime] është gjithmonë pranë meje. Dhe unë i jam mirënjohëse organizatës që e la me mua. Është gjëja më e rëndësishme për mua”.

Gjithsesi, rregullimi i grave dhe i fëmijëve brenda programeve ekzistuese të strehimit nuk ishte gjithmonë një zgjidhje e mirë për nënat, rezidentët e tjerë dhe fëmijët:

Disa herë unë kisha diskutime me vajzat e strehimit, nganjëherë prej fëmijëve të mi, që nuk më bindeshin dhe qanin nëpër korridor.

Një gjë që më shqetëson më shumë, në një farë mënyre, është fëmija... ajo ende nuk e kupton se si është puna. Por ajo është një fëmijë normal, ka dëshirë të luajë, dhe kur ajo qesh, e lëshon gjithë zërin, sikur thërret, dhe kjo nuk lejohet në një strehëz. Ndoshta vetëm kjo, të tjerat janë në rregull. Për shembull, kur ajo flet me zë të lartë, ose kur bërtet, ose bën ndonjë gjë tjetër...kjo nuk lejohet. Këtu e kam hallin. Dhe unë e kuptoj, por nuk mund t'i them që të mos bërtasë. Dhe kur i them, nuk mund të presë që ajo të kuptojë, se është fëmijë. Ato mund të mos të kënaqen me këtë. Ndoshta nuk u pëlqen fakti që ajo bërtet, apo qesh me zë të lartë.

Vetë fakti që strehimet, shpesh, janë të mbyllura, me pak liri lëvizjeje, e shton nivelin e ankthit. Për fëmijët, të cilët, si pasojë, nuk mund të luajnë jashtë, nuk kanë shokë, nuk shkojnë dot në shkollë, duhen bërë pyetje rreth ndikimit të këtyre rrethanave mbi procesin e zhvillimit të tyre, edhe kur plotësohen të gjitha nevojat bazike të tyre. Një grua kish qendruar në një strehim të mbyllur me vajzën e saj dy vjet e gjysmë, ndërkohë që përgatiteshin dokumentet e kujdestarisë dhe ndiqeshin procedimet ligjore. Vajza e vogël – tani dhjetë vjeç – nuk ishte në gjendje të shkonte në shkollë apo të luante lirshëm, dhe kishte marrë disa mësim të rastësishme e mbi bazë vullnetare prej një punonjëseje të strehimit. Që një e treta e jetës së saj ishte kaluar në një strehim dhe pjesa tjetër me nënën e saj në një situatë trafikimi, nuk mund të mos linte gjurmë mbi të.

Për shumë nëna, problemet e kujdestarisë ishin, gjithashtu, shqetësuese dhe ndihma e dhënë në lidhje me procesin ligjor u vlerësua lart dhe si shumë

e nevojshme. Një viktimë, e cila ishte mbajtur nga trafikanti si “gruaja” e tij, shpjegoi pamundësinë e saj që të kthehej në shtëpi, për shkak të çështjeve të kujdestarisë mbi fëmijën e saj:

Cili është plani? Plani im është që organizata të më ndihmojë ta regjistrojë fëmijën në kopësht. Nëpërmjet organizatës është më e lehtë. Ata i njohin njerëzit, kështu që unë dua ta çojë fëmijën në kopësht. Dua të shkojë në shtëpi, por meqë kjo nuk bëhet, dua të gjejë punë, të çojë fëmijën në kopësht dhe të bëhem e pavarur ... Do të dëshiroja të shkoja te shtëpia e nënës sime, por meqenëse nuk mundem për shkak të fëmijës, do të qendrojë në [këtë vend]... Pa firmën e [babait] nuk mund të largohem. Fëmija është me mua dhe askush tjetër nuk e ka kujdestarinë mbi të. Po presim vendimin e gjyqit.

Për gratë me fëmijë, një tjetër shqetësim ishte dhe aftësia e këtyre nënave për t’u kujdesur për fëmijët e tyre në një kohë të gjatë, duke patur parasysh mundësitë e tyre të kufizuara për ri-integrimin social dhe ekonomik. Disa gra mbështetësin mbi ndihmën humanitare për të gjetur ushqim për fëmijët e tyre, të tjerat flitnin mbi pamundësinë e tyre të kërkonin punë, sepse u duhej të merreshin me fëmijën e tyre, ndërsa të tjerat, nuk kishin një vend të përhershëm për të jetuar. Pengesat “normale” dhe natyra e ndërlikuar e ndihmës dhe e ri-integrimit shtohen në rastin e prindërve që kanë fëmijë në ngarkim. Ofrimi i ndihmës për prindërit përfshin, në mënyrë të domosdoshme, një marrje parasysh e nevojave të fëmijëve të tyre, e cila të mos përfshijë vetëm nevojat bazike, por edhe probleme të tilla si, fonde për librat shkollorë, për pagesat e kopshtit apo të çerdhes, ndihmën mjeksore, etj.

Problemet serioze mjeksore dhe shëndetësore

Një numër organizatash vunë në dukje se personat e trafikuar kalojnë probleme serioze dhe të ngatërruara shëndetësore, përtej shqetësimeve “të zakonshme” gjinekologjike që lidhen me shfrytëzimin e tyre seksual, probleme që kërkojnë një ndihmë mjeksore të specializuar, dhe shpesh, të kushtueshme. Një vajzë 17 vjeçe, kërkoi një ndërhyrje të specializuar mjeksore për tumoret që kishte në gjoks, të cilët ishin zhvilluar si rezultat i rrahjeve të vazhdueshme kur ishte e trafikuar. Në një rast tjetër, viktimja duhej të operohej në mënyrë urgjente, për shkak të dëmtimeve fizike si rezultat i trafikimit:

Më merreshin mendtë dhe nuk mund të kuptoja se për çfarë po flitnin midis tyre. Kuptova se flitej për diçka që ishte afër shtyllës kurrizore

dhe se infeksioni do të arrinte lëngun spinal, që do të thoshte se duhet të ndërhynin me urgjencë. Unë ende nuk e di se cili ishte shkaku i infeksionit, dhe ata thanë se kjo mund të ndodhë përsëri.

Po kështu, dy gra të intervistuar ishin infektuar me HIV, si rezultat i përvojës së tyre të trafikimit.⁴⁷ Në rastin e një gruaje, njëri nga fëmijët e saj ishte i infektuar edhe ai me këtë sëmundje. Nga intervistat nuk doli e qartë nëse ishte gjithmonë i disponueshëm trajtimi i nevojshëm mjekësor për këto paciente me HIV. Një e intervistuar merrte një mjekim të vazhdueshëm kundër kësaj sëmundjeje: “Marr mjekime në mënyrë të rregullt. Më duhet ta bëjë deri në fund të jetës sime, për të parandaluar virusin që të më shkatërrojë gjithë organizmin. I falemë përditë Zotit që të gjendet ilaçi që vret këtë virus”. Megjithatë, e intervistuar tjetër, kur u pyet nëse merr trajtim special për të mbajtur sistemin e saj imun, u përgjigj se nuk merrte, se merrte vetëm vitamina dhe ushqej mirë. Në shumë vende të rajonit të SEE-s, nuk është gjithmonë e lehtë që të kesh një ndihmë mjekësore të specializuar për një seri problemesh shëndetësore.

Abuzimi me substancat dhe varësia

Varësitë – ndaj alkoolit dhe/ose narkotikëve – gjithashtu përbënte një problem për shumë viktime, dhe, përgjithësisht, nuk ishte e mundur të shfrytëzoje programe dizintoksikimi. Një numër viktimash e përshkruan problemin e varësisë së tyre si një çështje kyç të jetës pas trafikimit. Disa viktime vazhduan të abuzonin me drogën dhe alkoolin për një farë kohe:

Në fillim, gjërat ishin të vështira. Kur isha me ndërmjetësit ata më jepnin ilaçe të cilat më bënin që koka të më vinte rrotull. Dhe kur erdha këtu, ishte shumë e vështirë të bëja pa to.

Isha e sëmurë. Nuk arrija as të zbrisja nga krevati, sepse nuk haja dot gjë, veçse pija ato tabletat [narkotike].

Po ashtu, kishte rëndësi dhe abuzimi me lëndët narkotike brenda familjes së viktimës. Për disa viktime, abuzimi me lëndën ishte dhe arsyeja përse ato

⁴⁷ Kjo përputhet me një numër të vogël, por për t’u vënë në dukje, të përfituesve me HIV pozitiv, që u zbuluan gjatë punës sonë kërkimore. Në Shqipëri, një viktimë, e cila po ndihmohej që nga 2002, dhe dy që nga 2004, ishin testuar me HIV pozitiv. Në BH, ofruesit e shërbimeve raportuan se një numër viktimash të huaja ishin testuar me HIV pozitiv. Dhe në Moldavi, që nga viti 2000 IOM kish ndihmuar nëntë viktime me HIV+. Problemi i infeksionit HIV/AIDS doli në dritë në rajon, kur në vitin 2004, një grua ukrainase, e trafikuar për shfrytëzim seksual në Bosnje-Hercegovinë vdiq nga kjo sëmundje (Surtees 2005: 74, 155, 361).

ishin larguar fillimisht nga shtëpitë, por tani kjo varësi krijonte pengesë të rëndë për ndihmën dhe ri-integrimin e tyre:

Po të më shërohej burri nga alkoolizmi, do të isha gruaja më e lumtur në botë.

E shikoni, [prindërit e mi] janë të alkoolizuar dhe ata nuk ishin në gjendje të kuptonin se çfarë mund të më ndodhte mua. Por, unë nuk i bëj me faj. Për më tepër, [trafikanti] ua paguante pijet.

Për viktimat, të cilat mund të mos kenë opsione të tjera por veçse të kthehen në shtëpi, abuzimi me lëndët narkotike mund të përbëjë rrezik serioz dhe ndërlikime brenda familjes. Kjo nënvizon rëndësinë e përfitimit nga programet e dizintoksimit dhe të abuzimit me lëndë narkotike jo vetëm për viktimat, por edhe për rrethin e tyre të ngushtë.

Ndihma për familjen në tërësi

Në rrethana ideale, ndihma duhet të marrë parasysh situatën specifike familjare të personave të trafikuar dhe, sa herë që të jetë e mundur, të kërkojë të trajtojë nevojat më të përgjithshme të familjes. Në një rast, një viktimë tregoi sesi kishte pranuar ndihmën pikërisht sepse vëllazëria e tij ishin në hall: “[Pranova ndihmën] sepse mendova se vellezërit dhe motrat e mia më të vogla se unë, kishin nevojë për ndihmën e ofruar”. Në rastet kur problemet familjare – qofshin sociale apo ekonomike – kanë kontribuar në një farë mënyrë për trafikimin, kjo është me të vërtetë një nevojë urgjente.

Është po ashtu me rëndësi të vihet në pah që, problemet mund të lindin dhe lindin nëpër familje – madje edhe në rastet më të suksesshme të procesit të ri-integrimit – të cilat pengojnë rikuperimin e viktimës. Një grua shpjegoi sesi kishte filluar vetë një biznes të vogël dhe po ecte mjaft mirë. Por, kur i doli një problem sado i vogël ekonomik, asaj i lindën probleme të tjera, të cilat arritën të zgjidhen vetëm nëpërmjet një ndihme për atë qëllim:

[Organizata] më ndihmoi që të fillojë një biznes të vogël, që merrej me shitjen e veshjeve të përdorura. Ajo periudhë për mua ishte e shkëlqyeshme. Biznesi po ecte gjithmonë e më mirë nga viti në vit. Unë isha shumë mirënjohëse, por nuk e mbajta fjalën që në atë biznes të investoja paratë e fituara. Ndodhi që prindërit e burrit tim të sëmuren. Dhe për mjekimin e tyre kisha nevojë për shumë para.

Meqenëse organizatat ndihmuese ishin në gjendje që t'i përgjigjeshin nevojave emergjente të kësaj gruaje dhe familjes së saj – kurat mjeksore dhe një farë mbështetje humanitare – u bë e mundur për këtë grua që ta risjellë biznesin në vijë. E rëndësishme për t'u vënë re në këtë rast është se, organizatat ndihmuese e bashkërenduan ofrimin e shërbimeve në mënyrë që t'i përgjigjeshin nevojave të ndryshme të saj, duke mundësuar një ri-integrim të suksesshëm të viktimës. Shembuj të tillë nënvizojnë faktin që ri-integrimi nuk varet gjithmonë vetëm nga viktima, dhe se problemet që hasen në familje apo në komunitet mund të pengojnë procesin e rikuperimit dhe të ri-integrimit. Për këtë arsye, ofrimi i shërbimit për familjen e viktimës ose i një mbështetjeje shtesë, kur familja është në krizë, mund të shërbejnë jo vetëm për galvanizimin e sukseseve të procesit të rikuperimit, por për parandalimin e dështimit të ri-integrimit, dhe në disa raste, të ri-trafikimit.

Kujdesi afat-gjatë për viktimat që nuk mund të kthehen në familjet e tyre

Disa viktima vijnë nga rrethana familjare që nuk mundësojnë rikuperimin dhe ri-integrimin e qendrueshëm. Në një numër rastesh, viktimat vinin nga familje problematike, ku kthimi në shtëpi do të thoshte të jetoje në një mjedis abuziv, pre e lëndëve narkotike, me mungesa të mjeteve bazike për jetesë dhe/ose e ri-trafikimit. Në raste të tjera, viktimat thjesht nuk kishin shtëpi, ku mund të ktheheshin, dhe ofrimi i kujdesit afat-gjatë, përfshirë strehimin, në shumë vende përbëjnë një hendek serioz, e të vështirë për t'u kapërcyer.

Për të miturit, alternativat e kësaj lloji ndihme ishin jashtëzakonisht të kufizuara, dhe në ato raste kur kujdesi afat-gjatë mungonte, disa viktima u kthyen në situata të rrëzikshme. Një vajze e re, që kishte qenë shitur nga e ëma, u kthye tek [njerku i saj abuziv] pas një kohe të shkurtër qëndrimi në strehëz: “Do të kisha qëndruar [në strehëz] më gjatë..., pas gjithë asaj që më ka bërë nëna ime, me siguri nuk do të kthehesha në shtëpi, njerku abuzonte me mua, nuk do të kisha shkuar prapë atje”.

Ndihma e specializuar dhe psikiatrike

Në shumë vende, mundësia për një ndihmë të specializuar psikologjike për viktimat është një problem madhor, veçanërisht për zona që ndodhen larg kryeqendrës së vendit. Për shkak të problemit të mungesave burimore, në shumë vende punonjësit socialë kryejnë këshillimin psikologjik me viktimat e trafikimit, duke trajtuar edhe çështje të vështira të shëndetit mendor. Mundësia për ndihmë profesionale psikologjike dhe psikiatrike ofrohet më së shumti në programet rezidenciale, megjithëse lloji dhe numri i këshillimeve ndryshon sipas kohës

që duhet të rri përfituesi në një strehëz. Për rrjedhojë, këshillimi i ofruar në një strehëz ri-integrimi afat-gjatë, është më gjithëpërfshirës se sa në strehëza afat-shkurtra, të cilat priren të përqendrohen mbi stabilizimin e përfituesit. Meqenëse pjesa më e madhe e viktimave qendrojnë në strehime për periodha të shkurtra kohe, atyre u ofrohet, përgjithësisht, një këshillim më bazik për "stabilizim". Kur viktimat kthehen në shtëpi, ofrimi i shërbimeve të duhura psikologjike është më i ndërlikuar, pasi shërbimet e specializuara këshillimore janë të vendosura nëpër kryeqendrat e vendit, në një kohë kur viktimat vijnë dhe kthehen në zona larg këtyre qendrave. Pra, lind nevoja që këshillimi afat-gjatë të mund të ofrohet nga OJQ-të e specializuara, ose punonjës të trajnuar për kujdesin shëndetësor nëpër komunitete, si pjesë përbërëse e programeve të ri-integrimit. Disa viktima ishin diagnostikuar me çrregullime psikiatrike, përfshirë skizofreninë, që kërkon një kujdes cilësor psikiatrik, i vështirë të realizohet nëpër rrethe. Edhe më të rralla janë programet psikologjike dhe psikiatrike me bazë rezidenciale (Surtees 2006b: 80).

Për shkak të një mungese të përgjithshme të shërbimeve të specializuara, një numër viktimash ishin strehuar bashkë me viktimat me sëmundje mendore. Kjo, jo vetëm që është e lodhshme për viktimat e tjera, por do të thotë që nevojat speciale të viktimës "së vështirë" nuk trajtohen si duhet. Një viktima e përshkroi përvojën e saj në strehim: "Po, dhe pastaj na çuan në një shtëpi ... një vajzë kishte probleme me kokën. Ajo është e çmendur, ajo thjesht mund të vriste dikë nga ne". Një tjetër e shpjegoi situatën në strehëzën ku ndodhej:

Kështu ishin rreshtuar krevatet. Kishte pese krevate në atë dhomë. Dhe atje ishte ajo vajza, krevati pranë saj ishte bosh, unë flija te ky këtu, një tjetër atje, dhe një tjetër në atë vendin pak më larg ... një përfituese ishte me çrregullime mendore dhe ishte në mjekim, por ajo nuk i merrte ilaçet. Ajo kishte haluçinacione, shikonte gjëra në ëndrra. Ajo shpesh ngrihej dhe ecte në gjumë.

Gjithsesi, ky rast ndriçon situatën e vështirë që ndeshet në shumë vende, ku nuk kishte kushte të përshtatshme për viktimat, që kishin nevojë për ndërhyrje psikiatrike ose psikologjike. Kur, si në këtë rast, individit i mungon mbështetja familjare, mbeten pak alternativa të tjera, përveç kthimit në programin e strehimit: "Ajo kishte haluçinacione, ishte larguar disa here, por kthehej prapë. Nuk kishte prindër dhe as njerëz të afërt". Gjetja e opsioneve të duhura për këtë profil përfituesish nuk është pa ndërlikime, qoftë për ndihmë afat-shkurtër apo afat-gjatë.

Ndihma për viktimat me të meta

Trafikimi i personave me të meta, qoftë mendore apo fizike, është dokumentuar si në drejtim të ashtu dhe brendapërbrenda rajonit të SEE-s.⁴⁸ Shërbimet duhet të ndryshojnë dhe të personalizohen sipas nevojave individuale e të përcaktuara rast pas rasti. Kjo, përgjithësisht, përfshin shërbimet e specializuara mjeksore, përfaqësimin e specializuar ligjor, caktimin e një kujdestari ligjor për viktimat me të meta mendore, opsionet e strehimit afat-gjatë, trainime të specializuara, punësim në një vend të mbrojtur pune dhe ndjekje afat-gjate të rastit. Viktimat me të meta mund të kërkojnë, gjithashtu, ndihmë për kontaktimin dhe komunikimin me ofruesit e shërbimeve dhe agjencitë shtetërore në lidhje me mbrojtjen ligjore.

Sot për sot, opsionet e disponueshme për personat me të meta janë të kufizuara. Një grua, e trafikuar për lypje, jo vetëm që ishte e verbër dhe shurdhe, por edhe e moshuar. Për rastin e saj opsionet ishin të pakta dhe ofruesit e shërbimeve patën probleme për të kontaktuar shërbimet për të cilat ajo kishte nevojë, përfshirë strehimin dhe operacionin e vështirë për t'i risjellë asaj një farë shikimi. Në të njëjtën mënyrë, gjetja e mundësive të duhura për arsimimin dhe punësimin e personave me të meta është tepër e vështirë. Një grua ndeshi me probleme për të gjetur një punë të qëndrueshme për shkak të epilepsisë së saj.

Edhe unë kam problem të rëndë shëndetësor. Jam epileptike dhe asnjë nuk do të më marrë në punë. Edhe po ta fshehë këtë fakt, më pushojnë menjëherë sapo më bie kriza e parë. Zakonisht më vjen kriza, kur nervozohem ... Nuk mund të gjejë një punë. Isha gati të punoja në fushë për disa fermerë, por asnjëri nuk ka kurajon të më punësojë, sapo marrin vesh për sëmundjen time.

Një tjetër ndërlikim që paraqitej ishte, se një ndihmë e tillë e specializuar është e kushtueshme dhe jashtë burimeve të çdo lloj organizate apo institucioni. Ky nuk është problem vetëm për rajonin e SEE-s. Për shembull, në Kanada

⁴⁸ Viktima me të meta ishin ndihmuar në Shqipëri, Bullgari, Kroaci, Maqedoni (FYROM), Moldavi, Mal të Zi në Territorin e Kosovës nën Administrimin e OKB-s, Rumani dhe Serbi. Për shembull, në Moldavi, midis 672 viktimash të ndihmuara nga IOM Chisinau, nga viti 2001 deri 2004, 15 përqind ishin me të meta mendore që në rekrutim, dhe përbënin shifrën prej 9.9 përqind të viktimave të ndihmuara në 2001, 9.3 përqind në 2002, 14.5 përqind në 2003 dhe 6.3 përqind në 2004. Po kështu, një numër viktimash të ndihmuara në 2003 ishin me të meta fizike. Në Serbi në 2004, një viktimë, e trafikuar për shfrytëzim seksual (ose 8.3 përqind) ishte me të meta mendore, ndërsa 28.6 përqind e viktimave serbe, të ndihmuara në 2004, ishin me të meta mendore ose fizike (Surtees 2005: 256, 344, 371, 501).

ekzistojnë shumë pak programe për njerëzit me të meta, të abuzuar, dhe, përgjithësiht, organizatat përkatëse dështojnë në përpjekjet e tyre për të trajtuar nevojat e personave me të meta. Ekziston, gjithashtu, mungesa e njohurive në lidhje me mënyrat e zgjidhjes së problemeve që hasin njerëzit me të meta, të abuzuar, si dhe në lidhje me qendrimet që duhen mbajtur nga ofruesit e shërbimeve ndaj këtij grupi të shënjuar (Cooper et al 2004: 35).

Viktimat meshkuj të trafikimit

Viktimat meshkuj përbënin një minoritet për t'u shënuar ndër viktimat e ndihmuara në vitet 2003 dhe 2004 në rajonin e SEE-s.⁴⁹ Megjithatë, viktimat meshkuj nuk mund të përshtaten lehtë brenda modeleve ekzistuese të ndihmës. Pjesërisht, sepse ndihma më e madhe është ajo e bazuar mbi modelin rezidencial dhe e personalizuar specifikisht për gratë. Kushtet e sotme nuk mund të përdoren për një vendosje mikse të viktimave. Një i intervistuar, një mashkull i rritur, i trafikuar në ish Bashkimin Sovjetik, u kthye në shtëpi dhe e gjeti atë të zënë nga të tjerët; nuk kishte vend tjetër ku të mund të rrinte. Po kështu, një djalë 16 vjeçar, i trafikuar për lypje brendapërbrenda SEE-s, u vendos përkohësisht në strehimin për viktimat (femra) të huaja, në pritje të rregullimit të dokumenteve të tij, por meqenëse strehimi nuk ishte i pajisur për qendrimin e një mashkulli të pashoqeruar, dhe meqenëse nuk u identifikuan shërbime të tjera të disponueshme, ai u dërgua në shtëpi me tren, i pashoqëruar vetëm pak ditë më pas, pavarësisht se e ëma ishte e përfshirë në trafikimin e tij (Surtees 2005; cf. Surtees 2006b). Për këtë arsye, mungesa e ndihmës për meshkuj, jo vetëm që mund të përkthehet në një dështim në përmbushjen e nevojave të tij, por mund edhe ta nxjerrë atë zbuluar ndaj shfrytëzimit, madje edhe ndaj ri-trafikimit.

Gjithsesi, edhe në ato raste kur disponoheshin (dhe ishin shumë të nevojshme) forma të ndryshme të ndihmës – për shembull, kujdesi mjekësor, këshillimi, ndihma ligjore – burrat nuk ishin gjithmonë të prirur të kërkonin apo ta pranonin atë:

Pikësëpari, për ata është e vështirë nga pikëpamja psikologjike ... ata nuk tregojnë të gjitha hollësitë e përvojës që kanë kaluar, megjithëse një koleg i imi më tha gjëra jashtëzakonisht të tmerrshme. Për shembull, shumë meshkuj shfrytëzohen fizikisht deri në shkatërrim. Por ata nuk e shprehin këtë dhe as nuk kërkojnë ndihmë mjekësore.

⁴⁹ Viktima meshkuj ishin ndihmuar në Shqipëri, Bullgari, Kroaci, Moldavi, Mal të Zi, Rimani, Serbi, në Territorin e Kosovës nën Administrimin e OKB-s, të trafikuar për punë, lypje, krime dhe birësime. Për shembull, në Shqipëri, 70 përqind të viktimave të trafikuar për punë, lypje ose krime në 2003 dhe 2004 ishin meshkuj, dhe 47.8 përqind të viktimave të huaja të trafikuar për punë në Serbi në 2004, ishin meshkuj (Surtees 2005: 13).

Dhe shumë nga ata nuk shkojnë të vizitohen tek mjeku i tyre, [por] vazhdojnë të vuajnë nga disa sëmundje kronike, duke patur probleme me shtyllën kurrizore, stomakun, hernian.

Sipas të intervistuarvë tanë, do të ishin vetëm situatat jashtëzakonisht të këqija, që do t'i bindnin burrat të pranonin ndihmën:

Vetëm kur kanë probleme të rënda me shëndetin e tyre, ose kur nuk ka asnjë vend ku të shkojë. Mesa di unë, burrave nuk u pëlqen të humbasin kohën nëpër doktorë apo të rrijnë larg familjes. Siç ju thashë, është më e vështirë për ta të pranojnë ndihmën, dhe kur pranohet, ajo duhet të jetë e menjëhershme (sa pa ndërruar mendjen) dhe për një periudhë të shkurtër kohe.

Pjesërisht, arsyeja mund të jetë se për t'u vetë-paraqitur si "viktimë" mund të mos përputhet me ndjenjën prej mashkulli që ka një burrë. Në shumë komunitete, të jesh burrë do të thotë të jesh i fortë, i vetë-mjaftueshëm dhe i zoti për t'u kujdesur jo vetëm për vete, por edhe për familjen:

Burrat mendojnë se janë më të fortë dhe se duhet të gjejnë rrugën për të dalë nga situatat e vështira, pa kërkuar ndihmë nga të tjerët.

Shumë burra nuk tregojnë se çfarë u ka ndodhur. U vjen turp nga fakti se u mashtruan dhe u gënjyen. Asnjëherë nuk do të duan të kërkojnë ndihmë nga organizatat, sepse të afërmit e tyre do të tallen dhe qeshin me ta. Një burrë duhet t'i rregullojë vetë problemet që ka.

Vendimet në lidhje me ndihmën lidhen jo vetëm me mendimin që krijon për vetveten, por edhe me perceptimin social. Pranimi i ndihmës i identifikon meshkujt në sytë e familjes dhe/ose të komunitetit sikur janë migrantë të dështuar, ose si migrantë të trafikuar, dhe asnjëra nga këto nuk është e pranueshme nga ana shoqerore për ta. Edhe në këtë rast, shfaqet imazhi social i burrërisë:

Kur vijnë në shtëpi janë të kënaqur nëse sjellin ca para. Ndryshe si do të mund të justifikohet mungesa e tyre në familje? Dhe në rast se u thonë familjeve se u duhen para për ndonjë trajtim – kostot e trajtimit mjeksor janë mjaft të larta në vendin tonë – atëherë do të dilte në dritë sekretet e tyre.

Unë as që mund të besoj se njerëzit si unë [viktima të trafikimit] ndihmohen ... më dukej se nuk duhet të ketë organizata të specializuara

për të ndihmuar njerëz si unë, dhe aq më tepër, për burra. ... E dini, në komunitetin tim njerëzit mendojnë se në rast se një burrë është futur në një situatë të tillë, atëherë ai është i metë.

Në përgjithësi, në komunitetin tonë burrat nuk duhet të ankohen për asgjë. Burri duhet të jetë i fortë, të kalojë të gjitha vështirësitë me vullnet e durim.

Pavarësisht nga këto ndeshje me publikun e gjërë, gjithsesi pranohet nëpër mjediset e anti-trafikimit, që burrat janë njëloj të zbuluar ndaj trafikimit dhe kanë nevojë për ndihmë. Dhe, meqenëse po pranohet gjithmonë e më tepër se edhe burrat trafikohen, është koha që t'u kushtohet më shumë vëmendje identifikimit të nevojave të tyre specifike për ndihmë. Ky studim zbuloi, duke u bazuar mbi një kampion të kufizuar rastesh të dymbëdhjetë meshkujve (të rritur dhe të mitur) të trafikuar, se përtej mundësive të strehimit, të ndihmës mjeksore, ekziston një tjetër fushë kryesore e ndërhyrjes, ajo e shqyrtimit të nevojave për rastet kur shfrytëzohen/trafikohen për punë: "Disa prej tyre vuajnë shpërthime akute të sëmundjeve, dhe ndodhen në një vend të huaj ku, për më tepër, punojnë në mënyrë të paligjshme". Edhe viktimat e tjera shfaqën probleme psikologjike dhe trauma. Në rastet kur burrat kanë familje në ngarkim, atëherë ka mundësi që të kërkohet ndërhyrja e nevojshme për familjen në tërësi (siç u diskutua dhe më lart). Identifikimi i nevojave të tjera, është një hap tjetër, i domosdoshëm.

Përveç natyrës së shërbimeve, viktimat meshkuj diskutuan edhe mënyrën sesi ofrohen këto shërbime. Fshehtësia ishte një fakt i rëndësishëm për meshkujt e intervistuar për këtë studim, dhe është e domosdoshme të gjindet se cila do të ishte mënyra më e mirë për të arritur deri tek burrat dhe djemtë, të ekspozuar ndaj trafikimit, duke siguruar, në të njëjtën kohë, fshehtësinë e tyre:

Do të ishte mirë që edhe informacioni që merret nëpërmjet linjës telefonike (helpline) të mbetet i fshehtë. Për shembull, që asnjë nga organizatat e tjera, përveç asaj që e administron këtë shërbim (helpline) të mund të ketë qasje në rrjet.

Nuk mendoj se ata burra do t'i drejtohen një organizate shtetërore, sepse ata mendojnë që ky informacion do të shndërrohet shpejt në lajm publik. Kryeplaku i fshatit dhe punonjësi i policisë do ta merrnin vesh të parët.

[Ndihma duhet të organizohet] në një mënyrë të tillë që të mos e marrë vesh njeri. Vetë personi duhet të shkojë tek vendi ku ofrohet ajo ndihmë. Sa më larg që të jetë ky vend nga shtëpia, aq më shumë siguri ka që

të mos merret vesh. Vetëm nëqoftë se personi është i sëmurë rëndë dhe nuk mund të lëvizë, atëherë ndihma duhet të ofrohet në shtëpi, por tanimë asnjëri nuk do të jetë më xheloz për të.

Po ashtu e rëndësishme është “shitja” dhe “paketimi” i këtyre shërbimeve, për të siguruar që këta persona të dijnë se ku gjenden dhe të përfitojnë prej tyre. Reklamimi i shërbimeve duhet të marrë parasysh se cili mesazh do të ishte mesazhi i duhur dhe i arritshëm për audiencën mashkullore, duke vlerësuar përgjegjësinë dhe ndjeshmërinë e meshkujve, siç u diskutua më lart. Gjuha është shumë e rëndësishme në këtë drejtim. Meqenëse koncepti “viktimë” mund të mos pritët mirë nga shumë burra, përpjekjet do të rezultojnë më të suksesshme nëse në këto mesazhe do të flitet për “migrantë”, ose “punëtorë”.

Mendoj se pas një njoftimi apo reklame që njofton se burrat mund të ndihmohen, për shembull me ndihmë mjeksore (por nuk duhet përmendur ndihma psikologjike, sepse shumë burra kanë frikë nga këto fjalë), ose me llojet e tjera të ndihmës, si ndihmë ligjore ... mendoj se shumë burra do të bien dakord të marrin ndihmë mjeksore falas, sepse shumë prej tyre, që janë shfrytëzuar për punë, nuk kanë të holla për mjekimin e tyre. Njoftimi mund të jepet edhe në radio dhe zëri që do të lexojë njoftimin mbi ndihmën e mundshme për burrat viktime të shfrytëzimit (besoj se duhet përdorur fjala ‘shfrytëzim’, sepse njerëzit nuk e kuptojnë se ç’është trafikimi), të jetë zë burri. Dhe, nëse është e mundur, të mos përdoret termi “viktimë”, sepse burrave nuk u pëlqen të jenë viktime. Ajo bie në kundërshtim me imazhin e një burri të vërtetë. Nuk besoj se burrat do t’i besojnë një njoftimi të lexuar nga një grua. Kjo duhet të bëhet vetëm nga një burrë, ndoshta nga një burrë që ka kaluar një përvojë të tillë. Mesazhi duhet të jetë i shkurtër dhe bindës, ku të theksohet ndihma e mundshme që ofrohet.

Sigurisht që duhet përdorur [një zë burri]. Kjo i jep besim burrave. Është e nevojshme që të bëhet një spot, ku personi që ka vuajtur shpjegon shkurtimisht përvojën e tij të shfrytëzimit. Mund të jetë një burrë që me të vërtetë ka vuajtur, ose një aktor jo shumë i famshëm, se ka rrezik të tingëllojë artificial, melodramatik ... Nuk e di...rruga më e suksesshme është njoftimi në TV ose radio. Por, siç e thashë dhe më parë, është tepër e rëndësishme që të zgjidhen fjalët që do të përdoren në njoftim.

Por mesazhi i [ndërgjegjësimit] duhet të jetë i shkurtër dhe bindës, dhe nuk duhet të përdorni fjalën ‘viktimë’.

Ndihmë për viktimat më të moshuara

Një numër të intervistuarish ishin në moshë të thyer, madje edhe pleq – disa rreth 50 e 60 vjeç, dhe një tjetër 75 vjeç. Disa ishin trafikuar pikërisht sepse ishin të moshuar, ata nuk kishin të ardhura të mjaftueshme për të mbajtur veten dhe nuk kishin qasje tek ndihma e shtetit. Prandaj, ofrimi i ndihmës këtij grupi, shpesh do të thoshte përkushtim më i madh ndaj mundësive ekonomike dhe kushteve të strehimit.

Ata më thanë se do të më ndihmonin të marrë pasaportën dhe të përfitojë pensionin. Në rast se nuk to të ketë mundësi të jetojë në shtëpinë time, shpresoj të më vendosin, të paktën, në një strehim për njerëz të moshuar në [kryeqytet].

Mendoj se ka shumë njerëz të moshuar që nuk gëzojnë kujdesin e fëmijëve të tyre, dhe nuk kanë as TV dhe as radio. Si unë, që nuk di se ku të drejtohem për ndihmë.

Kam marrëdhënie të mira me djalin tim ... [djali dhe gruaja e tij] kujdesen për mua. Por unë ndihem me faj, se nuk e njoftova kur po e shitja apartamentin tim. Dhe tani varem nga shtëpia dhe familja e tij. Këtu ka shumë pak vend.

Viktimat e moshuara mund të kenë nevojë edhe për forma të tjera të ndihmës, përfshirë ndihmën e specializuar mjeksore, ndihmën ligjore dhe mbështetje për strehim. Përveç formave specifike të ndihmës, është, po ashtu me vlerë, shqyrtimi i ndikimit të trafikimit mbi njerëzit në moshë, i parë në krahasim me atë mbi të rinjtë. Shumë pak dihet mbi shqetësimet dhe nevojat specifike të viktimave më të moshuara të trafikimit, dhe sesi e përjetojnë ato jetën para dhe pas trafikimit.

Kapaciteti profesional, trajtimi i viktimës dhe cilësia e kujdesit

Njihet gjërësisht që shërbimet për personat e trafikuar duhet të jenë falas, të arritshme dhe jo-turpëuese dhe se aktorët e anti-trafikimit duhet të jenë të mirë-treinuar dhe të ndjeshëm ndaj popullatave të cënueshme, përfshirë personat e trafikuar. Dhe shumë të intervistuar folën shumë mire, jo vetëm për cilësinë dhe qëllimin e ndihmës që merrnin, por edhe për trajtimin e tyre nga ana e personelit të anti-trafikimit. Ata theksuan se sa e rëndësishme ishte ndihma për ta në procesin e rikuperimit.

Jam e kënaqur me personelin, sepse tregohen të ndjeshëm ndaj problemeve tona. Na nxjerrin jashtë, për shëtitje. Më pëlqen, sepse kemi gjithçka, dhe gjithçka është falas. Jam shumë e lumtur sepse ndjek këtë shkollë. Asnjëherë nuk mendoja se do të mund të përfundojë shkollën. Nuk turpërohem më, kur dikush më thotë të hedh firmën, ose të lexojë diçka, nuk më duhet më të them se, 'nuk di'.

[Më pëlqente] sjellja, thjeshtësia dhe një farë binjakëzimi i shpirtrave me të. Për mua, në përgjithësi, është e vështirë sot të gjesh person të besuar.

Një përvojë pozitive është sjellja e mirë e personelit të strehëzës. Kanë kujdes për mua. Nuk kemi patur ndonjë përvojë negative.

Megjithatë, të intervistuarit tanë raportuan mbi rastet, kur nuk ishin plotësisht të kënaqur me shërbimet dhe trajtimin që merrnin dhe vunë në pah disa çështje shumë serioze në lidhje me ofrimin e shërbimeve. Këtu përfshinin moskokëçarjen dhe diskriminimin e profesionistëve të anti-trafikimit; dallimet midis një profesionisti me një tjetër dhe kushtet e përkujdesjes; dhe madje trajtimin e keq dhe abuzimin në trajtim. Në përmbledhje, mungesa e monitorimit dhe e sigurimit të cilësisë së domosdoshme ndikojnë për keq në mbarëvajtjen e çështjeve të mësipërme.

Mospërfillja dhe diskriminimi nga ana e profesionistëve anti-trafikim

Për shumë viktime, trajtimi i mirë dhe jo "përbuzës" është vendimtar në procesin e rikuperimit. Kur pyeteshin se çfarë nënkuptonin ata me 'trajtim të mirë', shumë thanë se me trajtim të mirë nënkuptonin trajtimin "sikur të ishim një nga ata". Ishte mirë. Na trajtonin këndshëm, tamam sikur të ishim një nga ata.

Dhe për personelin që punon këtu në [organizatë], thjesht më pëlqejnë. Nuk të shikojnë duke të gjykuar, mund të flasësh me ta mbi çdo gjë. Ata të kuptojnë dhe të shpjegojnë gjërat. Të dëgjojnë, të thonë sesi duhet vepruar, të ndihmojnë gjithmonë.

Nuk e ndjeja dallimin midis nesh. Kjo është mënyra që jam mësuar.

Po të lexohet së prapthi, do të kuptohet se sa të vrarë dhe të ofenduar e ndjenin viktimat veten, kur trajtoheshin ndryshe dhe me moskokëçarje nga profesionistët, që ishin atje për t'i ndihmuar:

Një vajzë ishte krejtësisht e lojtur nga mendja, nuk ia mbaj mend emrin. Ajo na trajtonte sikur të kishim sëmundjen e lebrës. Përdorte filxhanin

e saj, dhe sillte gjithçka nga shtëpia, pa prekur asgjë nga tonat, sillej si snobe, e tmerrshme.

Nuk mund të veprohet kështu. E kam fjalën se çdo njeriu që ka kaluar, të themi, diçka të keqe në jetë, do t'i pëlqente të vinte tek ne... dhe ju bëni kafe për të gjithë dhe i jepni një filxan edhe asaj. Dhe ajo fillon, jo, jo, jo, jo nuk mund të pi kafe me filxhanët tuaj, do ta pi vetëm me timin. E pastaj... E kam fjalën, ku është problemi?! Them se ajo thjesht nuk dinte të sillej me ne.

Po, e drejtë, mund ta thuash me plot gojën se ata nuk na trajtonin si njerëz të barabartë me to. Po, po, absolutisht.

Viktimat folën veçanërisht për disa grupe profesionistësh që silleshin me mospërfillje dhe diskriminim. Mjekët profesionistë ishte njëri nga këto grupe, dhe si viktimat ashtu dhe ofruesit e shërbimeve, bën disa komente shumë të forta në këtë drejtim. Një punonjës i një OJQ-je tregoi sesi një doktor, të cilit i ishin drejtuar për shërbim mjeksor, u tregua brutal dhe mospërfillës; "Nuk kam mbaruar për mjeksi unë, që të vizitojë prostituta". Viktimat përshkruan të njëjtat sjellje:

Më çuan te doktoresha e tyre. Ajo më pyeti, ajo gjinekologja: "Përse e ke bërë?"... Po, bëri këto komente. Si të përgjigjesha unë, nuk jam e vetmja. Janë me mijra vajza që kanë kaluar nëpër këtë. [U ndjeva] keq. Nuk ke pse të gjykosh dikë, të cilën e kanë detyruar të veprojë ashtu. Nuk ishte punë e saj. Puna e saj është të bëjë për çfarë është thirrur, dhe të mos bëjë pyetje të tilla ... Na priti se kishte lidhje me atë gruan e strehëzës dhe ne i kërkuam një kontroll. Ishte e sjellshme, por bëri komente.

[Mjekja] më tha të ngreja mëngët. I ngrita mëngët që të kontrollonin nëse merrja drogë. Ajo tha: "Mirë, ngreje këmishën, të të kontrollojë stomakun". Ngrita këmishën. Pastaj filloi të më kontrollonte kokën, të më tërhiqte flokët. Ai [polici] i tha asaj: "Mirë, mjaft, boll e bezdise. Mund të kuptohet që nga larg se vajza është e pastër". Ajo iu përgjigj se po bënte punën e saj dhe se duhej ta bënte. Dhe ai prapë: "Mos e lodh më. Nuk e shikon se është e trembur? Ajo as nuk ha dot". U kënaqa që ai mbajti anën time ... [Ndihesha] tmerrësisht keq. Mendoza, dale njëherë, çfarë jam unë? Kafshë, që ajo të më trajtojë kështu?

Arrin ta kuptosh. Kur ajo doktoresha më kontrollonte, ajo sillej sikur i vinte ndot të më prekte.

Në disa vende, kjo moskokëçarje i ka detyruar ofruesit e shërbimeve të kontaktojnë mjekët privatë (të ndjeshëm), të cilët, megjithëse të shtrenjtë dhe jo të disponueshëm për kohë të gjatë, e trajtojnë viktimën me një farë simpatie dhe përçojnë menjëherë tek to një ndjenjë qetësie.

Nuk ishte vetëm personeli mjekësor që ishte problematik në këtë drejtim. Në një numër situatash, viktimat folën për keqtrajtim nga ana e profesionistëve ligjorë, madje shpesh dhe nga ana e përfaqësuesve të tyre ligjorë, që e kishin për detyrë t'i përfaqësonin në procedimet ligjore. Një viktimë tregoi sesi i kishte bërë titur dhe e kishte ofenduar avokati i saj:

Ai gjithmonë më bërtiste. Më thoshte së çfarë duhej të tregoja në gjyq. Kur nuk thoja ato që deshte ai të dëgjonte nga unë, ai ulërinte. Njëherë, kur po dilnim nga gjykata, ai më tha se nuk isha për asnjë gjë, dhe se ai ishte i prirur të besonte më shumë trafikantin se sa mua.

Moskokëçarja dhe diskriminimi dukej se nuk vinte vetëm për shkak të trafikimit, por në disa raste, për shkak të racizmit. Një viktimë nga etnia rome e lidhi keqtrajtimin që i bëhej më shumë me etnicitetin e saj, se sa me statusin e të qenit e trafikuar:

Unë nuk u thashë se isha një viktimë e trafikimit. Kisha nevojë për para që të merrja çertifikatën e lindjes për fëmijën tim. Në zyrën e shefit më trajtuan keq. Qeshnin me mua se nuk kisha [afërsisht pesë Euro] për çertifikatën, u ndjeva e poshtëruar.

Një tjetër e intervistuar shpjegoi sesi diskriminimi kundër saj si person [nga një minoritet etnik] kishte ndikuar mbi aftësinë e saj që të kontaktonte shërbimet shtetërore:

[Organizata] iu drejtua zyrës së kryeplakut të fshatit ku kisha lindur, për t'i kërkuar që të më ndihmonte mua, ose, për të qenë më të saktë, fëmijët e mi. Shtëpia ku kisha lindur ishte shkatërruar shumë kohë më parë, dhe në vend të saj ishte ngritur një e re. Kryeplaku duhej të më siguronte një farë banese, në vend të së parës. M'u dha një shtëpi krejtësisht e shkatërruar, pa dritare, pa dyer, pa çati. Gjysma e kësaj shtëpie prej balte nuk ekzistonte më. Kishte mbetur vetëm një dhomë. Kryeplaku (grua) më premtoi se do të më siguronte ca materiale ndërtime për të ndrequr disi atë shtëpi. Iu deshën përpjekje shumë të mëdha avokatit [të organizatës] që të rregullonte të gjitha këto gjëra. Kur shkova te zyra e kryeplakut, ajo filloi të më bërtiste dhe ma mbylli derën në fytyrë. Pastaj e dëgjova duke debatuar me dikë në telefon

dhe thoshte: “Kjo grua [nga minoriteti etnik] kërkon ca si tepër”. Avokati im më rekomandoi të shkoja te [departamenti i mbrojtjes së fëmijëve], i cili supozohej t’i ofronte ndihmë fëmijës tim. Kur shkova atje, m’u refuzua. Ata thanë se nuk mund të më ndihmonin fare. Filluan të më pyetnin me egërsi se kush më kishte adresuar tek ata dhe unë ua thashë emrin [e organizatës ndihmuese]. Madje, edhe u grindta me ta. I pyeta se çfarë detyre kishin dhe sesi mund të më ndihmonte shteti. Si do t’u kishte vajtur halli nënave beqare, që ishin në një gjendje më të keqe se e imja. Më thanë, “Kush të tha të bësh kaq shumë fëmijë?”

Në një situatë tjetër, një viktimë foli për një frymë të përgjithshme dhe qendrim negativ ndaj grupeve lehtësisht të cënueshme: “Mendoj se nëpër organizatat shtetërore, që merren me ndihmën për të varfërit, punojnë njerëz që nuk dijnë të sillen. Nuk mjafton shkolla që ke bërë”. Një tjetër komentoi, “Jam mërzitur me organizatat shtetërore. Do të dëshiroja të silleshin më me takt me viktimat e trafikimit”.

Më përgjithësisht, viktimat raportuan edhe për raste të mospërfilljes dhe të paragjykitimit nga ana e ofruesve të ndryshëm të shërbimit. Siç u shqyrtua në seksionin e mëparshëm, viktimat pësojnë shumë fyerje dhe diskriminim, sepse shikohen nga shoqëria— si “prostituta”, “të huaja” dhe “migrantë të dështuar”. Në disa raste, viktimat folën për incidente ku kjo frymë sociale shprehej edhe brenda kuadrit të programeve të ndihmës.⁵⁰ Një grua foli për problemet që kishte patur me një punonjëse sociale, e cila punonte te strehimi ku rrinte kjo grua. Fjala ishte për rastin kur njëra nga banoret kishte marrë një sëmundje, dhe gruaja frikësohet se mos ishte infektuar edhe ajo, meqenëse banonin në të njëjtën dhomë. Kur i kërkon punonjëses sociale që të bëjë analizat, reagimi i punonjëses ishte mospërfillës:

Kur e pashë që kjo vajzë ishte sëmurë, nuk e dija se çfarë kishte. E pyeta atë që punon këtu, se përse nuk më kishin thënë gjë. Unë vetë jam mirë, nuk kam sëmundje, por nuk dua që të më gjejë gjë para se të shkojë në [vendin tim]. Dua që të bëjë prapë analizën e gjakut, dua t’i bëjë të gjitha analizat, dhe punonjësja m’u kthye, ‘Pse s’mendove

⁵⁰ Kjo nuk është unike për SEE-n. Në një studim mbi ri-integrimin në Kamboxhia, disa ofrues shërbimesh, gjithashtu, shfaqnin paragjykitime kundrejt viktimave të trafikimit. Një punonjëse e OJQ-s dallonte tri lloje të punëtoreve të seksit – ato që e kanë në natyrë të jenë punëtore seksi, ato që detyrohen kundër dëshirës së tyre, dhe ato që qendrojnë ose i kthehen punës së seksit, sepse e shikojnë si një mënyrë për të fituar para shpejt. Sipas kësaj punonjëseje të OJQ-s, vetëm grupi i dytë ka vullnet të ndryshojë dhe mund të edukohet me sukses.

për këtë kur flije me gjithë ata burra' ... Asnjëherë nuk kam për ta harruar këtë. Në rast se një grua ka vendosur të punojë atje, ajo duhet të mbajë krejt një qendrim tjetër ndaj nesh.

Dallimet në kapacitetet profesionale dhe në kushtet e përkujdesjes

Shumë profesionistë anti-trafiking në rajon kanë kapacitete të larta profesionale dhe nëpërmjet punës së tyre, kanë treguar kompetenca të forta në punën dhe mbrojtjen që kanë ofruar. Megjithatë, në disa programe viktimat ndjenin se personeli nuk i kishte gjithmonë aftësitë dhe përvojën e kërkuar për t'u dhënë atyre mbështetjen që kishin nevojë, dhe shërbimet që ofroheshin nuk ishin të mjaftueshme dhe cilësore.

Ato janë mirë, por unë e ndjej se nuk mund të më kuptojnë. Janë të reja dhe pa përvojë. Më duket se vijnë këtu vetëm për rrogën. Nuk arrij të flasë me to.

Më thanë se do të jetë një shtëpi për vajza si unë, tamam si kjo. Por ishte keq. Në turne vinin gra të ndryshme, i quanin psikologe ... Kishim mundësi të flitnim me personelin, por nuk na pëlqente të flitnim me to. Thjesht nuk na pëlqenin. Ato nuk dinin si të sillleshin, si të na flitnin. [Ato thonin] se ne do të qendronim atje dhe ato do të na ndihmonin për punët. Por nuk ndihmonin ... Nuk kishim marrëdhënie me personelin. Rrinin shumë të tërhequra. Dukej sikur kishin frikë nga diçka.

Një shqyrtim që iu bë ndihmës që ofrohej për viktimat në SEE (Surtees 2006a: 24) zbuloi se jo të gjitha OJQ-të anti-trafiking zotëronin kapacitete të mira profesionale, dhe nënvizoi se edhe nga OJQ-të, ON-të dhe donatorët u vu në dukje, ndër të tjera, se duheshin bërë përpjekje më të mira për ndërtimin e kapaciteteve të nevojshme:

Disa janë të shkëlqyeshmë, disa të tjera, jo. Ka shumë nivele kompetencash dhe të profesionalizmit nëpër OJQ (përfaqësues i një ON/donator).

Kjo OJQ është OJQ-ja më e vjetër që merret me ndihmën e drejtpërdrejtë [në vend] dhe përsëri po has probleme me procesin e rehabilitimit real të viktimave. Këshilltarët nuk angazhohen tërësisht në rehabilitimin e viktimave dhe godina është e llojit të mbyllur. Gjithashtu, personelit i mungojnë idetë mbi modalitetet e edukimit të viktimave, apo për inkurajimin e tyre të përgjithshëm (përfaqësues i një ON/donator).

... është lënë menjanë puna e drejtpërdrejtë me viktimat. Zbatimi i standardeve profesionale të punës me viktimat e dhunës është i vështirë për t'u arritur (përfaqësues OJQ-je).

Për të përforcuar zbatimin e strategjive afat-gjata për punën me viktimat e trafikimit, profesionistët kanë nevojë të mbështeten dhe të trejtohen më tej, të ofrojnë një shkëmbim non-stop të informacionit në nivele të ndryshme (përfaqësues i OJQ-s).

Natyra me stres të fortë e punës do të thotë që midis radhëve të personelit të ketë një qarkullim të madh të tij, gjë që ndikon mbi nivelin dhe kapacitetin profesional. Një viktimë, e ndihmuar në BE, trajtohej nga një program ndihme prej disa vitesh dhe tha se kishte punuar me një numër të madh asistentesh: "E kush i mban mend ato, çdo pesë muaj më vinte ndonjë e re ... dhe çdo herë më duhej të filloja nga e para. Nuk kishin fare kujdes për ty, se e dinin që do të largoheshin shpejt që andej". Dhe rezultati mund të jetë që ata që do të vijnë në këto poste pune me stres të lartë, do të jenë gjithmonë e më pak profesionistë.

Edhe në sektorët e tjerë profesionalë, kapaciteti ishte nga çështjet që u vu në dukje. Një grua, e cila kërkoi ndihmë nga policia, pasi i kishte ikur trafikantit të saj, u dërgua që të bënte një kontroll mjeksor, pasi ishte sulmuar dhe përdhunuar kohët e fundit. Megjithatë, doktori jo vetëm që u suall keq me të, por as nuk e bëri ekzaminimin mjeksor që kërkohet në rastet e përdhunimit, me qëllim që të formuloheshin akuzat kriminale, dhe ajo shpjegoi:

Më çuan tek mjeku, për analizën shkencore. Por ai mjeku ishte një njeri i pafytyrë. Po të më kishte ekzaminuar mirë do të zbulonte se unë isha përdhunuar. Kisha gërvishtje këtu. ... ai, thjesht kontrolloi vulat. Isha e ënjtur shumë. Kisha njolla nëpër trup. Ai, madje edhe i mati ato... Kontrolloi qafën dhe krahun dhe tha se çdo gjë ishte në rregull. Gruaja, pranë tij që shtypte në makinë, i tha që unë duhet të shkoja te gjinekologu, sepse unë kisha qenë me shumë burra. Ai tha se nuk ishte nevoja, sepse, "ajo gjë dihet tani".

Për disa viktime edhe në sistemin ligjor dhe gjyqësor mungonin aftësitë profesionale dhe angazhimi. Një viktimë, e cila u detyrua të martohet me trafikantin e saj, dhe më pas përjetonte dhunë familjare nga duart e tij, u përball me probleme kur kërkoi hapjen e procedurave të ndarjes me të shoqin dhe kujdestarinë e vajzës. Në vend që të pranonte seriozitetin e situatës dhe dhunimet e jashtëzakonshme që kish duruar viktimja, gjykatësi kryesor u përpoq të pajtonte çiftin:

Gjykatësi, për shkak të vajzës, u përpoq që të na pajtonte. Unë thashë jo, sepse i pata dhënë shumë mundësi për t'u përmirësuar dhe ai asnjëherë nuk e bëri këtë gjë. Dhe unë nuk dua të pajtohem. Ka një thënie – ujku mund të ndryshojë lëkurën, por jo karakterin.

Trajtimi i keq dhe abuzimi në përkujdesje

Ndërkohë që në pjesën më të madhe të rasteve viktimat treguan se ishin vendosur në mjedise të përshtatshme, me kushtet e duhura e madje edhe shumë të mira, vëmendje meriton fakti që mjaft viktimat u ankuan se ishin ekspozuar ndaj kushteve të këqija, madje edhe keqtrajtimit gjatë “marrjes së ndihmës”. Një vajzë e mitur, e trafikuar për prostitucion, u vendos në një qendër që strehonte të miturit e pashoqeruar dhe të kapurit për shkelje penale. Gjatë qëndrimit të saj në atë strehë për një periudhë prej tri javësh, ajo kishte pësuar dhunë në duart e të miturve të tjerë, dhe personeli nuk bëri asgjë për t'i ndëshkuar:

Pasi iku roja, djemtë filluan të më hidheshin e të më kërkonin që “të shkoja” me ta, dhe nëqoftë se na kapnin në tualet, kërkonin të na përdhunonin. Pastaj, unë i thashë rojes, por ai u përgjigj, “e pastaj, ku na qenka problemi?”... [Roja i qendrës] nuk bëri asgjë. Ditën e dytë erdhi një burrë tjetër. Ai ishte njeri i mirë dhe e dënoi atë të parin që nuk bëri gjë. Por, përsëri asgjë, se nuk e mbajti fjalën.

Ky abuzim vazhdoi gjatë kohës së qëndrimit të saj, me një roje që nuk ndërhynte asnjëherë: “Kisha gjithmonë frikë në darkë, para se të binim të flinim, rrija me sy hapur deri në dy, tre të mëngjesit sepse djemtë i kërkonin rojes çelësin e dhomës, dhe sikur ata të hapnin derën e të na hidheshin në krevat”. Ajo shtoi, “Kisha frikë. Sikur roja të dilte jashtë për pak kohë, të gjithë djemtë të na hidheshin përsipër, dhe ai të mos bënte gjë tjetër veç të tundte kokën”. Përveç kësaj, edhe roja abuzonte me të miturit: “Roja vetëm rrinte ulur me shkopin e tij, dhe na gjuante sa herë që mendonte se ne po bënim diçka. Ishte vetëm njëri që kishte mëshirë për ne, por gjithë të tjerët vetëm sa na goditnin, nëqoftë se nuk rrinim urtë në karrike, nëqoftë se flitnim....na rrihnin për çdo gjë që bënim”.

Për t'u shënuar këtu është ndikimi i gjatë i këtij abuzimi mbi këtë vajzë, e cila ishte ende e traumatizuar nga kjo përvojë në kohën e intervistimit. Ajo shpjegoi se kushtet e “ndihmës” ishin më të këqija, se sa përvoja e saj e trafikimit.

Edhe tani, pas gjithë asaj kohe, unë e kam brenda meje frikën. Nuk më ka dalë ende plotësisht jashtë. Dhe unë lutem shumë, gjatë gjithë kohës.

Duhet të ishte më mirë. Nuk duhet të na rrahin. Nuk duhet të përdorin fjalë të këqija kur u flasin vajzave. Nuk duhet të na thërrasin në dhomat e tyre për të na "treguar" gjëra. Nuk duhet të na detyrojnë të punojmë ose të rrijmë roje. Na detyronin të bënim ushtrime me pompa çdo mëngjes dhe çdo mbrëmje.

Vetëm në sajë të një ndërhyrjeje rastësore nga një OJQ, që vajza arriti të largohet nga programi. Siç shpjegoi drejtoresha e programit: "Me po të njëjtin rast [me të njëjtin trafikant] ne kishim marrë edhe vajza të tjera për t'u ofruar ndihmë. Dhe komisari i policisë më pyeti, nëse mund ta merrja edhe atë vajzë që të qendronte me ne". Drejtoresha e përshkroi momentin kur shkoi te qendra për të miturit, për të marrë vajzën në programin e saj: "Kishte dhe fëmijë të vegjël, pesë, gjashtë vjeç, dhe kur shkova ta marrë vajzën, u tmerrova kur i pashë fëmijët pas hekurash... dhe kur hymë atje, i pamë të gjithë që rrinin në një dhomë, e madhe sa kjo, dhjetë metra katrorë, gjithë ditën prapa hekurave".

Për fat të keq, kjo nuk ishte e vetmja e intervistuar, që ishte mbajtur në kushte të pasigurta dhe jo njerëzore, ndërkohë që "ndihmohej" ose "mbrohej". Një viktimë raportoi se ishte ngacmuar dhe abuzuar nga oficerët e zbatimit të ligjit, që punonin në një qendër të administruar nga qeveria:

Ishte një grua police që u bërtiste vajzave. Ajo i godiste ato, shpesh. Një ditë ajo e la një polic të hyjë brenda. Unë u trondita kur pashë një burrë brenda. Të dy filluan të tallen dhe të më qortojnë. Ai burri filloi të hidhte ca fjalë, se më dashuronte. Ishte e dhimbshme, ofenduese, pata ndjenja të poshtërimit. Shpresoj që të kenë marrë masa [kundër tyre].

Dhe një viktimë e mitur tregoi për përvojën e saj në qendrën për të miturit, ku ajo "u ndihmua" fillimisht, pas identifikimit të saj:

Na rrihnin me një shkop. Nuk guxonin të më godisnin mua, sepse unë do t'u hidhesha në grykë. Na i ruajtën kokat, thanë se kishim morra. Talleshin me ne. Ushqimi ishte i tmerrshëm. Mezi e çonim poshtë. Ai ishte ushqim për derrat, dhe atje ishte shumë pis. Aty nuk flitej për të drejtat e fëmijës Më thanë se isha lavire, dhe për këtë arsye nuk kisha të drejta. Fëmijët që lypnin nëpër rrugë, rriheshin aq keq sa kur flinin natën, urinonin në shtrat.

Të tjerët flitnin për dhunime më pak të rënda brenda kuadrit të ndihmës, që ndoshta mund të karakterizohen më shumë si mospërfillje, por që, gjithsesi, kishin lënë ndikim mbi to:

Njëherë [organizata] më dha një bombolë gazi. Unë duhej të merrja një faturë për të, por ajo që kisha marrë nuk kishte qenë e vlefshme. Punonjësja sociale filloi të më ulërasë. Unë kërkova falje se kisha harruar të pyesja se për çfarë lloj fature kishin nevojë. Ata nuk më thanë asgjë, as nuk u përpoqën të më shpjegonin sesi e deshën.

T'ju them të vërtetën, unë desha të ikja që këtej për shkak të një personi që punon këtu ... Ajo nuk ka interes për asgjë. Nuk e çan kokën fare. Unë merrja ato tabletat në mëngjes dhe ajo nuk i sillte në kohë, as mëngjesin nuk ma sillte, asgjë fare, po të ishte për të, unë mund të kisha vdekur.

Dhe kjo vajza, që vjen e më kontrollon pesë, gjashtë herë në ditë, thërret punonjësën sociale. Dhe ajo punonjësja pastaj i ngre këmbët mbi kolltuk dhe sheh TV dhe thotë, "Eh, ç'më do ajo, edhe unë kam dhimbje. Nuk ka doktor, ku ta gjejë unë doktorin?". Njëherë unë ndihesha keq dhe po nxirrja ushqimin, ajo ishte në kuzhinë dhe ma mbylli derën në vend që të më ndihmonte. Nuk e vriste mendjen fare ... Dhe ajo vajza erdhi dhe filloi t'i bërtiste asaj: "Mos do që kjo vajzë të vdesë? E pastaj? Mos mendon se do të thuash që nuk të kam paralajmëruar? Do të jetë faji yt që nuk ke qenë këtu, pranë saj". Dhe pastaj iku me vrap jashtë dhe thirri njerëzit, por nuk kishte doktorë, dhe ajo thirri infermieret. Më kontrolluan dhe thanë se kisha apendisit akut, se apendisiti më kishte plasur. Iku përsëri më vrap dhe gjeti menjëherë një mjek, më çuan në spitalin e [qytetit të afërt].

Është e çuditshme që edhe në kohët e sotme personat e trafikuar, të intervistuar për qëllimet e këtij studimi, të përmendin keqtrajtimin dhe nivelin e ulët të kujdesit, probleme që hasen jo vetëm në SEE, por edhe në vendet e destinacionit. Sigurimi i kujdesit të duhur dhe të përshtatshëm për personat e trafikuar, por dhe për shtresat më të pambrojtura të shoqërisë, më në përgjithësi, duhet të jetë shqetësimi më kryesor.

Mungesë monitorimi dhe sigurimi të cilësisë

Një problem i rëndësishëm që del në dritë, është se sot, në pjesën më të madhe të vendeve, nuk ekzistojnë mekanizmat për sigurimin e cilësisë së ndihmës së ofruar për rastet e trafikimit; në shumë vende ky problem del, më në përgjithësi, në drejtim të ndihmës sociale dhe të mbrojtjes. Rrallë ekziston ndonjë rregullore mbi shërbimet, pa folur për faktin se shumë pak kontrole

bëhen për të parë sesi realizohet ky shërbim. Mungojnë thuajse krejtësisht mekanizmat/instrumentet për të regjistruar ankesat, por edhe në ato raste ku depozitoheshin ankesat, rastet nuk ndiqen dhe nuk trajtohen. Vetë viktimat folën për mungesën e fuqisë së tyre apo të ndikimit të tyre mbi personelin dhe në drejtim të kushteve të ofrimit të shërbimeve.

Një pyetje që mbetet pa përgjigje në lidhje me problemin e cilësisë së shërbimeve, është sesi mund të sigurohet kjo cilësi. Në këtë drejtim është problem thelbësor licencimi i ofruesve të shërbimeve, monitorimi dhe rregullimi i ofrimit të shërbimeve. Po aq të rëndësishëm janë mekanizmat për trajtimin e komenteve dhe të ankesave që vijnë nga personat e trafikuar – të parë edhe si një mekanizëm për shqyrtimin e sugjerimeve të tyre, duke qenë brenda programit të ndihmës (p.sh. për të bërë një studim mbi sa të kënaqur janë klientët), por edhe si mjet për zgjidhjen e problemeve, kur ato ekzistojnë. Ndërkohë që ka shumë programe dhe organizata, të cilat ofrojnë ndihmë optimale për viktimat, kjo nuk ndeshet në të gjitha vendet, fakt ky që tërheq vëmendjen drejt domosdoshmërisë së sigurimit të cilësisë.

Ndihma si kusht

Për disa viktimat, marrja e ndihmës lidhej (ose u përceptua sikur lidhej) me disa kushte. Në ndonjë situatë, viktimat raportuan se ndjenin presion për të bashkëpunuar me autoritetet e zbatimit të ligjit dhe se referimi për ndihmë kushtëzohej me këtë bashkëpunim. Disa herë ky ishte një presion i ushtruar nga autoritetet e zbatimit të ligjit, dhe disa herë nga ofruesit e shërbimit:

Po, [polici] tha se në rast se jap dëshmi, atëherë do të vazhdonin të më ndihmonin ... Edhe unë isha gati të jepja dëshminë, sepse kisha paraqitur kërkesën për kompensim, dhe unë desha të më ktheheshin pasaporta dhe paratë e mia.

Po, [polici] tha se nëqoftë se unë desha që të ndihmohesha për të rimarrë pasaportën time, unë duhej të jepja dëshmi kundër trafikantëve. Përndryshe, ata do të më futnin edhe në burg për falsifikim dokumentesh.

[Në strehëz] nuk më ofruan ndonjë ushqim (isha e uritur) dhe menjëherë, punonjësja sociale filloi të më pyeste se çfarë më kishte ndodhur mua [jashtë vendit]. Nuk ishte fare e këndshme që të torturoheshe me pyetje. Desha të shkoja në shtëpi. Por, ata më shpjeguan se unë duhej të qendroja atje për disa ditë, me qëllim që

të jepja dëshmi kundër atij burri që na kishte shitur në skllavëri ... po, më thanë se duhet të bashkëpunosh me policinë.

Ekzistojnë situata ku ndihma nuk u kushtëzua nga bashkëpunimi, por viktimat folën për një presion të lehtë për t'u treguar bashkëpunuese:

[Policia] tha se do të merrja një ndihmë mjeksore. Do të mund të rrija atje aq kohë sa të më shërohej dhimbja e kokës. Ai më kërkoi, gjithashtu, që të vazhdoja të dëshmoja ndërkohë që do të trajtohesha me atë ndihmë. I besova. Me mendjen time, ai ishte një "oficer i mirë policie", i cili kërkonte të ndryshonte diçka në këtë botë ... Nuk kisha qejf të dëshmojë, por u ndjeva sikur kisha një detyrim.

Ata deshën të mbaronin punën e tyre. Unë desha të mbarojë me ta sa më shpejt dhe kështu që e dhashë [dëshminë].

Një grua nga SEE, e trafikuar për në BE, shpjegoi se asaj i kishin thënë për mundësinë e ndihmës, pasi ajo kishte rënë dakord që të jepte një deklaratë. Pra, pasi ajo shprehu gatishmërinë e saj që të bashkëpunonte me zbatuesit e ligjit, asaj iu ofrua ndihma; ndihma nuk iu ofrua menjëherë:

Unë u thashë atyre drejtpërdrejt se desha të jepja një deklaratë, në mënyrë që vajzat e tjera të mos kalojnë ato që kalova unë. Fillova të jepja deklaratën. Kaloi nja dy orë dhe pas asaj ata më folën [për ndihmën]. Në fillim mendoja se nuk do të më dëbonin, por kur dhashë deklaratën, më thanë se do të shkoja në një strehëz dhe do të qendroja atje për pak kohë. Nuk më thanë se do të qendroja atje përsa kohë do të ishte e nevojshme.

Vendosja e kushteve duket se ka qenë e zakonshme edhe midis disa organizatave fetare. Një burrë, i trafikuar në ish Bashkimin Sovjetik, eventualisht u identifikua dhe u ndihmua nga një grup fetar, i cili lehtësoi kthimin dhe referimin e tij te një grup me bazë kishën në vendin e tij të origjinës. Ndërkohë që në vendin e destinacionit ai nuk e kishte ndjerë se ndihma ishte e kushtëzuar – "nuk kërkuan asgjë prej meje, nuk më detyruan të shkojë në kishë, apo të lutem, apo të punoj" – ky nuk ishte rasti me kishën ndihmuese në vendin e tij të lindjes:

Organizata e parë që më ndihmoi ishte ajo kisha në [kryeqytet], ku isha referuar nga ata njerëzit fetarë në [vendin e destinacionit]. Kur mbërrita tek kjo këtu, më thanë se, nëqoftë se do të kthehesh në

besimtar, atëherë ne do të të ndihmojmë.. E kuptova se deshën që unë të shkoja rregullisht në lutjet dhe takimet e tyre.

Viktimat e tjera, gjithashtu, vunë në dukje raste kur ndihma nga grupet fetare ishte e kushtëzuar:

Në fshatin tonë vijnë shumë përfaqësues të feve të ndryshme që kërkojnë t'i tërheqin njerëzit dhe ofrojnë ndihmë me kusht që të kthehen në fenë e tyre. Kjo nuk është e mirë, kur manipulohesh në këtë mënyrë, ose kur të vejnë disa kushte për të marrë ndihmë. Ajo duhet të jetë e sigurtë, të vijë nga fundi i zemrës.

Fakt shqetësues është se shumë viktima – për shkak të pozicionit të tyre tepër të zbuluar – mund të mos jenë në gjendje t'u rezistojnë kushtëzimeve që vihen për ndihmat.⁵¹ Kjo pikë u bë shumë e qartë nga një viktimë, e cila ishte referuar një organizate fetare për ndihmë humanitare për veten dhe për vajzën e saj:

Më mori në telefon [punonjësja sociale] dhe tha se ishte një organizatë fetare, që ofronte ndihmë humanitare dhe mbështetje morale për njerëzit që kanë nevojë urgjente për të... Ajo më paralajmëroi se kjo organizatë [jo e të njëjtës fe] dhe vetë ajo mund të kërkonin që unë të merrja pjesë në shërbesat fetare dhe të lutesha, madje edhe të konvertohesha në fenë e tyre. Unë i thashë së mund të vinin tek unë dhe të kuptonin se mua as që më shkonte nëpër mend feja. Por, ju them ndershmërisht, isha gati të hiqja dorë nga besimi im për hir të vajzës sime.

Jo të gjitha kushtet dhe parametrat për pjesëmarrje në program janë problematike. Në rastet kur kushtet lidhen me kuadrin ligjor kombëtar, apo

⁵¹ Kjo nuk do të thotë se të gjitha organizatat fetare funksionojnë në këtë mënyrë. Viktima të tjera raportuan mbi ndihmën e pakushtëzuar që u ishte ofruar nga organizata të tilla:

Ajo asnjëherë nuk më flistë për Zotin, ose gjëra të ngjashme. Ajo më dëgjonte sikur të ishte një njeri i zakonshëm. Më pëlqeu. Megjithëse nuk më kërkoi t'i flisja mbi çfarë më kishte ndodhur, unë i thashë asaj çdo gjë. E çlirova shpirtin tim. Shpirti i saj është aq i hapur.

Qendra është një qendër fetare dhe kishin shumë libra fetarë atje... Nuk këmbëngulën që unë të isha apo të bëhesha një person fetar. Mësimet e fesë ishin vullnetare. Nuk na detyronim të bënim shenjën e kryqit, apo të ndiqnim shërbimet fetare.

Jo, absolutisht asnjë [kusht për ndihmë]. Nuk m'u kërkua që të kthehem në fenë e tyre. Ajo nuk më thoshte të shkoja në kishën e [vendit tim].

kur marrja e ndihmës kërkon disa angazhime nga ana e përfituesve, kjo nuk ka pse të jetë problematike. Megjithatë, ka shumë rëndësi se cilat janë kushtet dhe si vihen ato në jetë. Duket se disa organizata kanë kushte për të hyrë në skemën e ndihmës, kushte që lidhen më shumë me objektivat e veta, sesa me rikuperimin dhe mirëqenien e viktimës.

Mungesë e ndihmës së mjaftueshme shtetërore dhe e shërbimit bazik

Në tërësi, pjesës më të madhe të vendeve të SEE-s u mungon ndihma e mjaftueshme financiare nga shteti për personat e trafikuar. Pjesa më e madhe e financimeve për shërbime dhe ndihma vjen nga donatorët ndërkombëtarë, dhe shumë shërbime ofrohen nëpërmjet OJQ-ve dhe organizatave ndërkombëtare. Pavarësisht nga kjo, në disa raste viktimat folën për aktorë shtetërorë që punonin shumë për të gjetur mundësi dhe mbështetje për to, por që kishin burime të kufizuara nga shteti. Një grua u ndihmua nga një punonjëse shtetërore sociale, e cila e kishte nxjerrë nga burgu (viktima ishte kapur për vjedhje ushqimesh për fëmijët e saj, pasi ishte kthyer nga trafikimi), por mundi t'i ofronte vetëm pak mundësi financimi nga shteti për të dhe fëmijët e saj.

Ajo gruaja nuk dinte ç'të bënte me mua. Më tha, "e ku do të shkosh tani me një fëmijë? Nuk mund të të mohoj të drejtën prindërore". Dhe ishim tashmë në vjeshtë. Mbaja fëmijën e tretë në duar. Kalova tri netë në [jetimoren e fëmijëve], ndërkohë që ajo po kërkonte vend se ku të mund të vendosesha.

Ishte shumë e mirë. Mendoj se është personi që më bëri të besoja përsëri në jetë ... Nën mbrojtjen e saj, unë dhe fëmijët e mi ishim të sigurt.

Megjithatë, shumë viktima që ktheheshin, përballeshin me probleme për kontaktimin e shërbimeve bazike shtetërore dhe marrje të një mbështetjeje minimale nga shteti. Një viktimgë, që e kishte humbur apartamentin e tij sepse ia kishin zaptuar të tjerët, kur ky kishte qenë i trafikuar, shprehu pakënaqësinë e tij me shtetin:

Nuk jam i kënaqur me sistemin që përdor shteti për të mbrojtur shtetasit e vet. Shteti nuk është i zoti të mbroje shtetasit e tij që mbeten rrugëve prej transaksioneve të paligjshme të pasurisë së tyre. Gjatë katër vjetve që unë nuk isha këtu, apartamenti im është shitur shtatë herë. Asnjë avokat nuk mund të më ndihmojë.

Të intervistuarit e tjerë shpjeguan sesi pensionet dhe përfitimet që mund të merrnin nga shteti, thjesht, nuk ishin të përshtatshme për një mbijetesë bazike:

Pensioni im është [afërsisht 22 Euro] në muaj ... por çfarë do të thotë kjo shumë për një familje me gjashtë anëtarë?

Mesa kuptoj unë, ekzistojnë disa programe ndihme për nënat beqare. Po, ku janë ato? Ku është kjo ndihmë? Ata që kanë nevojë për të, nuk e marrin dot. Mendoj se kjo ndihmë shkon në duart e atyre që duhet të ofrojnë ndihmën. Dhe nënat beqare marrin një kuti me ushqime një herë në vit. Dhe pastaj duhet ato vetë të rropaten e të dalin nga hallet që kanë. Japin [rrreth gjashtë Euro] në muaj për një fëmijë. A është e mundur të ushqesh një fëmijë me kaq para?

Atje ku kishte mundësi ofrimi shërbimesh, ishte shumë e vështirë që të arrije t'i kontaktoje. Procedurat burokratike ishin një pengese për shumë viktima. Në shumë raste, mungesa e dokumenteve ligjore kombëtare ishte pengesa e pare, ndër shumë të tjera që të përfitoje shërbimet për të cilat kishe nevojë. Viktimat që ktheheshin nga jashtë hasnin shumë vështirësi në përpjekjet për të nxjerrë pasaportat dhe letrat e identitetit.

Nuk e dija se përveç organizatave shtetërore kishte dhe OJQ. Mendoja se nëse kisha ndonjë problem, mund të ndihmohesha vetëm në zyrën e pasaportave. Kur ma thanë se nuk mund të më nxirrnin pasaportën, sepse nuk kisha leje të përhershme qëndrimi, unë u shqetësova shumë. Mendova se nuk do të arrija të merrja një pasaportë deri në fund të jetës sime.

Jam e pakënaqur me ndihmën nga organizatat shetërore. Nëse nuk je e regjistruar, nuk mund të marrësh asnjë lloj ndihme, qoftë nga zyra e punës, qoftë nga organizatat e mbrojtjes sociale. Nuk mund të marrësh as pasaportën tënde. Si rezultat, edhe ata njerëz që kanë vërtet nevojë për ndihmë, nuk mund ta marrin atë për shkak të burokracisë.

Në të njëjtën mënyrë, viktimat që vareshin nga ndihma shtetërore për mbështetjen e familjeve të tyre, shpjeguan se nuk mund ta merrnin atë për shkak të problemeve burokratike:

[Marr afërsisht gjashtë Euro] në muaj. Megjithatë, në tre muaj nuk kam marrë asgjë. Sepse ma kanë ngatërruar emrin. Dhe unë mund

të marrë ndihmë vetëm në vendin e banimit, sepse atje më njohin se kush jam.

Duhet të më çojnë në sanatorium, të më bëjnë trajtim mjekësor. Djali më regjistroi në listën e invalidëve për trajtim falas në sanatorium. Atje i thanë se duhet të prisnim pesë vjet. Dhe unë nuk e di a do të jem gjallë pas pese vjetësh. Shërbimet sociale funksionin shumë më mirë.

Pyeteni djalin tim se ç'kemi hequr duke shkuar nga një institucion tek tjetri ... Plotësonim letra pas letrash, procedura burokratike ... Indiferencë e plotë, veçanërisht nga organizatat shtetërore ... mos dëshira e tyre për t'u ardhur në ndihmë shqetësimeve të njerëzve.

I thashë djalit të më vendosë në një vend për invalidë, por ai nuk deshte në fillim. Tani do, por del që qenkish një gjë shumë e ngatërruar. Duhet gjithë ato dokumente.

Disa viktimat mendonin se nuk merrej seriozisht përgjegjësia e përkujdesjes nga disa aktorë shtetërore, dhe se ata gjithmonë i adresonin tek ndonjë organizatë humanitare për të kërkuar ndihmë:

Një gjë nuk më pëlqeu. Punonjësja sociale [OJQ] u lidh me punonjësen sociale që punonte në fshatin tim dhe i kërkoi ndihmë për mua. Kur erdha në drejtori, më panë me një sy të keq ... Më pyetën përse kisha shkuar tek ata, çfarë kërkoja prej tyre. Më bënë të ndihem sikur u kisha borxh diçka ... [Punonjësja sociale] u kërkoi atyre që të jepnin ndihmën e nevojshme për mua dhe fëmijën tim. Në fakt, personi që u kontaktua jeton afër meje. U takuam në një market dhe më tha që ata nuk mund të më ndihmonin. I kërkova që të më jepte një çerifikate, ku të shkruhej se unë nuk kam të ardhura, që të mos paguaja taksa. Biznesi im i vogël është shitja në market, por unë kisha nevojë për një dokument të tillë, që të mos taksohesha. Ajo më tha që nuk mund të më ndihmonte as me atë dhe më drejtoi për tek personi që më kishte ndihmuar të hapja biznesin tim të vogël.

6.4. Përmbledhje

Ofrimi i një ndihme të përshtatshme për personat e trafikuar është një faktor jetësor për stabilizimin e tyre të shpejtë dhe një shtysë për rikuperimin më afat-gjatë të tyre drejt ri-integrimit në shoqëri. Pavarësisht nga dallimet midis

vendeve dhe përvojave të ndryshme të viktimave të trafikimit, disa nga temat e përhershme që dolën në dritë, kur u bisedua me viktimat, ishte sesi e shikonin, e kuptonin dhe e përjetonin ato ndihmën dhe mbrojtjen.

Personat e trafikuar përshkruan një gamë të gjërë emocionesh të përjetuar gjatë ndihmës dhe mbrojtjes. Sigurisht, shumë emocione ishin negative – që nga frika deri të tronditja dhe hutimi, që nga dyshimi e deri te ankthi dhe turpi. Megjithatë, ato njëlloj treguan sesi gjatë kësaj faze ato kishin përjetuar ndjenja pozitive, më së shumti ndjenjën e qetësisë dhe të sigurisë, ndjenjën se ishin pjesë e diçkaje, se nuk ishin vetëm, se ishin të çliruara dhe mirënjohëse. Në shumë raste, viktimat raportuan sesi me kalimin e kohës ndjenjat negative u transformuan në ndjenja më pozitive, me fitimin e besimit tek të tjerët dhe tek vetja. Përveç kësaj, emocionet ishin specifike dhe nuk lidheshin vetëm me periudhat e caktuara të jetës së tyre, por edhe me reagimin individual të viktimës ndaj pjesëmarrjes në programet e ndihmës.

Problemet që u vunë në dukje nga viktimat në lidhje me ndihmën dhe mbrojtjen ishin me mijra dhe nga më të larmishmet, duke prekur një sërë çështjesh të rëndësishme. Këtu përfshiheshin problemet e ndeshura për shkak të pengesave kulturore dhe gjuhësore midis përfituesve, si dhe midis përfituesve dhe personelit; disa shqetësime dhe ndijime që kishin viktimat rreth rregullave ekzistuese dhe kufizimeve në programet e ndihmës; rëndësia e mundësisë së zotërimit të një informacioni të arritshëm, të përshtatshëm dhe të gjithanshëm rreth mundësive të ndihmës, si jashtë ashtu dhe brenda vendit; përfshirja e viktimave në procesin e vendim-marrjes rreth ndihmës; mundësia e viktimës për t'iu drejtuar drejtësisë (dhe nganjëherë mungesa e kësaj mundësie); problemet e fajësimit dhe të diskriminimit në periudhën pas-trafikimit; çështje të sigurimit dhe të sigurisë fizike; vështirësitë dhe ndërlikimet për gjetjen e drejtpeshimit midis mëvetësisë dhe pavarësisë nga ndihma dhe shërbimet; probleme në lidhje me intimitetin dhe ruajtjen e fshehtësisë së viktimave të trafikimit; mënyrat sesi trajtohen nevojat për ndihmë të specializuar personave të trafikuar; kushtëzimet që vendoseshin për mundësinë e marrjes së ndihmës; mungesa e ndihmës shtetërore; vështirësitë e procesit të ri-integrimit dhe mënyrat për sigurimin e kapaciteteve profesionale dhe të cilësisë së shërbimit, përfshirë opsionet e përshtatshme të ndihmës.

7. Disa mendime dhe përfundime

Synimi i këtij studimi ka qenë që të ofrohet një pamje – e parë nga këndvështrimi i personave të trafikuar – sesi realizohen proceset e identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës nga, te dhe brenda rajonit të SEE-s. Në këtë aspekt janë ndjekur tri parime organizative – 1) të kuptohej sesi kryhej në praktikë ky proces; 2) të kuptohej se çfarë ndjenin viktimat gjatë përjetimit të procesit, dhe 3) të identifikoheshin cilat ishin, për viktimat, çështjet më kritike me të cilat përballëshin ato. Intervistat me personat e trafikuar zbuluan një material të shumtë, i cili mund të jetë i dobishëm për mënyrën sesi mund të formatohen ndërhyrjet në vijim dhe veprimtaritë përkatëse. Ndërkohë që të intervistuarit u shprehën, përgjithësisht, pozitivisht dhe mirënjohës për ndërhyrjet dhe mbështetjen që kishin marrë në fazat e ndryshme të jetës së tyre pas-trafikim, ato, gjithashtu, identifikuan zona ku kishin hasur probleme dhe shqetësime. Këto gjetje nuk janë specifike vetëm për një vend, organizatë apo sektor. Në të kundërt, ato përfaqësojnë tërësinë e çështjeve të ngritura nga viktimat e intervistuarat për këtë studim – viktima të ndihmuara në SEE, në BE, në ish Bashkimin Sovjetik, në Azinë e Mesme dhe Turqi nga OJQ-të, organizatat qeveritare dhe ndërkombëtare.

Një gjetje e rëndësishme ishte se, procesi jo gjithmonë kryhej drejt dhe sipas standardeve dhe parimeve të hartuara në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Vazhdojnë të ekzistojnë hendeqe në sistem, që nga faza e identifikimit, nëpër

atë të kthimit dhe gjatë fazës së ndihmës dhe të mbrojtjes. Intervistat zbuluan disa procedura identifikimi shumë profesionale, duke folur edhe për ndërhyrjen e personave jo tipikisht të angazhuar në identifikim, duke sinjalizuar se ka shumë ndërmjetës, që mund dhe që ndihmojnë në këtë proces. Identifikimi, në disa raste, ishte mirëdashës, i përshtatshëm dhe çoi ose kontribuoi në ndjenjën e sigurisë dhe të mirëqenies të viktimave dhe në dëshirën e tyre për të hyrë në kuadrin anti-trafikim të referimit dhe të ndihmës. Por, në të njëjtën kohë, kishte dhe me mijra shembuj të mundësive të munguara të identifikimit, që zgjatnin situatat e trafikimit dhe shtonin ndikimin mendor dhe fizik të shfrytëzimit mbi to. Ndërkohë që shumë viktima u ndihmuan në procesin e kthimit dhe ishin kthyer shëndosh e mirë dhe me vetëbesim në shtëpi, përsëri kishte të tjerë që hasnin me përvoja kthimi të pasigurta dhe jo dinjitoze, të cilat shpesh kishin të bënin me marrjen në pyetje në kufij, përballjen me shumë pyetje nga autoritete të ndryshme, ndalimin nga policia për moszotërim dokumentesh ligjore, rrezikun e interceptimit nga trafikantët e tyre, e kështu me radhë. Përvojat e ndihmës ishin me mijra dhe nga më të ndryshmet. Shtrirja dhe cilësia e ndihmës ndryshonte nga njëri vend tek tjetri, dhe viktimat raportuan përvoja shumë të pangjashme ndihme me njëra-tjetrën. Disa ndihmoheshin me anë të programeve rezidenciale të hapura, të tjerat në vende të mbyllura. Disa programe ishin afat-shkurtëra, të tjerat afat-gjata dhe të orientuara drejt ri-integrimit. Për disa viktima, shërbimi në shtëpi ndiqte programet e ndihmës, të ofruara në vendin ku viktimat ishin identifikuar. Gjithsesi, për viktimat e paidentifikuara jashtë, ndihma në vendin e tyre të origjinës ishte takimi i tyre i parë me ofruesit e shërbimit. Ndërkohë që ndihma ishte shumë pozitive për viktimat dhe kontribuoi në mënyrë domethënëse për stabilizimin, rikuperimin dhe ri-integrimin e tyre, ato megjithatë identifikuan situata, ku u ndeshën me vështirësi në ndonjë fazë të jetës së tyre pas-trafikim. Duke krahasuar dhe përqasur shërbimet dhe ndërhyrjet e ndryshme, viktimat e trafikimit kishin ide shumë të qarta mbi çfarë kishte qenë, dhe çfarë nuk kishte qenë e rëndësishme për rikuperimin e tyre.

Po ashtu me rëndësi për t'u theksuar është se ndjenjat e viktimave nuk ishin gjithmonë ato që pritnin ose që synonin aktorët e anti-trafikimit. Kur pritej që viktimat të ndiheshin të çliruara dhe të sigurt, ato, në fakt, ishin të frikësuara dhe të nervozuara. Atëhere kur mund të pritej që të ishin të qeta dhe të sigurt për jetën e tyre, viktimat ishin dyshuese dhe të dëshpëruara. Duhet të merret seriozisht parasysh dhe të vlerësohet drejt se përceptimet e viktimave mund të jenë krejtësisht ndryshe nga çfarë mendohet, apo pritet nga të tjerët. Emocionet negative nuk tejkaloheshin lehtë apo shpejt, dhe

nëpërmjet intervistave me viktimat u bë e qartë se viktimat, për të mundur frikën, dyshimin, nervozizmin dhe dëshpërimin e tyre, kishin nevojë për kohë dhe për shprehje të besueshme të mbështetjes dhe sinqeritetit. Për shumë viktimat, rënia dakord për t'u identifikuar, kthyer dhe ndihmuar ishte një "hap i madh besimi", dhe ata e bënë këtë, shpesh me shumë pasiguri dhe shqetësim. Pikërisht kundrejt këtij sfondi emocional do të duhet që të formësohen veprimet dhe reagimet e anti-trafikut.

Në lidhje me problemet që ndeshnin, intervistat me viktimat zbuluan jo vetëm shumë praktika të suksesshme, por edhe praktika të gabuara. Përgjatë punës sonë dolën disa tema të përbashkëta, të cilat mund të ofrojnë drejtim për hapat që do të ndërmerren në të ardhmen.

Mundësia e informimit: Në të gjitha fazat e procesit, viktimat folën për nevojën dhe dëshirën që kishin për më shumë informacion rreth mundësive që kishin dhe rreth procesit që do të ndiqnin. Informacioni duhet të jetë specifik, i arritshëm, i gjithanshëm, në përputhje me moshën, me gjuhë specifike dhe i përshtatshëm ndaj kulturave. Ai, gjithashtu, duhet të personalizohet sipas tipit të viktimave dhe specifikës së përvojës së trafikimit, si dhe sipas profileve të tyre individuale – nëse është burrë apo grua, i huaj apo i vendit, i rritur apo i mitur, etj. Një tjetër problem i përbashkët ishte se, koha kishte shumë rëndësi për dhënien e informacionit – ai duhet të jepet në kohën e përshtatshme, të jepet më shumë se njëherë dhe se viktimave duhet t'u lihet kohë për ta përpunuar informacionin dhe marrë vendimin e duhur. Por më me rëndësi është fakti që, viktimat duhet të përfshihen në vendimet që merren rreth procesit të plotë të ndërhyrjes anti-trafikim, të jenë në gjendje të zgjedhin nga menyuja e opsioneve dhe e mundësive, dhe jo të rrijnë pasivë e të informohen nga të tjerët se çfarë vendimi është marrë për hapat e mëtejshme që do të ndiqen.

Siguria fizike dhe sigurimi: Problemet e sigurisë fizike dhe të sigurimit shpesh trajtohen në mënyrë të pabarabartë në rastet e personave të trafikuar, disa viktimat u nënshtrohen protokolleve të rrepta të sigurisë, si strehime të mbyllura dhe lëvizje me roje, ndërsa të tjerat, për shembull viktimat dëshmitare, kanë një mbrojtje krejt të pamjaftueshme. Duket se i kushtohet pak vëmendje realizimit të shqyrtimeve/vlerësimeve sistematike dhe të detyrueshme të çështjeve të sigurisë dhe rrezikut jo vetëm brenda rajonit të SEE-s, por edhe më tej. Përveç kësaj, protokollet dhe procedurat e nevojshme për këto lloj analizash nuk janë të përpunuar dhe nuk vihen në jetë në nivelin e kërkuar. Problemet e sigurisë duhet të shqyrtohen rast pas rastit dhe rregullisht gjatë jetës pas-trafikim të viktimës, për të shqyrtuar rrezikun real për viktimat, në rast se ka, dhe për të

vendosur sesi duhet të trajtohen ato në mënyrën më të mirë të mundshme. Atje ku siguria është një problem – siç qe rasti për një numër viktimash – këto rreziqe duhet të merren seriozisht dhe të trajtohen përkatësisht. Në të njëjtën kohë, problemet e sigurisë duhet të drejtpeshohen me kujdes me ato të nevojës për një jetë normale dhe rikuperim më afat-gjatë; një përqendrim i tepëruar mbi çështjet e sigurisë dhe të sigurimit, atje ku ato nuk rezultojnë, mund të pengojë rikuperimin dhe ri-integrimin e viktimave.

Pengesat gjuhësore dhe kulturore: Mundësia e komunikimit dhe e lidhjes personale me aktorët e anti-trafikimit nga vetë viktimat, ishte një element shumë i rëndësishëm për t'i dhënë atyre ndjenjën e sigurisë dhe ndihmë në përfshirjen e tyre në procesin e identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës. Atje ku ekzistonin pengesat gjuhësore (dhe ky nuk ishte rast i rrallë), vështirësohej i gjithë procesi, dhe nganjëherë kompromentohej cilësia e ndërhyrjes. Më pak i dukshëm, por njëlloj i rëndësishëm, ishte problemi sesi dallimet kulturore mund të krijojnë pengesa në punën e anti-trafikimit. Për shumë viktimat, të trafikuar jashtë, pengesat gjuhësore dhe kulturore, në një farë mënyre, kishin ndikimin e tyre mbi përvojën e identifikimit dhe të ndihmës. Në disa raste, viktimat mund të mos kishin qenë identifikuar pikërisht për shkak të këtyre pengesave. Në rastet e tjera, identifikimi dhe ndihma ishin ndërlikuar nga dallimet gjuhësore dhe kulturore midis aktorëve të anti-trafikimit dhe viktimave. Zgjidhja e këtyre pengesave – nëpërmjet përkthimit, personelit me gjuhë të huaj, ndërmjetësve kulturorë, etj. – mund të ndihmojë në të gjitha këto faza të procesit, megjithëse çdo “zgjidhje” ka, gjithashtu, kufizimet e saj, si koston, mundësinë e realizimit, të cilat duhet të merren parasysh dhe të trajtohen me kujdes.

Modelet e ndërhyrjes dhe cilësia e përkujdesjes: Lloji dhe cilësia e ndërhyrjeve – që nga identifikimi, përgjatë kthimit dhe ndihmës – ishin çuditërisht të pabarabarta. Ndryshimet midis aftësive, në cilësinë e shërbimeve dhe në nivelin e profesionalizmit ishin të dallueshme jo vetëm nga njëri vend tek tjetri, por edhe brendapërbrenda vendeve. Disa viktimat kishin përfituar nga procedura profesionale, procedura identifikimi të kujdesshme ndaj viktimave, ndërsa të tjera ishin trajtuar nga aktorë identifikues të trenuar keq dhe mospërfillës. Disa procedura kthimi ndoqën rreptësisht protokollin e rregullta për një kthim të sigurtë dhe dinjitoz, ndërsa të tjerat u kryen sipas momentit, ishin të diskutueshme madje dhe ekspozuese ndaj rrezikut. Ndërkohë që disa viktimat merrnin shërbime shumë cilësore dhe sipas modeleve të përshtatshme të përkujdesjes, të tjerat jo. Vetë viktimat vinin në pikëpyetje disa nga modelet e përkujdesjes që përdorshin (d.m.th. modelet e mbyllura përkundrejt të hapurave, programet

rezidenciale përkundrajt atyre jo-rezidenciale), si dhe rregullat e rregulloret që zbatoheshin brenda shumë programesh. E lidhur ngushtësisht me këtë çështje është mungesa tërësore e monitorimit dhe e vlerësimit të këtyre modeleve dhe e ndërhyrjeve profesionale. Ofrimi i ndërhyrjeve cilësore në të gjitha fazat e jetës pas-trafikimit është një çështje e rëndësishme jo vetëm në SEE, por në të gjitha vendet e marra në shqyrtim gjatë realizimit të këtij studimi. Ndërkohë që ngritja e mekanizmave të monitorimit dhe të shqyrtimit është një komponent i rëndësishëm për sigurimin e ndërhyrjeve cilësore, ato kërkojnë, po ashtu, standarde më të larta profesionale dhe llogaridhënieje. Njëlloj e rëndësishme është që, sugjerimet, informacionet dhe vlerësimet e viktimave rreth ndërhyrjeve që kryhen në kuadrin e ofrimit të ndihmës, të jenë pjesë e zhvillimit, e personalizimit dhe e zbatimit të programeve dhe të reagimeve të policisë.

Trajtimi i keq dhe ndërveprimet problematike: Me mënyra të ndryshme dhe në faza të ndryshme, disa viktimat raportuan mbi trajtimin e dobët dhe keqtrajtimin në duart e aktorëve të anti-trafikimit. Në raste të tjera, do të ishte më korrekte po të thonim se bëhej fjalë më shumë për mospërfillje, pandjeshmëri dhe diskriminim. Ndërkohë që trajtimi i dobët shpesh i atribuohet aktorëve të anti-trafikimit, veçanërisht gjatë identifikimit fillestar, viktimat raportuan, gjithashtu, mbi trajtimin negativ gjatë ndihmës dhe ri-integrimit, në duart e aktorëve të ndryshëm të anti-trafikimit. Fakti që u raportuan raste të abuzimit me viktimat, ndërkohë që ishin në përkujdesje, është veçanërisht shqetësues. Trajtimi i dobët (edhe kur është i paqëllimshëm) ndikon mbi personat që janë tashmë të traumatizuar dhe shfrytëzuar, përfshirë dhe mbi dëshirën e tyre për t'u identifikuar dhe ndihmuar. Në rastet e keqtrajtit të qëllimshëm, duhet të gjinden mënyra për t'i vënë fajtorët para përgjegjësisë dhe parandaluar që këto keqtrajtime të ndodhin në të ardhmen. Mekanizmat e monitorimit dhe të sigurimit të cilësisë janë vendimtarë për të ndihmuar këtë përpjekje.

Ndërhyrja dhe ndihma me mbështetje nga shteti: Meqenëse në vendet e SEE-s mungon një ndihmë e mjaftueshme me fonde shtetërore për personat e trafikuar, shumë viktimat që kthehen, përballen me probleme kur kërkojnë të kontaktojnë me shërbimet edhe më bazike, dhe për rrjedhojë, marrin vetëm një mbështetje minimale. Në disa raste viktimat raportuan për aktorë shtetërorë që punojnë shumë për të ofruar opsione dhe mbështetje për to, por ata, shpesh, kufizoheshin, për shkak të burimeve të pakta të shtetit. Kontaktimi i shërbimeve ndërlikohej më së shumti edhe nga procedurat burokratike. Viktimat kanë nevojë për një gamë më të gjërë shërbimesh shtetërore dhe procese më pak të ndërlikuara për t'i kontaktuar ato shërbime.

Angazhimi i viktimave në projektimin dhe zbatimin e ndërhyrjeve: Diskutimet me viktimat nxorren në pah jo vetëm çështje me të cilat ishin përballur, por shpesh nënkuptonin edhe vëzhgime të tyre se çfarë mund të ishte bërë më mirë qoftë në identifikim, gjatë kthimit, ose në kontekstin e ndihmës. Viktimat, shpesh, ishin shumë të qarta mbi çfarë duhej të kishte ndodhur, në vend të asaj që kishte ndodhur, në mënyrë që të ishin krijuar ndjenja pozitive të sigurisë dhe të besimit dhe të ishte ndërhyrë më me efektivitet në rastin e tyre. Kjo nënvizon faktin që viktimat shpeshherë kanë ide të qarta mbi nevojat e tyre dhe si duhen përmirësuar proceset dhe procedurat. Angazhimi i viktimave në një diskutim të nevojave të tyre, si dhe tërheqja e komenteve të tyre në lidhje me projektimin dhe zbatimin e ndërhyrjeve, mund të shërbejë për të siguruar që ndërhyrjet – qofshin nga perspektiva e shërbimeve ligjore apo sociale – të vejnë në qendër viktimat dhe të bazohen mbi realitete të jetuara të një numri viktimash, në ndihmë të të cilave realizohen këto ndërhyrje. Ato sisteme ndërhyrjeje dhe ndihme që projektohen, zbatohen dhe përshtaten me anë të sigurimit të pjesëmarrjes së përfituesve, janë më efektive, eficientë, dhe në fund të fundit, më humanitare. Përveç kësaj, angazhimi i viktimave duhet të jetë një proces në vijim, duke i dhënë mundësinë viktimës që të japë mendimet e veta për t'u pasqyruar në programet dhe ndërhyrjet e ndihmës.

Mangësitë dhe çështjet e ndërhyrjeve dhe të procesit të anti-trafikimit: Në zbatimin e procesit të plotë të identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës për personat e trafikuar mbeten mjaft mangësi dhe çështje për zgjidhje. Ato përfshijnë:

- *Identifikimin:* Nganjëherë aftësitë e papërshtatshme të aktorëve identifikues dhe mundësitë e humbura të identifikimit mund të çojnë në ri-trafikim ose në shfrytëzim të vazhdueshëm të viktimës. Disa viktimat vazhdonin të ndaloheshin/arrestoheshin dhe të merreshin në pyetje, të trajtoheshin si kriminele dhe si fajtorë (për shkak të statusit të tyre të paligjshëm në vend, ose të përfshirjes në prostitucion), në vend që të trajtoheshin si viktimat të krimit.
- *Kthimin dhe referimin:* Në shumë situata, viktimat e pandihmuara vazhdonin të ktheheshin, gjë që ishte e lodhshme për viktimat dhe i vinte ato në pozita të vështira me zbatuesit e ligjit dhe punonjësit e kufirit, si dhe i zbulonte ato ndaj ri-trafikimit. Po në kontekstin e kthimit, ishte dhe kthimi i vonuar i viktimave të huaja të trafikimit, shumë nga të cilat mbaheshin nën vëzhgim ligjor, ndërkohë që përpunoheshin dokumentet e tyre, bëheshin marrëveshjet për transportimin,

lëshoheshin deklaratat dhe ndërmerreshin procedura të tjera. Një tjetër problem për disa viktime ishte që procesi i kthimit dhe i transportimit imiton procesin e trafikimit.

- *Ndihmën dhe mbrojtjen*: Në fazën e ndihmës, viktimat vunë në dukje mundësinë e kufizuar për t'iu drejtuar drejtësisë dhe pakënaqësinë e tyre me procesin kriminal dhe gjyqësor, si në drejtim të rezultateve ashtu dhe në drejtim të trajtimit që kishin nga aktorët ligjorë dhe gjyqësorë. Për disa viktime, mungesa e drejtësisë kishte krijuar pasoja reale në jetë në lidhje me ndëshkimet e pësura dhe, për pasojë, shumë nga to kishin frikë të ktheheshin tek familjet dhe komunitetet e tyre. Kushtëzimi i ndihmës ishte një tjetër problem kur disa viktime viheshin nën presionin e bashkëpunimit me autoritetet e zbatimit të ligjit, ose kur u thuhej se do të merrnin ndihmë nga organizatat sociale, vetëm nëse ato do të pranonin disa kushte. Problemi i vërtetë ishte se shumë viktime – për shkak të pozicionit të tyre tepër të zbuluar dhe të pambrojtur – mund të mos i rezistonin këtyre kushteve. Fakti që viktimat nuk dijnë ku të drejtohen për ndihmë dhe mbështetje, përbën një tjetër shqetësim për shumë viktime. Së fundi, diskutimet me viktimat nxorrën në dukje natyrën e ndërlikuar të procesit të ri-integrimit, duke përfshirë dhe nevojën e drejtpeshimit të ofrimit të ndihmës, pa krijuar situata të panevojshme varësie. Fajësimi dhe turpërimi, përbënin, gjithashtu, pengesë për përpjekjet e ri-integrimit, njëllor siç përbëjnë edhe problemet e vetë rendit ekzistues, si papunësia e lartë dhe mundësitë e kufizuara për viktimat për integrim në shoqëri. Ri-integrimi nuk është një proces linear dhe mund të nënkuptojë hapa prapa për viktimat, gjë që do të kërkonte forma të ndryshme të ndihmës dhe të mbështetjes në një afat të gjatë dhe përtej synimit të programit.
- Ndërkohë që pikat e mësipërme nuk shtjellojnë të gjithë gamën e mangësive dhe të çështjeve, ato sidoqoftë vejnë në dukje se cilat ishin për viktimat disa nga shqetësimet më urgjente, të përjetuara në rastin e tyre dhe që mund të shërbejnë si pikënisje për përmirësime në procesin e MTR-s.

Rëndësia e përqasjes individuale rast pas rasti: Nuk ka ndonjë formulë fikse për mënyrën sesi duhet të trajtohen rastet e trafikimit. Ashtu siç janë të ndryshme midis tyre viktimat dhe përvojat e tyre (si doli në intervistat me viktimat), ashtu janë dhe nevojat e tyre përgjatë procesit të identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës. Viktimat kanë shpesh profile të ndryshme – janë burra dhe gra, janë të rritur

dhe të mitur, të moshuar dhe të rinj, të huaj dhe të vendit – dhe përvoja të ndryshme të shfrytëzimit. Viktimat që shfrytëzohen për punë dhe lypje, jo gjithmonë kanë të njëjta nevoja për ndihmë, siç i kanë personat e trafikuar për shfrytëzim seksual. Vetë viktimat identifikuan rrugët dhe mënyrat sesi nuk ishin plotësuar nevojat e tyre plotësisht, ose mjaftueshmërisht brenda kuadrit të identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës. Fakti që po ndeshen shfaqje dhe profile të reja të viktimave të trafikimit, kërkon nga aktorët e anti-trafikimit që të jenë më elastikë dhe krijues përballë rrethanave të reja, mjaft unike dhe të pazakonta. Kjo kërkon dhe një elasticitet të vetë sistemit, për t’iu përgjigjur jo vetëm nevojave të ndryshme të identifikimit dhe të ndihmës, por edhe profileve të ndryshme të viktimave. Duke e konsideruar çdo rast si unik dhe duke iu përgjigjur nevojave individuale dhe rast pas rastit, është e vetmja mënyrë për t’iu përshtatur me efektivitet të ndryshueshmërie dhe këtij ndërlikimi. Të kuptuarit më mirë të formave më pak të zakonshme të trafikimit, dhe për rrjedhojë, të nevojave të viktimave, mund të luajë një rol në pajisjen më me shumë njohuri të vetë aktorëve të anti-trafikimit. Po njëllë i rëndësishëm është fakti që, ndihma e specializuar është e disponueshme për rastet “më të vështira”, si për shembull për viktimat me të meta, me çrregullime në sjellje, me varësi të ndryshme, me nevoja shëndetësore specifike, viktimat me njerëz në ngarkim, me probleme akute psikologjike, etj.

Seksi dhe çështjet gjinore: Përgjatë gjithë procesit duhet të merret parasysh çështja e seksit dhe e nevojave gjinore, që nga identifikimi, gjatë kthimit dhe gjatë ndihmës. Si burrat ashtu dhe gratë mund të jenë viktimat të trafikimit dhe shpesh kanë përvoja të ndryshme trafikimi, si edhe nevoja dhe interesi të ndryshme. Mendimet e mbledhura rreth çështjes së seksit dhe të gjinisë informojnë sesi ndërmerren dhe ofrohen masat anti-trafikim, duke i vështruar gratë si viktimat trafikimi, që kanë nevojë për mbrojtje dhe shërbime, ndërsa burrat duke i konsideruar shpesh si migrantë të pafat, që kanë vuajtur shumë abuzime dhe dhunime. Është e nevojshme të kushtohet shumë më tepër vëmendje mënyrës sesi seksi dhe gjinia informojnë mbi mënyrën si realizohet trafikimi, por edhe sesi ndërhyrjet anti-trafikim mund të mbështesin viktimat e të dy sekseve. Postulatet sociale mbi gjininë dhe problemet gjinore duhet të jenë pjesë e këtij ushtrimi, dhe angazhimi i të dyja sekseve mund të ndihmojë të zbulojë, nisur nga përvoja e tyre, sesi seksi dhe gjinia ndikojnë mbi mundësinë e përqasjes tek dhe përvojat e përjetuara gjatë identifikimit, kthimit dhe marrjes së ndihmës.

Nevoja e një studimi të përqendruar mbi viktimat, vlerësimi dhe hartimi i programit: Një nga përfundimet më të rëndësishme të këtij studimi është

se vetëm duke folur me viktimat e dukë mësuar nga to, do të jetë e mundur që të kuptohet plotësisht sesi realizohet procesi i identifikimit, i kthimit dhe i ndihmës. Personat e trafikuar janë ata që mund të identifikojnë më mirë dhe të komunikojnë në lidhje me nevojat e tyre – çfarë kanë nevojë dhe çfarë kërkojnë, çfarë mund të jetë më e dobishme dhe më e rëndësishme për ta. Pra, duke dëgjuar viktimat, do të mësosh shumë se çfarë veprimesh duhen ndërmarrë. Sigurisht, që ekziston një nevojë për të siguruar që viktimat të mos ngurrojnë nga studimi që bëhet, dhe të gjitha vendimet për të marrë pjesë në të duhet të jenë mbi baza vullnetare, dhe të bazuara mbi një informacion të plotë mbi punën studimore (përse duhet, si do të përdoret), mbi anonimat dhe fshehtësinë që do të ruhet, dhe vetëm pasi është dhënë pëlqimi i informuar i viktimave. Atje ku sigurohen këto parametra, studimi mund të shërbejë për të ofruar një informacion shumë të çmuar për ndërtimin e ndërhyrjeve të anti-trafikimit dhe për sigurimin që nevojat e viktimave të jenë të vendosura fort në qendër të diskutimit dhe të formulimit të përpjekjeve të anti-trafikimit. Ai mund të shërbejë, po ashtu, edhe për inkurajimin e mundshëm të viktimave – për t'i vendosur opinionet e tyre në të njëjtën shkallë me ato të profesionistëve, gjë që mund të luajë një rol të rëndësishëm në procesin e rikuperimit. Ekziston një nevojë reale për të përfshirë zërat e viktimave në punën kërkimore dhe në formulimin e politikës dhe të programeve të anti-trafikimit.

Këto gjetje – të zbuluara nga përvojat e drejtpërdrejta të personave të trafikuar – janë me vlerë në kuptimin e shtysës përpara që ato mund t'u japin përpjekjeve anti-trafikim. Përfundimet dhe rekomandimet e mësipërme formulohen në përgjigje të përvojave, përceptimeve dhe sugjerimeve vetjake të viktimave. Tregimet në vetën e parë të personave të trafikuar flasin shumë mbi mënyrën sesi po funksionojnë mekanizmat dhe procedurat anti-trafikim dhe ofrojnë mendime dhe sugjerime konkrete, të cilat, shpresohet, do të përmirësojnë politikën dhe praktikën e anti-trafikimit.

Referencat e cituara

- ABA CEELI (2005) *The Human Trafficking Assessment Tool Report for Moldova*. Chisinau, Moldova: ABA CEELI.
- Alexandru, M. and S. Lazaroiu (2003) *Who is the Next Victim? Vulnerability of Young Romanian Women to Trafficking in Human Beings*. Bucharest, Romania: IOM.
- Amnesty International – AI (2004) *'So does that mean I have rights?': Protecting the human rights of women and girls trafficked for forced prostitution in Kosovo*. London, UK: Amnesty International.
- Andreani, A. and T. Raviv (2004) *The Changing Patterns and Trends of Trafficking in Persons in the Balkan Region: Assessment carried out in Albania, Bosnia and Herzegovina, the Province of Kosovo, The Former Yugoslav Republic of Macedonia and the Republic of Moldova*. Geneva: IOM.
- Arora, A. (2004) *Experiences of frontline shelter workers in providing services to immigrant women impacted by family violence*. Practice Based Research Paper, Graduate Programme in Social Work. York University: Toronto, Canada.
- Bjerkan, L. (ed.) (2005) *A Life of One's Own: rehabilitation of victims of trafficking for sexual exploitation*. Oslo, Norway: Fafo Institute.
- Bjerkan, L. & L. Dyrliid (2005) 'A sheltered life'. In L. Bjerkan (ed.) *A Life of One's Own: rehabilitation of victims of trafficking for sexual exploitation*. Oslo, Norway: Fafo Institute.
- Bjerkan, L. & L. Dyrliid (2006a) *The courageous testimony: Trafficked women's motivations for and experiences from testifying against their traffickers*. Oslo, Norway: Fafo Institute.

- Bjerkan, L. & L Dyrliid (2006b) *The silence experience: reintegration of victims of trafficking for sexual exploitation*. Oslo, Norway: Fafo Institute.
- Blitz, L., Madsen, L, McCorkle, D and P. Panzer (2003) 'Sanctuary in a domestic violence shelter: a team approach to healing'. *Psychiatric Quarterly*. 74 (2): 155-171.
- Brunovskis, A. and R. Surtees (forthcoming 2008) 'Agency or illness – conceptualizing trafficking victims' choices and behaviors'. *Gender, Technology and Development*. Vol. 1.
- Brunovskis, A. and R. Surtees (2007) *Leaving the past behind: why some trafficking victims decline assistance*. Fafo Institute (Oslo) and Nexus Institute (Vienna).
- Brunovskis & Tyldum (2005) 'Describing the unobserved: methodological challenges in empirical studies on human trafficking'. *International Migration, special issue on data research on human trafficking, a global survey*. 43(1/2): 17-34.
- Brunovskis, A. and G. Tyldum (2004) *Crossing Borders: an Empirical Study of Transnational Prostitution and Trafficking in Human Beings*, Fafo Institute, Report 426: Oslo, Norway.
- Bump, M. & J. Duncan (2003) 'Identifying and Serving Child Victims of Trafficking'. *International Migration*. 41(5): 201-218.
- Cooper, M., I Hoffart & D. Warthe (2004) *Review of Best Practices in Family and Sexual Violence Programming, Family and Sexual Violence Sector Review, Companion Document 2*. Calgary, Canada: Family and Sexual Violence Review Advisory Committee.
- CPTW (2006) *Preventing and fighting Trafficking in Human Beings: Legal and social assistance of victims of trafficking*. Chisinau, Moldova: CPTW.
- Derks, A. (1998) *Reintegration of Victims of Trafficking in Cambodia*. Phnom Penh, Cambodia: IOM/CAS.
- Dottridge, M. (2006) *Action to Prevent Trafficking in South Eastern Europe: A Preliminary Assessment*. Terre des hommes Foundation and United Nations Children's Fund (UNICEF). Available at: http://www.childtrafficking.com/Docs/tdh_unicef_06_atoptraise_europe_280806.pdf.
- Dottridge, M. (2004) *Kids as Commodities – Child trafficking and what to do about it*. Terre des hommes. (IFTDH) International Federation. Available at: http://www.childtrafficking.com/Docs/tdh_2004_kids_as_commodities.pdf
- EC (2005) *European Commission on Fighting Trafficking in Human Beings – An Integrated Approach and Proposal for an Action Plan (COM (2005) 514 final)*. Brussels.
- ECPAT (2004) *Voices of victims*. Amsterdam, Netherlands: ECPAT.
- EU (2005) *European Union Action Plan on Best Practices, Standards & Procedures for Combating and Preventing Trafficking in Human Beings (2005/C 311/01)*. Developed within the framework of the Hague Programme "Strengthening Freedom, Security and Justice in the European Union" (Section 1.7.1), endorsed by the European Council in November 2004. Brussels.
- EU (2004) *European Union Council Directive 2004/81/EC on the Residence Permit*. Brussels.
- EU (2002) *European Union Brussels Declaration on Preventing and Combating Trafficking in Human Beings*. Brussels.

- FATW, GAATW and IHRLG (1999) *Human Rights Standards for the Treatment of Trafficked Persons*. Bangkok, Thailand: GAATW.
- Fulbright, L. (2004) 'Abuse victims get chance for private shelter'. *Seattle Times*. July 24.
- GAATW (2000) *Human Rights and Trafficking in Persons: a Handbook*. Bangkok, Thailand: GAATW.
- Handziska, M. & G. Schinina (2004) *Risk Assessment on Trafficking of Males for Homosexual Exploitation in the Republic of Macedonia*. Skopje, Macedonia: IOM.
- Hollifield, M. (2002) 'Accurate Measurement in Cultural Psychiatry: Will we Pay the Costs?' *Transcultural Psychiatry*. December. 39(4): 419-421.
- Hunzinger, L. & P. Sumner-Coffey (2003) *First Annual Report on Victims of Trafficking in South-Eastern Europe*. Belgrade: RCP, IOM, ICMC & SPTF.
- ICCO (2004) "If our skirt is torn"...: *Safe Return and Social Inclusion of Victims of Traffic in Human Beings, An inventory of Neglected Areas in Ten European and Asian Countries*, ICCO: The Netherlands.
- ICMPD (2006) *Guidelines for the development and implementation of a comprehensive national anti-trafficking response*. Vienna, Austria: ICMPD.
- ICMPD (2003a) *Regional Standard for Anti-trafficking Police Training in SEE*. Vienna, Austria: ICMPD.
- ICMPD (2003b) *Anti-trafficking Training Manual for Judges and Prosecutors. Draft April 2003*. Vienna, Austria: ICMPD.
- ILO (2006) *Child-friendly standards and guidelines for the recovery and integration of trafficked children*. Bangkok, Thailand: ILO.
- IOM (2007) *The IOM handbook on direct assistance to victims of trafficking*. Geneva: IOM. Available at: http://www.iom.int/jahia/webdav/site/myjahiasite/shared/shared/mainsite/published_docs/books/CT%20handbook.pdf
- IOM (2005a) *Identification and protection schemes for victims of trafficking in persons in Europe: tools and best practices*. Brussels, Belgium: IOM.
- IOM (2005b) *Resource Book for Law Enforcement Officers on Good Practices in Combating Child Trafficking*. Vienna, Austria: IOM and the Austrian Ministry of the Interior.
- Jordan, A. (2002) 'Human rights or wrongs? The struggle for a rights based response to trafficking in human beings'. In R. Masika (ed.) *Gender, Trafficking and Slavery*. Oxford, UK: Oxfam.
- Kvale, S. (1996) *Interviews: an introduction to qualitative research interviewing*. Thousand Oaks, California: Sage.
- Kvinna till Kvinna and Kvinnoforum (2003) *Evaluation of IOM Counter-Trafficking Programme in Western Balkans*, SIDA: Stockholm, Sweden.
- Kvinnoforum (2003) *European Good Practice on Recovery, Return and Integration of Trafficked Persons: A Study Commissioned by the Swedish Ministry of Forum Affairs*, Kvinnoforum: Stockholm, Sweden.
- La Strada Moldova (2005) *Good Practice of Assistance to Trafficked People*. Chisinau, Moldova: La Strada.

- La Strada Moldova & OSCE (2006) *Trafficking in Human Beings in Moldova: Normative Acts*. Chisinau, Moldova: La Strada & OSCE.
- Limanowska, B. (2002) *Trafficking in Human Beings in South-Eastern Europe: Current situation and responses to Trafficking in Human Beings in Albania, Bosnia and Herzegovina, Bulgaria, Croatia, the Former Yugoslav Republic of Macedonia, Moldova, Serbia and Montenegro, the UN Administered Province of Kosovo and Romania*, UNICEF, UNOHCHR and OSCE/ODIHR.
- Limanowska, B. (2003) *Trafficking in Human Beings in South-Eastern Europe: 2003 Update on Situation and Responses to Trafficking in Human Beings in Albania, Bosnia and Herzegovina, Bulgaria, Croatia, the Former Yugoslav Republic of Macedonia, Moldova, Serbia and Montenegro, the UN Administered Province of Kosovo and Romania*, UNICEF, UNOHCHR and OSCE/ODIHR.
- OSCE (2003) *OSCE Action plan to combat trafficking in human beings*. Vienna: OSCE. PC. DEC/557
- OSCE/ODHIR (2004) *National Referral Mechanisms: Joining Efforts to Protect the Rights of Trafficked Persons*, OSCE/ODHIR: Warsaw, Poland.
- Pearson, E. (2002) *Human traffic, Human Rights: Redefining Victim Protection*. London, UK: Anti-slavery International.
- Reiter, G. (2005) *Assessment on the situation of internal trafficking in Bosnia and Herzegovina*. Sarajevo, BiH: UNICEF & Office of the State Coordinator.
- Rosenberg, R. (2006) *Shelter assessment in Bosnia and Herzegovina*. Sarajevo, BiH: USAID.
- Somach, S. & R. Surtees, (2005) *Anti-Trafficking Programmes in Albania – an Evaluation*. Tirana, Albania: USAID.
- Surtees, R. (2008) 'Traffickers and trafficking in South and Eastern Europe: considering the other side of human trafficking'. *European Journal of Criminology, Special Issue on Organised Crime and Terrorism*.
- Surtees, R. (2007) *Labour Trafficking in SE Europe: Developing Prevention and Assistance Programmes*. Vienna: Nexus Institute.
- Surtees, R. (2006a) *An Evaluation of Victim Assistance Programmes in SE Europe*. Belgium, Brussels: King Baudouin Foundation.
- Surtees, R. (2006b) 'Child Trafficking: Different Forms of Trafficking and Alternative Interventions' *Tulane Journal of International & Comparative Law*. Vol. 14 (2).
- Surtees, R (2005) *Second annual report on victims of trafficking in South-Eastern Europe*. Geneva: IOM.
- Surtees, R. (2003) 'Cultural Factors and Trafficking' In R. Rosenberg (ed.) *Trafficking of Women and Children in Indonesia*. Jakarta, Indonesia: ICMC, ACILS & USAID.
- Surtees, R. (2000) *Cambodian women and violence: considering NGO interventions in cultural context*. Macquarie University, Sydney, Australia. Dissertation.
- Tdh & ARSIS. (2006) *Transnational Protection of Children: The Case of Albania and Greece 2000-2006*. Terre des hommes Foundation & ARSIS. Available at: http://www.childtrafficking.com/Docs/tdhfoundation_n_arsis06_ttpoc_tcoaag0006.pdf.

- Tdh (2005) *Child Trafficking in South-Eastern Europe: The Development of Good Practices to Protect Albanian Children*. Tdh. Available at: http://www.childtrafficking.com/Docs/tdh_2005_development_of_good_practices_to_protect_albanian_children_6.pdf
- Tozaj, D. (2006) *The state of efforts to combat trafficking of persons in Albania, 2005: An overview of government and civil society policies and programmes*. Tirana, Albania: Creative Associates and USAID.
- van der Kleij, A. (2003) *Provisions for Victims of Trafficking in Sexual Bonded Labour in six European countries*. The Netherlands: NOVIB & Humanitas.
- World Health Organization (WHO) (2003) *Ethical and safety recommendations for interviewing trafficked women*. Geneva: WHO.
- UNICEF (2005) *Guidelines of the Protection of the Rights of Child Victims of Trafficking, Updated 2005*. UNICEF: SEE.
- UNICEF (2004) *Trafficking in Children in Kosovo – A study on protection and assistance provided to children victims of trafficking*. Kosovo: UNICEF.
- Mitchels, B. (2004) *Let's talk: developing effective communication with child victims of abuse and human trafficking*. Kosovo: UNICEF & UNMIK.
- UNICEF & STC (2004) *Research on Child Trafficking in Bosnia and Herzegovina*. BiH: UNICEF & Save the Children-Norway.
- UNOHCHR (2002) *Recommended Principles and Guidelines on Human Rights and Human Trafficking*. New York: United Nations: E/2002/68/Add.1.
- Zimmerman, C. & C. Watts (2006) *Stolen Smiles: the physical and psychological health consequences of women and adolescents trafficked to Europe*. London, UK: London School of Hygiene and Tropical Medicine.